

Msc. Safinas Boksi (Boriçi)

# LIBRI I MËSUESIT

## Letërsia

11

Shtëpia Botuese & Shtypshkronja FILARA  
Tiranë, 2017



**Titulli i librit:**

LIBRI I MËSUESIT  
LETËRSIA 11

**BOTIME SHKOLLORE****Autore:**

Msc. Safinas Boksi (Boriçi)

**Redaktor gjuhësor:**

Msc. Merita Balliçi

**Arti grafik:**

Studio grafike **FILARA**

**Punoi:**

Gazmir Myteberi

**Botimi i parë FILARA**

Tiranë, 2017

© Shtëpia Botuese, **FILARA**

---

Shtypur në shtypshkronjën **FILARA**

**Adresa:**

Rruga "Sabaudin Gabrani"  
Ish - kombinati "Misto Mame"  
Tiranë

Tel: 04 222 88 71/ 04 225 88 01

Cel: 069 33 30 983

Cel: 069 66 99 693

E-mail: [filarabotime@yahoo.com](mailto:filarabotime@yahoo.com)

website: [www.filarabotime.com](http://www.filarabotime.com)

Librin e Mësuesit, Planin Mësimor mund ta shkarkoni në formatin Word, PDF falas nga faqja jonë e internetit [www.filarabotime.com](http://www.filarabotime.com)

*Për çdo paqartësi, kërkesë lidhur me librin e Mësuesit dhe librin e nxënësit LETËRSIA 11 mund të na telefononi apo të na shkruani në email dhe adresat e mësipërme.*

## **PËRMBAJTJA**

<b>I. PËRMBAJTJA</b>	<b>3</b>
<b>II. PLANI SINTETIK</b>	<b>4</b>
<b>III. PLANI ANALITIK</b>	<b>8</b>
<b>IV. PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE</b>	<b>26</b>
<b>V. KONTROLL NJOHURISH PËR ÇDO AUTOR (TEST 1-8)</b>	<b>167</b>

**PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA XI**  
**36 javë x 2 orë = 72 orë**

**FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**  
**LËNDA: LETËRSI**  
**PLANI MËSIMOR SINTETIK:**

	Përdorimi i orës mësimore	Orë	%
<b>A.</b>	<b>I. Njohuri të reja</b>	<b>54 orë</b>	<b>75 %</b>
<b>B.</b>	<b>II. Përpunimi i njohurive</b>	<b>18 orë</b>	<b>25 %</b>
<b>1.</b>	<b>Përsëritje</b>	<b>3 orë</b>	<b>16.6 %</b>
<b>2.</b>	<b>Testime</b>	<b>3 orë</b>	<b>16.6 %</b>
<b>3.</b>	<b>Projekte kurrikulare</b>	<b>4 orë</b>	<b>22.2 %</b>
<b>4.</b>	<b>Biseda letrare</b>	<b>2 orë</b>	<b>11.1 %</b>
<b>5.</b>	<b>Ese ose punë me shkrim</b>	<b>4 orë</b>	<b>22.2 %</b>
<b>6.</b>	<b>Dramatizime</b>	<b>2 orë</b>	<b>11.1 %</b>

Nr	Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
		Shtator – Dhjetor Orët 1-28	Janar–Mars Orët 29-52	Prill–Qershor Orët 53-72
1	<b>Teori letërsie 3 orë</b>	-Zhvillimi historik i gjinisë epike -Zhvillimi historik i gjinisë lirike -Zhvillimi historik i gjinisë dramatike		
2				
3				
4	<b>Romantizmi 2 orë</b>			
5				
6	<b>Johan Volfgang Gëte 5 orë</b>	-Romantizmi -Gëte dhe “Stuhi dhe vrull” -Jeta dhe veprat e -Johan Volfgang Gëtes -Analizë “Fausti” Fragment: Në studion e Faustit -Fragment: Vdekja e Faustit		
7				
8				
9				
10				
11	<b>Dramatizim</b>	Nga “Fausti “ Gëte		
12	<b>Bisedë letrare 1.2</b>	Libër nga lista e MAS-it		
13	<b>Bisedë letrare 2.2</b>			
14	<b>Projekt 1.4</b>	Planifikimi i projektit (ora e parë)		

## PLANI MËSIMOR SINTETIK

15	<b>Viktor Hygo 5 orë</b>	-Jeta dhe veprat e Viktor Hygosë -Analizë “Katedralja e Parisit” -Fragment: <i>Gungaçi i katedrales</i> -Fragment: <i>Shpëtimi i Esmeraldës</i> -Skedari i artit		
16				
17				
18				
19				
20	<b>Xhorxh Gordon Bajronit 5 orë</b>	-Jeta dhe veprat e Xhorxh Gordon Bajronit -Analizë “Shtegtimet e Çajld Haroldit” -Fragment: <i>Bajroni në Shqipëri</i> -Fragment: <i>Suliotët</i> -Koment “Suljotët” Bajroni Vazhdim (mjetet stilistike, elementet etnografik..)		
21				
22				
23				
24				
25	<b>Ese 1.4</b>	Ese përshkruese		
26	<b>Ese 2.4</b>	Ese përshkruese		
27	<b>Përsëritje 1.3</b>	Përsëritje mbi zhvillimin historik të gjinive, Gëte, Hygo , Bajroni		
28	<b>Testim 1.3</b>	Mbi zhvillimin historik të gjinive, Gëte, Hygo , Bajroni		
29	<b>Romantizmi shqiptar 1 orë</b>			
30	<b>De Rada 5 orë</b>		-Jeta dhe veprat e Jeronim de Radës -Analizë “Këngët e Milosaos” -Fragment: <i>Kënga II</i> -Fragment: <i>Kënga XII</i> -Fragment: <i>Kënga XXII</i> -Fragment: <i>Kënga XXX</i>	
31				
32				
33				
34				
35	<b>Projekt kurrikular 2.4</b>		Projekt kurrikular (ora II)	

36	<b>Naim Frashërit</b> <b>5 orë</b>		-Jeta dhe veprat e Naim Frashërit -Analizë "Lulet e verës" -Koment: <i>Fyelli</i> -Koment: <i>Koh' e shkuarë</i> -Koment: <i>Bukuria</i>	
37				
38				
39				
40				
41	<b>Realizmi</b> <b>2 orë</b>			
42				
43	<b>Honore de Balzak</b> <b>5 orë</b>		-Jeta dhe veprat e Honore de Balzak -Analizë "Xha Gorio" -Fragment: <i>"Biruca" e plakut Gorio</i> -Fragment: <i>Protesta e Gorioit</i> -Mendimi kritik për veprën "Xha Gorio" Balzak	
44				
45				
46				
47				
48	<b>Ese 3.4</b>		Ese argumentuese	
49	<b>Ese 4.4</b>		Ese argumentuese	
50	<b>Përsëritje 2.3</b>		Përsëritje mbi Romantizmin shqiptar, De Radën, N. Frashërin, Realizmin dhe Balzakun	
51	<b>Testim 2.3</b>		Mbi Romantizmin shqiptar, De Radën, N. Frashërin, Realizmin dhe Balzakun	
52	<b>Projekt 3.4</b>		Punë me projekt (ora III)	
53	<b>Gustav Flöberit</b> <b>5 orë</b>			-Jeta dhe veprat e Gustav Flöberit -Analizë "Zonja Bovari" -Fragment: <i>E para ditë pas dasmës</i> -Fragment: <i>Njohja me Leonin</i> -Fragment: <i>Rikthim</i>
54				
55				
56				
57				

**PLANI MËSIMOR SINTETIK**

58	<b>Fjodor Mihajloviç Dostojevskit 5 orë</b>			-Jeta dhe veprat e Fjodor Mihajloviç Dostojevskit -Analizë “Vëllezërit Karamazovë” -Fragment: <i>Përse rron një njeri si ky?</i> -Fragment: Rebelimi -Skeda e komentit: <i>Inkuizitori i madh</i> Skedari i kritikës
59				
60				
61				
62				
63	<b>Projekt 4.4</b>			Prezantimi i projektit ( ora IV )
64	<b>Letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XIX 1 orë</b>			
65	<b>Sharl Bodlerit 5 orë</b>			-Jeta dhe veprat e Sharl Bodlerit -Analizë “Lulet e së keqes” -Koment: <i>Albatrosi</i> -Koment: <i>Epilog</i> -Skedari i kritikës
66				
67				
68				
69				
70	<b>Prozat poetike: Interpretim</b>			Interpretim nga poezia e Bodlerit
71	<b>Përsëritje 3.3</b>			Flober, Dostojevski, Bodler
72	<b>Testim 3.3</b>			Flober, Dostojevski, Bodler

## PLANIFIKIMI VJETOR KOMPETENCAT PËR SECILIN TREMUJOR

### FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI LËNDA: LETËRSI XI

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë.

#### 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

##### Nxënësi:

- shprehet përmes një forme komunikimi për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material;
- diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;
- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë nga 3-5 paragrafë, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilin e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe në forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
- lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në një gjuhë të huaj ose në gjuhën amtare, të përbërë prej disa paragrafëve, si dhe tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së asaj gjuhe me gjuhën amtare;
- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me tre deri pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;
- shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të esesë;
- prezanton një projekt (artistik, humanitar, eksperimentues etj.) për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera;
- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënësit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.

#### 2. Kompetenca e të menduarit

##### Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e mbledhjes, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar;
- ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë dhe rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kritere të përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbrërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.



### 3. Kompetenca e të nxënësve

#### Nxënësi:

– demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënësve të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;

– shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore;

– përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;

– shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informacioni për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat, më pas, i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;

– kërkon dhe shfrytëzon në mënyrën e duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura;

– paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritshme (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepra artistike etj.);

– shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).

### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

#### Nxënësi:

– harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer përvojë, duke u konsultuar me të tjerët dhe duke i informuar ata, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;

– analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë) dhe pasojat e ndotjes; propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe ndërmerri zgjidhje konkrete;

– merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, komuniteti dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.); diskuton me të tjerët për procesin e organizimit dhe për rezultatet e arritura, si dhe jep argumente në formë të ndryshme shprehëse si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre dhe si të rritet pjesëmarrja në aktivitete.

### 5. Kompetenca personale

#### Nxënësi:

– analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat, përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;

– merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe menaxhon, në mënyrë konstruktive, emocionet e veta;

– ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

**6. Kompetenca qytetare****Nxënësi:**

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në lokal dhe në nivel shtetëror); tregon, gjatë diskutimit, tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

**7. Kompetenca digjitale****Nxënësi:**

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet paraqitjeve filmike apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

## KOMPETENCAT E LËNDËS “LETËRSI” PËR KLASËN XI

### I. KOMPETENCA: ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TEKSTEVE TË GJINIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME LETRARE

#### Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

##### Nxënësi:

- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti;

- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.;

- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik si: trajtimi i temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analiza e marrëdhënieve mes personazheve etj.;

- dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare.

#### • Njohuritë

##### Zhvillimi historik i gjinive letrare

– Zhvillimi historik i gjinisë epike.

– Zhvillimi historik i gjinisë lirike.

– Zhvillimi historik i gjinisë dramatike

##### Elementet e tekstit letrar

– Fabula, subjekti.

– Personazhet.

– Tema dhe motivet e veprës letrare.

– Mjedisi, koha dhe atmosfera.

– Stili dhe gjuha.

#### • Shkathësitë

##### Teoria e letërsisë. Zhvillimi historik i gjinive letrare.

##### Nxënësi:

• dallon tipare të gjinive

• zbulon zhvillimin e gjinive letrare në këndvështrimin historik

• klasifikon gjinitë sipas llojeve dhe nënllojeve

• evidenton tiparet kryesore të gjinive letrare

• analizon elemente të analizës së teksteve të këtyre gjinive.

##### – Fabula dhe subjekti

##### Nxënësi:

– tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;

– përcakton fabulën e një teksti;

– dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të një teksti;

– dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre;

– dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;

– analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;

– përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori (p.sh., një tregim është shkruar në formën e një letre, në një novelë jepen ngjarjet në rend kronologjik etj.).

**a. Personazhet****Nxënësi:**

- analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;
- shpjegon rolin dhe qëllimet e personazheve;
- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;
- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;
- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, kryesorë, dytësorë);
- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;
- analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.

**b. Mjedisi, koha dhe atmosfera****Nxënësi:**

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

**c. Tematika****Nxënësi:**

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;
- demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.

**d. Stili dhe gjuha****Nxënësi:**

- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.:
  - gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve);
  - përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.);
  - muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);
  - rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë);
  - toni (i gjallë, i zyrtë, i ngrohtë, solemn);
  - gjatësia e fjalive, elipsa, asindetit etj.;
- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.

**Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror****Nxënësi:**

- demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;
- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.

**Lidhja mes tekstit dhe lexuesit****Nxënësi:**

- tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;
- tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.

### Reflektimi ndaj tekstit

#### Nxënësi:

- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;
- reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;
- shprehhet, në mënyra të ndryshme, për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.

#### Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve

##### Nxënësi:

- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;
- organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).

#### • Vlerat dhe qëndrimet

##### Nxënësi:

- komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët;
- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;
- respekton mendimin e të tjerëve;
- demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;
- ndërmerr iniciativë dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënit;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- kritikon duke u mbështetur mbi argumente;
- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.

## II. KOMPETENCA: VLERËSIMI I LETËRSISË SHQIPE DHE BOTËRORE NË PERIUDHA TË NDRYSHME LETRARE

### Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

#### Nxënësi:

- analizon tiparet kryesore të letërsisë Romantike, Romantizmit shqiptar, të Realizmit dhe Simbolizmit; përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues;
- analizon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit, simbolizmit; përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues;
- krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore;
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.

**PLANIFIKIMI 3-MUJOR**  
**SHTATOR-DHJETOR ( 28 orë )**

NR.	TEMATIKA	ORË	TEMAT MËSIMORE	SITUATAT E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETE MËSIMORE
1	Teori letërsie 3 orë	1	Zhvillimi historik i gjinisë epike	Diskutim në lidhje me epikën, rrefehet një ngjarje. Bisedë për historinë e zhvillimit të epikës.	Bashkëbisedim; Klaster; Përmbledhje e strukturuar; Plotësim të dhënash.	Vlerësim diagnostikues; Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm): për mënyrën se si e studiojnë informacionin dhe se si e paraqesin atë; Vlerësim për punën individuale, në lidhje me saktësinë e informacionit shkencor; Vlerësim pa notë, por motivues, për nxënësit që aktivizohen.	Teksti shkollor Tekst nga Vedat Kokona Tekste tregimtare Tabela Shkumësia
2		2	Zhvillimi historik i gjinisë lirike	Diskutim në lidhje me poezinë lirike; Heroin lirik, ngarkesa emocionale; Bisedë për historinë e zhvillimit të gjinisë lirike.	Përvijim i të menduarit; Klaster; Insert; Plotësim të dhënash; Punë në grupe.	Vlerësim i nxënësit për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor; b) aftësinë e secilit nxënësit për të kombinuar, harmonizuar dhe paraqitur saktë punën në grup dhe punën në dyshe (3-4 nxënësit vlerësohen me notë).	Teksti shkollor Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, mjetet stilistike Tekste poezish Tabela Shkumësia
3		3	Zhvillimi historik i gjinisë dramatike	Bisedë për dramën dhe pjesët dramatike, teatrin, një pjesë teatrale që u ka pëlqyer dhe historinë e zhvillimit të këtij teksti.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Klaster; Përmbledhje e strukturuar; Punë në grupe.	Vlerësim për punën në grupe, për mënyrën se si e studiojnë informacionin dhe se si e paraqesin atë; Vlerësim për punën individuale, në lidhje me saktësinë e informacionit shkencor.	Teksti mësimor Përvoja e nxënësve Projektor Audio Tekste dramatike
4	Romantizmi 2 orë	1	Zhvillimi i Romantizmit (Ora I)	Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për epokën e Romantizmit.	Stuhi mendimesh, Përmbledhje e strukturuar, Harta e epokës.	Vlerësim për saktësinë e informacionit shkencor (1-2 nxënësit vlerësohen me notë).	Teksti shkollor Tekste letrare Tabela Shkumësia
5		2	Veçoritë e Romantizmit (ora II)	Analizon veçoritë dhe pamjet estetike të romantizmit;	Di/Dua të di/Mësova; Përmbledhje e strukturuar; Insert; Ditari dy pjesësh.	Vlerësohet aftësia e secilit nxënësit për të paraqitur saktë punën në grup (3-4 nxënësit vlerësohen me notë).	Teksti shkollor Tekste letrare Tabela Shkumësia

## PLANI MËSIMOR ANALITIK

6	6	Johan Volfgang Gëte 5 orë	1	Romantizmi Gëte dhe "Stuhi dhe vrull"	Diskuton rreth lëvizjes "Stuhi dhe vrull", përfaqësuesit e saj dhe rëndësia për epokën. Veçoritë dhe roli i Gëtes.	Dëgjim i drejtuar; Stuhi mendimesh; Përmbledhje e strukturuar; Harta e lëvizjes.	Vlerësim i punës së pavarur individuale; Vlerësim motivues dhe pa notë.	Teksti mësimor Informacione të sjella nga nxënësit
7	7	Jeta dhe veprat e -Johan Volfgang Gëtes	2	Jeta dhe veprat e ndikimin e personalitetit të Gëtes dhe rëndësinë e krijimtarisë së tij si paraprrijës i Romantizmit.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Bisedë; Punë në grupe; Punë e udhëhequr.	Vlerësim individual; Vlerësim i punës me grupe; Vlerësohen për paraqitjen e saktë të informacionit shkencor.	Teksti shkollor Tabela apo flipchart Interneti Biblioteka.	
8	8	Analizë "Fausti" Gëte	3	Në video-projektor shfaqen disa sekuenca nga tragjedia e Gëtes "Fausti".	Vëzhgim filmi; Diskutim mbi njohuritë paraprake; Harta e ngjarjes; Klaster; Punë në grupe; Pesëvargësh.	Vlerësim për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor; b) aftësinë e secilit nxënësit për të kombinuar, harmonizuar dhe paraqitur saktë punën në grup (3-4 nxënësit vlerësohen me notë).	Teksti shkollor Video-projektor Flipchart Tabela e zezë <a href="https://www.youtube.com/watch?v=8-8keXo_ygl">https://www.youtube.com/watch?v=8-8keXo_ygl</a>	
9	9	Fragment: Në studion e Faustit	4	Interpretim i monologut të Faustit "Natë".	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Lexim shprehës; Praktikë e udhëhequr; Punë e pavarur në grupe; Organizues grafik për reagim letrar.	Vlerësim individual; Vlerësohet marrëdhënia e anëtarëve të grupeve me njëri-tjetrin; Vlerësohet saktësia e paraqitjes së materialit.	Teksti mësimor Veprat letrare Skeda Kartonë Fletë formati	
10	10	Fragment: Vdekja e Faustit	5	Interpretim me role i fragmentit.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Grupet e ekspertëve me role të specializuara; Korniza të skeletizuara.	Vlerësim i vazhdueshëm me gojë mbi progresin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathësie që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Disa nxënësit vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxitin për të realizuar punë cilësore, me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi.	Teksti shkollor Skeda Kartonë Fletë formati Korniza të skeletizuara	
11	11	Dramatizim nga "Fausti"	1	Dramatizim i një fragmenti.	Dramatizim i fragmenteve të përzgjedhura nga vepra "Fausti".	Nxënësit vlerësohet për interpretimin e realizuar.	Teksti mësimor	

12	12	1	Bisedë letrare	Çfarë përfituam nga ky libër?	Bashkëbisedim; Diskutime në grup.	Vlerësim në grup dhe vlerësim individual.	Libër nga lista e MAS-it.
13	13	2	Bisedë letrare				
14	14	1	<b>Planifikimi i projektit (ora e parë)</b>	Për çfarë mund të bëjmë një projekt.	Stuhi mendimesh; Kllastër; Punë me grupe.	Vlerësohen për mënyrën e paraqitjes së ideve dhe nivelin e bashkëpunimit	Teksti mësimor
15	15	1	<b>Viktor Hygo 5 orë</b>	Bisedë rreth romantizmit dhe Hygo si një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm.	Stuhi mendimesh; Përmbledhje e strukturuar; Lexim i pavarur /Kllastër; Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i punës së pavarur individuale; Vlerësim për punën individuale dhe punën në grup; Vlerësim për paraqitjen saktë të punës së kërkuar.	Teksti mësimor Video-projektor Tabela apo flipchart Internet
16	16	2	<b>Analizë "Katedralja e Parisit"</b>	Sekuenca filmike të përzgjedhura nga Katedralja e Parisit.	Vëzhgim filmi; Diskutim mbi njohuritë paraprake; Lexim në dyshe; Praktike e udhëhequr.	Vlerësim individual (i diferencuar); Vlerësohet harmonizimi i punës në dyshe, me njëri-tjetrin dhe cilësia e informacionit.	Teksti mësimor Veprat letrare Flipchart ose tabela Videoprojektor Skeda personazhesh Interneti
17	17	3	<b>Fragment: Gungaçi i katedrales</b>	Si e përshkruajnë Kuazimodon, pamja, karakteri etj.	Teknikat e të pyeturit; Praktike e udhëhequr; Punë e pavarur në grupe; Shkrim i lirë.	Vlerësim individual; Vlerësohet marrëdhënia e anëtarëve të grupeve me njëri-tjetrin; Vlerësohet saktësia e paraqitjes së materialit.	Teksti mësimor Veprat letrare Interneti Skeda Kartonë Fletë formati
18	18	4	<b>Fragment: Shpëtimi i Esmeraldës</b>	Filmi "Katedralja e Parisit", fragmenti në vazhdim.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Praktike e udhëhequr; Punë e pavarur në grupe; Diskutim.	Vlerësim individual; Vlerësohet marrëdhënia e anëtarëve të grupeve me njëri-tjetrin; Vlerësohet saktësia e paraqitjes së materialit.	Teksti mësimor Veprat letrare Interneti Skeda Kartonë Fletë formati
19	19	5	<b>Skedari i artit. Dramatizim.</b>	Ç'është skeda e komentit? Elementë të epikës, dramës në vepër. (Lojë me role-dramatizim)	Dramatizim i fragmenteve të përzgjedhura nga vepra "Katedralja e Parisit".	Vlerësohet puna në grupe; Vlerësim individual; Vlerësohen për mënyrën e saktë të paraqitjes së punës.	Teksti mësimor Skeda për komente



## PLANI MËSIMOR ANALITIK

20	20	Xhorxh Gordon Bajronit 5 orë	1	Jeta dhe veprat e Xhorxh Gordon Bajronit	Diskutim për jetën e Bajronit, udhëtimet në vendet e mesdheut.	Stuhi mendimesh; Organizues grafik; Shkrim i lirë.	Vlerësim në dyshe (mënyra se si i harmonizojnë punët, si e plotësojnë dhe e korrigjojnë njëri-tjetrin); Vlerësim individual.	Teksti mësimor Video-projektor Foto Tabela ilustruese
21	21		2	Analizë "Shtegtimet e Çajlid Haroldit"	Recitohen vargje nga poema. Foto nga Bajroni	Diskutim mbi njohuritë paraprake: Interpretim; Harta e ngjarjes.	Vlerësim individual; Vlerësim në grupe; Vlerësohen për paraqitjen e saktë të informacionit shkencor.	Teksti mësimor Interneti Tabakë Kartonë Fletë formati
22	22		3	Fragment: Bajroni në Shqipëri	Recitohen vargje nga poema. Foto nga Bajroni.	Kllastër; Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD); Punë në grupe; Diskutim.	Vlerësim për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor; b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar, harmonizuar dhe paraqitur saktë punën në grup (3-4 nxënës vlerësohen me notë).	Teksti mësimor Harta e Shqipërisë Interneti
23	23		4	Fragment: Sullfotët	Studiuesi Moikom Zeqo mbi Bajronin, referuar dy vargjeve të para të fragmentit.	Diskutim; Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD); Punë e udhëhequr në grupe.	Vlerësim për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor; b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar, harmonizuar dhe paraqitur saktë punën në grup (3-4 nxënës vlerësohen me notë).	Teksti mësimor Tabela e zezë ose flipchart.
24	24		5	Koment "Sullfotët" Bajroni Vazhdim (mjetet stilistike, elementet etnografike, interpretim)	Lexim dhe demonstrim në klasë i materialeve të sjella nga nxënësit për veshjen e Jugut, foto etj.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD); Diskutim.	Vlerësimi i nxënësve në mënyrë individuale dhe për punën në dyshe.	Teksti mësimor Interneti Vepra letrare Dërrasa e zezë
25	25	Ese 1.4	1	Ese	Punë me shkrim	Shkrimi paraprak; Strukturimi; Redaktim,	Vlerësim individual	Teksti mësimor Format esesh Libri Si të shkruajmë një ese? B.Musai
26	26	Ese 2.4	2	Ese	Punë me shkrim	Korrektrim; Shkrimi përfundimtar; Vetëvlerësim.	Vlerësim individual	Teksti mësimor Format esesh Libri Si të shkruajmë një ese? B.Musai

27	Përsëritje 1.3	1	Përsëritje	Diskutim	Vlerësim individual motivues; Vlerësim i punës në grupe.	Vlerësim individual; Vlerësim në grup.	
28	Testim 1.3	1	Testim (tremujori i parë)	Punë me shkrim	Vlerësim individual	Vlerësim individual	Teksti mësimor Format A4

**PLANIFIKIMI 3-MUJOR JANAR-MARS ( 24 orë )**  
**FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIIMI**  
**LËNDA: LETËRSI XI**

NR.	NR. periudha	TEMATIKA	ORË	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
29	1	Romantizmi shqiptar 1 orë	1	Romantizmi shqiptar	Bisedë rreth njohurive që kanë nxënësit për Romantizmin në Shqipëri.	Punë e drejtuar; Kllastër Pema e mendjes; Ditarët e të nxënëtit; Punë në grupe; Diagramë Veni.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve	Teksti shkollor Teksti letrar Dërrasa e zezë
30	2	Jeronim De Rada 5 orë	1	Jeta dhe veprat e Jeronim de Radës	Bisedë mbi të veçantat e jetës së De Radës.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Stuhi mendimesh; Punë në grupe; Shkrim i lirë.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve	Teksti mësimor Tabela e zezë Tabela apo flipcharti Interneti Biblioteka
31	3	Analizë "Këngët e Milosaos"	2	Përmbledhje e subjektit të Milosaos.	Përmbledhje e subjektit të Milosaos.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Praktikë e udhëhequr; Punë në grupe; Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për pjesëmarrjen aktive në mësim, për argumentet që ndërton, për saktësinë e përgjigjeve dhe mendimin kritik.	Teksti mësimor, vepra letrare
32	4	Studim teksti. Fragment: <i>Kënga II</i>	3	Interpretim i këngës	Teknika e të pyeturit; Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD); Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.	Teksti mësimor Veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës) Interneti	

PLANI MËSIMOR ANALITIK

33	5	4	<b>Studim teksti.</b> <b>Fragment: Kënga XII</b>	Interpretim i këngës	Diskutim mbi njohuritë paraprake;  Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD); Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për detyrën e shtëpisë, rolin në grup, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, analizat dhe interpretimet.	Teksti mësimor Tabela e zezë ose flipcharte Biblioteka e shkollës Interneti
34	6	5	<b>Studim teksti.</b> <b>Fragment: Kënga XXII, Kënga XXX</b>	Interpretim i këngës	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Interpretim; Teknika e të pyeturit; Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD); Punë në grupe.	Nxënësi vlerësohet për detyrën e shtëpisë, rolin në grup, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, argumentet, analizat dhe interpretimet.	Teksti shkollor Veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës) Interneti
35	7	2.4	<b>Projekt kurrikular ora II</b>	Pyes nxënësit: A kanë hasur vështirësi në gjetjen e materialeve?	Bashkëbisedim; Diskutim në grupe.	Nxënësit stimulohen për objektivat e realizuara dhe inkurajohen për realizimin e objektivave të tjera.	Botime akademike enciklopedike Video Albume me fotografi
36	8	1	<b>Jeta dhe veprat e Naim Frashërit</b>	Bisedë mbi njohuritë e nxënësve për Naim Frashërin.	Stuhi mendimesh; Organizues grafik; Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.	Teksti mësimor Video-projektor Tabela apo flipchart Internet
37	9	2	<b>Analizë "Lulet e verës"</b>	Interpretoj vargje nga vëllimi "Lulet e verës".	Diskutim mbi njohuritë paraprake, Pema e mendjes, Diskutim, Praktikë e udhëhequr	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.	Teksti mësimor Tabela apo flipchart Interneti Biblioteka
38	10	3	<b>Koment: Fylli</b>	Interpretim i poezisë "Fylli".	Diskutim për njohuritë paraprake; Lexim shprehës; Veprimtari e leximit të drejtuar; Punë e udhëhequr.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, Pyetjet dhe përgjigjet që formulon, rolin në grup	Teksti mësimor Interneti Vepra artistike

39	11	4	<b>Koment: Koh' e shkuarë</b>	Ç'ndjesi ju jep titulli i poezisë?	Diskutim për njohuritë paraprake; Lexim shprehës; Veprimtari e leximit të drejtuar; punë e udhëhequr.	Nxënësi vlerësohet cilësinë e informacioneve të përzgjedhura, pyetjet dhe përgjigjet, pjesëmarrjen në punën në grup.	Teksti mësimor Interneti Vepra letrare
40	12	5	<b>Koment: Bukuria</b>	Ç'dini për dashurinë platonike?	Diskutim për njohuritë paraprake; Klaser; Veprimtari e leximit të drejtuar; Punë e udhëhequr.	Nxënësi vlerësohet për mendimet e sakta, rolin aktiv në grup, pjesëmarrjen në diskutim dhe argumentet që jep në mbrojtje të mendimit dhe pozicionit që mban.	Teksti mësimor Interneti Vepra letrare
41	13	1	<b>Realizmi ora I</b>	Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për realizmin.	Stuhi mendimesh; Di/Dua të di/Mësova; Grupet e ekspertëve; Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.	Teksti shkollor Tekste letrar Dërrasa e zezë
42	14	2	<b>Realizmi, parimet , veçoritë ora II</b>	Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për realizmin.	Diskutim mbi njohuritë paraprake, Pema e mendjes, Ditari tripjesësh, Vëzhgim dhe diskutim	Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.	Teksti shkollor Tekste letrare
43	15	1	<b>Jeta dhe veprat e Honore de Balzak</b>	Diskutim për jetën e Balzakut.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Stuhi mendimesh; Ditari dypjesësh; Korniza të skeletëzuara të mësimt.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave. Për Kornizën e skeletëzuar të mësimt:	Teksti shkollor Foto Tabela ilustruese

## PLANI MËSIMOR ANALITIK

44	16	2	<b>Analizë "Xha Gorio"</b>	Diskutohet mbi rolin e familjes si bërthama e shoqërisë njerëzore.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Harta e ngjarjes; Punë në grupe; Pesëvargësh.	Nxënësi vlerësohet për analizën që i bën elementeve të rrëfimit të veprës, për përgjigjet e dhëna gjatë mësimit, për pjesëmarrjen aktive në mësim.	Teksti mësimor Tabela Interneti
45	17	3	<b>Fragment: "Biruca" e plakut Gorio</b>	Nxënësit pasi kanë lexuar fragmentin, diskutohet mbi situatën e fragmentit Biruca.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Praktikë e udhëhequr; Punë e pavarur në grupe; Shkrim i lirë.	Nxënësi vlerësohet për interpretimin artistik, për përgjigjet e dhëna gjatë mësimit, për pjesëmarrjen aktive në mësim.	Teksti mësimor Interneti Skeda, kartonë Fletë formati
46	18	4	<b>Fragment: Protesta e Gorioit</b>	Sa e rëndësishme është familja, dashuria për prindin etj.	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Praktikë e udhëhequr; Punë e pavarur në grupe; Punë e udhëhequr.	Nxënësi vlerësohet për analizën e personazhit, përgjithësimet morale, për pjesëmarrjen në mësim, për formulimin e përgjigjeve.	Teksti mësimor Interneti Skeda, kartonë Fletë formati
47	19	5	<b>Mendimi kritik për veprën "Xha Gorio" Balzak</b>	Diskutim në lidhje me familjen, kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore, respektin e fëmijëve ndaj prindërve.	Diskutim për njohuritë paraprake; Interpretim i fragmentit; Diskutim; Korniza të skeletëzuara.	Nxënësi vlerësohet për detyrën e shtëpisë, rolin në grup, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, analizat dhe interpretimet.	Teksti mësimor Interneti Fjalë të urta
48	20	3.4	<b>Ese letrare</b>	Punë me shkrim	Bashkëbisedim, shkrim i lirë	Nxënësit stimulohen me gojë për kapjen e temës, strukturën e esesë, gjuhën eseistike.	Teksti mësimor <i>Si të shkruajmë një ese</i> B.Musai
49	21	4.4	<b>Ese letrare</b>	Punë me shkrim	Redaktim, lexim i punimeve	Nxënësi vlerësohet për gjykimet që bën për veprat letrare apo autorin, strukturën, stilin vetjak.	Teksti mësimor <i>Si të shkruajmë një ese,</i> B.Musai

50	22	Përsëritje	2.3	Përsëritje	Ç'kemi mësuar gjatë periudhës së dytë?	Diskutim me grupe	Nxënësi vlerësohet cilësinë e informacioneve të përzgjedhura, pyetjet dhe përgjigjet, pjesëmarrjen në punën në grup.	Teksti mësimor
51	23	Test	2.3	Testim (tremujori i dytë)		Test i strukturuar		Teksti mësimor, Formate A4
52	24	Projekt	3.4	Projekt kurrikular (ora III) Përpunimi i materialeve.	Pyetje për nxënësit: A jeni të kënaqur me punën e realizuar në grup?	Diskutime në grup dhe diskutime individuale	Nxënësi vlerësohet për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.	Dosja e projektit

**PLANIFIKIMI 3-MUJOR PRILL - QERSHOR ( 20 orë)**  
**FUSHA : GJUHËT DHE KOMUNKIMI**  
**LËNDA: LETËRSI XI**

NR.	Tematika	ORË	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
53	1 Gustav Flobor 5 orë	1	Jeta dhe veprat e Gustav Floborit	Bisedë mbi të veçantat e jetës së Floborit.	Stuhi mendimesh, Diskutim mbi njohuritë paraprake; Organizues grafik; Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.	Teksti mësimor Tabela apo flipchart Interneti
54	2 Analizë "Zonja Bovari"	2		Diskutim: Ema Bovari e parakohëshme	Diskutim mbi njohuritë paraprake; Hartën e ngjarjes; Punë në grupe; Diskutim.	Nxënësi vlerësohet për saktësinë e përgjigjeve, fjalorin e përdorur, rolin në punën në grup, argumentet dhe shembujt që sjell për çështjet që ngrihen.	Teksti shkollor, Tabakë Skeda Kartonë Interneti

55	3	3	<b>Fragment: Ditët pas dasmës</b>	Diskutohet mbi bovarizmin	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Punë në grupe; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për saktësinë e përgjigjeve, fjalorin e përdorur, rolin në punën në grup, argumentet dhe shembujt që sjell për çështjet që ngrihen.	Teksti mësimor Interneti Tabela
56	4	4	<b>Fragment: Njohja me Leonin</b>	Si gjykoni me veprimet e Emës	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Praktikë e udhëhequr; Punë në grupe; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për njohuritë që demonstroi për veprën, saktësinë e përgjigjeve, saktësinë në krahasimin mes personazheve, ilustrimet e goditura nga fragmenti dhe nga vepra, imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.	Teksti mësimor Skeda e rrefimit të ngjarjes
57	5	5	<b>Fragment: Rilikthim</b>	Si gjykoni me veprimet e Emës	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Teknikat e pyetjes; Hapësira e fjalës; Nxjerrja e përfundimeve.</b>	Nxënësi vlerësohet për njohuritë që demonstroi për veprën, saktësinë e përgjigjeve, saktësinë në krahasimin mes personazheve, ilustrimeve të goditura nga fragmenti dhe nga vepra, imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.	Teksti mësimor Interneti Skeda Kartonë
58	7	1	<b>Jeta dhe veprat e Fjodor Mihajloviç Dostojevski</b>	Bisedë mbi të veçantat e jetës së Dostojevskit.	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Klaster; Ditari i të nxënëtit; Vendosje.</b>	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.	Teksti mësimor Tabela ilustruese Foto
59	7		<b>Analizë "Vëllezërit Karamazovë"</b> Dostojevski	Diskutim rreth veprës	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Hartën e ngjarjes; Punë në grupe; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për leximin e veprës "Vëllezërit Karamazovë" dhe plotësimin e saktë të rubrikave të hartës së ngjarjes, analizës së personazheve, duke ilustruar me shembuj nga vepra.	Teksti mësimor Tabela apo flipchart Interneti Biblioteka
60	8	3	<b>Fragment: Përse rron një njeri si ky?</b> Dostojevski	Lexohet përmbledhja e pjesës së parë të fragmentit.	<b>Stuhi mendimesh; Praktikë e udhëhequr; Punë në grupe; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.	Teksti mësimor Biblioteka Interneti Skeda, Kartonë Bioskeda personazhesh

61	10	4	<b>Fragment: Rebelimi</b>	Diskutohet mbi fragmentin.	<b>Stuhi mendimesh; Grupe ekspertësh; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën.	Teksti mësimor Video-projektor Flipchart Tabela e zezë
62	11	5	<b>Skeda e komentit: Inkuizitori i madh</b> <b>Skedari i kritikës</b>	Diskutohen fragmentet e fundit.	<b>Diskutim për njohuritë paraprake; Interpretim i fragmentit; Diskutim; Korniza të skeletëzuara.</b>	Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën. Kornizën e skeletëzuar	Teksti mësimor Skeda Kartonë Fletë formati
63	11	4.4	<b>Projekt kurrikular (ora IV) Prezantimi final.</b>	Prezantimi gjuhësor dhe jogjuhësor	Prezantime individuale e në grup, interpretime.	Vlerësohet prezantimi në grup dhe ai individual.	Materiali i përgatitur Video-projektor
64	12	1	<b>Letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XIX</b> <b>1 orë</b>	Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për letërsinë e kësaj periudhe.	<b>Stuhi mendimesh; Lexim i imët me kodim teksti; Pema e mendjes; Ditari dy pjesësh; Vëzhgim dhe diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për imagjinatën e tij, për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre, për përmbledhjen dhe sqarimin e informacionit.	Teksti mësimor
65	13	1	<b>Jeta dhe veprat e Sharl Bodëlerit</b>	Bisedë mbi të veçantat e jetës së Bodëlerit dhe poezisë simboliste.	<b>Interpretim; Diskutim mbi njohuritë paraprake; Punë në grupe; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.	Teksti mësimor Tabela apo flipchart Interneti Biblioteka
66	14	2	<b>Analizë "Lulet e së keqes"</b>	Interpretoj vargje nga vëllimi "Lulet e së keqes"	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Të nxënit me këmbime; Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për leximin e vëllimit "Lulet e së keqes", veçorive të simbolizmit, figurat letrare etj.	Teksti mësimor Tabela ilustruese
67	15	3	<b>Koment: Albatrosi</b>	Interpretim i poezisë	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Interpretim; Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD); Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për detyrat e shtëpisë, leximin aktiv të tekstit, për saktësinë e përgjigjeve.	Teksti mësimor Interneti



68	16	4	<b>Koment: Epilog</b>	Interpretim poezie	<b>Diskutim mbi njohuritë paraprake; Interpretim; Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD); Diskutim.</b>	Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.	Teksti mësimor Tabela Teksti letrar
69	17	5	<b>Skedari i kritikës</b>	Dramatizim i një fragmenti.	<b>Bashkëbisedim; Interpretim; Diskutim; Shkrim i lirë.</b>	Nxënësi vlerësohet për Interpretimin e realizuar. Bisedat rreth vlerësimit të veprës së Bodlerit.	Teksti mësimor
70	18	<b>Prozat poetike: Interpretim</b>	<b>Interpretim proza poetike nga Bodler.</b>	Interpretim poezie	Interpretim me poezi të zgjedhura nga Bodleri.	Nxënësi vlerësohet për Interpretimin e realizuar.	Teksti mësimor
71	19	<b>Përsëritje</b>	<b>Përsëritje</b>	Leximi dhe prezantimi i shkrimit përmbledhës vetëvlerësues.	Bashkëbisedim; Punë e pavarur me shkrim.		Teksti mësimor
72	20	<b>Testim</b>	<b>Testim (tremujori i tretë)</b>		Punë me shkrim		Teksti mësimor, format A4

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Zhvillimi historik i gjinisë epike</b>			
<b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave lëndore sipas temës së mësimet :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon tipare të gjinisë epike</li> <li>zbulon zhvillimin e gjinisë epike në këndvështrimin historik</li> <li>klasifikon gjininë epike sipas llojeve dhe nënlojeve</li> <li>evidenton tiparet kryesore të gjinisë epike</li> <li>analizon elemente të analizës së teksteve të gjinisë epike</li> <li>krahason romanin tradicional me atë modern</li> <li>komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët</li> <li>përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>epikë, poemë epike, miti</li> <li>elemente rrëfimi</li> <li>personazhe</li> <li>subjekt, fabul</li> <li>koha artistike</li> <li>hapësira</li> <li>rrëfimtari</li> <li>tematika</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Tekst nga Vedat Kokona</li> <li>Tekste tregimtare</li> <li>Tabela</li> <li>Shkumësa</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Qytetari	<b>Situata e të nxëniet:</b> Diskutim në lidhje me epikën, rrëfhet një ngjarje,		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- <i>Bashkëbisedim, kllaster, përmbledhje e strukturuar, plotësim të dhënash.</i></b>			

## Organizimi i orës së mësimet

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme*****Bashkëbisedim:***

Mësimi fillon me bashkëbisedim mes mësuesit dhe nxënësve lidhur me epiken si gjini letrare, veçoritë e saj, dallimin me gjinitë e tjera dhe vlerësimin që kanë për të. Biseda zhvillohet mbi bazën e pyetjeve dhe komenteve personale.

*Cilat janë gjinitë letrare?*

*Mbi ç'baza bëhet kjo ndarje ?*

*Çfarë e dallon epiken ?*

*Veçoni disa karakteristika të saj ?*

*A mbani mend vepra që i përkasin llojeve të ndryshme të epikës ? Mbani mend lloje të epikës ?*

**B. Ndërtimi i njohurive të reja*****Kllaster: Mbajtja e strukturuar e shënimeve:***

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin brenda një kohe të caktuar dhe të punojnë në dyshe gjatë leximit të informacionit. Nxënësit zgjedhin vetë mënyrën se si do ta përmbledhin informacionin sipas udhëzimeve që mund t'u japë mësuesja apo aftësive të tyre për të përmbledhur. Shënimet në këtë rast mund të kenë formën e skedimit sipas teknikës pyetje-përgjigje.

- Prezantohen çështjet në tabelë dhe shpjegohet në mënyrë të strukturuar: ç'është **epika**, si ka lindur dhe si është zhvilluar ajo?

- Pasqyrohet në tabelë një kllaster me veçoritë e epikës dhe llojet e saj.



## Mbajtja e strukturuar e shënimeve:

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin brenda një kohe të caktuar dhe të punojnë në dyshe gjatë leximit të informacionit. Nxënësit zgjedhin vetë mënyrën se si do ta përmbledhin informacionin sipas udhëzimeve që mund t’u japë mësuesja apo aftësive të tyre për të përmbledhur. Shënimet në këtë rast mund të kenë formën e skedimit sipas teknikës pyetje-përgjigje.

Pasi bëhet skematizimi i mëposhtëm në tabelë shpjegohen nëndarjet e epikës duke nxitur nxënësit të ilustronjë me shembuj.

### Gjinia epike dhe llojet e saj

-Veprat epike, për nga mënyra e organizimit të gjuhës, shfaqen të shkruara në vargje, si poezi dhe të shkruara në prozë.

-Veçoria dalluese kryesore e tyre është rrëfimi për ngjarjet. Prej kësaj vjen dhe emri i gjinisë epike: në greqishten e vjetër *epos* do të thotë *fjalë, rrëfim*.

Ka *subjekt si zinxhir ngjarjesh*, ku personazhet shfaqin karakteret e veta.

-Rrëfimi për ngjarjet bëhet nga vetë autori ose (pjesërisht) nga personazhet.

-Luajnë një rol të rëndësishëm edhe përshkrimet e natyrës, të mjedisit ku jetojnë personazhet, si dhe gjendja e tyre shpirtërore.

### Disa nga llojet kryesore të epikës janë:

- poema epike
- miti, legjenda, përralla
- tregimi, novela
- romani

Organizohet në poezi

Organizohet në prozë

**Poema epike**

Është një vepër me karakter rrëfimtari, e shkruar në vargje, që ka përmasa të gjera dhe që trajton tema të rëndësishme, ngjarje të mëdha historike. Përmendim: *Gilgameshin* (e letërsisë sumero-babilonase), poemat *Mahabharata* dhe *Ramajana* (të letërsisë induse), *Iliada* dhe *Odisea* (të letërsisë greke). Tek *Iliada* tregohet lufta greko-trojane, tek *Eneida* formimi i popullit të ri latin.

**Poema liriko-epike**

Është një krijim i gjatë në vargje ku elementi lirik (meditimet e heroit lirik) ndërthuren me atë epik (rrëfimtari)

**Veçori:** gjuha poetike lakonike, përdorimi i figurave stilistike, larmi e formave të ligjërimit artistik.

Përmendim poemën *Bagëti e bujqësi* e N. Frashërit

**Poema liriko-epike** është një krijim i gjatë në vargje ku elementi lirik (meditimet e heroit lirik, ndjenjat e tij) ndërthuren ngushtë me elementin epik

Veçori kryesore e formës së tyre është --**gjuha poetike lakonike**, me nëntekste të pasura,

-përdorimit të figurave stilistike me një forcë të madhe shprehëse,

-larmia e formave të ligjërimit artistik. Një nga shembujt më të arrirë të poemës liriko-epike në letërsinë shqipe është poema *Bagëti e bujqësi* e N. Frashërit.

**Epika në prozë ka bazë të hershme epin.**

**Ndahet në :**

- **format elementare** si: miti, përralla, legjenda
- **Format e përbëra:** tregimi, novela, romani.

**Tregimi** është një lloj i shkurtër në prozë. Ka subjekt të thjeshtë, por konflikt të ngjeshur. Ngjarja zhvillohet brenda një kohe të shkurtër dhe ka në qendër një personazh kryesor. Në letërsinë shqipe tregimi u shfaq gjatë Rilindjes. Ndër autorët e parë është Kristoforidhi me *Gjahun e malësorëve* dhe më pas N. Bulka, Migjeni, M. Kuteli, T. Laço, Z. Çela, N. Prifti etj..

**Novela** është një lloj më i gjatë se tregimi. Trajton një motiv të vetëm. Në letërsinë shqipe novela është lëvruar që nga Rilindja me Mihal Gramenon. Novelistë të shquar shqiptarë janë M. Kuteli, E. Koliqi, Migjeni, A. Pashku, M. Camaj, D. Agolli e I. Kadare.

**Romani**

-Është **lloji më i gjatë i gjinisë epike në prozë.**

-Tiparet themelore romani i shfaqti në **Rilindjen Europiane** me Gargantua e Pantagruel të Rabëlesë dhe Don Kishotin e Servantesit.

-Në shekullin XIX, në kushtet e kapitalizmit, romani u lëvrua nga **romantikët** e shquar si -Hygoi dhe nga realistët e mëdhenj, të paraprirë nga Balzaku e të pasuar nga Floberi, Stendali, Tolstoi, Dostojevski, etj. Romanet e shekullit XIX patën **karakter shoqëror, psikologjik e historik**. Kushtet e reja që karakterizuan shekullin XX sollën një zhvillim të madh të romanit.

-Romani i shekullit XX është **roman modern**.

-Romani i shekullit XX u zhvillua në fillim si **roman psikologjik** i thellësive e i nënvetëdijes me Xh. Xhojsin dhe M. Prustin.

-Në vitet 1960, si kundërvënie ndaj romanit realist klasik, lindi "**antiromani**" apo "romani i ri". Përfaqësuesja më në zë e këtij romani ishte Natali Sarrot.

-Një traditë e shquar e romanit të shekullit XX është ajo e "**brezit të humbur**", traditë që u përfaqësua nga autorë që përjetuan tmerret e dy luftërave botërore. Të tillë ishin T. Drajzer, S. Cvajg, Remark e Heminguej

-Një çast kulmor në zhvillimin e romanit është romani i absurdit dhe ai **ekzistencialist** me A. Kamy-në, F. Kafkën, Zh. P. Sartrin e A. Moravia.

-Shekulli XX solli dhe **romanin e sociealizmit** në vendet ish-komuniste. Në gjysmën e dytë të shekullit XX u shfaq romani desident me Pasternakun, Sollzhenicin etj..

-Pas viteve '50 mori **romani i realizmit magjik** në Amerikën Latine. Përfaqësuesi më i shquar i tij është G. G. Markes.

### Romani në letërsinë shqipe

-Në letërsinë shqipe romani është lëvruar **vonë**.

-Romancierit i parë i letërsisë shqiptare është **Ndoc Nikaj**. Një nga romanet e tij më të njohura është *Shkodra e rrethueme*.

-Ndërmjet dy luftërave botërore lloji i romanit nuk u zhvillua shumë, me përjashtim të romanit sentimental të Haki Stërmillit *Sikur të isha djalë* dhe *Pse të Sterjo Spasses*.

Zhvillimin më të madh romani shqiptar e mori rreth **viteve '60**. Të kësaj periudhe janë romanet: *Lumi vdekur* i J. Xoxes, *Krastakraus (Ra Berati)* i B. Xhaferit, *Gjenerali ushtrisë së vdekur*, *Kronikë në gur*, të I. Kadaresë, *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* i D. Agollit etj..

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Plotësim të dhënash:

Në këtë fazë do të punohet në mënyrë të pavarur ose të udhëhequr, e gërshetuar me diskutime, për të plotësuar përgjigjet në pyetjet e aparatit pedagogjik.

#### Ushtrimi 1

Mbi bazën e tipareve të përbashkëta që shfaqin në përmbajtjen dhe formën e tyre artistike.

#### Ushtrimi 2

-rrëfimi për ngjarjet.

-subjekti si *zinxhir ngjarjesh*,

-personazhet shfaqin karakteret e veta.

-Rrëfimi për ngjarjet bëhet nga vetë autori ose (pjesërisht) nga personazhet.

-përshkrimet e natyrës, të mjedisit ku jetojnë personazhet, si dhe gjendja e tyre shpirtërore.

#### Ushtrimi 4

Nxënësit lexojnë fragmentin nga romani *Kush e solli Doruntinën* e Kadaresë dhe i japin përgjigje pyetjeve.

### a.Elemente të legjendës: f

- f Emri i Doruntinës dhe Kostandinit;
- f dy personazhet: Doruntina dhe nëna e saj;
- f mallkimi i nënës;
- f ngritja nga varri e Kostandinit;
- f martesë larg e Doruntinës;
- f vdekja e Kostandinit tre vjet më parë;
- f udha e gjatë që Doruntina bëri;
- f përfundimi tragjik i dy grave.

### Elemente të krijuar nga autori:

- personazhi i Stresit,
- f ndihmësi,
- f gruaja që ndihmon,
- f hetimi që Stresi zhvillon,
- f ndjenja e Stresit për Doruntinën,
- f flokët e verdhë të Doruntinës, etj.

b. Nxënësit gjejnë disa nga figurat stilistike dhe detajet e përzgjedhura.

Figurat e stilistikës: **Krahasimi**: si mjegulla, si vesa e mëngjesit; **epitetet**: e ëmbël, e holluar, kaltëroshe; **metaforat**: e frenuar prej tij qetësisht, ajo mjegull kaltëroshe të dendësohej e të krijonte një re.

**Detajet**: vesa, mjegulla, reja.

c. Kush të solli, Doruntinë?

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për evidentimin e karakteristikave të gjinisë epike dhe analizës së teksteve konkrete, si dhe për seriozitetin e treguar gjatë vjeljes së informacionit.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Krahasoni romanin tradicional dhe modern përmes diagramës së Venit
- Sillni shembuj të teksteve të gjinisë epike, të shkruara në prozë dhe në poezi.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – Zhvillimi historik i gjinisë lirike			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon tipare të gjinisë lirike</li> <li>zbulon zhvillimin e gjinisë lirike në këndvështrimin historik</li> <li>klasifikon gjininë lirike sipas llojeve dhe nënllojeve</li> <li>analizon elemente të analizës së teksteve të gjinisë lirike</li> <li>komenton vlerën artistike të secilit element organizues të poezisë</li> <li>komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët</li> <li>përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Poezi</li> <li>Varg</li> <li>Strofë</li> <li>Ritëm</li> <li>Figura stilistike</li> <li>Surrealizëm</li> <li>Dadaizëm</li> <li>Simbolizëm</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Fjalor shpjegues i termave të letërsisë</li> <li>Tekste poezish</li> <li>Tabela</li> <li>Shkumësa</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Qytetari		<b>Situata e të nxënit:</b> diskutim me kllaster dhe shkrim i lirë për lidhjen e tyre me poezinë; analizë poezish.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Përvijim i të menduarit, Kllastër, Insert, Plotësim të dhënash, Punë në grupe			

## Organizimi i orës së mësimi

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme


**Përvijimi i të menduarit:**

Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë. Nxënësit përmes diagramës së Venit kanë realizuar krahasimin mes romanit tradicional dhe modern:



**Kllaster:**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të gjejnë sa më shumë fjalë që lidhen me termin “poezi”, të cilat shënohen në dërrasë



**Interpretim:**

Nxënësit rrecitojnë një poezi ose dëgjojnë vargje më CD

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**INSERT:**

U kërkohej nxënësve të lexojnë tekstin brenda një kohe të caktuar dhe më pas të plotësojnë me shenja dalluese informacionin dhe ta përmbledhin në tabelën e mëposhtme:

v	+		?
Njohuritë e reja që merren dhe që nuk kanë paqartësi	Njohuri të marra më parë	Njohuri të reja që i mëson ndryshe nga sa i ka kuptuar më parë	Njohuri të reja që i ka të paqarta
Veçoritë e lirikës Llojet e lirikës Zhvillimi i llojeve të lirikës	Llojet e lirikës , veçoritë: Himni Elegjia Soneti tingëllima	Sipas njohurive që ka nxënësi	Lirika moderne Zhvillohet në Evropë, Francë në shek. XIX Sharl Bodler, i ndjekur Vërlen, Rembo, Malarme Simbolizmi, hermetizmi surrealizmi, dadaizmi

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Plotësim të dhënash:**

Në këtë fazë do të punohet në mënyrë të pavarur ose të udhëhequr, e gërshetuar me diskutime, për të plotësuar përgjigjet në pyetjet e aparatit pedagogjik.

**Ushtrimi 1**-Kur dhe ku lindi gjinia lirike? Përmendni disa nga përfaqësuesit kryesorë të lirikës antike.

-Lirika lindi dhe u zhvillua nga **poezia antike greke-romake** midis shekujve VII dhe V para erës sonë.

-Përfaqësuesit më të shquar të lirikës greke qenë Alkeu, Anakreonti, Safo, Pindarietj..

-Llojet më të lëvruara prej tyre ishin **odeja, himni dhe elegjia**.

-Poetët romake e çuan përpara lirikën. Horaci shkroi ode, Katuli, Tibuli dhe Ovidi shkruan elegji etj.

**Ushtrimi 2**-Cila është karakteristika kryesore e lirikës moderne?

-zbulimi i të së panjohurës dhe misterit që e rrethon realitetin.

**Punë në grupe:**

**Grupi 1** Ushtrimi 3

<b>Rryma</b>	<b>veçoritë</b>
Simbolizmi	e interpretojnë botën si një tërësi simbolesh...

## LIBRI I MËSUESIT LETËRSIA 11

Dadaizmi	revoltën ndaj degradimit moral e politik të Europës...
Surrealizmi	prirjen nga "mbirealiteti" ose realiteti i ri...
Hermetizmi	përsosin formën artistike...

### Grupi II Ushtrimi 4

Plotësoni në tabelën e mëposhtme zhvillimet e gjinisë lirike sipas treguesve kohorë.

Treguesit kohorë	shek. VII-V p.e.s	shek. XI-XIII Mesjetë	shek. XIV-XVII Rilindja Europiane	Fundi shek. XIX	Fillimi shek. XX	Gjysma dytë shek. XX	Pas viteve '90 (Shqipëri)
Përfaqësuesit							
Llojet e lirikës							

### Grupi III Ushtrimi 5

Nxënësit lexojnë poezinë "Zemra e liqerit". Ç'veçori karakteristike për gjininë lirike dalloni në të?

Komentojeni poezinë duke u ndalur te:

- përshkrimi i peizazhit të vendlindjes së poetit;
- përshkrimi i jashtëm si shprehje e trazimeve të brendshme shpirtërore të heroit lirik;
- roli i elementeve të muzikës dhe pikturës në poezinë lirike.

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për evidentimin e karakteristikave të gjinisë lirike dhe analizës së teksteve konkrete, si dhe për seriozitetin e treguar gjatë vjeljes së informacionit.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Krahasoni mes tyre poezitë e mëposhtme. Listoni disa prej dallimeve kryesore që vëreni nga ky krahasim. (mund tu jepet detyrë portofoli)

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Zhvillimi historik i gjinisë dramatike.</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• evidenton tiparet e dramës</li> <li>• zbulon zhvillimin e dramës në këndvështrimin historik</li> <li>• përcakton llojet që i përkasin gjinisë dramatike</li> <li>• analizon dramën moderne</li> <li>• komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tekst dramatik</li> <li>• teatër</li> <li>• tragjedi</li> <li>• komedi</li> <li>• dramë moderne</li> <li>• didaskali</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Përvoja e nxënësve</li> <li>• Projektor</li> <li>• Audio</li> <li>• Tekste dramatike</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
Gjuhë shqipe, Histori, Gjuhë e huaj, Bashkëjetesa paqësore		Bisedë për teatrin; një pjesë teatrale që u ka pëlqyer	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, kllaster, Përmbledhje e strukturuar, Punë në grupe.</b>			



Organizimi i orës së mësimi


**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës lidhur me krahasimin mes poezive. Listojmë në dërrasë të zezë disa prej dallimeve kryesore që vëreni nga ky krahasim dhe veçantitë e secilës poezi.

Nxënësit evidentojnë: gjininë, llojin, heroin lirik, mjetet stilistike, metrikën etj

**Kllaster:** Punohet në tabelë me kllastër për të kuptuar tekstin dramatik



**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Përmbledhje e strukturuar:**

- Prezantohet zhvillimi historik në tabelë dhe shpjegohet në mënyrë të strukturuar si ka lindur dhe si është zhvilluar dramaturgjia.

Plotësoni në tabelën e mëposhtme zhvillimet e gjinisë dramatike sipas treguesve kohorë.

Treguesit kohorë	shek. V- p.e.s Greqinë e lashtë	shek. XI- XIII Mesjetë	shek. XIV- XVII Rilindja Europiane	shek. XVIII	Fundi i shek. XIX	Shek. XX Drama moderne (teari absurd)	Pas viteve '90 (Shqipëri)
Përfaqësuesit	Eskili, Sofokliu, Euripidi, Aristofani		Shekspiri, Molieri, Rasini, Kornei	Gëte, Shiler	Ibsen, Stringberg, Çehovi	E. Jonesko, S. Beket dhe A. Adamov Breht	Santori, Çajupi, Haxhiademi, Çomora, Jakova, Agolli, Pulaha, Pitarka
Llojet e dramës	Tragjedi, komedi		Tragjedi, drame, komedi	Tragjedi, drame	drama	Drame absurde, shoqërore	Dramë, komedi

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Punë në grupe:** Nxënësit punojnë në grupe me ushtrimet 1, 2, 3

#### Grupi I.

Listojnë veçoritë e gjinisë dramatike

- I rindërton ngjarjet nëpërmjet fjalëve, gjesteve dhe lëvizjeve të personazheve që veprojnë në skenë
- Veprimi i personazheve Dialogu, monologu
- Veçori: realizimi skenik
- Gërsheton artin e fjalës me arte të tjera skenike
- Nuk ka rrëfimtari, përshkrime
- Ka didaskali-sqarime të domosdoshme
- Ndërtohet me akte dhe skena
- Ndikon tek emocionet dhe mendimet e njerëzve-katarsis

#### Grupi II

**Tragjedia :**

- Fillon mirë dhe përfundon keq
- Imitim i veprimeve të larta fisnike
- Tema universale
- Gjuhë e figurshme dhe me stil të lartë
- Heronj me veti të larta
- Heronj tragjikë (fatin e tyre e vendosin hyjnite, e kanë të paracaktuar fatin etj.)

#### Grupi III

- Tragjedia antike greke: Eskili, Sofokliu, Euripidi;

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për evidentimin e karakteristikave të gjinisë dramatike dhe analizës së teksteve konkrete, si dhe për seriozitetin e treguar gjatë vjeljes së informacionit.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Lexoni fragmentin e mëposhtëm të shkëputur nga drama *Shtëpi kukulle*, H. Ibsen.

a. Dalloni në të disa veçori të llojit (dramës).

b. Vini re situatën në të cilën ndodhet Nora. Shpjegoni pse konflikti i saj me Helmerin mund të quhet një konflikt dramatik. Ç'ndjenjë ju ngjall Nora me dramën e saj tronditëse?

**Punë me portofolin :** *Punë në dyshe:* Ktheni një fragment të një teksti tregimtar (roman, novelë) në një tekst dramatik. Mësojeni pjesën dhe përpiquni ta interpretoni bukur në klasë.

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore– Romantizmi</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton rreth zhvillimit të Romantizmit, si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike</li> <li>• veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj epoke në Evropë dhe në botë.</li> <li>• tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romantizëm</li> <li>• Revolucion borgjez</li> <li>• Stuhi dhe vrull</li> <li>• Mbizotërimi i ndjenjës</li> <li>• Romantizmi gjerman</li> <li>• Lëvizja “Stuhi dhe vrull”</li> <li>• Kulti i lirisë</li> <li>• Ekzotizmi</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Tekste letrare</li> <li>• Tabela</li> <li>• Shkumësa</li> <li>• Interneti</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave		Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për epokën e Romantizmit.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- Stuhi mendimesh, Përmbledhje e strukturuar, Harta e epokës.</b>			

**Organizimi i orës së mëimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Stuhi mendimesh:**

- Çfarë njohurish keni për kontekstin historik dhe kulturor të Romantizmit?
- Cilët janë faktorët historikë që ndikuan në zhvillimin e Romantizmit?
- Cilët janë përfaqësuesit që njihni?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Përmbledhje e strukturuar:**

- **Kushtet historiko-shoqërore:**

Romantizmi u përcaktua nga një sërë faktorësh historikë dhe shoqërorë:

- Revolucioni Industrial Anglez dhe Revolucioni Borgjez Francez. Të dy këto revolucione sollën tronditje të mëdha në të gjitha fushat e jetës si në Angli ashtu edhe në Francë dhe mbarë Evropën. Këto revolucione, nuk mundën të bënin ndryshime rrënjësore e gjithëpërfshirëse.

- Karakteristikë që i afron është pakënaqësia që ato shkaktuan në klasa e forca shoqërore.

-E pakënaqur është aristokracia feudale. Ajo idealizon të kaluarën dhe do të rikthejë të pakthyesmen, “parajsën e humbur feudale”.

-E pakënaqur është borgjezia, e cila nuk mund të zhvillojë plotësisht fuqitë e saj ekonomike

-E pakënaqur është masa popullore, që ndjehet e mashtruar në shpresat e saj për një jetë më të mirë. Ajo sheh se nuk vjen “mbretërimi i arsyes”, siç ëndërruan e shpresuan iluministët, as “mbretërimi i lirisë, i vëllazërisë dhe i barazisë”.

Romantizmi është një lëvizje ideore dhe artistike, që lindi në Gjermani dhe u zhvillua në Europë nga çereku i fundit i shekullit XVIII deri në fillim të shekullit XIX. Kjo lëvizje gjeti pasqyrim në fusha të

ndryshme të shkencës dhe të artit.

- **Romantizmi europian. Përfaqësuesit kryesorë**

Romantizmi zhvillohet në vende të ndryshme të Europës dhe fiton tipare të veçanta, origjinale sipas kushteve specifike të vendit ku zhvillohet.

Në **Gjermani** romantizmi u parapri nga lëvizja “Stuhi dhe vrull”. Baza e romantizmit gjerman ishte idealizmi. Ai pati karakter patriotik, vlerësoi krijimtarinë popullore, i dha vend të rëndësishëm natyrës dhe botës së ndjenjave. Përfaqësues të shquar janë: **Gëteja** dhe **Shileri**.

Edhe në **Angli** romantizmi u parapri nga disa drejtime letrare dhe u karakterizua nga dy breza shkrimtarësh romantikë.

-Brezi i parë trajtoi temën e përditshmërisë, kultin e natyrës dhe synuan karakterin kombëtar të letërsisë.

-Shkrimtarët e brezit të dytë (**Bajroni, Shellli**) i kënduan lirisë dhe shprehën hapur konfliktin e tyre me realitetin. Romantikët anglezë evokuan epokën e Rilindjes dhe patën për model Shekspirin dhe veprat e tij.

Romantizmi **francez** u ndikua thellësisht nga Revolucioni Borgjez dhe idetë e tij. Karakteristikë dalluese e tij është kundërvënja ndaj klasicizmit. Në ballë të romantizmit francez qëndrojnë **Lamartini, Zhorzh Sandi** e mbi të gjitha, **Hygoit** i cili u bë prijës i romantizmit.

Në **Itali**, romantizmi u përfaqësua nga **Manxoni, Leopardi** dhe **Foskolo**. Romantizmi Italian dallohet për ndjenjat kombëtare që lidheshin me nevojën për bashkimin e vendit dhe për pavarësi.

Në **Amerikë**, romantizmi u zhvillua nën ndikimin e romantizmit anglez. Ai pati veçori: individualizmin, dashurinë për jetën primitive në gjirin e natyrës, idealet e lirisë e të barazisë. Romantizmin amerikan e përfaqësojnë denjësisht **Edgar Alan Poe** dhe **Uolt Uitman**

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Harta e Epokës:**

Nxënësit do të lexojnë në libër informacionin për Romantizmin dhe plotësojnë hartën.

Romantizmi	Veçoritë	Përfaqësuesit	Gjinitë që u lëvruan
Romantizmi gjerman			
Romantizmi francez			
Romantizmi anglez			
Romantizmi italian			
Romantizmi amerikan			

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Shihni me vëmendje dy pikturat. William Tërner “Peshkatarë në det”, 1796, Londër, Eugjen Dalakrua “Liria drejton popullin” 1830, Muzeu i Luvrit, Paris

Dallonin në to veçori të artit romantik dhe diskutoni në klasë mbi rëndësinë e romantizmit dhe kontributin e kësaj rryme në letërsinë dhe në artin botëror.

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore– <b>Romantizmi (ora II)</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon veçoritë dhe parimet estetike të romantizmit;</li> <li>• diskuton rreth lëvizjes “Stuhi dhe vrull”, përfaqësuesit e saj dhe rëndësia për epokën</li> <li>• tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> <li>• demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romantizëm</li> <li>• Revolucion borgjez</li> <li>• Stuhi dhe vrull</li> <li>• Mbizotërimi i ndjenjës</li> <li>• Kulti i arsyes</li> <li>• Kulti i lirisë</li> <li>• Ekzotizmi</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor</li> <li>• Tekste letrare</li> <li>• Tabela</li> <li>• Shkumësa</li> <li>• Interneti</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për epokën e Romantizmit.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Di/Dua të di/Mësova, Përmbledhje e strukturuar, INSERT. Ditari dypjesësh			

**Organizimi i orës së mësimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

***Di/Dua të di/ Mësova: Përmbledhje e strukturuar, INSERT.***

Njihen nxënësit me teknikën Di/Dua të di/Mësova. Plotësohen dy kolonat e para të tabelës.

Di	Dua të di	Mësova

Bëhet një përmbledhje e strukturuar nga mësuesja dhe u jepet detyrë nxënësve të lexojnë materialin në tekst duke përdorur teknikën INSERT.

√	+		?
<i>Njohuritë e reja që merren dhe nuk kanë paqartësi</i>	<i>Njohuri të marra më parë</i>	<i>Njohuri të reja që i mëson ndryshe nga sa i ka kuptuar më parë</i>	<i>Njohuri të reja që i ka të paqarta</i>

Pasi nxënësit lexojnë tekstin dhe e pajisin atë me shenjat përkatëse, sqarohen nga mësuesja pyetjet e nxënësve, diskutohet informacioni i ri dhe kontrollon shkalla e të kuptuarit të tekstit me anë të pyetjeve të mësueses:

1. *Cilat ishin kushtet socio-ekonomike e politike në fillim të mijëvjeçarit të dytë, që favorizuan lindjen e një epoke të re?*
2. *Çfarë është Romantizmi?*
3. *Në cilat shtete lulëzoi dhe cilët ishin përfaqësuesit më në zë të saj?*

4. Ç'është lëvizja "Stuhi dhe vrull" përfaqësuesit.

4. Cila është rëndësia e kësaj epoke?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Ditari dypjesësh:**

<b>Parimi</b>	<b>Komenti</b>
Mohimi i 'kultit të arsyes'	
Mbizotërimi i ndjenjës	
Kulti i natyrës	
Ekzotizmi	
"Kulti i lirisë"	
Heroi romantik	
Raporti me historinë	
Koncepti i popullit dhe i kombit (nacionalizmi):	
Rivlerësimi i fesë	
Gërshetimi i gjinive dhe llojeve letrare	
Arti i përqsjes	

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Di/Dua të di/Mësova:**

Përmblihen informacionet e nxjerra dhe shkruhen në dërrasë duke plotësuar kolonën e tretë "Mësova"

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Lexoni jetën dhe veprën e Gëtes. Përmblihdni në fletore të dhënat që ju duken më të rëndësishme.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Johan Wolfgang Gëte. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Johan Wolfgang Gëte, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij</li> <li>• veçon veprat kryesore të Gëtes</li> <li>• diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Gëtes në letërsinë botërore.</li> <li>• diskuton rreth vlerave të veprave lirike, tregimtare dhe dramatike, filozofisë së veprës.</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> <li>• respekton mendimin e të tjerëve</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fausti</li> <li>• Udhëtim</li> <li>• "Geci i Berlihingenit"</li> <li>• "Olimpiku i Vajmarit".</li> <li>• Këngët folklorike</li> <li>• Njeriu</li> <li>• Natyra</li> <li>• Bukuritë e jetës</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Interneti</li> <li>• Biblioteka.</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe.		<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi formimin e ndikimin e personalitetit të Gëtes dhe rëndësinë e krijimtarisë së tij si paraprijës i Romantizmit.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprak, Bisedë, Punë në grupe, Punë e udhëhequr:

## Organizimi i orës së mësimi

### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

#### Diskutim mbi njohuritë paraprake:

Punohen në tabelë të dhënat kryesore për jetën dhe veprën e Gëtes, pasi lexohen disa nga përmbledhjet e nxënësve. Mësuesi/ja mund të përdorë teknika vizuale.

- Johan Volfgang Gëte, më i madhi poet e shkrimtar gjerman dhe një nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave.

- Lindi më 28 gusht 1749 në një familje borgjeze, në Frankfurt mbi Main.

- Gëteja u shqua për zgjuarsia, vullnet të fortë e këmbëngulje për të përvetësuar dituritë. -Shpirti i tij kërkues synonte më të mirën, më të lartën.

- Në moshën 16- vjeçare Gëteja u largua nga qyteti i lindjes dhe shkoi në Lajpcig, ku, sipas dëshirës së të atit, do të studionte drejtësi.

- Në Lajpcig ai filloi të shkruante vargjet e para në të cilat mbizotëronin motivet anakreonike. (hiqe fare)

- Më 1768 ai u sëmur rëndë dhe u detyrua të kthehet në shtëpi pa e mbaruar universitetin. --Pas shërimit, më 1770, shkon në Strasburg ku diplomohet si avokat. Në Strasburg Gëte njihet me filozofin Herder, i cili i zbuloi i pari bukuritë e jashtëzakonshme të poezisë popullore. Nga bashkëpunimi Gëte-Herder mori udhë lëvizja "Stuhi dhe vrull".

- Pas studimeve, ai u kthye në Frankfurt dhe nisi të punojë si avokat, por gjente edhe kohën për t'u marrë me letërsi. Në këtë kohë zunë të ngjizen në mendjen e tij personazhet më të rëndësishme të krijimtarisë letrare,

- Më 1775 Gëte shkon në Vajmar i ftuar nga duka liberal i Saksës, Karl Augusti. Gëtes i besohen detyra të larta shtetërore dhe arrin ta shndërrojë Vajmarin në kryeqytetin kulturor të të gjithë Gjermanisë. Në respekt të punës së tij të jashtëzakonshme, ai u quajt "**Olimpiku i Vajmarit**".

- Udhëton në Itali për rreth dy vjet. Në këtë periudhë ndikohet nga arti i Rilindjes dhe letërsia antike greke.

- Vdiq në Vajmar më 22 mars 1832.

#### Veprat

Më 1773, Gëtja botoi dramën;

"Vuajtjet e djaloshit Verter" ;

lirikat "Këngët për Lilin"( të cilat ia kushtoi të bijës së bankierit Shoeman me të cilën ra në dashuri) ; "Lirika" ;

Ciklin poetik " Elegjitë romane" dhe më 1787 dramën " Ifigjenia në Tauridë".

Më 1789 botoi dramën "Turkuato Taso".

Më 1796 mbaroi romanin "Vilhelm Majster".

Në këtë kohë të begatë krijimtarie ai botoi pjesën e parë të "Faustit"(1806),

"Udhëtimi në Itali", dhe " Divani perëndimor-lindor".

Më 1809 boton veprën "Poezi dhe e vërtetë".

Pjesa e dytë e Faustit u botua si vepër postume pas vdekjes së Gëtes.

Kryeveprat lirike të Gëtes janë: "Mbreti i pyllit", "Kënga e natës e një shtegtari", "Trëndafil i fushës", "Nusja nga Korinthi", "Vilhelm Maister"

**Bisedë:**

Zhvillohet një bisedë mbi:

- rëndësinë e Gëtes gjatë periudhës së Romantizmit dhe lëvizjes “Stuhi dhe vrull”.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Punë në grupe:****Grupi I**

Rendisni në mënyrë kronologjike informacionin mbi momentet kryesore të jetës së Gëtes.

1749- \_\_\_\_\_

1765- \_\_\_\_\_

1768- \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Grupi II**

Gëteja ishte një nga shkrimtarët e drejtuesit kryesor të lëvizjes “Stuhi dhe vrull”. Cilët ishin disa nga përfaqësuesit e tjerë të kësaj lëvizjeje kulturore dhe çfarë risish solli kjo lëvizje në letërsinë e kulturën gjermane?

**Grupi III**

Organizoni informacionin mbi veçoritë e krijimtarisë së Gëtes sipas tabelës.

Veçoritë e krijimtarisë së Gëtes:				
Periudha e rinisë (Laipcig, Strasburg) 1749-1765	Periudha e pjekurisë (Frankfurt) 1765-1771	Periudha e Vajmarit I (Vajmar) 1771-1786	Periudha “Klasicizmi i Vajmarit” (udhëtimi në Itali) 1786-1788	Periudha e Vajmarit II (Vajmar) 1788-1794:

**Grupi IV**

Listoni titujt e veprave poetike të Gëtes dhe ato të shkuara në prozë dhe dramaturgjë

Vepra poetike	Vepra në prozë	Dramaturgjë



**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

***Punë e udhëhequr:***

Në këtë fazë do të punohet në mënyrë të pavarur ose të udhëhequr, e gërshetuar me diskutime **Ushtrimi 7**-Lexoni poezinë “Hënës” dhe reflektoni rreth marrëdhënieve që ka poeti romantik me natyrën.

- *Lidhje shume e ngrohtë, frymëzim prej saj;*
- *Heroi lirik është i lidhur ngushtësisht me natyrën;*
- *Merr frymëzim prej saj;*
- *Kulti i ndjenjës si poet romantik e ka veshur heroin;*
- *Kërkon të njësohet në gjirin e natyrës;*
- *Ndjehet i lirë, i bukur, del nga gjendja e melankolisë apo trishtimit;*
- *Bëhet me krahë pranë gjirit të saj;*
- *Shihet kontrasti si veçori e romantikut;*
- *Hëna është element romantik*

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Lexoni dy variantet e përkthyer të poezisë “Mbreti i Tulës” dhe dalloni ndryshimet që shfaqen në:

- fonetikë (shqiptim)
- leksik (fjalët dialektore)
- sintaksë ( ndërtimet sintaksore të vargjeve)
- morfologji (forma gramatikore) (Mund të përdoret për portofolin)

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Gëte. Analizë “Fausti”</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon dy pjeset e tragjedisë “Fausti” të Gëtes</li> <li>dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të tragjedisë;</li> <li>dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre;</li> <li>shpjegon rolin dhe qëllimet e personazhit kryesor Faustit.</li> <li>evidenton mesazhet që përcjell vepra</li> <li>dallon temën dhe konfliktet në tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;</li> <li>analizon se si ndryshon ose zhvillohet personazhi kryesor Fausti, krahasuar me Mefistofelin.</li> <li>analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, (koha vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat.</li> <li>demonstron njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst</li> <li>analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe të sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>legjenda e Dr. Faustit</li> <li>plan filozofik</li> <li>djalli</li> <li>kronika</li> <li>kushtim</li> <li>paraloja në teatër</li> <li>prologu në qiell</li> <li>studioja</li> <li>Mefistofeli</li> <li>çmenduri</li> <li>kopshti i Martës</li> <li>etj</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor ,</li> <li>Video-projektor,</li> <li>Flipchart,</li> <li>Tabela e zezë,</li> <li><a href="https://www.youtube.com/ëatch?v=8-8keXo_ygl">https://www.youtube.com/ëatch?v=8-8keXo_ygl</a></li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte		<b>Situata e të nxënit:</b> Në video-projektor shfaqen disa sekuenca nga tragjedia e Gëtes “Fausti”.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Vëzhgim filmi, Diskutim mbi njohuritë paraprake, Harta e ngjarjes, Kllaster, Punë në grupe, Pesëvargësh			

## Organizimi i orës së mëimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

- Vëzhgim filmi:** [https://www.youtube.com/watch?v=8-8keXo\\_ygl](https://www.youtube.com/watch?v=8-8keXo_ygl)

Në video projektor shfaqen disa sekuenca nga vepra e Gëtes “Fausti”, dramatizim.

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Nxënësit kanë lexuar tragjedinë “Fausti” dhe materialin teorik në libër dhe kanë punuar hartën e ngjarjes, të cilën e saktësojnë së bashku me mësuesen.

<b>Vendi dhe koha</b>	<b>Hapësira</b> në vepër duket e pafundme, sepse e çon lexuesin nga njëri skaj i botës në tjetrin, nga njëra botë tek tjetra: herë në mjedisin fantastik të shtrigave në malin e Harcit, herë në bodrumet e Auerbahut në Lajpcig, herë në dhomën e Margaritës dhe herë në burgun e errët ku dergjet vajza mëkatore.
-----------------------	---

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

<b>Dy pjesë</b>	<p>Tragjedia “Fausti” ka dy pjesë. Pjesa e parë ndahet në 25 skena, kurse pjesa e dytë përbëhet prej 5 aktesh. Për nga <b>kompozicioni</b> kjo vepër është ndërtuar në ngjashmëri me modelin e kronikave shekspiriane.</p> <p>Në pjesën e parë ka mjaft <b>personazhe</b> biblike, kurse në pjesën e dytë këta ia lënë vendin personazheve nga mitologjia antike, gjithashtu ka dhe shumë personazhe episodike.</p>
<b>Tema</b>	<p>Është marrëveshja që Fausti bën me djallin, duke i dorëzuar atij shpirtin e tij, në këmbim të aftësisë për të kuptuar çdo aspekt të natyrës dhe të dijes njerëzore dhe për të gjetur lumturinë.</p>
<b>Rrëfimi</b>	<p>Ndodh në <b>dy plane</b>: Në njërin plan paraqiten skena nga jeta e rëndomtë njerëzore, kurse në planin tjetër zhvillohen skena të një botë fantastike, plot me figura mitike.</p>
<b>Simbolikat</b>	<p>-Simbolika e <b>udhëtimit</b> përcillet nga njëra epokë në tjetrën për të mbërritur tek Fausti, i cili do të synojë të zbulojë përmasat e natyrës, e botës, e kozmosit, e qenies, e njeriut dhe të shoqërisë.</p> <p>-<b>Zoti, Mefistofeli, kryeengjëjt</b> e të tjera personazhe kanë kuptime simbolike dhe janë shprehje e forcave të natyrës dhe të shoqërisë</p> <p>-Po kështu edhe <b>ferri dhe parajsa</b> janë simbole të fatkeqësisë dhe të lumturisë së njeriut në tokë.</p>
<b>Ngjarjet kryesore</b>	<p>Tragjedia fillon me vargjet <b>“Kushtim”</b>, ku paraqiten që në fillim dallgëzimet e brendshme që e shtynjë poetin të krijojë. Më pas në <b>“Paraloja në teatër”</b>, nëpërmjet dialogut të drejtorit të teatrit, poetit dhe gastorit përcillet vlera estetike që duhet të mishërohet në çdo vepër dramatike që ajo të jetë e përsosur artistikisht.</p> <p>Shtjellimi i mirëfilltë i poemës nis me <b>“Prologu në qiell”</b>, ku Zoti dhe djalli, Mefistofeli, janë përfshirë në një diskutim të zjarrtë filozofik mbi vendin e njeriut në gjithësi. Ata kanë mendime të kundërta për njeriun: Mefistofeli mendon se punët e njerëzve në tokë shkojnë gjithnjë e më keq dhe për Faustin thotë se kërkon të bëjë të pamundurën, por gjithnjë mbetet i pakënaqur. Mefistofeli premton se do ta largojë fare lehtë Faustin nga kjo rrugë dhe Zoti e lejon që ai ta vërë në provë, i bindur për të kundërtën:</p> <p><b>Pjesa e parë:</b> Tragjedia e Margaritit. Konsiderohet më pranë realitetit.</p> <p>-Fausti ia kushtoi shkencës, filozofisë, drejtësisë, mjekësisë, teologjisë e alkimisë, i mërziur dhe i zhgënjyer kupton se dituria e tij nuk vlen për asgjë përballë detit të madh të të fshehtave të pazbuluara të natyrës, ndaj jepet pas magjisë.</p> <p>-Megjithatë Fausti nuk arrin ta mposhtë krejtësisht dëshpërimin dhe në një moment vendos të çlirohet nga brengat e jetës duke u helmuar.</p> <p>-Dyzimi torturues midis “shpirtit soditës” dhe “shpirtit vepronjës” vazhdon ta brengosë shpirtin e tij, e bën atë të vuajë dhe të mos i gëzohet së bukurës dhe të mirave që jeta i ka dhënë.</p> <p>-Teksa kthehet natën për në kabinetin e tij, Mefistofeli (djalli) i shndërruar në një qen të zi, e ndjek Faustin deri brenda në kabinet dhe i shfaqet atij duke u transformuar tashmë si qenie njerëzore...</p> <p>-Mefistofeli kërkon ta bëjë të lumtur me anë të pijes, shthurjes, por Fausti nuk e ndjen veten të lumtur. Mefist. Thur intrigën për të shtënë në dorë Margaritën, ajo i dorëzohet Faustit. Por kjo dashuri përfundon tragjikisht dhe Fausti e ndjen veten fatkeq.</p> <p><b>Pjesa e dytë:</b> Tragjedia e Helenës. Është më filozofike. Ndihet në të ndikimi i letërsisë klasike, Në këtë pjesë përdoret gjerësisht figuracioni mitologjik. Paraloja që zhvillohet në vise të bukura shërben si urë lidhëse midis dy pjesëve.</p> <p>-krizë shpirtërore e morale të Faustit nga humbja e Margaritës.</p> <p>-Vuan, bie në gjumë të thellë.</p> <p>-shpirtrat e mirë ja njomin plagët.</p> <p>Shpirti i zgjimit thotë: “mundës del veç zemërbardhi që vepron e s’mbrapset kurrë.</p> <p>-Fausti zgjohet, harton projekte zhvillimi për t’i bërë njerëzit të lumtur.</p> <p>-Fausti pas një mundimi të gjatë zbulon qëllimin e jetës.</p> <p>“Meriton lirinë dhe jetën vetëm ai që mundohet ditë për ditë t’i fitojë”</p> <p>Mefistofeli pret t’i marrë shpirtin por hapet qielli dhe engjëjt e shpëtojnë.</p>

<b>Personazhet</b>	Fausti, Mefistofeli, Margarita
<b>Mesazhe</b>	<p>Vepra përcjell mesazhe <b>humaniste</b> dhe <b>universale</b>.</p> <p>-Fausti e gjen kuptimin dhe shijen e jetës te puna dhe veprimtaria me vlerë shoqërore.</p> <p>-Mund të thuhet se ideja e punës si burim i të mirave materiale përbën një prej elementeve kryesore të kulturës tradicionale jetësore edhe të kombit tonë.</p> <p>-“Fausti” i Gëtes vjen kështu si një përforcim i vlerës parësore që ka puna e frymëzuar nga vlerat shoqërore në përparimin e çdo kombi dhe të të gjithë njerëzimit.</p> <p>-Gjithashtu ideja se arsyeja dhe dashuria njerëzore mundin çdo të keqe, tingëllon një mesazh kuptimplotë e optimist për çdo brez lexuesish.</p> <p>-Besimin në vlerat humane të njeriut.</p> <p>-Mesazhin e paqes dhe drejtësisë.</p>


## B. Ndërtimi i njohurive të reja

### **Punë në grupe:**

- Pasi punohet me hartën e ngjarjes dhe diskutohen pyetjet dhe çështje të ndryshme të ngritura nga mësuesja dhe nxënësit, kalohet në analizën e personazheve të veprës.
- Lexohet materiali teorik në tekst.
- Ndahet klasa në grupe.
- Çdo grup do të analizojë një personazh: Fausti, Mefistofeli, Margarita.

### **Kllaster:**

Punohen në tabelë tiparet dhe veçoritë për secilin personazh. Ndalohet te figura e Faustit.



**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Pesëvargësh:**

Nxënësit ndërtojnë një pesëvargësh për Faustin dhe për Margaritën.  
Përshkruaj Faustin.

- Me anë të një emri \_\_\_\_\_
- Me anën e dy mbiemrave \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_
- Me tri folje \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_
- Me anën e një fraze \_\_\_\_\_
- Duke e ripërcaktuar me një sinonim \_\_\_\_\_

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për leximin e veprës “Fausti” dhe plotësimin e saktë të rubrikave të hartës së ngjarjes, analizës së personazheve, duke ilustruar me shembuj nga vepra, për plotësimin e saktë të pesëvargëshit.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Komentoni mesazhin që përcjell Gëteja nëpërmjet raportit dashuror Faust-Margarita. Krahasojeni me raportin Hamlet-Ofeli ose Romeo-Zhuljetë. Jepni dhe ju mendimin tuaj.

**Dashuria është ndërtuese vetëm kur udhëhiqet nga arsyeja.**

- Lexoni fragmentin nga “Fausti”

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Koment “Në studion e Faustit” Gëte</b>			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga fragmenti;</li> <li>• analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta</li> <li>• analizon figurën e Faustit duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• shpjegon rolin dhe qëllimet e Faustit, gjendjen e tij shpirtërore duke e ilustruar me detaje nga teksti.</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst.</li> <li>• tregon se si fragmenti e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• studiova teologji</li> <li>• medicinë</li> <li>• s’mund të dimë asgjë</li> <li>• skëterrë</li> <li>• djaj</li> <li>• fuqi e veprimit</li> <li>• Dil jashtë në hapësirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fletë formati.</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	Situata e të nxëniet: Interpretim i monologut të Faustit “Natë”
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, Lexim shprehës, Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur në grupe, Organizues grafik për reagim letrar.	

### Organizimi i orës së mësimit

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### Diskutim mbi njohuritë paraprake:

1. Çfarë simbolizojnë personazhet e mëposhtme në vepër?

Margarita \_\_\_\_\_  
Fausti \_\_\_\_\_

Helena \_\_\_\_\_  
Mefistofeli \_\_\_\_\_

2. Vepra “Fausti” është ndërtuar për nga ana kompozicionale në dy pjesë. Gruponi saktë veçoritë artistike të listuara në kuadratin e mëposhtëm në organizuesit grafik përkatës.

5 akte; tema e parasë; kriza e ekzistencës; tema e dashurisë për Margaritën; dashuria për të bukurën e simbolizuar nga Helena e Trojës; kërkimi i kënaqësisë së jetës te puna dhe veprimtaria me vlerë shoqërore; kapërcime të befasishme kohore; personazhe mitologjike; tema e luftës; personazhe të Antikitetit; 25 skena; ngjallja e vullnetit; tema e bukurisë së Antikitetit; kriza e moralit.

PJESA I E “FAUSTIT”

PJESA II E “FAUSTIT”

#### B. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Lexim shprehës:

Lexohet bukur fragmenti duke krijuar atmosferë në klasë.

##### Praktikë e udhëhequr:

Punohet me aparatën pedagogjik në tekst. Pyetje për kuptimin.

1. Si e paraqet Fausti veten në këtë takim të parë me lexuesin. Çfarë e shqetëson atë? Përshkruani gjendjen e tij shpirtërore duke e ilustruar me detaje nga teksti.

*Fausti në studion e vet (e quan qilar) është i vetmuar, i dëshpëruar, i pushtuar nga mendime të zymta se as jetën s’e ka gëzuar, as njerëzve s’u ka dhënë dije apo ide që të njohin të fshehtat e botës e të jetojnë më mirë. Vargjet 1-6 shprehin faktin se mundësitë e njeriut janë të kufizuara, ndërsa dija e pakufizuar.*

2. Fausti ka kryer studime në shumë fusha të dijes njerëzore. Cilat janë cilësitë që e bëjnë atë një kërkues të palodhur të së vërtetës?

*Cilësitë që e bëjnë Faustin një kërkues të palodhur të së vërtetës janë: etja për dijen, kërkimi i palodhur për të mësuar të vërtetën, njohja e shumë fushave të ndryshme të dijes, dashuria dhe humanizmi për njerëzit, puna e palodhur, e papërtuar dhe e dobishme për të gjithë, mohimi dhe sakrifkimi i vetvetes dhe jetës personale; vendosja e të tjerëve përpara vetes etj.*

*Vargjet që e ilustrojnë 1-4, sidomos vargu 4 me fjalët kyçe: studim me themel, me zell, me durim.*

3. Cila është ndjenja që mbizotëron në vargjet: “Dhe ja ku jam unë lol trutharë /Aspak më i mençur se më parë.”? Çfarë imazhi zgjojnë tek ju fjalët lol trutharë?

*Fausti vuan. Ai ironizon dhe përbuz vetveten. Me vetëcilësimin “ lol (o) trutharë” ai zgjon te lexuesi imazhin e një njeriu që është bërë gazi i të tjerëve; me të cilin të tjerët qeshin e tallen, sepse harxhoi të gjithë jetën e vet dhe asgjë të mirë s’bëri...), po kështu dhe dhaskenjtë (mësuesit) e*

tjerë. Ai bie në dëshpërim sepse kupton se ndër “budallenjtë e mençur” më i mençur është ai që i njih çaqet e dijës së tij.

4. Përse Fausti nuk zotëron as pasuri, as nder duke qenë se ai ka punuar gjithë jetën? Çfarë e mundon më tepër shpirtin e tij?

*Edhe pse ka punuar gjithë jetën e tij, madje duke e stërmunduar vetveten e duke mohuar kënaqësitë e vogla që të fal jeta, Fausti nuk zotëron asgjë, as të mira materiale e as dijen e nevojshme për të vënë në jetë qëllimin e tij “T’u bëjë mirë njerëzve, ta vërë shkencën në dobi të njerëzve”. Këtu qëndron tragjedia e tij. Kjo e mundon atë më tepër se çdo gjë.*

5. Pse Fausti jepet pas magjisë pas gjithë studimeve e përpjekjeve të tij të mundimshme? Çfarë synon ai të zbulojë përmes magjisë?

*Shkenca e Mesjetës nuk ia siguron Faustit njohjen e lartë, ndaj vendos të merret me magji, me besimin se kështu do të arrijë të komunikojë me shpirtat e lartë. Gëteja ruan kështu linjën origjinale të legjendës: magjinë. Përcillet nëpërmjet vargjeve 24-32.*

6. Cila është dëshira që zgjohet në shpirtin e Faustit sapo ai sheh hënën e plotë në qiell? Çfarë nënkupton ky monologim i tij me hënën?

*Thirrja që Fausti i drejton hënës përmban gjithë dhimbjen e tij për mosrealizimin e qëllimit. “O hënë e plotë, sonte e pafsh/ Të fundit herë brengën time;”. Feksjja e hënës lart në qiell zgjon tek ai tundimin e madh për t’u shkrirë e për t’u bërë njësh me natyrën “Ah, të bridhja...” Ky monologim i tij me hënën, miken e ngushtë, e vetmja që nuk e ka braktisur “Pa vije, mike e mallëngjyer,/ Më derdhje dritë përmbi letra e libra”, së pari është një tregues i lidhjes së ngushtë të heroit romantik me natyrën, së dyti, nënkupton dëshirën e fshehtë të shpirtit të Faustit për t’u bërë pjesë e botës, pjesë e gjithësisë, për t’i dhënë fund viteve të mundimshme në atë qilar të ndyrë plot myk, tym, kocka, nënkupton gjithashtu dëshirën e tij për t’u hedhur në veprim, dëshirën e tij për të jetuar...*

7. Cila është domethënia e fjalëve “Dil jashtë! Në hapësirë!” në vargun e fundit?

*Shpërthimi i Faustit me fjalët “Çohu! Dil jashtë!...” është thirrja që Fausti ia drejton thellësisë së vetvetes s’i për ta shkundur atë që të reagojë, që të veprojë. Fausti do ndryshim, do përgjigje. Thellë në vetvete nuk e toleron më gjendjen në të cilën ndodhet. Nostradamusit ai nuk i beson deri në fund, sepse dija e Faustit buron më tepër nga shpirti i tij i lartë e humanist. Ai rreh ta zbulojë botën përmes përvojës vetjake. Kjo është grishja për të hedhur tutje dëshpërimin, për t’u hedhur në veprim, për t’ë zbuluar të fshehtat e botës duke jetuar mes njerëzve dhe botës reale.*

**Punë e pavarur në grupe:**

**Grupi I:**

**1. Përshkruani me detaje nga teksti kabinetin ku punon Fausti. Shpjegoni pse Fausti e konsideron burg kabinetin e tij të punës.**

*Nënvizohen detajet përshkruese në vargjet 45-56 : dritë e turbullt, xham i ngjyer i penxhereve, stivë e ngushtë librash... etj.*

*Blozë e diturisë- Fausti kupton se dituria nuk vlen po s’u fut në punë. Bloza- simbolikë për shkencën mesjetare që ka ngecur e nuk i shërben përparimit.*

*Studion e tij të punës Fausti e konsideron **burg, birucë, qilar**. Ajo i pengon lirinë, frymëmarrjen, veprimin, ia ngushton hapësirën e kërkimit e të veprimt. Përshkrimi i studios kulmon në vargun « Me rraqet e stërgjyshërve... » që tregon se asgjë s’ka ndryshuar, shkenca mesjetare ka mbetur në vend.*

*Nga këtu buron edhe gjendja e rëndë shpirtërore e Faustit : 1. Zemra mëshon e pikëlluar ; 2. Dhimbja të mbytur ; 3. I rrethuar nga tymi e myku, nga kërcinjt e kockat e kufomave (të tëra simbole që vijnë nga Mesjeta).*

**2. Ç’funktion ka natyra në monologun e mësipërm? Ç’ndikim ka ajo në gjendjen shpirtërore të protagonistit? Pse e intrigon Faustin njohja e natyrës dhe pafundësive të saj?**

*Natyra është shtëpia e njeriut. Vetëm në gjirin e natyrës njeriu mund të rrokë dëshirën e tij për ta shijuar e gëzuar jetën. Kredhja në soditjen e natyrës dhe monologimi me të zgjon te Fausti dëshirën për të lënë mënjanë ankimet e për t’u kredhur në aventura të reja plot ngazëllim. (Ndryshimet në gjendjen shpirtërore të Faustit do të shoqërohen në vazhdim edhe me ndryshim të metrit të vargjeve).*

3. Shpjegoni përdorimin e ironisë në vargun: “Ja bota jote, Faust, botë i thënçin!” Ç’imazhe (ose asosacione, përfytyrime) zgjon tek ju fjala *botë*?

4. Çfarë tiparesh të romantizmit, si drejtim letrar përcjellin vargjet 33-44?

**Grupi II:**

Vargjet e mësipërme karakterizohen nga një figuracion i ngjeshur. Gjeni figurat e shumta stilistike dhe renditini ato në tabelën e mëposhtme. Zgjidhni një prej tyre dhe shpjegoni si është ndërtuar nga ana gjuhësore.

Metafora	Epitete	Përsëritje artistike	Enumeracion
kam humbur gjithë gazn e jetës, Me shpresë se me forcën e me gjuhën e shpirtit do ta njoh të fshehtën, I shkundur nga kjo blozë e diturisë Ta mbyl çdo gjallëri të jetës? Dhe pastaj pyet përse zemra Mirëpo kam humbur gjithë gazn e jetës, Në gjoks të mshon e pikëlluar? sonde e pafsh të fundit herë brengën time;	Birucë e nëmur, Gazplotë e ngjeshur t’ëmbël, mjerisht		Jurisprudencë e medicinë, mjerisht edhe teologji, nga themeli, me zell e me durim; Dhaskenjtë,skrivanët, papazët, doktorët; Pa s’kam as pronë, as pasuri, as nder, Me qelqurina, kutira, instrumente,

**Grupi III:**

1. Në vargjet e mësipërme gjeni raste të përdorimit të figurës së pasthirmës dhe të pyetjes retorike. Interpretoni përdorimin e tyre në funksion të përmbajtjes dhe të formës poetike të vargjeve.

**Pasthirmë-** *O hënë e plotë, Medet! Çohu! Dil jasht!*

**Funksioni:** është një shpërthim poetik i ndjenjave, që shërben për t'i bërë më prekëse fjalët.

**Pyetje retorike** -*Medet! Në burg akoma qenkam?; Në gjoks të mshon e pikëlluar?; Ta mbyl çdo gjallëri të jetës?;*

**Funksioni-** tregon pakënaqësi, padurim, qortim, keqardhje.

2. Gjeni elementet gjuhësore që krijojnë kontrastin në vargjet 62-64. Sipas jush, si tingëllon thirrja që Fausti i drejton vetvetes në vargun e fundit? Cili është toni që e karakterizon këtë varg?

**Elementet gjuhësore:** Alitracioni me *m*, *k* jep ndjesinë e tmerrit që e rrethon me myk, kufomë.

**Thirrja:** e fortë , urdhëruese për të dalë prej asaj gjendjeje.

**Toni:** i ashpër, urdhërues...

Vargje nga reagimi letrar	
Në fillim, për temën dhe skenën reflektoj	
Dhe pastaj për personazhet,të këqij dhe heronj	
Unë futem brenda tyre, në vendin e tyre vihem, ashtu i kuptoj më mirë nga çfarë thonë dhe si sillen.	
Gërmoj që të gjej konfliktin a problemin për t’u zgjidhur	
Shoh si ndryshojnë personazhet qoftë të vegjël a të rritur.	



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Dhe gjatë gjithë historisë mundohem të mos harroj se qëllimin e autorit më duhet të zbuloj.	
Temë shumë interesante, sa e sheh që në fillim	
Por kur zhytemi më thellë e kuptojmë mençurinë,	
Syrin tjetër e mbaj hapur për temat universale	
Dhe pastaj i lidh ato me jetën time personale,	
Dashuri, urrejtje, shpresë, paqe dhe kulturë,	
Kështu mësoj të dalloj ç'është e keqe dhe e mirë,	
E shoh si më ka prekur libri në mendjen dhe në zemrën time,	
Pastaj me libra të tjerë shoh a ngjan a ka dallime.	
Kërkoj pjesë të rëndësishme, tekste a ndonjë citim	
Apo bëj interpretime, metaforë a krahasim.	
Jam kritik letrar i sertë, vlerësoj me rreptësi, personazhi dhe subjekti sa kanë vërtetësi?	
Më në fund e organizoj që të rrjedhë e gjitha qartë.	

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Organizues grafik për reagim letrar:**

Mësuesja ka përgatitur nga një skedë të rimuar për të nxitur krijimtarinë dhe reagimin e nxënësve dhe ia shpërndan secilit duke i lënë kohën e duhur për reagimin letrar.

Nxënësit mund ta vazhdojnë punën edhe në shtëpi.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Në një nga aforizmat e shkruara prej tij, Gëteja thotë: *“Njeriu që është i zoti t'i njohë kufizimet e tij shpesh arrin përkryerjen.”* Po ju si mendoni? Ilustrojeni përgjigjen tuaj:

- a) Nëpërmjet figurës së Faustit, mbështetur në vargjet e mësipërme.
- b) Duke sjellë në klasë raste që njihni nga jeta reale.

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Koment <b>“Vdekja e Faustit”</b> Gëte			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të fragmentit;</li> <li>• analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes Faustit</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme</li> <li>• tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit</li> </ul>			

<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ditëzi</li> <li>• rropatesh</li> <li>• rrëmeti</li> <li>• mbikqyrës</li> <li>• vardarin</li> <li>• varrin</li> <li>• truall i lirë</li> <li>• akrepi bie</li> <li>• shkoi, mbaroi</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor</li> <li>• skeda</li> <li>• kartonë</li> <li>• fletë formati.</li> </ul>
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	<b>Situata e të nxënit:</b> Interpretim me role i fragmentit
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Grupet e ekspertëve me role të specializuara, Korniza të skeletëzuara.</i>	

### Organizimi i orës së mësimi

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### **Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me kontrollin e dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë.

#### B. Ndërtimi i njohurive të reja

##### **Grupet e ekspertëve me role të specializuara :**

Për të krijuar atmosferë në klasë, lexohet bukur fragmenti, në fillim nga mësuesja dhe më pas, nga disa nxënës nëpërmjet lojës me role.

Analizohet fragmenti duke përdorur metodën **Grupet e ekspertëve**.

**1. Hulumtuesi** - Në ç'moment të jetës së tij është Fausti në këtë fragment? Si paraqitet gjendja e tij shpirtërore në këto vargje? Nga është përcaktuar kjo gjendje? Pse Fausti nuk vdes në shtrat?

A ndihet ai më në fund i lirë dhe i lumtur? Si paraqitet marrëdhënia mes personazheve, mesazhet etj.

**2. Gjetësi i citimeve** - Detyra e tij është që të gjejë citimet dhe fjalët më domethënëse që karakterizojnë personazhet, t'i paraqesë me zë dhe të ftojë grupin në komentim.

- Vargjet e mëposhtme janë ato që karakterizojnë më tepër Faustin, por nxënësit mund të zgjedhin për ilustrim edhe të tjera.

Kështu u hapet vend milionave të rrojnë,  
Jo ngeshëm, por në punë dhe të lirë

Dhe rreh të futet, por forcat e përbashkëta

Tok turren për të mbyllur plasat.

Këtij qëllimi i jam truar unë.

Ja përfundimi i mbram' i urtësisë:

Vetëm ai meriton lirinë e jetën

Që rreh ditë për ditë t'i fitojë.

“Pa ndalu! Sa e bukur qenke!

Shenjat e jetës sime tokësore

nuk do të shuhen kurrë nëpër shekuj;

në parandjenjë të lavdisë së tillë

- Analizoni nëntekstin e togjeve: Çfarë tregon domethënia e këtyre togjeve për perspektivën e njerëzimit. A është ajo një perspektivë e ndritur apo e errët e parë me sytë e Faustit?

- “toka si parajsë” që sigurohet me punë vetmohuese;
- lufta për të hequr “pellgun e molepsur”;
- “tallazi bregun rreh të futet” për të shkatërruar ç’është ndërtuar;
- “forcat e përbashkëta” tok turren për të mbyllur plasat.

**3. Interpretuesi i personazheve**-Detyra e tij është që të mendojë me kujdes për personazhet, karakteret e tyre mesazhet që përcjellin fjalët dhe sjellja e tyre dhe ti diskutojë ata me nxënësit e tjerë. Metoda e zgjedhur është plotësimi i bioskedës për personazhet si me poshtë:

**Fausti**

Plan	Mendime	Fjalë	Ndjenja
Veprime	Anët e dobëta	Anët e forta	Personaliteti

**4. Lidhësi:** Ka për detyrë të gjejë lidhjet mes tekstit dhe botës jashtë shkollës, realitetit të përditshëm, shembuj nga letërsia, filma, fjalë të urta shqiptare që përcjellin mesazhe të ngjashme për punën, përpjekjen për të arritur suksesin etj.

**5. Pyetësi** - Kërkon në tekst pyetje dhe probleme për t’u shqyrtuar, p.sh.:

- a. Pse atij i shkakton kaq shumë kënaqësi zhurma e shatave? A ndihet ai më në fund i lirë dhe i lumtur?
- b. Gëteja që mbrojtës i flaktë i jetës aktive. Ai i thuri lavdi heroizmit dhe guximit krijues. Me figurën titanike të Faustit ai dënon njerëzit që kanë frikë nga shtrëngatat. Gjeni vargjet ku shprehet kjo ide.
- c. Marrëdhënia e Faustit me Mefistofelin ka ndryshuar. Duket që Fausti ndihet i lirë dhe s’i bëjnë përshtypje fjalët nanuritëse e të zbrazëta të Mefistofelit, të cilin, madje, e shtrëngon t’i shërbejë një qëllimi pozitiv. Gjeni vargjet ku shprehet kjo ide në tekst dhe shpjegoni ku buron kjo forcë e brendshme e Faustit.
- d. Cila është ndërmarrja e guximshme që Fausti merr përsipër në fund të jetës së tij? Ç’kuptim merr rrëfimi i bërë me sytë e një të verbëri? Cila është drita që i ndrin atij në zemër dhe ia qartëson qëllimin?
- e. Analizoni bindjet e Faustit mbi çështjen e lumturisë duke u bazuar në idetë e listuara më poshtë:
  - Njeriu është i lumtur nëse dhe të tjerët janë të lumtur.
  - Çdo sakrificë e ka një shpërblim, dhe s’ka asgjë që njeriun mund ta lumturojë më shumë sesa shijimi i rezultateve të punës së vet.
  - Bindja dhe vendosmëria e tij vjen pas gjymtimit fizik dhe dëshirës për vetëpërsosje e pastrim moral.
  - Ai që ndien kënaqësi duke punuar dhe kënaqet për ato që ka bërë, është i lumtur.

Pasi grupet eksperte mbarojnë punën, diskutohet mbi çështjen e mëposhtme:

***Diskutoni në klasë mbi kënaqësinë që të fal puna për të mirën e shoqërisë si dhe mbi sakrificat që shpesh duhet të bësh.***

Ilustrojini mendimet tuaja duke sjellë raste nga jeta juaj personale, raste që njihni nga personalitetet e njohura të artit, letërsisë, historisë, politikës, shkencës.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura****Korniza të skeletëzuara.**

U shpërndahen nxënësve disa korniza të skeletëzuara për të reflektuar mbi fragmentin dhe veprën.

**1. Argumentim bindës**

A dëshironi të jetoni në një botë \_\_\_\_\_. Kjo do të ndodhë në qoftë se \_\_\_\_\_ të gjithë ne \_\_\_\_\_. Pse? Sepse \_\_\_\_\_. Disa thonë që \_\_\_\_\_. Ata motivohen nga \_\_\_\_\_.

Përkundrazi këto zgjidhje vetëm shërbejnë për të \_\_\_\_\_. Në fund të fundit propozimi ynë është më i efektshëm sepse \_\_\_\_\_.

**2. Interpretim**

Në pamje të parë \_\_\_\_\_ ishtenjëvepër \_\_\_\_\_ përnjë \_\_\_\_\_. Megjithatë besoj se autori e ka përdorur ngjarjen për t'u dhënë lexuesve një mësim më të thellë për \_\_\_\_\_.

Për shembull \_\_\_\_\_ . Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Po kështu kur \_\_\_\_\_.

Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Së fundi \_\_\_\_\_.

**3. Zbatimi**

Unë e kuptoj shumë mirë qëllimin \_\_\_\_\_. Në moment të caktuara edhe unë ndihem \_\_\_\_\_. P.sh. \_\_\_\_\_.

Megjithatë unë nuk \_\_\_\_\_ pasi \_\_\_\_\_.

**4. Zbatimi - Reagim ndaj një vepre.**

Në tragjedinë \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ më ka bërë veçanërisht përshtypje \_\_\_\_\_ e personazhit \_\_\_\_\_. Përshtypja ishte shumë e fuqishme, sepse \_\_\_\_\_.

Për shembull unë \_\_\_\_\_. Megjithatë reagimi im nuk do të ishte i njëjtë me atë të personazhit. Unë \_\_\_\_\_, kurse personazhi \_\_\_\_\_.

Mendoj që \_\_\_\_\_. Në të ardhmen do të \_\_\_\_\_.

**5. Sintezë**

Përtë arriturtë kuptojmë më mirë çështjone \_\_\_\_\_ duhet të sintetizojmë këndvështrimet e mëposhtme: Këndvështrimi i parë thotë që \_\_\_\_\_ dhe si prova përdor \_\_\_\_\_. Kjo mund të jetë e vlefshme për \_\_\_\_\_.

Kjo \_\_\_\_\_ . Këndvështrimi i tretë i përshtatet më shumë \_\_\_\_\_. Për këtë arsye ndonëse për këtë \_\_\_\_\_ ekzistojnë shu më \_\_\_\_\_ sinteza e këtyre këndvështrimeve tregon bindshëm që \_\_\_\_\_.

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë e përvetësuara për tragjedinë “Fausti”, për rolin në grupet e ekspertëve dhe për reagimin origjinal ndaj veprës.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Mësim përmendësh i rolit të caktuar për orën e dramatizimit.
- Shkruani një ese letrare me temë:(Shënim: Mund të përdoret për portofolin)

“Dashuria për dijen dhe për jetën janë krahët e shpirtit për bëma të mëdha”.

## PLANIFIKIMI DITOR


<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore –Viktor Hygoi. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>përshkruan momentet kryesore të jetës së <b>V. Hygo</b>, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij</li> <li>veçon veprat kryesore të V. Hygo</li> <li>dallon veçoritë e romantizmit në vepërimtarinë krijuese</li> <li>diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Hygos në letërsinë botërore.</li> <li>përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> <li>respekton mendimin e të tjerëve</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Plaku i mençur</li> <li>Roman</li> <li>Romantik</li> <li>Napoleoni</li> <li>“Katedralja e Parisit”</li> <li>francez</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Video-projektor</li> <li>Tabela apo flipchart</li> <li>Internet</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi njohuritë e nxënësve për Viktor Hygoin.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Stuhi mendimesh, Përmbledhje e strukturuar, Lexim i pavarur /Kllaster, Pyetje-përgjigje</i>			

### Organizimi i orës së mëimit

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### **Stuhi mendimesh:**

Ç’dini për romantizmin?




**Përmbledhje e strukturuar:**

Mësuesi/ja flet në mënyrë të përmbledhur për kontekstin historik kur jetoi V. Hygo, krijimtaria, veçoritë e romantizmit dhe rëndësia e tij

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Lexim i pavarur/Kllaster:**

Lexohet materiali në tekst dhe më pas hartohet kllasteri me të dhënat kryesore.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura****Pyetje-përgjigje:**

Punohen pyetjet me të gjithë klasën:

1. Hygoi është shkrimtari i madh i shek. XIX, figura më e ndritur e romantizmit francez. Pse cilësohet si i tillë?

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

2. Cilat janë disa nga veprat e tij më të rëndësishme? Flisni për to.

3. Hygoi mendon se e keqja nuk duhet ndëshkuar me të keqe, vetëm zemërgjerësia mund ta zhdukë atë. Po ju, ç'mendim keni? A gjeni në përditshmërinë tuaj raste ku zë vend kjo ide?

4. Nuk mungojnë në veprën e Hygoit dhe refleksione e meditime filozofike, politike, sociale a ekonomike. Ja, një përsiatje mbi shpikjen e Gutenbergut:

*Shpikja e shtypshkronjës është ngjarja më e madhe në histori. Ajo është nëna e të gjitha revolucioneve. Në fjalën e shtypur mendimi u bë i pavdekshëm, u bë fluturues, i pakapshëm, i parrënueshëm: u përzie me ajrin. Në kohën e arkitekturës, mendimi shndërrohej në një shkëmb, në një grumbull gurësh dhe pushtonte një shekull dhe një hapësirë të caktuar. Tani ai shndërrohet në një tufë me zogj, fluturon në të katër anët dhe zë njëherësh të gjitha pikat e ajrit dhe të tokës.*

Mbi ç'figurë letrare është ngritur ky meditim? Bëni interpretimin tuaj.

Antitezë: Në kohën e arkitekturës, mendimi shndërrohej në një shkëmb, në një grumbull gurësh dhe pushtonte një shekull dhe një hapësirë të caktuar. - Tani ai shndërrohet në një tufë me zogj, fluturon në të katër anët dhe zë njëherësh të gjitha pikat e ajrit dhe të tokës.

Antiteza vihet në funksion të rëndësishë së shpikjes së Gutenbergut. Falë saj libri përhapet me shpejtësi në kohë e hapësirë gjeografike.

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për detyrat e shtëpisë, leximin aktiv të tekstit, për pyetjet dhe saktësinë e përgjigjeve.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Dallonin disa veçori të romantizmit në poezinë *KËNGA E ATYRE QË IKIN PËRTEJ DETIT*, Viktor Hygo dhe krahasoni atë me krijimin "Lamtumirë" të Xh. Bajronit.

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: V. Hygo. Analizë "Katedralja e Parisit"			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të romani "Katedralja e Parisit";</li> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);</li> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi (koha, vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat e një teksti;</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vepra romantike</li> <li>• pasione njerëzore</li> <li>• turma</li> <li>• stili gotik</li> <li>• ngjarjet në shek. XV</li> <li>• gungaçi</li> <li>• pasion demoniak</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Flipchart</li> <li>• Tabela e zezë</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe	Situata e të nxënit: Në video-projektor shfaqen disa sekuenca nga Notre Dame Paris
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP-Vëzhgim filmi, Diskutim mbi njohuritë paraprake, Lexim në dyshe, Praktikë e udhëhequr	

### Organizimi i orës së mësimi

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim:** Mësuesja diskuton me nxënësit detyrate shtëpisë. Kanë bërë krahasimin mes dy poezive

- Janë poezi romantike (kulti i ndjenjës, largimi, zhgënjimi, vetmija...etj.)
- Vihen re motivi i -vetmisë , zhgënjimit, dëshira për ikje, malli e pesimizmi, liria si kërkesë të brendshme e qenies.

– Një nga tiparet është paralelizmi i gjendjes shpirtërore të heronjve me natyrën psh. Tallazi dhe tronditja

shpirtërore në shpirtin e heroit gjejnë pasqyrim në element të natyrës (deti, shpendët e detit) *Gjëmon stuhia me tërbim/ çaçri gërhet mbi valë.../ Atdhe, lamtumirë! /Vala shfryn si egërsirë.*

- Heroi romantik në dy poezitë ka ikje, largim , braktisje trishtim , mall, dhimbje.
- Janë në kërkim të lirisë personale.
- Ngarkesat emocionale, figuracioni, metri, strofa ndryshon (këtu është strofa Safike) etj.

**Vëzhgim filmi:** <https://www.youtube.com/watch?v=k3Vc11CdsIA>

Në video-projektor shfaqen disa sekuenca nga vepra “Katedralja e Parisit”.

Nxënësit kanë lexuar “Katedralen ” dhe materialin teorik në libër dhe kanë punuar hartën e ngjarjes, të cilën e saktësojnë së bashku me mësuesen.

<b>Vendi dhe koha</b>	Katedralja e Shën Maria, vendosë ngjarjet në mesjetë, në Parisin e shekullit XV
<b>Lloji</b>	<b>Roman historik</b> shkruar, sipas mbresave të ngjarjeve të Revolucionit të 1830-ës, i cili përmbysi monarkinë.
<b>Personazhet</b>	Kuazimodo, Esmeralda, Klod Frolo, Febys, Luigji XI
<b>Mjedisi</b>	Arkitektura është një dëshmi e gjallë e racës njerëzore ku çdo brezni shkruan kalimthi historinë e vet, ndaj Hygoi ndalon në një përshkrim të detajuar të arkitekturës gotike të Katedrales së Parisit.
<b>Rrëfimi</b>	Bëhet në vetën e III, <i>E papritura, e jashtëzakonshme, rastësorja, befasuesja dhe tronditësja</i> përbëjnë elementet bazë të rrëfimit romantik.
<b>Ngjarjet kryesore</b>	-Esmeralda, cigania 16-vjeçare, mishërimi i bukurisë morale e fizike, kishte një efekt magjik mbi këdo. E gjendur e vetme, natën, sulmohet nga gungaçi i katedrales dhe prifti i saj, Klod Frolo. -Esmeralda shpëtohet nga kalorësi Febys dhe Shatoper. -Cigania e dlië bie në dashuri me shpëtimtarin e saj. -Klod Froloja, dashuruar marrëzisht me pasion demoniak pas Esmeraldës, nuk mund të tolerojë këtë dashuri, ndaj qëllon Febysin dhe, duke qenë se Esmeralda më mirë pranon të vdesë sesa të bëhet e tija, fajëson ciganen për këtë krim. -Esmeralda, bashkë me dhinë e saj, e akuzuar për magji, për çoroditje morale dhe për vrasjen e zotit Febys dhe Shatoper, dënohet me varje. -Në çastin fatal të ekzekutimit gungaçi e rrëmben nga krahët e vdekjes dhe e strehon në Katedrale, por Klod Froloja nuk mund të heqë dorë nga pasioni i tij i çmendur. Ky i lig i pashpirt e çon ciganen drejt vdekjes. -Fundit tragjik të Esmeraldës do t'i bashkohet dhe Kuazimodoja. Jeta e tij mbaron duke përqaftuar Esmeraldën që s'jeton më. -Pavarësisht këtij fundi, fitorja morale është e tyre: në ndeshjen dramatike të së mirës me të keqen, trumfi i takon së mirës.



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

<b>Situatat e pazakonta</b>	<p>Përshkrimi i varësisë së njeriut të mesjetës nga dogma dhe bestytnitë e përshkon tërë romanin. Nga ky këndvështrim, e papritura, e jashtëzakonshme, rastësorja, befasuesja dhe tronditësja përbëjnë elementet bazë të rrëfimit romantik. Kjo bën që në roman të pleksen një sërë situatash të tilla të pazakonta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuazimodoja, një i shurdhër, merret në pyetje dhe gjykohet nga një ndihmësgjyqtar shurdh;</li> <li>• cigania Esmeraldë pranon të marrë për burrë Grenguarin vetëm që ta shpëtojë atë nga ekzekutimi me vdekje;</li> <li>• E Vetmuara, nga biruca, varri i përkohshëm i nënës së pashpresë që ka humbur vajzën-foshnjë, shfryn e mallkon ciganen pa ditur që ajo është e bija për të cilën ka qaq vjet që po vuan. E Vetmuara njuh dhe ka pranë vetes të bijën vetëm në çastin që do ta humbasë përgjithmonë atë;</li> <li>• gungaçi besnik ngrihet ndaj Atit, Zotit të tij, arqidiakut Frolo për të cilin më parë ishte gati të kryente çdo çmenduri;</li> <li>• pas vdekjes së Esmeraldës gungaçi zhduket. Në varrezën e Monfokonit gjejnë një skelet të shtrembëruar që mbante përqaftuar një skelet gruaje. Kur i ndanë nga njëri-tjetri, skeleti i shtrembëruar u bë hi e pluhur.</li> </ul>
<b>Linja kryesore</b>	Lufta për të shpëtuar Esmeraldën
<b>Përshkrimet</b>	Përshkrimi i ngjarjeve që zhvillohen brenda dhe rreth Katedrales jepen në formën e një rrëfimi gotik, që imiton me mjeshtëri të rrallë arkitekturën gotike të Katedrales. Është i drejtë vlerësimi që thotë se katedralja e <i>Notrë Damë</i> dhe romani i Hygoit do ta ndajnë bashkë përjetë lavdinë.
<b>Tema</b>	Fatet vetjake të personazheve dhe fati i një turme të harbuar në Katedralen e mesjetës me ngjarjet brenda dhe rreth saj.
<b>Mesazhe</b>	Lufta e së mirës kundër së keqes, e drejtësisë kundër padrejtësisë.

### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### **Lexim në dyshe:**

Pasi punohet me hartën e ngjarjes mësuesja kalon në analizën tematike ideore të veprës. Me anë të teknikës *Lexim në dyshe* nxënësit përvetësojnë materialin në tekst:

**1.** Kur dhe ku zhvillohen ngjarjet në roman? I ç’lloji është ai?

*Katedralja e Shën Maria, vendosë ngjarjet në mesjetë, në Parisin e shekullit XV*

**2.** Pse Hygoi i vendos ngjarjet në mesjetë?

*Si romantik, Hygoi e kërkon subjektin për veprën të historia e kombit të tij dhe përmes trajtimit të temës historike, tregon epërsinë e sistemit demokratik e republikan mbi atë monarkik e autokratik*

**3.** Si e përshkruan Hygoi Katedralen? Përshkrimi i saj bëhet thjesht nga pozitat e një romantiku?

*Shën Mëria e Parisit është një ndërtesë madhështore që ngrihet gjer lart në qiell, një simfoni e madhe prej guri, një tërësi e vetme dhe njëkohësisht e ndërlikuar ku koha ka lënë gjurmët e veta dhe koloritin e errët të shekujve. E mistershme, me kube të errta e pllakat të lagështa, kulla të larta, kërcënuese, të frikshme dhe fasadë të zyrtë, Katedralja bëhet një godinë fantastike, e mbinatyreshme. Kështu, Katedralja ngjason me një gjallesë që vjen nga bota e miteve të lashta.*

**4.** Cilat janë ngjarjet kryesore të romanit?

*-Esmeralda, cigania 16-vjeçare, mishërim i bukurisë morale e fizike, kishte një efekt magjik mbi këdo. E gjendur e vetme, natën, sulmohet nga gungaçi i katedrales dhe prifti i saj, Klod Frolo.*

*-Esmeralda shpëtohet nga kalorësi Febys dhe Shatoper.*

*-Cigania e dlië bie në dashuri me shpëtimtarin e saj. etj.*

**5.** Me ç’tipare janë vizatuar tri personazhet kryesore? Po turma? Pse janë aq mbresëlënëse ato?

*-Esmeralda, dielli që shndrit bodrumet e Parisit, është mishërim i bukurisë morale, shpirtërore e fizike.*

*-Kuazimodoja, gungaçi me shëmti të jashtëzakonshme fizike, është ndërmjetësi që siguron lidhjen mes turmës dhe Katedrales. Bukuria e Esmeraldës transformon Kuazimodon. Gjymtimi i tij fizik nuk*

cënon shpirtin e tij, vendin ku ruhet njerëzorja.

-Froloja, prifti i Katedrales, karakterizohet nga fanatizmi e obskurantizmi fetar mesjetar. Tek ai, edhe ndjenjat më të natyrshme njerëzore kanë shfaqje të shëmtuar.

-Turma, personazhi me mijëra fytyra e ngjyra. Skenat masive plot gaz e bujë popullojnë tërë romanin. Turma bën sheshin të oshëtijë prej gëzimit ose të lebetitet nga ankthet e saj; turma, e dehur, brohoret me klithma entuziazmi

6. Hygoi e parapëlqen kontrastin dhe e bën themel të veprës. Pse? Çfarë kontrastojnë në vepër?

- Kontrasti, teknika e preferuar e romantikëve;

- Madhështia e Katedrales përkundër gjallërisë së sheshi;

• Shëmtimi i Kuazimodos përkundër bukurisë së Esmeraldës;

• Poezia e lartë përkundër karikaturës groteske;

• Përçudnimi i Kuazimodos përkundër shpirtmadhësisë së tij;

• E madhërishmja përkundër së ultës;

• E jashtëzakonshmja është rregulli, kurse e përditshmja dhe realja vetëm përjashtim nga rregulli.

7. Cilat janë idetë kryesore në roman?

- Lufta e së mirës kundër së keqes.

- Të drejtësisë kundër padrejtësisë

8. Ku shfaqet romantizmi në vepër?

- Vlerësohet si një ndër romanet më përfaqësuese të drejtimit letrar romantik. Hygo ka derdhur në këtë vepër një fantazi thuajse përrallore

• Kontrasti, teknikë e preferuar e romantikëve, i ndërton tablotë në pranëvënie kundërshtuese, për të nxjerrë në pah me forcë tiparet dhe detajet

• Kthesat e befasishme

• Përshkrimi madhështor i katedrales etj

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Pesëvargësh:**

Nxënësit ndërtojnë një pesëvargësh për Kuazimodon dhe për Esmeraldën.

Përshkruaj Kuazimodon.

-Me anë të një emri \_\_\_\_\_

-Me anën e dy mbiemrave \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

-Me tri folje \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

-Me anën e një fraze \_\_\_\_\_

-Duke e ripërcaktuar me një sinonim \_\_\_\_\_

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Lexoni fragmentin “Gungaçi i Katedrales”, V. Hygo.


PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Koment “Gungaçi i Katedrales” V. Hygo</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësim:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj;</li> <li>• dallon temën dhe motivet e fragmentit;</li> <li>• analizon personazhin e Kuazimodos, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim);</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuazimodo</li> <li>• Kambanarja</li> <li>• memeci</li> <li>• shurdhi</li> <li>• pishtari</li> <li>• gungaç</li> <li>• çalaman</li> <li>• për zemer</li> <li>• mendjegjysmaku</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fletë formati</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi		<b>Situata e të nxënit:</b> Filmi “Katedralja e Parisit”, fragment.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Teknikat e të pyeturit, Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur në grupe, Shkrim i lirë</i>			

**Organizimi i orës së mësim**

A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

Hartë personazhi:



B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Praktikë e udhëhequr:**

Punohet me aparatën pedagogjik në tekst. Pyetje për kuptimin.

1. Fragmenti na paraqet portretin e Kuazimodos në disa plane. Me ç’detaje jepet:

**portreti fizik** : gungaç, çalaman dhe gjysmë i verbër ;

**shpirti**: mjerueshme, të rrëgjuar, të drobitur ;

**mendja e Kuazimodos** : mendje e gjymtuar, shtrembërim i të menduarit, budalla, i çmendur.

2. Pse Kuazimodoja e dënoi veten me heshtje? Cilës gjë i druhej ai?

*Sapo dalloj që ishte shurdhuar, e dënoi veten me heshtje, të cilën e thyente vetëm kur s’kishte njeri*

tjetër pranë. E lidhi me dashje gjuhën që të mos qeshnin me të.

*Kuazimodoja i druhej talljes.*

3. Hygoi thotë se Kuazimodoja e donte Frolon sa Katedralen. Pse kjo shenjë barazie? Cili ishte raporti i gungaçit me arqidhiakun Frolo?

*Ky njeri ishte Klodi, i ati në shpirt, ai që e kishte marrë, ushqyer e rritur. Që në moshën më të njomë Kuazimodo gjeti strehë te këmbët e Klod Froloit.*

*Të mos harrojmë dhe lidhjet e tij tmerrësisht të fuqishme me Shën Mërinë, Katedralen.*

*Pushteti i arqidhiakut mbi kambanarin ishte i stërmadh, i shenjtë, i pakrahasueshëm. E tillë ishte dhe dashuria e Kuazimodos për priftin.*

*Jeta e Kuazimodosë lidhej me Katedralen dhe Frolon. Ai është rritur me to dhe i ka strehë e shpëtim.*

*Prandaj Kuazimodoja nuk i ndante dot nga njëri-tjetri dhe i donte njësoj si Katedralen, ashtu dhe arqidhiakun.*

4. Cila ishte marrëdhënia e kambanarit me Katedralen? Gjeni në fragmentin e 2-të similitudën që tregon këtë lidhje të veçantë.

*Kuazimodoja e donte arqidhiakun aq fort sa as qeni, as kali, as elefanti, kurrë nuk e ka dashur të zotin.*

### **Punë e pavarur në grupe:**

#### **Grupi I:**

1. Lexojeni dhe një herë paragrafin e mëposhtëm dhe përgjigjuni kërkesave në vazhdim:

*Po të rrëmonin nën koren e trashë e të ashpër të shpirtit të Kuazimodos, në thellësitë e brendshme të krijesës së shëmtuar, do të shihnim me ndihmën e një pishtari se çfarë do të kishte pas lëvozhgës së patejdukshme, mund të preknim botën e brendshme e të papërshkueshme, mund të arrinim në skutat e errëta, në qoshet e fshehta të ndërgjegjes dhe të hidhnim papritur një rreze të fortë drite mbi shpirtin e kapur me thonj në fundin e shpellës, do ta gjenim atë patjetër në gjendje të mjerueshme, të rrëgjuar, të drobitur, si ata të burgosurit e birucave prej guri të ngushta e të ulëta, të Venecias, që plakeshin të përkulur e të enjtur nga tmerri.*

a) Në këtë fragment Hygoi tregon qartë se nuk duhet t'i shohim gjërat vetëm në atë që jep dukja, sipërfaqja e tyre; ai na fton të zhbijojmë në brendësi e në thellësi të tyre. Gjeni detaje që na japin shpirtin e Kuazimodos në këto plane:

Në sipërfaqe	Në brendësi
<i>Krijesë e shëmtuar, kore e trashë, e ashpër, lëvozhgë e patejdukshme.</i>	<i>Shpirt i kapur me thonj në fundin e shpellës, gjendje të mjerueshme, të rrëgjuar, të drobitur, si ata të burgosurit e birucave prej guri të ngushta e të ulëta, të Venecias, që plakeshin të përkulur e të enjtur nga tmerri.</i>

b) Hygoi kërkon një pishtar që të hedhë një rreze të fortë drite në shpirtin e Kuazimodos? Ç'kuptoni ju me këtë? Cila është vlera simbolike e dritës në këtë rast?

*Krejt në kontrast me pamjen kërkon të zbuloj dritë shirti të madh në thellësi të këtij njeriu të vrarë nga jeta por që ndriçon nga brenda...Të zbulojë*

*Hygoi sugjeron të shihet brendësia e njeriut, shpirti i tij. Të trajtohet ai butësisht, të ngjallet shpresa. Drita simbolizon mirësinë. Te rrezatimi i saj Hygoi beson fort. Përmes saj e keqja dobësohet dhe njeriu nxjerr në pah vlerat e virtytet njerëzore.*

c) Gjeni similitudën e përdorur në fragment dhe bëni komentin tuaj.

*si ata të burgosurit e birucave prej guri të ngushta e të ulëta, të Venecias, që plakeshin të përkulur e të enjtur nga tmerri.*

*Njeriu nul lind i keq, po kështu dhe Kuazimodoja. Ai është tallur, përbuzur, ka marrë një mijë e një mallkime, është trajtuar shtazërisht nga të gjithë, ndaj dhe shpirti i tij ka pësuar deformime njësoj si fiziku i tij. I burgosur në skutat e veta, shpirti i Kuazimodosë është përkulur e enjtur nga tmerri, njësoj si të burgosurit e birucave.*

**Grupi II:**

1. Hygoi bën analiza të imta të shpirtit njerëzor, hyn në vetëdijen dhe në skutat e errëta të pavetëdijes, kërkon të gjejë shpjegime, arsyeton, zbulon raporte shkak-pasojë. Rendisni disa raste të raporteve të tilla. Ndalonini në secilin prej tyre dhe thoni a ndani të njëjtin mendim me autorin. Shpjegoni pse.

Shkaku	Pasoja
- zhurma e kambanave - <b>shurdhësia...</b> - derë e mbyllur - shurdhësia - për të mos u dhënë të tjerëve shkak të qeshnin edhe më - rronte i vetmuar, ishte i shëmtuar; kishte parë veten të përbuzur, të përqeshur, të poshtëruar etj.	- iu ça daullja e veshit dhe u shurdhua - e veçon nga bota - ndal rrezen e vetme të gëzimit e të dritës, që depërtonte ende në shpirtin e Kuazimodos. Pas kësaj ky shpirt u krodh në errësirë të thellë. - e bëri pothuajse memec - Kuazimodoja e dënoi veten me heshtje - bëhet i lig etj.

2. Ç'ide përcjell, sipas jush, Hygoi në paragrafin e fundit të pjesës së 1-rë?

*Jo, ligësia e tij nuk ishte diçka e lindur bashkë me të. Që në hapat e parë bashkë me njerëzit ai e kishte ndjerë urrejtjen dhe pastaj e kishte parë veten të përbuzur, të përqeshur, të poshtëruar. Të folurit e njerëzve ishte për të ose një përqeshje, ose një mallkim. Duke u rritur, ai kishte gjetur përqark tij vetëm urrejtje. Këtë urrejtje ai e kishte përvetësuar, ishte bërë i lig si të tjerët dhe kishte rrokur armën me të cilën e patën plagosur.*

*E keqja nuk lind bashkë me njeriun. E keqja mbjell veç të keqe. Duhet ta trajtojmë tjetrin me dashuri e butësi, pasi çdo gjë na kthehet pas.*

**Grupi III:**

1. Antiteza, kontrasti dhe hiperbola janë figura të parapëlqyera të romantikëve. Gjeni një hiperbolë dhe një antitezë në tekst dhe tregoni funksionin artistik të tyre.

*në skutat e errëta - një rreze të fortë drite*

*çka hynte në të, dilte së andejmi e shtrembëruar.*

*Kjo gjendje e çuditshme përfuthte tek ai njëmijë fanitje të rreme*

2. Gjeni në fragment rastin kur dy shprehje frazeologjike të njëpasnjëshme janë antiteza të njëra-tjetrës; jepni fjalët sinonimike me to.

*E lidhi me dashje gjuhën - që Klod Froloi mezi ia zgjidhi*

*lidh gjuhën - hesht*

*zgjidh gjuhën - flas*

3. Ç'kuptoni me togun *shëmtimi i tij i bukur*?

*Kuazimodoja ishte i shëmtuar vetëm fizikisht. Në trupin e tij të shëmtuar jeton një shpirt i bukur që vlerëson çdo gjest mirësie që tregohet ndaj tij. Përmes togut kuptojmë dhe simpatinë e Hygoit për personazhin.*

4. Gjeni fjalinë eliptike në fragmentin e 1-rë.

*Trupi i gjymtuar, edhe mendja po ashtu.*

a) Shkruajeni atë si një fjali të përbërë:

-bashkërenditëse \_\_\_\_\_

-nënrenditëse shkakore: \_\_\_\_\_

b) Si e kuptoni secilën prej tyre? A jeni dakord për secilin rast. Argumentoni pse.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Shkrim i lirë:

Reagim ndaj historisë së këtij romani. Nxënësit shkruajnë në minutat e lëna në dispozicion reagimin dhe përshtypjet për ngjarjen e fragmentit.

Në historinë e Kuazimodos më ka bërë veçanërisht përshtypje \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_. Përshtypja ishte e fuqishme sepse \_\_\_\_\_

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në klasë, për njohuritë mbi veprën, për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi fragmentin.

Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur: Ushtrimi nr. 12

Lexoni fragmentin “Shpëtimi i Esmeraldës” nga “Katedralja e Parisit”

### PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – <b>Koment “ Shpëtimi i Esmeraldës”, V. Hygo</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përmbledh me fjalët e tij përmbajtjen e fragmentit duke e ilustruar me detaje dhe shembuj;</li> <li>• dallon temën dhe motivet e fragmentit;</li> <li>• analizon personazhin e Kuazimodosë, Esmeraldës, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim);</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme, kontrastet</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuazimodo</li> <li>• Katedralja</li> <li>• shurdhi</li> <li>• Xhali</li> <li>• e dënuar me vdekje</li> <li>• i shëmtuar</li> <li>• mozaik</li> <li>• e qeshur shurdhuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fletë formati</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	<b>Situata e të nxënit:</b> Filmi “Katedralja e Parisit”, fragmenti në vazhdim		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake: praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur në grupe, Diskutim.</i>			

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë.

-dashuria e Kuazimodos për priftin janë në raporte të drejta, ka pasë mbështetje nga ana e priftit...

-Paragrafi i fundit i fragmentit

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Praktikë e udhëhequr:**

Punohet me aparatën pedagogjike në tekst. Pyetje për kuptimin.

1. Në këtë fragment Katedralja nuk shfaqet vetëm si mrekulli e artit gotik mesjetar, por edhe si vendstrehim i fatkeqëve, i të përvuajturve dhe të përndjekurve. Ku duket kjo?

*Në strehimin e Esmeraldës...*

2. Kuazimodoja shpëton Esmeraldën, të cilën e kishte sulmuar pak kohë më parë. Nisur nga romani, shpjegoni pse Kuazimodoja kryen këtë akt human. Çfarë e bëri të ndryshojë qëndrimin ndaj ciganes?

*Esmeralda i jep ujë gungaçit të mjerë, e ndihmon kur të gjithë po e tallnin dhe po e përbuznin....*

3. Cila është pyetja që Esmeralda i drejton Kuazimodos? Ç'kuptojmë përmes saj? Si ndjehet Esmeralda?

*- Pse më shpëtuat?*

*Esmeralda është e lodhur, e dërrmuar, ajo s'ka dëshirë të jetojë.....*

4. Komunikimi i Kuazimodos me Esmeraldën më shumë se në fjalë bazohet në veprime, mbushur me dashuri e përkujdesje njerëzore. Çfarë i ofron Kuazimodo Esmeraldës?

*Ai i ofron Esmeraldës veshje, ushqime dhe një dyshek.*

*Ai kishte në një dorë një shportë dhe në tjetrën një dyshek. Në shportë kishte një shishe, pak bukë dhe disa ushqime*

*Ata ishin të shtypur, të varfër, njerëz të thjeshtë...e mjerë, fëmijë e gjetur dhe e dënuar me vdekje, krijesë fatkeqe, pa atdhe, pa familje, pa strehë!*

**Punë e pavarur në grupe:**

**Grupi I**

1. Cili është tipari dallues i gjuhës së Kuazimodos? Nga është përcaktuar ky tipar?

*Tipar dallues i gjuhës së Kuazimodosë është lakonizmi. Ky tipar është përcaktuar nga shurdhësia e tij, nga tallja e përbuzja e të tjerëve...*

2. Gjeni retrospektivën (flashback-un) në fragment. Cili është funksioni i saj? A paralajmëron ajo ndryshime në sjelljen e mëvonshme të Esmeraldës?

*Atëherë iu zgjuan edhe kujtimet dhe këto i dolën para syve e para mendjes një nga një. Ajo e kuptoi që ndodhej në katedralen e Shën Mërisë; u ndërmend që e kishin rrëmbyer nga duart e xhelatit, që Febysi ishte gjallë dhe që Febysi nuk e donte më.*

*Esmeralda ishte e dashuruar me Febysin dhe jeta e saj pa të nuk do të kishte asnjë vlerë.*

3. Befasia dhe e papritura përbëjnë indin romantik të romanit. Gjeni situatat e tilla në fragment. Si ndikojnë ato tek Esmeralda?

*Shfaqja e dhisë është një tjetër e papritur lidhur me fragmentin. Xhali do të ndryshojë gjendjen emocionale e shpirtërore të Esmeraldës.*

*Ishte ftuja e saj e mjerë, e shkathëta Xhali, që kishte rendur prapa të zonjës... Cigania e mbuloi ftujën me të puthura.*

*Një si dorë e padukshme i hoqi barrën që i rëndonte në zemër, dhe lotët, që deri atëherë mezi i kishte mbajtur, filluan t'i ridhnin faqeve. E, duke qarë në këtë mënyrë, ndjente se bashkë me lotët po i derdhej edhe vreri i hidhur i brengës.*

4. Esmeralda përjeton ndjesi të ndryshme përgjatë fragmentit. Cilat janë ato? Gjeni katër mbiemrat kyç që shprehin etapat nëpër të cilat kalon ndryshimi i shkallëshkallshëm i botës ndjesore të ciganes:

*e alivanosur, e tronditur, e çuditur, e lehtësuar*

5. Bëni komentën tuaj për fjalinë: *Me t'u errur, nata iu duk e bukur dhe vezullimi i hënës i butë.*

*Ka elemente romantike që shoqërojnë heroinën, për të gjithçka kishte kaluar, tani e lehtësuar nga mundimet po shijonte hënën që ndriçonte aq shumë terrin e natës duke e bërë më të butë e të qetë momentin.*

### Grupi II

1. Cila është figura letrare e përdorur në togun e përpiu të kuqtë? Ç'tregon kjo për natyrën e Esmeraldës?

Shpjegoni funksionin artistik të figurës.

*përpiu të kuqtë- metaforë ka funksionin e turpit të madh*

2. Kuazimodo i sjell veshje Esmeraldës: Ishte një fustan i bardhë, me një vel të bardhë, veshja e murgeshave të spitalit Otel-Die. Mendoni se përmes kësaj fjalie Hygoi shenjon më shumë se thjesht një veshje? Po, simbolizon pafajësinë, pastërtinë shpirtërore, shenjë paralajmëruese e vdekjes ...

3. Në fragment gjejnë përdorim një sërë gjymtyrësh homogjene. Veçoni një rast të tillë dhe shpjegoni rolin e tyre. *Pamje e trishtuar për kurbatkën e mjerë, fëmijë e gjetur dhe e dënuar me vdekje, krijesë fatkeqe, pa atdhe, pa familje, pa strehë!*

*Në funksion të mjerimit të ciganes.*

4. Tregoni si janë formuar fjalët e mëposhtme:

*Fat+keq(e)- e përbërë                      flokë+hallakatur- e përbërë*

*Të fuqi+shëm- e prejardhur me prapashtesë dhe paranyjëzim*

*Triumf+al(e)- e prejardhur*

### Grupi III

1. Kuazimodoja, në këtë fragment, e mbyll komunikimin e tij me Esmeraldën me fjalinë thirrmore: *“Do t’ju vrisnin dhe unë do të vdisja!”*. Hygoi, lakonik, me fare pak fjalë shpalos dashurinë e pastër e vetësakrifikuese të gungaçit për ciganen. Duke iu referuar fundit të romanit, shpjegoni se si kjo fjalë e Kuazimodos nuk ishte thjesht një mënyrë të thëni, por e vërteta tragjike.

*Kuazimodoja shpreh shkurt, pa fjalë të bukura vetësakrifikimin e tij. Mbyllja e romanit (gungaçi nuk po shihej për shumë kohë, gjetja e skeleteve të përqaftuar...) dëshmon vërtetësinë e thënies së tij. Pa Esmeraldën Kuazimodoja nuk mund të jetojë: jeta e tij është lidhur ngushtë me jetën e saj.*

2. Përfytyroni gungaçin e katedrales në skenën e rrëmbimit të Esmeraldës. Hartoni një tekst përshkrues ku të paraqesni gjeste, veprime, ndjesi të tij.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

- A ju duket utopike apo e parealizueshme ideja se dashuria, mirësia dhe mëshira mund të ndryshojnë botën? A mund të përsoset moralisht dhe shpirtërisht njeriu në një realitet si ky i shekullit XXI?

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Bëni një ese krahasim-kontrasti me temë: *“Esmeralda dhe Margarita, dy krijesa të bukura romantike të dy penave të ndritura.”*

Ora tjetër do t'i kushtohet tërësisht interpretimit në role. Nxënësve iu janë ndarë rolet disa orë më parë dhe është ndjekur çdo ditë nga mësuesja përvetësimi i roleve.



**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Dramatizim nga vepra “Katedralja e Parisit”</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë interpretimit;</li> <li>• tregon shkathësi në lojën me role dhe menaxhon me sukses emocionet e veta;</li> <li>• demonstroi vullnet dhe gatishmëri në interpretimin e rolit;</li> <li>• demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• personazhe</li> <li>• interpretim</li> <li>• role</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Vepra letrare</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte.	<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me role-dramatizim		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Dramatizim i fragmenteve të përzgjedhura nga vepra “Katedralja e Parisit”</i>			

**Organizimi i orës së mëimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

- Realizime bazuar në veprën “Katedralja e Parisit”
- Historia e kambanarit të Katedrales dhe ciganes së bukur është mjaft popullore. Që me botimin e romanit, më 1831, e deri në ditët tona, vepra ka qenë objekt frymëzues për zhanre të ndryshme të artit.
- 1836, dhe vetëm pak vite më vonë romani frymëzon krijimin e një baleti. Nga fillimi i shekullit XX e deri më sot numërohen një sërë ekranizimesh, si: rreth 15 filma artistikë, film i animuar, disa shfaqje muzikore e madje edhe lojëra kompjuterike.
- Krijimi i parë bazuar mbi romanin e Hygoit është një opera me titullin “Esmeralda”

-Shfaqja muzikore e Parisit, e vitit 1998, me muzikë të Rikardo Koçantes e Luc Plamondon, që nga debutimi i parë deri më sot njih një sërë turesh anembanë botës e vlerësohet me çmimin Gines (Guinness World Records).

-Shfaqja muzikore është shitur në më shumë se 10 milionë kopje CD-je e DVD-je, njih mbi 3000 performanca me një sukses të padiskutueshëm në 15 vende në 7 gjuhë dhe disa çmime si shfaqja më e mirë muzikore (Best musical). Spektatorët e shumtë të mbarë botës, disa milionë, kanë rënë në dashuri me shfaqjen.

-Kënga “Belle” nga “Katedralja e Parisit” u zgjodh si kënga më e mirë e shekullit XX nga shikuesit e televizionit francez, ndërsa audienca ruse e ka përcaktuar atë si këngën e dekadës.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Interpretim:**

- Mësuesja krijon atmosferën dhe mjedisin e përshtatshëm për fillimin e dramatizimit.
- Nxënësit interpretojnë rolet e tyre pa u ndërprerë.
- Mësuesi/ja dhe nxënësit bëjnë komente përgëzuese.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Diskutim:**

- Sa përputhet imazhi që keni krijuar ju nisur nga vepra, me atë që ofron shfaqja muzikore “Katedralja e Parisit”?

- Vlerësoni lojën aktoriale, skenografinë dhe muzikën e këtij krijimi artistik.
- Flisni për rolin e muzikës në këtë shfaqje muzikore, si një vlerë e shtuar në pasqyrimin e gjendjeve shpirtërore të personazheve dhe dhënien e plotë të situatave dramatike e të pstershme.

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për interpretimin e realizuar.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Flisni për rolin e muzikës në këtë shfaqje muzikore, si një vlerë e shtuar në pasqyrimin e gjendjeve shpirtërore të personazheve dhe dhënien e plotë të situatave dramatike e të pstershme.

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Bajroni, jeta dhe krijimtaria</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Bajronit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• veçon veprat kryesore të Bajronit;</li> <li>• diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Bajronit në letërsinë botërore.</li> <li>• evidenton veçoritë e romantizmit në veprat e Bajronit</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romantik</li> <li>• Anglez</li> <li>• Udhëton</li> <li>• Vetmi</li> <li>• himnizon</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor</li> <li>• Foto</li> <li>• Tabela ilustruese</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori	<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim për jetën e Bajronit		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Stuhi mendimesh, Organizues grafik, Shkrim i lirë</i>			

**Organizimi i orës së mësimit****A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Stuhi mendimesh:**

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë. Më pas lexohen dhe diskutohen ato që nxënësit kanë lexuar për Bajronin.

- Ç'dini për jetën dhe veprën e Bajronit?
- Çfarë keni lexuar nga Bajroni?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Organizues grafik:**

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin dhe më pas ta përmbledhin atë duke ndërtuar një organizues grafik.

Temat: Liria, forca e natyrës, marrëzia e dashurise, vlerësimi i kulturës antike, realizmi në letërsi, arti.

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Romantik i shek XIX

22 janar 1788 shek

Poet, romancier dhe dramaturg anglez

Ai është me një superioritet moral, intelektual, me zhgënjime nga realiteti, me ndjenja liridashëse, mahnitet pas vendeve ekzotike bën thirrje për humanizëm dhe paqe.



Në verën e vitit 1809, kur Europa kishte kohë që ziente nga luftërat napoleonike, Bajroni njëzetenvjeçar u nis për udhëtimin e tij të famshëm drejt lindjes.

**Periudha e parë:** fillon me krijimet e para poetike, ku heroi qendror hyn në konflikt të papajtueshëm me shoqërinë.

**Periudha e dytë:** i përket veprave dramatike, në të cilat heroi kërkon të gjejë kuptimin e jetës, arsyet e pabarazisë dhe të varfërisë.

**Periudha e tretë:** duke vëzhguar me një sy më objektiv realitetin, jep një tablo të jetës shoqërore të kohës.

Dy këngët e “Çajld Haroldit” dhe “Poemat e Lindjes”, ku më të njohurat janë “Gjauri”, “Korsari”.

Drama me karakter liriko-filozofik, “Manfredi”, “Kaini” etj.

Romani në vargje “Don Zhuani”.

Diskutohet për jetën e vështirë të Bajronit, famën e tij dhe raportin me të tjerët për shkak të veprave të tij.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Shkrim i lirë:**

Ditari në vargje është një nga format e parapëlqyera të Bajronit. Duke u nisur nga fotoja në libër provoni dhe ju të shkruani një ditari të shkurtër gjatë një udhëtimi



#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për detyrat e shtëpisë, leximin aktiv të tekstit, për saktësinë e përgjigjeve.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Gjeni informacion, për veprat, foto dhe kuriozitete nga Bajroni

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Analizë "Shtegtimi i Çajld Haroldit" Bajroni</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, (koha vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat në të cilën ndodhet heroi romantik.</li> <li>• Evidenton veçoritë e romantizmit në vepër.</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat në vepër.</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, etj. Metrikën dhe llojin e strofës</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• vende ekzotike</li> <li>• Spanjë</li> <li>• Greqi</li> <li>• Shqipëri</li> <li>• poemë epiko-lirike</li> <li>• zhgënjim</li> <li>• vetmi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Vepra letrare</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe,	<b>Situata e të nxënit:</b> Recitohen vargje nga poema. Foto nga Bajroni		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake</i> : Interpretim, Harta e ngjarjes			

## Organizimi i orës së mësimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

1. Cilat janë ngjarjet kryesore të jetës së Bajronit? Shquani në to faktorët që përcaktuan formimin e Bajronit si personalitet dhe si poet romantik që ndikoi fuqishëm për një kohë të gjatë në romantizmin europian.

-Fëmijërinë e kaloi në Skoci bashkë me të ëmën ku u njoh me natyrën e egër dhe me jetën e legjendat e malësorëve të atij vendi.

-Më 1801, Bajronin e dërguan në shkollë, në Harrou, ku studioi gjuhët greke e latine, historinë dhe letërsinë angleze. Këtu spikatën ato cilësi të karakterit të tij që i ruajti gjithë jetën: serioziteti dhe zotësia të mendohej thellë mbi ngjarjet e jetës dhe bashkë me këto gëzimi, vrulli shpirtëror e temperamentit i zjarrtë.

-Kur ishte akoma student, botoi vjershat e tij të para lirike "Orët e prehjes", të cilat u kritikuan ashpër nga shtypi zyrtar. Që në nisje, u duk qartë që Bajroni po shkonte drejt një konflikti të egër me shoqërinë zyrtare angleze.

-Kur më 1809, në moshë madhore, vajti të zërë vendin e tij në parlament, u prit ftohtë prej dhomës së lordëve. Konflikti midis poetit e shoqërisë angleze po rritej.

-Kur Europa kishte kohë që ziente nga luftërat napoleonike, Bajroni njëzetënjëvjeçar u nis për udhëtimin e tij të famshëm drejt lindjes. Pasi vizitoi Portugalinë dhe Spanjën Perëndimore, lundroi prej Gjibraltarit për në Maltë. Këtu vendosi të vizitonte Shqipërinë

2. Cilat janë veprat kryesore të Bajronit dhe si ndikoi përvoja e udhëtimeve në krijimtarinë e tij letrare?

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Dy këngët e “Çajld Haroldit” dhe “Poemat e Lindjes”, ku më të njohurat janë “Gjauri”, “Korsari”. Drama me karakter liriko-filozofik, “Manfredi”, “Kaini” etj. Romani në vargje “Don Zhuani”.

3. Pse themi që Bajroni, me veprat që shkroi, u bë figurë e madhe e romantizmit anglez dhe europian? Ç’pasqyroj ai në to?

Bajroni është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit XIX, përfaqësuesi më i denjë i romantizmit, i cili pasqyroj epokën pas Revolucionit Francez të 1789-ës, hovin e lëvizjes çlirimtare në Angli dhe Europë, shpresat për një fitore të afërt të çështjes së lirisë dhe dëshpërimin përpara triumfit të përkohshëm të forcave të vrazhda të reaksionit. Bajroni, me jetën dhe veprën e tij ngriti zërin për të protestuar kundër reaksionit anglez e europian. Poezia e tij zgjonte frymën e revoltës.

4. Çfarë e tërhoqi Bajronin në vendet e Lindjes? Po sot, cilat janë vendet ekzotike që ju do dëshironit të vizitonit?

Vëzhgim i disa fotove të Bajronit

Nxënësit komentojnë rreth tyre

### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### Harta e ngjarjes:

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin e nxënësit dhe nisur nga ajo që ata kanë lexuar të ndërtojnë hartën e ngjarjes.

<b>Vendi dhe koha</b>	Vende të ndryshme rreth mesdheut, shekulli XIX Spanjë, Shqipëri, Greqi, Turqi, Zvicër, Itali,
<b>Lloji</b>	<b>Poemë liriko-epike</b> , në bazë të së cilës qëndron ditari i vetë poetit.
<b>Tema</b>	Temë të gjerë shoqërore; nuk është vetëm një tregim mbi fatin e heroit romantik, por dhe një vepër me temë politike. <b>Etja për liri, urrejtja kundër tiranisë përbëjnë thelbin kryesor të veprës.</b>
<b>Personazhet</b>	1. Çajld Haroldi, heroi romantik, njeriu i ri i vetmuar, i pakënaqur me gjendjen aktuale, i zhgënjyer nga shoqëria e cila për të bëhet burg dhe atdheu “ <i>më i shkretë se qeli e murgut</i> ”. 2. Populli, njerëzit e thjeshtë.
<b>Ngjarjet kryesore</b>	Poema është e ndarë në <b>4 këngë</b> , të cilat nuk flasin vetëm për viset e ndryshme: Spanjë, Shqipëri, Greqi, Turqi, Zvicër, Itali, por secila vjen me ngjyra e nuanca të veçanta. Kështu kënga e parë është melodramatike; E dyta, plot patos liridashës, E treta të mrekullon me natyrën. E katërta vë në dukje romantikën në histori dhe në art, ndonëse të katërta përshkohen pak a shumë nga të gjitha këto elemente. Falë këtyre, poeti herë entuziasmohet e herë dëshpërohet, herë proteston e bën thirrje, duke ndërhyrë pareshtur në zhvillimin e ngjarjeve. Në qendër të veprës qëndron Çajld Haroldi, heroi romantik, njeriu i ri i vetmuar, i pakënaqur me gjendjen aktuale, i zhgënjyer nga shoqëria e cila për të bëhet burg dhe atdheu “ <i>më i shkretë se qeli e murgut</i> ”. Në moshë fare të re “ <i>pa arrirë akoma pragun e burrnisë</i> ”, u vel nga jeta, iu mërzi shtëpia, nuk desh më të rronte në atdheun e tij dhe jeta në Angli u bë më e tmerrshme se ferri. Dhe njeriu mund të jetë i lumtur vetëm kur është i lirë: Çajld Haroldi nis për udhëtim, duke u thënë lamtumirë vendeve ku lindi e duke u larguar pa ndonjë trishtim, pasi kujtimet dhe e shkuara nuk i sjellin ndonjë gëzim. Në dy këngët e para, heroi i veprës shëtit nëpër Portugali, Spanjë, Greqi e Shqipëri duke u endur nëpër bukuritë e këtyre vendeve, nëpër kopshte e kodra romantike, nëpër male me ajrin e freskët që falin jetë, duke u kënaqur nga zhurmat e dallgëve të detit, i tërhequr nga bujaria e njerëzve të thjeshtë trima e liridashës. Me ç’zemër të ngrohtë i kujton bijtë e Shqipërisë!

	<p>Poema është e ndarë në <b>4 këngë</b>, të cilat nuk flasin vetëm për viset e ndryshme: Spanjë, Shqipëri, Greqi, Turqi, Zvicër, Itali, por secila vjen me ngjyra e nuanca të veçanta. Kështu kënga e parë është melodramatike;</p> <p>E dyta, plot patos lirishtës,</p> <p>E treta të mrekullon me natyrën.</p> <p>E katërta vë në dukje romantikën në histori dhe në art, ndonëse të katërta përshkohen pak a shumë nga të gjitha këto elemente. Falë këtyre, poeti herë entuziasmohet e herë dëshpërohet, herë proteston e bën thirrje, duke ndërhyrë pareshtur në zhvillimin e ngjarjeve.</p> <p>Në qendër të veprës qëndron <i>Çajld Haroldi</i>, heroi romantik, njeriu i ri i vetmuar, i pakënaqur me gjendjen aktuale, i zhgënjyer nga shoqëria e cila për të bëhet burg dhe atdheu “<i>më i shkretë se qeli e murgut</i>”.</p> <p>Në moshë fare të re “<i>pa arrirë akoma pragun e burrnisë</i>”, u vel nga jeta, iu mërzit shtëpia, nuk desh më të rronte në atdheun e tij dhe jeta në Angli u bë më e tmerrshme se ferri. Dhe njeriu mund të jetë i lumtur vetëm kur është i lirë:</p> <p>Çajld Haroldi niset për udhëtim, duke u thënë lamtumirë vendeve ku lindi e duke u larguar pa ndonjë trishtim, pasi kujtimet dhe e shkuara nuk i sjellin ndonjë gëzim.</p> <p><i>Në dy këngët e para</i>, heroi i veprës shëtit nëpër Portugali, Spanjë, Greqi e Shqipëri duke u endur nëpër bukuritë e këtyre vendeve, nëpër kopshte e kodra romantike, nëpër male me ajrin e freskët që falin jetë, duke u kënaqur nga zhurmat e dallgëve të detit, i tërhequr nga bujaria e njerëzve të thjeshtë trima e lirishtës. Me ç’zemër të ngrohtë i kujton bijtë e Shqipërisë!</p> <p>Autori herë-herë harron heroin dhe jepet pas shijimit të pamjeve që ofron natyra, jep mendime për doket dhe historinë e popullit. Në këto vende, heroi përballet edhe me ngjarjet historike plot dramacitet. Të tilla ishin ato të Spanjës, ku ai qe vetë dëshmitar. Napoleoni, më 1808. Nisi lëvizja çlirimtare e popullit. Një nga episodet heroike të kësaj lufte ishte mbrojtja e Saragozës. Banorët, burra e gra, e mbrojtën qytetin e tyre për tetë muaj rresht. Bajroni, midis tyre dallon bijën e Spanjës, imazhin e vajzës së butë spanjolle, “<i>Vajza e Saragozës</i>”:</p> <p>Kështu shfaqet në këto këngë figura e dytë, po aq e rëndësishme, ajo e popullit, njerëzve të thjeshtë që “<i>luftojnë për liri...</i>”.</p> <p>Në qendër të këngës së dytë kemi Greqinë e robëruar që ka humbur lirinë e madhështinë e dikurshme. Përballë Athinës, Maratonës e Termopileve të dikurshme, përballë lavdisë antike, poeti na bën të prekim robërinë e kohës. Për këtë Bajroni fajson Anglinë dhe Turqinë që i kanë vënë popullit grek zinxhirë të dyfishtë robërie.</p> <p>Midis dy këngëve të para dhe të tretës shtrihet një interval prej gjashtë vjetëve dhe poeti është më i pjekur. Në këto dy këngë stili bëhet më i fuqishëm.</p> <p><i>Në këngën e tretë</i>, botuar në qershor 1816, Bajroni shpreh qëndrimin e tij ndaj Republikës borgjeze franceze të shekullit XVIII, ndaj luftrave napoleonike, ndërsa <i>në këngën e katërt</i>, botuar më 1818.</p> <p>Në këtë vepër përshkruhen dhe jepen detaje të shumta kulturore, gjeografike dhe etnografike të vendeve që vizitoheshin.</p>
<b>Ngjarjet përfundimtare</b>	<p>Fundi i veprës tingëllon si himn madhështor kushtuar detit, si përfytyrim i forcave të pashtershme të popullit. Kjo e bëri Pushkinin të thotë për Bajronin: “<i>Ai, o det, qe këngëtari yt!</i>”</p>
<b>Gjuha dhe stili, metrika</b>	<p>Ka trajtën e një rrëfimi të lirë, me strofa spenseriane 9 vargëshe, me varg pesëkëmbësh jambik. Kjo lloj strofe të le mjaft hapësirë për përshkrime dhe i shkon përshtat asaj çka Bajroni dëshiron të na përcjellë mes vargjeve. Në parathëniet e këngëve të para, Midis tyre ka dhe intermexo me strofa katërvargëshe, siç janë “<i>Kënga e lamtumirës</i>”, “<i>Tamburxhi</i>” etj.</p> <p>-Gjuha e Bajronit në këtë poemë është e pasur dhe me figura stilistike.</p> <p>-Që në fillim e deri në fund, vepra ngrihet si antitezë e fuqishme, veçanërisht në dy këngët e para që duhen kuptuar si kontrast ose antitezë me Anglinë e kohës.</p> <p>-Ka përshkrime idilike të këtyre viseve, përshkrime të jetës, zakoneve të vendeve.</p>

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

<b>Bajronizmi</b>	<i>Bajronizmi</i> u krijua si një frymë e veçantë romantike, që lindi nga ndikimi i dyfishtë i Bajronit dhe i heronjve që ai krijoi.
<b>Mesazhe</b>	Vepra e Bajronit oshëtin nga motivet romantike të ëndrrës për liri: <i>“O bij skllëvërish! S’e ditkeni ju se robërit i këputin vetë prangat, kur i frymëzon zëri i lirisë!”</i>

### A. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Diskutim:**

1. Vepra “Shtegtimet e Çajld Haroldit” është një rrëfim lirik. Çfarë rrëfehët në të?
2. Në sa pjesë-këngë ndërtohet vepra? Ku ndodhet heroi në secilën këngë? (Në 4 pjesë dhe heroin e gjejmë nëudëhtimin e tij në vende të ndryshme nga Spanjë, Shqipëri, Greqi, Turqi, Zvicër, Itali)
3. Cilat janë karakteristikat që e dallojnë Çajld Haroldin? Pse themi që ai është tipi i heroit romantik? Ç’e bën atë të tillë?
4. Pse i drejtohet natyrës Haroldi? Ç’gjen apo ç’kërkon në të? Si e dëshiron natyrën një romantik?

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për leximin e poemës “Shtegtimet e Çajld Harold” dhe plotësimin e saktë të rubrikave të hartës së ngjarjes, analizës së personazheve, duke ilustruar me shembuj nga vepra.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

-Romantikët e kanë lirinë të rëndësishme dhe kjo bie në sy si tipar i dallueshëm i tyre. Analizojeni këtë tipar në idetë që autori kërkon të na përcjellë gjatë udhëtimit në disa vende, ku historia bëhet tema kryesore.

-Lexoni vargjet e këngës “Shqipëria dhe shqiptarët”

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Koment “Bajroni në Shqipëri”</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon ngjarjet, largimin nga vendlindja, zhgënjimet , vetminë, lidhjen me natyrën dhe luftrat çlirimtare gjatë rrugëtimit të tij. dallon temën, motivet dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;</li> <li>analizon heroin lirik, karakteristikat e tij bashke me njeriun e thjeshtë</li> <li>analizon veçoritë e romantizmit në fragment</li> <li>analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, ( koha vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat e një teksti.</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Shqipëri</li> <li>male</li> <li>tbanat</li> <li>mëzenj</li> <li>e egër, e bukur</li> <li>sodit</li> <li>ligj</li> <li>fanar i të urtëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor,</li> <li>Vepra letrare</li> <li>Dërrasa e zezë</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjeografia, Historia


Situata e të nxënësve: Rrecitohen vargje nga poema. Foto nga Bajroni

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- *Kllaster*, *Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD)*, *Punë në grupe*, *Diskutim*.

## Organizimi i orës së mësimi

### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Kllaster:** *Nxënësist një orë më parë kanë marrë njohuri teorike nga vepra*



### B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD):**

Lexohen vargjet pjesë - pjesë dhe ngrihen pyetje mbi to nga mësuesja dhe nga nxënës të ndryshëm. Poeti si romantik adhuron natyrën, e dashuron atë, prehet qetësisht në gjirin e saj, e adhuron paqtinë dhe soditjen.

*Natyra është nëna më e dashur,  
Gjithmonë e butë, po gjithkund e ndryshme;  
Nga gjir' i saj i zhveshur të mëzenj  
Vërtet s'më desh, po nuk më zwordhi kurrë.*

Në këngën e dytë, për shqipërinë dhe shqiptarët përmend dy Iskanderët *O Shqipëri ku lindi Iskanderi...* Janë Aleksandri i madh i Maqedonisë dhe i dyti Gjergj Kastrioti. Aleksandri i Madh është krenari, frymëzim i të rinjve dhe modeli, shembulli për të vjetrit; *"Këngë e rinis', fanar i t'urtëvet!"*, përmes metaforës. Skëndërbeut si vlerë i çmohet trimëria (*dërrmoi armiqtë*) dhe shpata legjendare



(Kordhn' e tij kreshnike) jo më kot shkruhet me shkronjë të madhe. Të bën përshtypje dhe ndajfolja **përherë** që tregon një tjetër vlerë të Skëndërbeut që nuk u mundet asnjëherë.

Përmes apostrofës:

*Shqipëri, lejomë të kthej syt' e mi/  
mbi ty, o nënë e rreptë burrash t'egër.*

Nisur nga fjala lejomë, dallojmë respektin që ka për vendin (të cilit duke e personifikuar i kërkon leje për ta parë) – nisur nga fjalët nënë e rreptë burrash t'egër shohim që çuditërisht Bajroni ka të njëjtin vlerësim që kanë edhe shqiptarët.

Bajroni nuk përshkruan vetëm pamjen që sheh Haroldi, por shtyhet më thellë në kohë duke dhënë dhe historinë e vendit *Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë...* historia është krishtërimi i cili po tërhiqet dhe po i lë vendin islamit; zbritja e kryqit prej kupolave dhe zëvendësimi me hënëzen e zbehtë

I njëjti vend përshkruhet me dy pamje:

*Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë...*

Kënga e dytë vendos në qendër Greqinë, por dhe Shqipërinë bukuria e së cilës e mahnit Bajronin.

*agimi lind, me tëp o çohen brigjet...*e vjetra e përhershme, e rreptë, me ngjyra mashkullore brigjet e saj duken me lindjen e agimit, me tbanat e malcorëve që janë aq lart sa duken vetëm kur shpërndahen retë/ dhe ajo që po pushtohet Shqipëria e tanishme: në muzg ( e zbehta *hënëz, Me kryqin që zbret... Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë*, figura e metonimisë ka kuptimin e hyrjes në një vend ku ka më shumë myslimanë, ndryshe nga vendet përreth, apo vjen në kuptimin e historisë së vendit tonë, si një vend i pushtuar nga turqit.

*Këtu bredh ujku, shqipja sqepin mpreh/zogj, bisha, njerëz t'egër zënë e duken...*

tipare të mjedisit janë: mjedisi në përshkrimin e këtyre vargjeve është natyror, i egër (ujku, shqipja, bisha) me fenomene natyrore të egra (stuhitë) . Pamja e njerëzve nuk stonon në pamjen e përgjithshme të mjedisit. Jane pjesë organike e këtij mjedisi (njerëz t'egër) Janë zgjedhur ujku dhe shqipja për t'u përmendur, sepse të dy janë grabitqarë, me sa duket Bajroni e di shumë mirë prehistorinë, të dy përshtaten me emërtimin bisha; të dyja janë kafshë totem për vendasit, me një rëndësi të veçantë simbolike.

Dy kuptimet e fjalës i egër:

1. Njerëz që janë ende larg qytetërimit evropian, por janë më afër natyrës së egër ; një epitete që merr vlerën e vendit ekzotik, të paprekur nga dora e njeriut.

2. Njerëz të ashpër, të rreptë , të fortë... Marrëdhëniet mes përcaktimit të rreptë dhe vetitë nuk u mungojnë janë kundërshtuese (lidhëza por) Pra megjithëse bijtë e shqipes janë të rreptë, përsëri vetitë nuk u mungojnë.

*Prijsin e Shqipëris, urdhr' i të cilit*

*Është ligj pa ligj, sepse me dorën gjak*

*Sundon një popull kryengritës trim;*

Këto vargje kanë kuptim realist, sepse shqiptarët i binden të parit të tyre, pasi i kanë dhënë besën dhe është në nderin e tyre ta mbajnë (pa e analizuar fare urdhërin). Për Bajronin, vendi ynë është një vend i bukur ekzotik, i cili ka natyrë të mrekullueshme, por që nuk drejtohet si duhet, *me ligje të drejta e pa gjakderdhje*.

Kënga e dytë vendos në qendër Greqinë, por dhe Shqipërinë bukuria e së cilës e mahnit Bajronin.

Vargjet më poshtë nxjerrin në pah, vënë në dukje bukuritë shqiptare, gjer "*në kërthizë të Ilirisë*", krahasuar me viset e njohura greke. Lexuesi përfytyron përmes haroldit gjithë udhëtimin nëpër Shqipëri, parë dhe në aspektin gjeografik

Në kuptimin romantik: Shqiptarët janë trima, nderojnë të parin e tyre dhe nuk llogarisin as jetën, kur është fjala për të mbrojtur vlerat besën, nderin.

*Nga mat i zyrtë shqipëtar Haroldi*

*Kaloi gjer në kërthizë t'Ilirisë,*

*Nër pllajë e male fort të madhërishëm*

*E vise q'Historia s'i kujton:*

*N'Atikën e përmendur rrallë sheh*

*Lugina kaq të bukura; s'ka Tempja*

*Stoli që aty s'e gjen; Parnasi i dashur,*

Udhëtimi- karakteristikë e romantikëve drejt vendeve ekzotike, i himnizon, natyrën dhe vetitë e shqiptarëve.

Poeti shfaqet mjaft realist kur komenton vende e burra fisnikë. Heroi duket tejet i entuziazmuar nga ajo çfarë i jep vendi, historia, në shprehjen e tij vihen në dukje dukuritë estetike si e madhërishmja, e bukura.

*Munshtir i Zicës! nga kjo streha jote,*

*E vogël por e shenjtë e plot me hije,*

*Kudo që shohim, rrotull, siër, poshtë,*

*Na le pa mend magjia ngyrë ylberi!*

*Shkëmbinj e prrenj e pyll e qjell i rimtë,*

*Të gjitha treten n'harmoni të plotë:*

*Buçim e largë e prroit na tregon vendin*

*Ku rrukulliset uj i kataraktit,*

*Ndër gërxhe, që tmerrojnë, e ta kënaqin shpirtin.*

Poeti përmend vende reale, përmes antonimive kontekstuale *e vogël /e shenjte* që të kënaq shpirtin me gëzim. Përdorimi i enumeracionit *Shkëmbinj e prrenj e pyll e qjell i rimtë*, rrit përfytyrimin e së bukurës ngado, imazhe plot jetë dhe të pakrahasueshme, të magjishme. Shkrihen në një panoramë hiperbolike dhe ndjesore përrallore.

Mali i madhërishëm është dëshmi e një vendi të ashpër në fizik, të brishtë në ndjesi dhe të bukur në pamje.

Ç'bën poeti me epitetin "i egër", identifikon tiparin dallues të natyrës së Shqipërisë apo atë të vetë banorëve të këtij vendi, shqiptarëve? Nëse e mendoni si përdorim vlerësues, cili është qëllimi i këtij etiketimi?

Paralelizëm figurativ –vend i ashpër, me dimër të ftohtë- njerëz të egjër, trima, të fortë, maskilistë më shumë.

Është vjeshtë e tretë (nëntor) dhe kjo e ndihmon poetin të bëjë një përshkrim të goditur. Stuhitë që tundin motin sjellin imazhin e një natyre sa të bukur, po aq të egër.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Punë në grupe:**

Pasi lexohet dhe komentohet fragmenti deri në fund ndahet klasa në grupe:

#### **Grupi I-** Ushtrimi 8.

Në vargun "Sa e bukur qenka në tipare t'egër", gjeni epitetet. Si janë këto epite të përballje me njëri-tjetrin? Duke patur parasysh romantikët, si e duan natyrën ata dhe cila është lidhja, sipas një romantiku midis këtyre dy epite të zgjedhur?

Në vargun "Sa e bukur qenka në tipare t'egër", fjalët e nënvizuara janë epite të përballje me njëri-tjetrin? Janë antonime, në kundërshti. Duke patur parasysh romantikët, e duan natyrën të virgjër, të paprekur.

#### **Grupi II-** Ushtrimi 9.

Shpjegoni kuptimin e fjalës sodis sipas fjalorit. Po në kontekstin që e jep autori, cili është kuptimi

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

“ndonse e sodis si s’e sodit askush”?

*Kuptimi e fjalës sodis sipas fjalorit është kundroj, vështroj me shije, dëshirë nga brenda. Në kontekstin që e jep autori, “ndonse e sodis si s’e sodit askush” kuptimi është mëse i qartë e ndjen, e përjeton, shijon natyrën duke u mbushur me kënaqësi, jetë, mrekulli!*

**Grupi III-** Ushtrimi 13.

13. Vargjet:

*Kaloi gjer në kërthizë t’Ilirisë,*

*Nër pllajë e male fort të madhërishëm*

*E vise q’Historia s’i kujton:*

- Shkruajini si parafrazë dhe bëni komentin tuaj për vargun e fundit.

**Diskutim:** Kalohet në diskutim me klasën

- Tregoni diçka interesante nga historia e qytetit tuaj.

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Natyrë shihet si një nënë e dashur, herë e butë, herë e egër. Autori kërkon të vërë në dukje bukurinë e saj në të gjitha format. Bëni një ese përshkuese ose një vizatim për natyrën, duke u frymëzuar nga strofa e parë e fragmentit. (mund të mbahet për portofol)

- Lexoni fragmentin “Suljotët”

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
<b>Tema mësimore – Koment “Suljotët” Bajron</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar vepra.</li> <li>• dallon ngjarjet, largimin nga vendlindja, mahnitjen e heroit lirik nga natyra shqiptare lidhjen me natyrën, trimërinë dhe heroizmin e suljotëve .</li> <li>• analizon fragmentin parë në aspektin historik, gjeografik, kulturor, moral</li> <li>• analizon heroin lirik, karakteristikat e tij bashke me njeriun e thjeshtë</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, ( koha vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat në tokën shqiptare.</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Suliotët</li> <li>• Greqi</li> <li>• Shqipëri</li> <li>• Poemë liriko-epike</li> <li>• Zhgënjim</li> <li>• vetmi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Vepra letrare</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Gjeografia, Historia	<b>Situata e të nxënit:</b> Studiuesi Moikom Zeqo mbi Bajronin, referuar dy vargjeve të para të fragmentit.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim, Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD), Punë e udhëhequr në grupe.</i>			

## Organizimi i orës së mësimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim:**

1. Janina, në atë kohë njihej si “kryeqyteti i Vilajetit”, siç e thotë dhe poeti. Ndaluni në qytetet e përmendura dhe diskutoni për kohën që ka drejtuar vendin Ali Pashë Tepelena, të cilin autori e quan “Prijsin e Shqipëris” .

2. Autori i drejtohet historisë së vendit tonë edhe përmes luftrave të brendshme. Kur thotë në vargje “*fis guximtar*”, e ka fjalën për suljet, të cilët u bënë ballë sulmeve të Ali Pashës; u mundën më në fund nga tradhtia e një drejtuesi që pranoi rryshfet. Si e lidhni këtë shpjegim nga historia me shprehjen e thënë nga autori në fjalët “*ndë mos floririt*”?

3. Natyra jepet në dy anët e saj, e bukur dhe e egër, përmes të kundërtave që për poetin krijojnë harmoninë e përkryer. Studiuesit e shohin romantizmin si art i kontrastit. Diskutoni mbi këtë koncept të Bajronit.

## B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD):**

Lexohen vargjet pjesë - pjesë dhe ngrihen pyetje mbi to nga mësuesja dhe nga nxënës të ndryshëm.

Në këtë fragment të këngës së dytë, autori tregon Haroldin duke u larguar nga shtëpia e Ali Pashës për në Prevezë me anijet turke. Gjatë udhëtimit, anijet gati u mbytën, por u ndihmuan në brigjet shqiptare dhe u shpëtuan nga suljet trima.

1. Virtytet e shqiptarëve janë të shumta dhe këto vihen në dukje edhe nga poeti i madh. Ndalemi tek disa nga virtytet e shqiptarit të shprehura përmes vargjeve.

Heroi romantik viziton Shqipërinë e Jugut dhe qëndron si bujtës në sarajet e Ali Pashës ku pritet me nderë të mëdha.

a) **Heroi magjepset nga natyra madhështore dhe e ashpër**

b) **Karakter i burrëror**, bujar i shqiptarëve. I quan kryelartë, me një autoritet sovran. Ka lirizëm të theksuar. Admirimi për shqiptarët shprehet në aspektin që ka për to. Ai i quan “njerëz t’egër”, por jo në kuptimin e shpirtit të tyre, por duke i vendosur në harmoni me natyrën shqiptare. Sinonime të fjalës *të egër* mund të përdorim : te fortë, të ashpër, të pathyeshëm.

c) Në aspektin **historik**, himnizoi historinë shqiptare, Skenderbeun dhe kordhën e tij legjendare

d) **Gjeografik**, himnizoi natyrën shqiptare (Agimi)

e) **Moral**, himnizoi virtytet, por dhe vuri në dukje paragjykimet patriarkale *nanë e rreptë burrash*

f) **Kulturor**, vlerësoi veshjet dhe këngët polifonike.

Apostrofat e fuqishme shprehin mahnitjen e Haroldit për kreshat e maleve ku “*shqypja sqepin mpreh.*”

Vlerësoi vetitë e shqiptarit të thjeshtë, i cili ecte kryelartë në truallin stërgjyshor, ku spikat mikpritja, bujaria, besa etj. Bajroni ngrii lart dhuntitë morale të gruas shqiptare si fisnikerinë, bukurinë, por nga ana tjetër ai pa edhe shtypjen që i bëhet asaj.

Marrëdhëniet mes përcaktimit të rreptë dhe vetitë nuk u mungojnë janë kundërshtuese (lidhëza por) Pra, megjithëse bijtë e shqipes janë të rreptë, përsëri vetitë nuk u mungojnë. Pse thotë *veç duhet të ishin më të arrira?*

Ka të drejtë : i quan të paarrira, sepse vetitë janë ende të egra, të pa qytetëruara. Por në rastin e gjakmarrjes nuk pyet asnjëherë në emër të kujt bëhet kjo, pra jo trimëri e qytetëruar. Besa e shqiptarëve është veti, vlerë, por nuk pyet asnjëherë nëse besa që i ka dhënë të parit të fisit duhet respektuar kur ky është gabim.

Në vargjet:

*Shkëmbinjt’ e tyre s’janë më të patundur  
nga ata në cast rreziku e nevoje.*

E veçanta e krahasimit qëndron në atë që është krahasim i anasjellë (inversion) në vend të

krahasohen shqiptarëtme shkëmbenjtë, siç mund të bëhen rëndom krahasohen shkëmbinjtë me shqiptarët dhe efekti është ky: Kur krahasohen shqiptarët me shkëmbinjtë, shqiptarët marrin nga vetitë e shkëmbinjëve: të fortë, të patundur, stoikë etj ndërsa inversion të krijon idenë se shqiptari është njësia matëse për trimëri, fortësi qëndrueshmëri dhe shkëmbinjtë mund të krahasohen me ta.

Është veçori e romantikëve kontrasti, antiteza:

*Ç'armiq për vdekje , po sa miq besnikë!*

Në përshkrimin e një situatë apo gjendjeje dy të kundërta bëjnë efekt të madh, sepse të përcjellin parafytyrimin e diçkaje të madhërishme, tronditëse dhe jo të zakonshme. *Kur besa a nderi i thrrret të derdhin gjakun/si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre.* Këto vargje kanë kuptim realist, sepse shqiptarët i binden të parit të tyre, pasi i kanë dhënë besën dhe është në nderin e tyre ta mbajnë (pa e analizuar fare urdhërin).

Në kuptimin romantik: Shqiptarët janë trima, nderojnë të parin e tyre dhe nuk llogarisin as jetën, kur është fjala për të mbrojtur vlerat besën, nderin. *Vargu (i pa shqiptarët)* tek niseshin në luftë dhe fitore i jep trimërisë shqiptare një tipar: vërtetësinë, padyshueshmërinë nëse niset në luftë është e sigurtë se do të kthehet me fitore.

*Pastaj i pa kur vetë u ranë dorë*

*kur rasti i bën të ligjtë më të ligj.*

Të ligjtë do të sillen të ligj në çdo rast, por nëse je i dobët do bëhen edhe më të ligj. Në rrethana të tilla u ra në dorë Haroldi Suljotëve, por ata nuk shfrytëzuan dobësinë e tij, përkundrazi i shtrinë dorën dhe e pritën si mik, kjo e ngre shumë më lart mikpritjen e tyre.

*Gjind më pak t'egër presin ca më pak:* bashkëatdhetarët do ta linin vetëm. Në zjarr, sa pak zemra i bëkan ballë provës! Bota e qytetëruar i ka bjerrë vlerat e saj. Heroi romantik i zhgënjyer i kërkon dhe i gjen ato në popuj primitivë që ende nuk i ka prishur qytetërimi.

*Suljotët u dhanë dorën, i përcuall...*

Bashkëatdhetarët janë kthyer në shfaqje hipokrizie e suljotët i pritën pa lajka. Dhe shtruan sofrën me atë që paten

Vlerësohet ai që ka pak e jep me lehtësi, kjo është për t'u vlerësuar.

Sipas Bajronit modeli që duhet ndjekur:

*Kësaj i thonë dashuri njerëzore!*

*T'i japësh prehje e ngushëllim fatkeqit /*

*I mëson fatbardhët e të liqt' i bën të skuqen.*

Janë vargje moralizuese të poemës: Bajroni u bën moral bashkëatdhetarëve duke u rrëfyer ç'është dashuria njerëzore dhe ku gjendet ajo. Humanizmi është vlerë bazë e qytetërimit evropian por humanizmi i vërtetë (*kësaj i thonë dashuri njerëzore*) gjendet mes shqiptarëve të egër. Anglezët e trashëgojnë këtë vlerë sepse kanë fatin të kenë lindur në Angli.

Në këto vargje ai tregon për islamizmin dhe krishtërimin, këto dy fe që modeluan rrjedhën e historisë se Shqipërisë.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### ***Punë e udhëhequr në grupe:***

#### ***Grupi I- Ushtrimi 3.***

Duke qenë një poemë liriko-epike, në të mbisundon më tepër elementi lirik, përshkrimet e njerëzve, natyrës. Në këtë fragment kemi një rrëfim të shkurtër mbi arsyen si u gjend autori me anijen e tij në këto brigje. Bëni një përmbledhje të shkurtër të ndodhisë.

#### ***Grupi II – Ushtrimi 4.***

Autori përpiket herë pas herë të përcjellë mesazhe mbi vlerat dhe të vërtetat e jetës, që ia mësojnë njerëzit e thjeshtë që kanë dashuri për njeriun. Gjeneri disa shprehje të tilla në fragment.

#### ***Grupi III – Ushtrimi 2.***

Bëni një parafrzim të vargjeve:

*E pritën në shtëpi me gjith të mirat,  
Gjind më pak t'egër presin ca më pak,  
Bashkatdhetarët do ta linin vetëm...*

Cilët janë njerëzit (*gjind*) më pak të egër për poetin? Si janë suliotët përballë anglezëve (*bashkatdhetarët*)?

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Shprehjen "*Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!*", komentojeni dhe diskutoni mbi të në kontekstin e sotëm. A është vlerësues gjithnjë një mendim i tillë? Si e shikoni natyrën e shqiptarit sot, në raportet dashuri/urrejtje?

-Gjeni materiale dhe informacione në internet rreth elementeve etnografike të zonës së Shqipërisë së Jugut, foto të bajronit me veshje kombëtare shqiptare etj.

**PLANIFIKIMI DITOR**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – <b>Koment "Suljotët" Bajroni Vazhdim (mjetet stilistike, elementet etnografik..)</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimi :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet</li> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);</li> <li>• Zbulon në fragment elemente etnografike</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.)</li> <li>• analizon heroin lirik, karakteristikat e tij bashke me njeriun e thjeshtë</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti</li> <li>• respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Suliotët</li> <li>• Greqi</li> <li>• Shqipëri</li> <li>• Poemë liriko-epike</li> <li>• Zhgënjim</li> <li>• Vetmi</li> <li>• Dashuri</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• Vepra letrare</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Gjeografia, Historia	<b>Situata e të nxënit:</b> Rrecitohen vargje nga poema. Foto nga Bajroni		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD), Diskutim.</i>			

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë:

Lexohen materiale të sjella nga nxënësit në bibliotekën e shkollës ose në internet mbi elemente etnografike të Shqipërisë së Jugut dhe Bajronin.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD):**

Lexohen vargjet në vazhdim pjesë - pjesë dhe ngrihen pyetje mbi to nga mësuesja dhe nga nxënës të ndryshëm.

**Motivi i ekzotizmit** është i pranishëm: “Gjind më pak të egër presin ca me pak”—kemi paraysh që Bajroni shkruan për lexuesin anglez që s’i njej shqiptarët, dhe i cilëson ata si njerëz të egër, pra larg qytetërimit, afër natyrës së virgjër. Ekzotizëm ndeshin europianet apo njerëzit e botës perendimore kur përballen me një botë plotësisht ndryshe, larg qytetërimit me njerëz, zakone e tradita të panjohura.

Nga ana tjetër, Bajroni i paraqet shqiptarët si model për tu ndjekur nga anglezët, të cilët e mbajnë veten të qytetëruar, sepse anglezët nuk i presin miqtë në sallonet e tyre, siç i presin shqiptarët në kasollet e tyre. Ky është një tipar i romantikëve të cilët përdorin motivin ekzotik për të kritikuar veset e bashkëatdhetarëve të tyre.

**Veshja me fustanellë**



Edhe kjo veshje burrash këtë emërtim e merr nga një lloj fundi i bardhë, i bërë me pëlhurë pambuku dhe me shumë rudha. Nën këtë fund mbatheshin të mbathura të gjata, mbi të cilat nga nyje e këmbës e deri tek gjuri visheshin kallei prej shajaku. Në disa raste keto zgjateshin deri në rrëze të kofshëve, prandaj dhe quhen kofshare.

Në pjesën e sipërme vishej një këmishë e shkurtër me mënge të gjëra, jeleku dhe mëngorja (në mënyrë të varura pas).

Në bel vinin një brez të gjërë leshi, mbi të dhe një tjetër prej lëkure të zbukuruar mbi të cilin futeshin e vareshin armët e brezit.

Në stinën e ftohtë pjesë e kësaj veshjeje ishte edhe flokata e leshit. Ndonse në kokë vihej një feste e bardhë me një thumb në mes.

Deri në fillim të shek. XX kjo veshje është mbajtur në të gjitha trevat shqiptare, që nga Kosova e deri në Çameri. Me pas ajo u kufizua vetëm në fshatrat e Shqipërisë së Jugut.

Trimat suljot dinin të luftonin por dhe të dëfrenin me këngë dhe vallen e tyre karakteristike.

Trupi I tij I zhdërvjellët nis këngën hëdh tutje shpatën me kokën lart, fisnik, të kapur doë për dore , në varg , nën një ritëm me këngë labe nisën, kërcyen , u drodhën fustanellat, e dredhin trupin marrin vlerë duke dhënë të gjallë çdo lëvizje dhe hare gjatë dëfrimit të tyre.

Ritmi i tamburit është një ritëm kushttrimi dhe luftime që nxit luftëtarët. Në këtë këngë kemi një ritëm dhe strofë tjetër nga strofa spenseriane me të cilën e ka ndërtuar poemën Bajroni. Kemi ndryshime me strofat e tjera nga 9 vargje spenseriane kalon në strofa 4 –she . Një intermexo lirike që shoqëron vallen dhe këngën e suljotëve.

**Stilistika:**

**Pyetjet retorike** janë të shumta, pasi tërheqin vëmendjen e lexuesit, krijojnë komunikim me të, i japin formës elegancë duke mos dhënë përgjigje për shumë elemente, ngrihen në nuance ironie a qortimi apo shprehin qëndrimin emocional të poetit. Vendi përshkruhet nëpërmjet **epiteteve dhe krahasimeve**: *Shqipëri e rreptë, ngjyra mashkullore* (epitet metaforik - mjedisi dhe njerëzit) etj. Ato shoqërohen me **inversionin** i cili i jep melodi e ritëm sintaksës poetike: *Të Pindit, çuka mjegull veshur*.

Tipar i romantizmit janë **kontrastet** dhe **antitezat**, psh në vargjet:

*Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!*

**Enumeracioni** këtu shërben për të renditur shumëllojshmërinë e botës natyrore, atë shtazore, vlerat dhe virtytet e shqiptarit.

Nëpërmjet **antonimisë**, si nje prej përdorimeve më të shpeshta stilistike të romantikëve, poeti himnizon virtytin e bujarisë: *“Ti japësh prehje e ngushëllim fatkeqit, i mëson fatbardhët e të liqt i bën të skuqen”*, shfaq karakterin burror, mikpritjen ende të gjallë në vendet e paqytetëruara.etj.

Nxënësit vazhdojnë për pak minuta të gjejnë mjete të tjera stilistike në dy fragmentet.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura****Diskutim:**

Bajroni është lord me prejardhje fisnike dhe i di mirë rregullat e mirësjelljes apo të fisnikërisë. Në përballje me figurën e trimave suljotë, Bajroni vlerëson përmbi çdo gjest fisnikërie, mikpritjen e tyre. Çfarë do të na thotë autori me shprehjen sintetike **“Kjo është dashuri njerëzore”**? Si e gjykoni ju civilizimin në raport me dashurinë njerëzore?

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Sillni foto, modele të kostumeve kombëtare nga treva juaj

**PLANIFIKIMI DITOR**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore– <b>Romantizmi në Shqipëri</b>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mësimin :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton rreth zhvillimit të Romantizmit në Shqipëri, si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike.</li> <li>• veçon përfaqësuesit kryesorë.</li> <li>• dallon veçoritë e romantizmit si drejtim letrar.</li> <li>• Krahason romantizmin shqiptar dhe atë evropian</li> <li>• përcakton gjinitë letrare që u lëvruan nga romantikët.</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij.</li> <li>• respekton mendimin e të tjerëve.</li> <li>• respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• romantizëm</li> <li>• poezi lirike intime</li> <li>• njeri i thjeshtë</li> <li>• mbizotërimi i ndjenjës</li> <li>• kulti i arsyes</li> <li>• kulti i lirisë</li> <li>• folklor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Teksti letrar</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> <li>• Shkumësa</li> </ul>		



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave


**Situata e të nxënit:** Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për Romantizmin në Shqipëri

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve hap pas hapi:** - *Punë e drejtuar, kllastër, pema e mendjes, Ditaret e të nxënit, punë në grupe, Diagramë veni*

### Organizimi i orës së mësimit

#### **Hapi I (Punë e drejtuar, kllastër, pema e mendjes)**

Nxënësit njihen me temën e re “Romantizmi shqiptar” dhe objektivat që duhet të arrijnë dhe u lihet kohë të lexojnë informacionin në libër. Nënvizojnë në libër veçoritë, të cilat do të shërbejnë për të ndërtuar skemën.



#### **Hapi II Ditaret e të nxënit: Punë në grupe**

Nxënësit do të punojnë në dy grupe për të lexuar, analizuar dhe përmbledhur informacionin për veçoritë e romantizmit dhe me të dhënat do të plotësojnë ditaret e të nxënit.

**Grupi 1:** Harton **tabelën e koncepteve** për kontekstin historik të romantizmit dhe përfaqësuesit e saj. Nxënësi përcakton fjalët kyçe të secilit paragraf të informacionit dhe jep sqarime të ërmbledhura, duke i hedhur në tabelë.


KONCEPTI	SHPJEGIMI
Lëvizje	
Perandoria Osmane	
Dy fazat	
Mungesa e unitetit kombëtar	
Krijohet vetëdija kombëtare	
Gjuha shqipe	
Alfabeti	
Arsye historike	
Arsye shoqërore	
Arsye artistike	
Përfaqësuesit	
Arbëreshët	

**Grupi 2:** Nxënësi ndërton një ditar tri-pjesësh dhe përmbledh parimet dhe veçoritë dhe më pas jep dhe komentit e tij për të.

Veçoritë, parimet	Përmbledhje/sqarim	Komenti i nxënësit
Largimi në histori		
Lirizmi a kulti i ndjenjës		
Tema e dashurisë për atdheun		
Dashuria për vashën		
Kulti i natyrës		
Epizmi.		
Dramatizmi.		
Stili retorik.		

### Hapi III Diagramë veni

Evidento dallimin mes romantizmit shqiptar dhe romantizmit evropian.



#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për imagjinatën e tij, për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre, për përmbledhjen dhe sqarimin e informacionit.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Ushtrimi nr. 9

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Jeronim De Rada. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së De Radës, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• liston veprat kryesore të De Radës;</li> <li>• gjykon për mënyrën se si romantizmi gjen shprehje në veprën e De Radës;</li> <li>• respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• romantik</li> <li>• arbëresh</li> <li>• poema liriko-epike</li> <li>• evokim</li> <li>• folklor</li> <li>• çlirim kombëtar</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Interneti</li> <li>• Biblioteka</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Njohja e kulturave, Histori	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi të veçantat e jetës së De Radës.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Shkrim i lirë.</i>			

**Organizimi i orës së mëimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

***Diskutim mbi njohuritë paraprake:***

Punohen në tabelë të dhënat kryesore për jetën dhe veprën e De Radës, pasi lexohen disa nga përmbledhjet e nxënësve. Mësuesja mund të përdorë teknika vizuale, si: pemë mendjeje, kllaster ose thjesht tabela.

- Jeronim de Rada lindi më 29 nëntor 1814 në fshatin Maki të Kozencës, qendër e kolegjit arbëresh të Shën Adrianit.
- Një botë më e gjerë hapet para De Radës më 1834, kur nis studimet për drejtësi në Napoli,
- Gjatë ngjarjeve të revolucionit italian të 1848, De Rada mbron aktivisht idetë përparimtare nëpërmjet gazetës së tij, “*L’Albanese d’Italia*” (“*Arbëreshi i Italisë*”).
- Më 1850 poeti u martua me arbëreshen Madalena Melikji, me të cilën pati katër djem dhe gëzoi për disa vjet lumturinë familjare.
- Në vitet 1883-1887 botoi revistën e parë shqiptare “*Fiamuri i Arbërit*”
- Vitet e fundit të jetës qenë të rënda e të mundimshme për De Radën. Fatkeqësitë familjare (vdekja e gruas dhe e djemve)
- Më 1899 ishte përsëri mësues i shqipes në Kolegjin e Shën Adrianit.
- Vdiq më 28 Shkurt 1903, në vetmi dhe në një varfëri të dhimbshme, kur ishte 89 vjeçar.

- Jeronim de Rada konsiderohet si themeluesi i romantizmit arbëresh
- Tri janë parimet krijuese të poetikës së De Radës: parimi epik, parimi lirik dhe parimi dramatik.
- De Rada mbetet **themeluesi i publicistikës shqiptare** jo vetëm si nismëtar, por edhe si profesionist në këtë fushë. Gazeta “L’Albanese d’Italia”.
- Në fushën e publicistikës, De Rada kontribuoi edhe me botimin e “Fiamuri i Arbërit” (1883-1887), një revistë e përjavshme.
- De Rada shquhet si studiues në fushën e gjuhësisë dhe në fusha të tjera të artit.
- Në vitet 1870-1894 boton punime shkencore mbi prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, si dhe për strukturat gramatikore të gjuhës shqipe.
- Më 1861 botoi veprën Parimet e Estetikës, që është vlerësuar si testamenti i tij, manifesti i romantizmit shqiptar.
- Në vitin 1864 botoi Lashtësia e Kombit Shqiptar dhe pas dy vjetësh Rapsodi të një poeme arbëreshe.
- De Rada mbetet kryesisht poet.
- Tingëllima e parë i përket vitit 1829.
- Poemën Odiseu e shkroi më 1832.
- Skënderbeu i pafan dhe Serafina Topia.
- Këngët e Milosaos e shkroi më 1936.

### **Stuhi mendimesh:**

- Nga leximi i të dhënave të jetës së De Radës, çfarë ju bën përshtypje?
- A ka ndikuar largësia, të qenit arbëresh në aktivitetin e madh të De Radës, për çlirimin dhe emancipimin e kombit shqiptar që të punojë kaq shumë për kombin e tij.
- Mbi ç’parime e ndërtoi krijimtarinë e tij ?

### **B. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **Punë në grupe:**

Ndahet klasa në grupe me detyra të përcaktuara nga mësuesja në skeda apo kartonë për secilin grup. Të gjithë nxënësit do të lexojnë me vëmendje tekstin dhe do të plotësojnë tabelat që u janë caktuar.

#### **Grupi i parë:**

<b>Detaje të atmosferës Politike</b>	<b>Detaje të atmosferës ekonomike</b>	<b>Detaje të atmosferës shoqërore</b>

#### **Grupi i dytë:**

<b>Detaje Objektive</b>	<b>Detaje subjektive</b>

### **C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

#### **Shkrim i lirë: 5'**

Cilat janë veçoritë e letërsisë së Rilindjes të reflektuara në veprën e De Radës?

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Shkruani një tekst të shkurtër reflektues me temë: “Shkrimtarët janë pasqyra e epokës në të cilën ata jetojnë. Shkrimtarët novatorë e kapërcejnë epokën e tyre. Ata krijojnë ura lidhëse me të ardhmen dhe i paraprijnë asaj”.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
<b>Tema mësimore – De Rada. “Këngët e Milosaos” Analizë</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton fabulën dhe strukturën e veprës “Kënga e Milosaos</li> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat në vepër.</li> <li>• Analizon dy linjat e subjektit : detyra ndaj Atdheut dhe dashurisë me Rinën</li> <li>• dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre në poemën e Milosaos</li> <li>• dallon temën dhe motivet në vepër: patriotik, ripërtëritja e jetës, dashurisë</li> <li>• analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve. Milosaos, Rinës, Zonjës Mëmë</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• vepër epiko-lirike</li> <li>• pasione njerëzore</li> <li>• çështja kombëtare</li> <li>• dashuria</li> <li>• zakonet shqiptare</li> <li>• lakonizmi</li> <li>• ndjenja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Flipchart</li> <li>• Tabela e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Historia	<b>Situata e të nxënit:</b> Përmbledhje e subjektit të Milosaos.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Praktikë e udhëhequr, Punë në grupe, Diskutim.</i>			

### Organizimi i orës së mësimit

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### **Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me tregimin e subjektit të poemës “Këngët e Milosaos”.

Nxënësit kanë lexuar “Këngët e Milosaos” dhe materialin teorik në libër dhe punojnë hartën e ngjarjes të cilën e saktësojnë së bashku me mësuesen.

<b>Vendi dhe koha</b>	Në Shkodër, shek. XV, Moti i madh. Veprimi tregimtar i poemës zhvillohet brenda nëntëmbëdhjetë vitesh, nga 7 qershori i 1405, deri më 7 maj 1423.
<b>Lloji</b>	Epiko-lirik
<b>Personazhet</b>	<b>Milosao, Zonja mëmë, Rina, motrat</b>
<b>Fabula</b>	-Milosaoja, djali i sundimtarit të Shkodrës në shekullin XV, dashurohet me Rinën e varfër, të bijën e Kallogresë, dhe për hir të kësaj dashurie ndeshet me paragjykimet patriarkale dhe klasore. -Atdheu rrezikohet nga turqit dhe Milosaoja niset për luftë. -Dy të dashurit martohen, gëzohen me një fëmijë dhe kalojnë një periudhë të shkurtër lumturie, -Por gjithçka merr fund me vdekjen e fëmijës dhe më pas dhe vdekjen e Rinës nga hidhërimi. -Në fund, niset prapë në luftë dhe vritet duke mbrojtur qytetin e tij.
<b>Struktura</b>	-Poema Këngët e Milosaos është një veprë e ndërtuar mbi një plan të vetëm subjekti. -Ajo përbëhet nga 30 këngë të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.
<b>Konflikti</b>	Dy konflikte: <ul style="list-style-type: none"> <li>• konflikti i parë, më i dukshmi është ai me karakter shoqëror, midis dashurisë së të rinjve dhe paragjykimeve klasore e patriarkale që i pengojnë të kurorëzojnë dashurinë e tyre.</li> <li>• konflikti tjetër është ai midis ndjenjës dhe detyrës, pra midis dashurisë ndaj Rinës dhe atdheut.</li> </ul>
<b>Veçoritë e veprës</b>	-Poemës nuk ia jep unitetin bashkërendimi logjik i ngjarjeve, në rrjedhën e subjektit -Kompozicioni i saj, nga njëra anë i ngjan një mozaiku: secila këngë është pjesë e një të tërë e, megjithatë, zotëron një lloj pavarësie, ndërsa nga ana tjetër i ngjan një kurbe të dallgëzuar, ku dallojnë vetëm kulmet e ngjarjeve: lindja dhe shpërthimi i dashurisë, martesat, lindja e fëmijës, vdekja e Rinës etj. -Në plan të parë, siç e sugjeron vetë titulli, vendoset Milosaoja, heroji lirik, i cili i paraqitet lexuesit jo aq përmes veprimit, sa përmes ndjenjave, përjetimeve, emocioneve dhe meditimeve të veta. -De Rada <b>nuk rrëfen në mënyrë kronologjike</b> ndodhi të caktuara të jetës së Milosaos, ai nuk jep detaje jetësore të heroit të vet; këto lexuesi i kupton në radhë të parë nga përjetimet e Milosaos -Kjo risi artistike: nxjerrja në plan të parë e unit lirik në raport me rrëfimin (karakteristikë për kompozicionin klasik) i jep poemës së De Radës origjinalitet dhe e bën atë një vepër moderne. -Copëzimi ose dukja fragmentare e poemës përputhet me parimet krijuese të De Radës, sipas të cilave poezia duhet të japë kulmet e jetës dhe të shfrytëzojë <b>nëntekstin</b> . -Prej synimit të poetit për të pasqyruar kulmet buron dhe një nga tiparet më karakteristike të veprës, <b>konciziteti</b> . Kështu një forcë sintetike të jashtëzakonshme kanë vargjet që hapin poemën, të cilat përmes tablosë së ringjalljes së natyrës japin idenë e përtëritjes së vazhdueshme të jetës: <i>Bota kish ndërruar lisa, uji i ri në det kaltëronte n'ditn'e re;</i> -Forcën shprehëse lirike të poemës e rrit gjithashtu dhe gjallëria e figuracionit, pasuria e detajeve dhe e nuancave e shoqëruar me një lakonizëm karakteristik të shprehjes gjuhësore.
<b>Ngjarjet përfundimtare</b>	Në fund, Milosaoja niset prapë në luftë dhe vritet duke mbrojtur qytetin e tij.
<b>Tema</b>	Poema për njeriun që e do jetën dhe atdheun.

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

<b>Motivet dhe idetë</b>	Në vepër shtrohen kryesisht dy motive kryesore: motivi patriotik dhe ai i dashurisë.
<b>Ideja</b>	<p>-Kjo poemë përshkohet nga ideja e çlirimit të atdheut dhe nga ideja se detyra ndaj atdheut qëndron mbi gjithçka.</p> <p>-Një ide tjetër e poemës është ajo e barazisë midis njerëzve. Kjo pohohet përmes dashurisë së dy të rinjve prej klasash të ndryshme, përmes figurës së bijës të Kallogresë, vajzë me virtyte të larta; po kështu përmes përshkrimit të idealizuar të lumturisë së tyre të thjeshtë, që i mposht vështirësitë materiale</p> <p>- De Rada e shfaq veten demokrat në këtë poemë. Ai shpreh edhe filozofinë e qëndrësës morale nëpërmjet vargjeve të thjeshta e të madhërishtme të frymëzuara nga poezia popullore:</p>
<b>Mbështëtja në folklor</b>	<p>-Mënyra e konceptimit poetik të poemës <i>Këngët e Milosaos</i> mbështetet te poezia popullore, e cila karakterizohet nga parimi i sintezës.</p> <p>-Gjithashtu, poezia popullore e ka ushqyer veprën me frymën patriotike dhe me optimizmin e natyrshëm përmes të cilit populli kupton jetën, vdekjen dhe dashurinë.</p> <p>-De Rada, i frymëzuar nga poezia popullore, i merr elementet nga natyra e vendit të tij, duke përdorur dhe toponimet arbëreshe, që i shërbejnë për të identifikuar më mirë vendet dhe ngjarjet.</p> <p>-Poezia popullore e ka ushqyer veprën me figuracionin e pasur, të freskët dhe tepër origjinal si dhe metrikën ku zotëron vargu i bardhë tetërrokësh trokaik.</p>
<b>Natyra</b>	<p>Është e pranishme gjithkund në vepër. Ajo është pjesë e mjedisit ku veprojnë personazhet e lëvizin ndjenjat. Si romantik, De Rada e sodit natyrën në mënyrë aktive dhe bën që ajo të ndihmojë e shpjegojë shqetësimet e brendshme të heronjve:</p> <p>Shqetësimin e Milosaos pas grindjes me të dashurën poeti e jep përmes lëvizjes së deleve nëpër vathë, kurse dhimbjen e thellë për humbjen e gruas, e jep përmes kontrastit me ripërtëritjen e përhershme të natyrës. Ajo është plot ngjyra e nuanca që nisin me të kaltrën e detit e të luleve të lirit që përkunden si në ninullë e përfundojnë me grinë e trishtimit që sjell era e maleve, teksa fryn e rrëzon hijen e lisit.</p>
<b>Gjuha</b>	<p>-De Rada e shkroi poemën në variantin arkaik arbëresh.</p> <p>-De Rada ka krijuar fjalë të reja për të shprehur me nuanca më të holla dhe me larmi më të madhe mendimet dhe ndjenjat.</p> <p>-Gjuha e poemës dallohet për figuracionin e pasur artistik, epitetet e bukura metaforike, lirizmin delikat, stilin konçiz, fjalën e kursyer dhe të matur.</p> <p>- Besnik i parimeve të tij estetike, De Rada synon ta bëjë veprën plot muzikalitet, e kërkon ritmin onomatopeik(2) që vargjet të vijnë tek lexuesi të gjalla, të ëmbla e plot ndjenjë. Pjesa më e madhe e onomatopeve në poemë lidhet me imitimin e zhurmave natyrore: <i>frushullon elbi, zhurmërima e lumit, i dha një shkundullimë</i> etj..Përdorimi i tyre, përveçse i jep ngjyra piktoreske ambjentit shpreh dhe thelbin e brendshëm të gjërave, duke shkrirë në një tërësi të harmonishme formën me përmbajtjen.</p>

### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### **Praktikë e udhëhequr:**

Nxënësit kanë lexuar veprën dhe së bashku me ndihmën e mësueses ritregojnë subjektin duke u ndalur në ngjarjet më kryesore, pasi vepra përbëhet nga shumë bërthama rrëfimtare. Nxënës të ndryshëm tregojnë në klasë ngjarjet që u kanë bërë më shumë përshtypje dhe u kanë ngelur në mendje nga vepra.

#### **Punë në grupe:**

Mësuesja u ndan nxënësve fleta me skema të gatshme për t'i plotësuar me të dhëna që do t'i nxjerrin

nga leximi i tekstit dhe do t'i ilustrojnë me momente nga vepra.

**Grupi 1: Si shfaqen personazhet dhe cilat janë karakteristikat për secilin?**

**Milosaolja**

- Është personazhi më i plotë i poemës.
- karakterizohet nga një botë e pasur shpirtërore.
- Mbart tiparet e përgjithshme të një heroi romantik.
- Si shumë heronj romantikë, është një alter ego i poetit dhe me ide të përparuara.
- shpreh psikologjinë e shtresës së idealizuar të aristokracisë arbëreshe të shekullit XIX.
- Ka karakter burrëror dhe është një dashnor i zjarrtë.
- Di të arsyetojë mbi atë që ndjen dhe karakterizohet nga ndjenja e patriotizmit.

**Zonja e Madhe**

- Nëna e Milosaos, mbart tiparet e asaj pjese të aristokracisë shqiptare që mbrojti interesat e atdheut në shekullinXV.
- Dallohet për patriotizmin e vendosur, gjë që shfaqet në këshillat që i jep të birit të shkojë në luftë të mbrojtë atdheun.
- Zonja e Madhe është mjaft e prerë edhe në paragjykimet klasore që mbart.
- Ajo bëhet pengesë e pakapërcyeshme për bashkimin e të rinjve.

**Rina**

- Personazhi i saj mishëron idealet e poetit për të dashurën, bashkëshorten dhe nënën.
- Mishëron tiparet reale të fshatares arbëreshe.
- Cilësitë që e karakterizojnë figurën e saj ia shtojnë romantizmin poemës.
- Rina është një vajzë e thjeshtë, e dliirë, e bukur jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht.
- Delikate në ndjenjat e saj, por edhe e drojtur për shkak të pozitës së saj shoqërore.

**Grupi 2: Mbështetja në folklor, natyra dhe gjuha në poemë**

Mbështetja në folklor	Natyrë	Gjuha
<p>-<i>Këngët e Milosaos</i> mbështetet te poezia popullore, e cila karakterizohet nga parimi i sintezës. Kjo bën që të mos thuhet gjithçka, por të nënkuptohet.</p> <p>-Gjithashtu, poezia popullore e ka ushqyer veprën me frymën patriotike dhe me optimizmin.</p> <p>-De Rada i merr elementet nga natyra e vendit të tij.</p> <p>-Përdorur toponimet arbëreshe, që i shërbejnë për të identifikuar më mirë vendet dhe ngjarjet.</p> <p>-Poezia popullore e ka ushqyer veprën me figuracionin e pasur, të freskët dhe tepër original. Po ashtu edhe metrikën ku zotëron vargun i bardhë tetërokësh trokaik.</p>	<p>-Natyrë është e pranishme gjithkund në vepër.</p> <p>-Ajo është pjesë e mjedisit ku veprojnë personazhet e lëvizin ndjenjat.</p> <p>-Si romantik, De Rada e sodit natyrën në mënyrë aktive dhe bën që ajo të ndihmojë e shpjegojë shqetësimet e brendshme të heronjve.</p> <p>-Natyrë jepet në ripërtëritje të përhershme.</p> <p>-Ajo është plot ngjyra e nuanca që nisin me të kaltrën e detit e të luleve të lirit që përkunden si në ninullë e përfundojnë me grinë e trishtimit që sjell era e maleve, teksa fryn e rrëzon hijen e lisit.</p>	<p>-De Rada e shkroi poemën në variantin arkaik arbëresh.</p> <p>-De Rada ka krijuar fjalë të reja për të shprehur me nuancat më të holla ndjenjat dhe idetë.</p> <p>-Gjuha e poemës dallohet për figuracionin e pasur artistik, epitetet e bukura metaforike.</p> <p>-Gjuha dallohet për lirizmin delikat.</p> <p>-Stilin konçiz, fjalën e kursyer dhe të matur.</p> <p>-Gjuha është plot muzikalitet dhe ritëm onomatopeik.</p> <p>-Të gjitha dukuritë e realitetit jepen në poemë me një dorë prej piktori.</p> <p>-Muzikaliteti i vargut, ndonse rima mungon, është i lartë.</p>



**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Diskutim:**

Në bazë të informacionit të dhënë në libër nxënësi gjykon mbi krijimtarinë e tij në bazë të pyetjes së bërë nga mësuesja:

- Sa i gjejmë parimet e romantizmit në veprën e De Radës?

<p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, ndërtimin e pyetjeve, saktësinë e përgjigjeve dhe pjesëmarrjen në veprimtari.</p>
<p><b>Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexoni fragmentin “Kënga e II”</li> </ul>

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Fragment: Kënga e II De Rada. Studim teksti</b>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mësimin :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• analizon përdorimin e gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikalitetin (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat.</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<p><b>Fjalë kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vreshta</li> <li>• dielli</li> <li>• Fjokat</li> <li>• mendim</li> <li>• vasha</li> <li>• dy buzë</li> <li>• të qeshura</li> </ul>	<p><b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• interneti</li> </ul>		
<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.</p>	<p><b>Situata e të nxënësve:</b> <i>Interpretim i këngës</i></p>		
<p><b>Metodologjia dhe veprimtari të nxënësve:</b> PNP-Teknika e të pyeturit, Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD): Diskutim</p>			

**Organizimi i orës së mësimin**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Teknika e të pyeturit:**

Ora nis me kontrollin e njohurive për materialin teorik.

**Pyetjet:**

1. Cilat janë veçoritë e romantizmit shqiptar?
2. Cilat janë disa nga veprat kryesore të De Radës?
3. Sa këngë ka poema ?

4. Cilët janë dy motivet në vepër?
5. Si shfaqet në vepër koncepti filozofik për jetën?
6. Si jepet personazhi kryesor?

#### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD):

Lexohen vargjet pjesë - pjesë dhe ngrihen pyetje mbi to nga mësuesja dhe nga nxënës të ndryshëm.

#### 1. Cili është motivi i kësaj kënge dhe ç'vend zë ajo në vepër?

Motivi i dashurisë zë një vend të rëndësishëm në vepër.

#### 2. a. Cila është atmosfera e përshkruar në vargjet e para të këngës:

Vreshtat ishin verdhëllore.

Erdh nga mali dhelpëra

Me të lodhurat të bijat,

me të mbaruar të vjelat;

Atmosferë e ditëve të stinës së të korrave, të pjekura, me punë në bujqësi e në traditat e vendit.

#### b. Gjeni detajet që theksojnë idenë se është fillimi apo fundi i stinës?

Është fillimi i stinës, përcjellur me detaje: vreshtat verdhëllore, erdh dhelpëra, të vjelat

#### 3. Kroi është mjedisi ku takohen dy të rinjtë. A duhet kuptuar ai thjesht si vendi i ngjarjes apo si një mjedis shpirtëror i mirëfilltë? Argumentoni mendimin tuaj.

Kroi është një mjedis ku takohen të dashuruarit në traditën popullore, ndaj duhet kuptuar si një mjedis shpirtëror i mirëfilltë, janë romantik, lidhja shpirtërore tek natyra e pastër, e virgjër.

#### 4. Jepni shpjegimin tuaj për krahasimin e diellit me mëmat. A është ky një krahasim i zakonshëm?

Dielli është burim i jetës dhe mamat japin jetë.

#### 5. Ç'e bën këtë këngë një fragment tipik të një poeme epiko-lirike? Gjeni veçantitë dhe ilustroni mendimin tuaj.

Këtë këngë e bën liriko-epik:

- në kontekstin epik-rrëfimi, tregohet ngjarja (me pak fjalë nxënësit rrëfejnë çfarë ndodh në këngë)
- në kontekstin lirik- ndjenja. De Rada shquhet më shumë për ndjenjën se për veprimin (nxënësit evidentojnë detaje ndjesore)

#### 6. Veçoni elementet e portretit fizik të Rinës nga ato të portretit moral-shpirtëror dhe thoni ç'përfaqson ky portret.

**Portreti fizik:** ballët e zbuluar, llërëpërgjakur, gjifryrë, me gërshet të pleksur, e përveshur

**Portreti moral-shpirtëror:** trembur hare, çeret të ndezur, e lartë, te balli

një mendim i kishte hie.

Rina përfaqëson vajzën shqiptare, vajzë tipike e mjedisit patriarkal, arbëreshen.

#### 7. De Rada shquhet për mbështetjen në folklor. Ku duket kjo në këngë?

De Rada ka marrë emërtimet vasha dhe trimi, takimi i tyre në krua, dialogu që bëhet, figurat letrare, traditat, 8 rrokëshin.

#### 8. Raporti autor-hero në këngë është:

- |                               |                                   |                    |
|-------------------------------|-----------------------------------|--------------------|
| a. autori i spostuar          | b. ndërrojnë vendin herë pas here | c. shkrihen në një |
| d.kundërshtojnë njëri-tjetrin |                                   |                    |

#### 9. Vargu "me një të trembur hare" është konceptuar mbi bazën e figurës së:

- |               |               |              |             |
|---------------|---------------|--------------|-------------|
| a. paradoksit | b. kontrastit | c. antitezës | d. epitetit |
|---------------|---------------|--------------|-------------|

#### 10. Cila është figura letrare me të cilën poeti jep lindjen e ndjenjës së dashurisë? Gjeni vargjet ku shfaqet kjo figurë. Ç'mbresa ju shkakton?

Kënga është plot figura, spikat epiteti që jep cilësi të vajzës. Poeti jep lindjen e dashurisë në katër vargjet e fundit, përmes figurës së metaforës. Ai vë në dukje elementin sensual buzët në një çast të

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

*bardhë-epitet, çast plot ndjenja të ngrohta dashurie, duke ngjallur mbresa mjaft të bukura impresionuese. Gjithashtu, ka përdorur inversionin për të theksuar ndjenjën; folja ka dalë në fund.*

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Diskutim:**

#### Pyetja 11

**Krahasoni tetë vargjet e para me tri të fundit të këngës, lidhur me :**

a. gjendjen shpirtërore të Milosaos në fillim të këngës dhe në fund të saj.

b. raportin mes rrëfimitarit dhe heroit

c. detajin romantik që shënon lindjen e dashurisë

*Dy të rinjtë takohen te kroi i fshatit, në perëndim të diellit. Është moment i lindjes së ndjenjës së dashurisë. Takimi dhe biseda mes tyre realizohen në këngë me detaje realiste.*

*Kënga nis me përshkrimin e natyrës në perëndim. Gjendja shpirtërore e Milosaos në fillim të këngës është normal, e ndoshta i lodhur, pa emocion më pas ndjenja rritet me takimin e vajzës në krrua, shkon drejt lindjes së dashurisë. Gjendja e Milosaos në fillim të këngës dhe mbyllet është e ndryshme.*

*Raporti mes rrëfimitarit dhe heroit vjen i shkrirë*

**Detaji romantik:** *Buzë të qeshura, çast i bardhë*

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantik.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Si e gjeni të shprehur në këngë vlerësimin e E.Koliqit për De Radën: “ I pajisur me ndjenjën e realitetit dhe me shijen e ëndrrës, çdo gjë e çudit.”

Lexoni “Kënga XII”

### PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – <b>Fragment: Kënga e XII De Rada. Studim teksti</b>			
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• analizon përdorimin e gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikalitetin (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat në këngë;</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• flasin për çupën</li> <li>• malli im i parë</li> <li>• vasha rrinte gjithë turp</li> <li>• mos u qaj</li> <li>• lotët s’duhen derdhur</li> <li>• njeriu si bëre keq</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënimit:</b> <i>Interpretim i këngës</i>		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD), Diskutim</i>			

## Organizimi i orës së mësimi

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

*Diskutohet detyra e shtëpisë: Si e gjeni të shprehur në këngë vlerësimin e E.Koliqit për De Radën: “ I pajisur me ndjenjën e realitetit dhe me shijen e ëndrrës, çdo gjë e çudit.”*

Diskutohet në këndvështrime të ndryshme, gjithmonë duke pasur parasysh De Radën romantik.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Veprimtari e leximit të drejtuar.**

*Rina e do Milosaon, por si krijesë e brishtë që ishte dhe si vajzë tipike e mjedisit patriarkal ajo ka frikë dhe është e tronditur sa nga ndjenja që përjeton, aq nga raporti që mjedisi konservator ndërton me njerëzit që dashurojnë.*

**1. Si përcillet në këtë këngë atmosfera e krijuar në fshat nga dashuria e dy të rinjve?**

Dashuria e dy të rinjve përcillet e paragjykuar: një djalë i pasur nuk mund të matohet me një vajzë të varfër sipas paragjytimeve klasore. Milosaonja ishte djali i Despotit të Shkodrës ajo e bijë e kallogresë. Atmosfera është mbytëse, të gjithë i përflasin.

**2. Dalloni fjalët e Rinës, ku shprehet qartë frika e saj nga thashethemet?**

*-Trim, ti mua në më do fort;  
udhëve të mos më pjekësh,  
ndër shoqe mos më vështrosh.*

**3.** Cilat janë pengesat e tjera që hasin dy të rinjtë, përveç thashethemeve? Dalloni vargjet ku shfaqen ato.

*Dallohen largësia,*

**4. Si e gjykoni Milosaon, i cili në një kohë kur djemtë e tjerë kanë vajtur në luftë, qëndron ende në fshat?**

*Milosaon e thërriste lufta një çështje e rëndësishme kombëtare; mbrojtja e atdheut aq më shumë që ishte dhe djalë prijësi por forca e dashurisë ishte më e madhe ndaj qëndron në fshat. Në ato kohë ishte më e rëndësishme motivi patriotik*

**5. a. Ndajeni këngën në dy pjesë, sipas vetave të foljes që përdor poeti për të realizuar rrëfimin. Përcaktoni cilat janë këto veta.**

Pjesa e parë	Veta III
Pjesa e dytë	Veta I

**b. Identifikoni cili është personazhi që flet në vetën e parë.**

*Vajza / djali*

**c. Analizoni mënyrën si ndërthuret dialogu me rrëfimin dhe tonet lirike në këtë këngë.**

*Dialogu është i ndjeshëm, përmes tij informohemi për shqetësimin dhe ndjenjat e personazheve. Ka shkrirje të natyrshme. Kjo e bën më të gjallë, më shprehës dhe më emocional dialogun.*

**7. De Rada frymëzohet nga poezia popullore si dhe përdor toponime arbëreshe për të identifikuar më mirë vendet dhe ngjarjet. Gjeni në vargjet e mësipërme raste të përdorimit të tyre. (Figura apo motive popullore dhe raste të përdorimit të toponimeve arbëreshe.)**

*Korqiollo, linja flisnin, për shami e fustane.*

**8. Komentoni similitudën e tetë vargjeve të para të këngës. Cila është vlera e përdorimit të saj?**

*Similituda është e goditur për të krahasuar thashethemet që nuk janë të mira me valën e turbullt, që sa vjen e rritet, duke mos u tërhequr dhe që vazhdojnë të qëndrojnë si mali.*

**9. Gjeni në këtë këngë (si dhe në këngë të tjera) tri raste të përdorimit të inversionit. Shpjegoni cila është vlera artistike e tyre dhe si duhet të ishte renditja e rregullt e fjalëve.**

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

*udhëve të mos më pjekësh,- të mos më pjekësh udhëve  
ndër shoqe mos më vështrosh.- të mos më vështrosh ndër shoqe  
për lotët që s'duhën derdhur:- s'duhën derdhur lotët*

Nxjerr në krye fjalët që kërkon t'i theksojë më tepër për qëllime stilistike, gjithashtu edhe për efekte të ritmit, muzikalitetit.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim: Pyetja 6

Plotësoni skemën e mëposhtme, duke analizuar me fjalët tuaja personazhet e kësaj kënge.

Përshkrimi	Milosaolja	Rina	Fshatarët
Nga fjalët e poetit			
Nga fjalët e Milosaos			
Nga fjalët e Rinës			
Nga fjalët e fshatarëve			

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantik.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Me ç'figura të tjera e shoqëron atë poeti për të dhënë shqetësimin për fatin e dashurisë që duhet të jetohet në një mjedis mbytës?

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Fragment: Kënga e XXII De Rada. Studim teksti			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• gjykon mbi veçoritë e romantizmit që gjejnë shprehje në këngë</li> <li>• analizon përdorimin e gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikalitetin (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bie po s'dua të fle</li> <li>• Shtatin e bukur</li> <li>• Ditët e mia fatmira</li> <li>• Përkund djepthin</li> <li>• Kohë e shkuar</li> <li>• Si drita në qiell</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënit:</b> Interpretim i këngës		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake; Interpretim, Teknika e të pyeturit, Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD), Punë në grupe			

## Organizimi i orës së mësimi

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Diskutohet detyra e shtëpisë: Nxënësit kanë gjetur figurat letrare.

**Interpretim:** Për të krijuar atmosferë në klasë interpretohen vargjet e këngës së XXII

**Teknika e të pyeturit:**

-Në ç'moment të veprës jemi ?

-Si jepet gjendja shpirtërore e Milosaos

*Është kënga e lumturisë. Shtëpia fatbardhë e Milosaos ndrit. Shkëlqejnë sytë e Milosaos. Shndrit e tëra Rina. Ata janë bërë me djalë. Sa bukur! Po sa zgjat lumturia?!*

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Veprimtari e leximit të drejtuar.**

Kjo këngë është një provë e qartë e pohimit se poezia është muzikë e krijuar me anë të fjalëve. Lajtmotivi i saj: *“Bie, por s`dua të fle.”*, që përsëritet tri herë dhe që shpreh lumturinë e madhe të Milosaos, mbyll si në korniza të arta imazhin e kësaj lumturie.

**1. Identifikoni vargjet ku shprehet:**

a. Lumturia e Milosaos

Bie, por s`dua të fle.

Si drita në qiell e syu

në kurm të njeriut,

kur e sheh të pamenduar,

ajo shpisë i ka hie.

b. ideja se lumturia nuk është e përjetshme.

Ditët e mia fatmira,

do kujtoheni mbi dhe

si këto brigje e lumenj,

që të moçëm do t`u duken

atyre që do të lejnë.-

**2. Renditni disa nga detajet e përdorura nga autori për të konkretizuar pamjet e lumturisë së Milosaos.**

*Lumturia e Milosaos është e pamatë, ajo shprehet përmes shumë detajeve: bie, por s`dua të fle; le të hyjë dielli; me hare; si drita në qiell e syu; shtëpisë i ka hije; ditët e mia fatmira*

**3.Kënga nis me intonacion të qetë, të butë dhe përfundon me shpërthim të shprehur përmes një thirrjeje. Cili është roli që luan shkallëzimi në shprehjen e ndjenjave?**

*E gjithë kënga deri në gjysëm, pra jo pjesa e fundit e këngës është në një shkallëzim ngjites, gjendja emocionale e heroit romantik kulmon në një shpërthim ndjenjash sepse është e ngarkuar nga lumturia*  
*Është kënga e lumturisë. Shtëpia fatbardhë e Milosaos ndrit. Shkëlqejnë sytë e Milosaos. Shndrit e tëra Rina. Ata janë bërë me djalë. Sa bukur!*

**4. Kundërvënia dhe krahasimi janë veçori kryesore të stilit të De Radës.****a. Identifikojini ato në vargjet e këngës XXII. Cila është vlera artistike e përdorimit të tyre?**

Bie, por s`dua të fle – kundërvënie. Milosaoja është kaq i lumtur sa nuk mund të flejë. Në jetën e një njeriu ka shqetësime dhe gëzime, për të dy rastet nuk mund të flemë. Këtu Milosaoja është i lumtur, i martuar dhe trashëguar

**b. Ndaluni dhe shpjegoni mënyrën e ndërtimit të vargut-refren “Bie, por s`dua të fle.” Cili është kuptimi që mbart ai në shprehjen e gjendjes shpirtërore të heroit lirik.**

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Mban peshën e lumturisë ky varg ndaj përsëritet me intensitet si lajtmotiv kryesor.

**5. Krahasoni në aspektin gjuhësor variantin e përshtatur të Këngës XXII me atë origjinal, të shkruar nga De Rada nëarbërishten e kohës së tij. Renditni disa dallime fonetike, morfologjike dhe leksikore.**

Nxënësit me ndihmën e mësuesit bëjnë dallimet fonetike, morfologjike leksikore.

**6. Studiuesi arbëresh Mikele Markiano mendon se pikërisht këtu, tek kjo këngë do të duhej të përfundonte poema. A jeni dakord me këtë mendim? Argumentojeni përgjigjen tuaj.**

Mendimet vijnë subjektive duke argumentuar mbi këtë rast.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

#### Punë në grupe

#### Grupi I ushtrimi 3

Përshtatini vargjet e këngës së mësipërme në një prozë poetike. Ruani fjalët me ngjyrimë arkaike, që karakterizojnë kohën dhe mjedisin.

#### Grupi II ushtrimi 4

Si në gjithë poemën edhe në këtë këngë paraqitja e natyrës i shërben poetit për të dhënë artistikisht gjendjen emocionale të personazheve, këtu të Milosaos. Plotësoni skemën e mëposhtme ku krahasohen dy peizazhe të ndryshme të natyrës. Cilat janë detajet që i dallojnë dy peizazhet dhe si na ndihmojnë ato për të kuptuar gjendjen shpirtërore të Milosaos.

Natyra në këngën XX	Gjendja shpirtërore e Milosaos
Gjethet ishin si të mpira, dielli i fshehur resh, zemr` e grave pa dëshirë, kur, - ia dha një shkundullim...	
Natyra në këngën XXII	
Bie, por s`dua të fle. Mos e mbyll ti derën, le të hyjë era e detit, të më ftohë, si më ftoh vashëzat më të prashitur; le të hyjë dielli, që te vatrat, i pafaj.....	

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantik.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Shkruaj një ese duke zgjedhur njërën nga temat e mëposhtme:

- a. Ideja se lumturia është e përkohshme më shkakton dhimbje.
- b. Lumturia familjare është shumë e rëndësishme në jetë.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
Tema mësimore – <b>Fragment: Kënga e XXX De Rada. Studim teksti</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon figurën e heroit lirik i cili bie në luftë për atdhe duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• analizon përdorimin e gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, elipsinë, muzikalitetin (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>• evidenton mesazhet e këngës së XXX</li> <li>• krahason këngën e I dhe XXX</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e këngës</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth këngës, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrëzoi hijen e lisit</li> <li>• Gjaku im</li> <li>• Te lumi</li> <li>• Shkodrën</li> <li>• Nuk do zgjohem më</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Interpretim i këngës</i>		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake: Lexim shprehës, Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD), Diskutim.</i>			

## Organizimi i orës së mësimimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me kontrollin e dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë. Puna me esenë.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Lexim shprehës:**

Lexohet bukur fragmenti duke krijuar atmosferë në klasë.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Veprimtari e leximit të drejtuar.****1. Si zgjidhet në këtë këngë konflikti i gjithë poemës?**

Milosaaja tashmë pas shumë humbesh e ka bërë zgjidhjen e tij ka shkuar në luftë për çlirim të atdheut. Pas vdekjes së fëmijës dhe të së shoqes, Milosaaja kalon ditë të zymta, pa gjetur askund ngushëllim. Por, nga ato që i ndodhin nxjerr dhe një mësim të madh: "Askush nuk mund të jetë i lumtur kur atdheu vuan". Kënga e fundit e poemës paraqet Milosaon të plagosur në buzë të lumit të Vodhit, që poeti e vendos pranë Shkodrës. Milosaaja vdes duke luftuar në emër të jetës, duke mbrojtur bashkë me shokët e tij ushtarë qytetin, atdheun.

**2. Përshkruani atmosferën që sundon në këtë këngë. Tregoni funksionin artistik që merr kjo atmosferë në përshkrimin e ngjarjes dhe të ndjenjave të heroit lirik.**

**a. atmosfera- Prag dimri.** Natyra e kësaj kënge të jetë pikërisht dimri? A ka ndonjë lidhje me jetën e Milosaas? Po, ai po vdes (shihni dhe këngën e pare, ishte pranverë.). Mos harroni që për romantikët



natyra luan një rol të dorës së parë për të shpjeguar dhe ilustruar situata.

**b. Funksioni-** Është dimër, në paralelizëm me këtë vjen vdekja e heroit Milosaos.

3. **a ) Çfarë kërkon Milosaoja të shohë në fund dhe pse? Ç’ndjenja e përshkojnë heroin në këto vargje?**

-vendosja në një radhë (varg) e Shkodrës dhe motrës (e njëjta dashuri?). Dashuria për atdhe, motivi patriotik dhe familjen.

**b) Zbuloni në këtë këngë një tipar të Milosaos që e bën atë një hero romantik.**

*Heroi ka mall, nostalgji, ai është melankolik, ndjenja të rënduara në prag të vdekjes.*

**4. Poema Këngët e Milosaos hapet me stinën e pranverës në lulëzim dhe mbyllet me fundin e vjeshtës apo fillimin e dimrit.**

**a. Krahasoni rolin që luan natyra në vargjet e këngës së parë të poemës dhe në ato të këngës së fundit.**

Kënga I	Kënga XXX
Bota kish ndërruar lisa, Uji i ri në det Kaltëronte n’ditn’e re;	Fryjti era e maleve dhe rrëzoi hien e lisit

*Natyra është bashkëudhëtare e romantikut, frymëzohet prej saj. Ajo merr pjesë me gjendjen shpirtërore të heroit, në paralelizëm figurativ.*

*Detaje e një stine pranverore, ripërtëritëse, si shpirti i djaloshit që po kthehet në shtëpi: **ndrruar lisa, uji i ri, kaltëronte n’ditn e re***

*Detaje të një stine acari dimëror, përmbysje natyrore, ka vdekje të heroit: **fryjti erë, rrëzoi hijen e lisit***

**b. Ç’përfaqëson imazhi i lisit në këngën e fundit? Krahasojeni atë me imazhin që krijohet në këngën e parë.**

Vihen në kontrast. Lisi si pemë jeton gjatë, ka kaluar shumë kohë, është në lulëzim ndërsa në këngën e fundit bie (rrëzohet hija) siç bie heroit.

**c. Cila është figura e stilistikës në vargun “dhe rrëzoi hijen e lisit” ? metaforë**

**5. Gjeneri kohët e foljeve në vargjet e mëposhtme. Shpjegoni këtë përdorim në funksion të idesë që mbartin vargjet përmbyllëse të kësaj kënge:**

**Mblidhen** shokët mbrëmanet

në katund, në vatërët.

Unë **i lashë** si ëndërrëz.

Janë shprehur dy kohë :

**koha e ardhme** do të mblidhen shokët, jeta vazhdon.

**Koha e tashme**, veprimi është duke u kryer, në vazhdimësi-përdorimi kohës së tashme e bën real, konkret, aktual

**6. Çfarë ka të veçantë nga mënyra e ndërtimit (fjalëformimit) fjala ëndërrëz? Shpjegoni përfytyrimin që ajo krijon.**

Mënyra e ndërtimit

Prapashtesë zvogëluese

Përfytyrimi: jeta është shumë e shkurtër- si një ëndërr

**8. Në vargjet e kësaj kënge vihet re përdorimi i shumë foljeve. Ç’rol luajnë ato në krijimin e tablosë, në dhënien e veprimit dhe mesazhin që përcillet?**

*Tregon veprimin, kalon koha, rrjedl, lëviz gjithçka, jeta vazhdon në mënyrë ciklike duke ja lënë vendin brezave të tjerë.*

a. Cila është figura stilistikore që krijohet nga mungesa e foljes në vargun e tretë :  
Gjaku im te Lumi i Vodhit- Figura e elipsës për të mos dhënë imazhin e rënies së heroit.

b. Me cilën veçori të stilit të De Radës lidhet kjo mungesë?

Koncizitetin

9. Si harmonizohen në këtë këngë lloji i vargut dhe ndryshimi i ritmit me gjendjen shpirtërore të heroit dhe mesazhin e poetit?

Vargu shkurohet kur hero i është në çastet e fundit...elipsa..shkallëzimi.

C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Diskutim: Pyetja 5**

Cila është ideja filozofike që përçojnë vargjet e fundit të poemës? Zgjidhni dhe argumentoni alternativën:

- Jeta është një iluzion;
- Pavarësisht nga vdekja, jeta ia vlen të jetohej;
- Dhimbja dhe lumturia i japin kuptim jetës;
- Jeta ka kuptim kur lëmë pas vepra të mira.

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantik.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Shkruaj një ese duke zgjedhur njëren nga mesazhet që përcjell Kënga XXX

**PLANIFIKIMI DITOR**


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Naim Frashëri. Jeta dhe vepra			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimi :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Naim Frashërit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• veçon veprat kryesore të N. Frashërit;</li> <li>• diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Naimit në letërsinë Rilindjes.</li> <li>• Evidenton veçoritë e romantizmit në veprat e autorit</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• rilindas i shquar</li> <li>• përfaqësues i iluminizmit</li> <li>• shkolla shqipe</li> <li>• romantik</li> <li>• bektashi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Video-projektor,</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Internet</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Historia e kulturës shqipe.	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi njohuritë e nxënësve për Naim Frashërin		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP-Stuhi mendimesh, Organizues grafik, Diskutim.			

**Organizimi i orës së mësimi**

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutim e detyrave të shtëpisë. Më pas lexohen dhe diskutohen ato që nxënësit kanë lexuar për Naim Frashërin.

- Ç'dini për jetën dhe veprën e Naim Frashërit?
- Çfarë keni lexuar nga Naimi?



### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### Organizues grafik:

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin dhe më pas ta përmbledhin atë duke ndërtuar organizues grafik.

<p><b><u>Veprat e para</u></b></p> <p><i>Ëndërrimet</i>  <i>Dëshira e vërtetë e</i>  <i>Shqiptarëvet</i>  <i>Fletore e Bektashinjve</i>  <i>Dashuria</i>  <i>Qerbelaja</i></p>	<p><b>Poet</b></p> <p>1846-1900</p>	<p>Veprat didaktike dhe fabulat</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vjersha për mësonjëtorët e para,</li> <li>-Parajsa dhe Fjala fluturake.</li> <li>-Histori e përgjithshme për mësonjëtorët e para,</li> <li>-Dituritë për mësonjëtorët e para,</li> <li>-Histori e Shqipërisë.</li> </ul>
<p>Bagëti e bujqësia (1886)- poemë liriko baritore.</p>	<p>Aktivist i shquar i lëvizjes kombëtare gjatë Rilindjes</p>	<p>Vëllimi poetik Lulet e verës</p>
	<p>Histori e Skënderbeut (1898) - poemë epike-heroike</p>	

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

1. Cilët ishin faktorët kryesorë që ndikuan në formimin e Naim Frashërit si patriot, poet e mendimtar?
2. Pse Naim Frashëri konsiderohet si figura më përfaqësuese e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Cili është kontributi i tij në çështjen kombëtare si dhe në letërsinë shqipe?

3. Naimi, si rilindës dhe njohës shumë i mirë i gjuhës shqipe, bëri një punë sistematike për zhvillimin dhe pasurimin e saj. Lexoni fjalët që ai shkruan në parathënien e Këngës së parë të Iliadës (përkthyer prej tij):

*“Gjuha jonë duhetë shkruarë thjeshtë shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është’e gjërë gjuha jonë dhe’e bukurë shumë, ka fort fjalë të mira për të vënë në vent të fjalëve të huaja.”*

- a. Çfarë dëshmojnë këto fjalë dhe cila është rruga që sugjeron Naimi për zhvillimin e gjuhës shqipe?
- b. Shprehni mendimin tuaj në lidhje me vlerësimin që i bëhet Naimit si “bilbil i gjuhës shqipe”.

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për leximin aktiv të tekstit, për pyetjet dhe saktësinë e përgjigjeve.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Ndaluni tek poemat *Bagëti e bujqësia* dhe *Histori e Skënderbeut*. Ku qëndron e veçanta e romantizmit të Naimit në secilën prej këtyre dy veprave?

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore –Naim Frashëri “Lulet e verës” Analizë</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon gjerësia e tematikës, thellësia e ndjenjës, bukuria e vargut në vëllimin <i>Lulet e verës</i>.</li> <li>dallon lirizmin, si prirja më e natyrshme e talentit të Naimit</li> <li>dallon temën dhe motivet në vepër;</li> <li>analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi,( koha, vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat e një teksti.</li> <li>analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>motiv erotik</li> <li>patriotik</li> <li>filozofik</li> <li>panteizmi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Flipchart</li> <li>Tabela e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe	<b>Situata e të nxënit:</b> Interpretoj vargje nga vëllimi “Lulet e verës”		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Pema e mendjes, Diskutim, Praktikë e udhëhequr</i>			

## Organizimi i orës së mësimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme


**Diskutim mbi njohuritë paraprake :**

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutim i detyrave të shtëpisë. Komentohen *Bagëti e bujqësia* dhe *Histori e Skënderbeut*. Ku qëndron e veçanta e romantizmit të Naimit në secilën prej këtyre dy veprave?


## B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Pema e mendjes:**

Rreth vëllimit “Lulet e verës” Informacionet dhe diskutimet e nxënësve grupohen në një pemë mendjeje.



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE



### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

1. Cilat janë tri çështjet themelore të krijimtarisë meditative-filozofike të Naimit në vëllimin *Lulet e verës*?
2. a. Ç'është Zoti për Naimin?  
b. Ç'atribute i nje poeti atij?  
c. Shpjegoni kuptimin e panteizmit si thelb i filozofisë së Naim Frashërit.
3. Në ç'raporte vendosen jeta, vdekja dhe koha e shkuar në poezinë meditative-filozofike të Naimit?
4. Diskutoni për Naimin si poet i dashurisë, duke u ndalur në të veçantën e tij.

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për evidentimin e tematikës, motiveve, veçorive romantike të vëllimit, për analizën e tekstit poetik, për saktësinë e përgjigjeve.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Përmbliidhni në formën e një eseje argumentuese mendimet tuaja në lidhje me origjinalitetin e romantizmit të Naim Frashërit.

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Koment “Fyelli” N. Frashëri			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon tematikën dhe motivet në poezi si dhe shpjegon rëndësinë e tyre në fragmentin “Fyelli”;</li> <li>• dallon simbolikën si element i poezisë meditative -filozofike;</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.);</li> <li>• muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>• analizon ndjenjat që e karakterizojnë heroin lirik</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga leximi poezisë</li> <li>• analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore, jetën dhe vdekjen</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fyelli</li> <li>• Mërgim i shkretë</li> <li>• Mik me besë</li> <li>• Poezi filozofike</li> <li>• Rrëmet i njerëzisë</li> <li>• Zjarr i bekuar</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Vepra letrare</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat

ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe,

Situata e të nxënit: Interpretim i poezisë Fyelli

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- *Diskutim për njohuritë paraprake, lexim shprehës, Veprimtari e leximit të drejtuar, Punë e udhëhequr*

## Organizimi i orës së mësimi

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë.

Përmbledhni në formën e një eseje argumentuese mendimet tuaja në lidhje me origjinalitetin e romantizmit të Naim Frashërit.

**Lexim shprehës:***Lexohet bukur fragmenti duke krijuar atmosferë në klasë.*

## B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Veprimtari e leximit të drejtuar.**1. Poezia *Fyelli* është lirikë që filozofon:

a. për artin dhe Zotin b. për dashurinë njerëzore c. për jetën në përgjithësi

d. për dhimbjen dhe shpirtin njerëzor

2. Mesazhi i poezisë *Fyelli* është:

a. poezia është arti i dashurisë, i dhimbjes, i humbjes dhe i fitores së njeriut

b. arti është vetëm poezia

c. kënga (fyelli, poezia) ua bën njerëzve më të bukur jetën

d. poezia është arti me të cilin Perëndia u flet njerëzve

3. Në poezinë *Fyelli* gjenden të gërshetuara disa motive. Cilat janë ato?*Në poezi gjenden të gërshetuara motivi meditative-filozofik, motivi atdhetar, i vetmisë.*

4. Ç'është fyelli në poezi? Kush fshihet pas tij?

*Fyelli simbolizon njeriun. Shfaqet kulti i shpirtit njerëzor. Vetë fyelli simbolizon poetin, vetë melodia e tij prek telat e shpirtit njerëzor.*

5. Fyelli ankohet e vuan pse s'e dëgjojnë apo pse s'e kuptojnë? Arsyetoni përgjigjen.

*Fyelli ka vajtim e ngashërim përbrënda. Një instrument kaq i hollë dhe i ndjeshëm i përcjell njerëzisë brengën dhe botën e vet duke e ndërthurur me atë njerëzore. Fyelli ka dhimbjet e veta që, po ashtu, përcillen me një lloj pikëllimi të vajshëm, mallëngjimi të përherëshëm. Simbolizon zërin dhe dhimbjen e poetit por që nuk e kuptojnë atë nuk e njohin zjarrin e brendshëm të tij. Poeti materien, zjarrin e ka vënë në themel të krijimit të gjithësisë, po ai zjarr i ka dhënë trajtë.*

6. Ku e gjeni të shprehur në poezi panteizmin e Naimit? Ilustroni me vargje.

*Nga ky zjarr Zot' i vërtetë,**Që ka ngehur gjithësinë,**Hoth një shkëndijë në jetë**Dhe bëri soje njerinë.*

7. a. Ndajeni poezinë në pjesë dhe thoni për çfarë këndon poeti në secilën prej tyre.

- Zëri i fyellit, dhimbja e poetit (7 strofat e para).

- Zëri i fyellit, zjarri brendshëm (8 deri në fund).

b. A është procesi i krijimit shkaku i vuajtjes së Naimit artist? A ka shkaqe të tjera që përcaktojnë dhimbjet, vuajtjet e poetit? Nëse po, të ç'natyre janë këto shkaqe?

*Atë e shqetëson ndarja nga njerëzit, mërgimi, jo vetëm ai fizik, po sidomos, ai shpirtëror. Poeti rron i ndarë nga shokët dhe miqtë. Është i sëmuar dhe vuan për të tjerët. Ata sikur nuk e kuptojnë vuajtjen e tij.*

8. Fyelli është i vetmuar që është i vetëm në jetë apo është i vetmuari midis njerëzve? A ka të bëjë vetmia e Fyellit me vetminë e romantikëve? Arsyetoni përgjigjen, duke u mbështetur në ilustrime.

1. Qëkurse më kanë ndarë

*Nga shok' e nga miqësija,*

*Gra e burra kanë qarë*

*Nga ngashërimat' e mija.*

2. Dhe me botën e gëzuar

*Bënem shok edhe marr pjesë*

*Dhe me njerës të helmuar*

*Bënem mik me besa-besë.*

9. Cili është kuptimi i vargut “*bëri soje njerinë*”? Me ç’pikëpamje të Naimit kemi të bëjmë?

*Procesi i krijimit, panteizmi.*

10. Zjarri në poezi është një nga katër elementet e krijimit të universit apo simbol me kuptim disaplanësh? Argumentoni përgjigjen.

*Poeti, materien, zjarrin, simbolikisht e vë në themel të krijimit të gjithësisë. Po ai zjarr i ka dhënë trajtë, energji dhe bukuri botës në tërësi. Me atë zjarr është rishkrirë edhe shpirti i poetit, i cili do të vazhdojë të jetojë përjetësisht.*

11. Si e ndërton poeti ligjeratën e tij poetike? Ç’i sjell kjo mënyrë ndërtimi poezisë?

*Ligjërata poetike ndërrohet në vetën e parë. Kjo e bën poezinë më subjektive, një shprehje të drejtpërdretë të unit poetik, e bën më emocionale duke i dhënë trajtën e një monologu lirik intim.*

12. Gjeni vargjet ku poeti jep një përfytyrim konkret të sakrificës që bën poeti. Si janë shprehur artistikisht ato?

1. *I ra qiellit, e ndriti,*

*I ra zëmërsë, e nxehu.*

*I ra verës, e buçiti,*

*I ra shpirtit dhe e dehu.*

2. *I dha erë trëndafilin,*

*I dha dritë bukurisë,*

*I dha këngëtë bilbilit,*

*I dha shije gjithësisë.*

13. Kujt u drejtohet poeti me apostrofën e papritur *O rrëmet i njerëzisë*? A e vëmë re ballafaqimin e pashprehur mes fyellit dhe poetit?

*Njerëzve. Po e vëmë re ballafaqimin e pashprehur mes fyellit dhe poetit*

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Praktikë e udhëhequr:**

Nxënësit pasi kanë komentuar me mesuesin poezinë, i jepet detyrë të gjejnë mjetet stilistike

*Mërgimet e shkreta, zjarr i bekuar-epitete metaforike*

*Psherëtin zemra ime-personifikim*

*Bëri soje njerinë, të kam shpirt- metonimi*

*I dha, i ra -përsëritja etj.*

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantik.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Analizoni ndonjë poezi tjetër filozofike të Naimit të ngjashme me Fyellin si: “*Bilbili*”, “*Fjalët e qiririt*”

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Koment “Koh’ e shkuar” N. Frashëri</b>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon tematikën dhe motivet në poezi si dhe shpjegon rëndësinë e tyre në fragmentin “Koh’ e shkuar”;</li> <li>dallon simbolikën si element i poezisë meditative;</li> <li>analizon ndjenjat që e karakterizojnë heroin lirik</li> <li>veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);</li> <li>analizon gjendjen emocionale që krijohet;</li> <li>analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore, jetën dhe vdekjen;</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>koh’ e shkuar</li> <li>zemër të përvëlur</li> <li>kohë gënjeshtare</li> <li>zogu</li> <li>drurë të uruar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor,</li> <li>Vepra letrare</li> <li>Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Filozofi	<b>Situata e të nxënësve:</b> Interpretim i poezisë “Koh’ e shkuar”		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim për njohuritë paraprake, lexim shprehës, Veprimtari e leximit të drejtuar, punë e udhëhequr</i>			

## Organizimi i orës së mësimimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë.

Nxënësit sjellin poezinë “Fjalët e qiririt” “Bilbili”

**Lexim shprehës:**

Lexohet bukur poezia Koh’ e shkuar, duke krijuar atmosferë në klasë.

## B. Ndërtimi i njohurive të reja

**Veprimtari e leximit të drejtuar.****1. Poezia Koh’ e shkuarë është:**

a. meditim për jetën

c. meditim për fatin e paracaktuar të njeriut

b. përshkrim paralelizues natyrë-jetë njerëzore

d. meditim për pafuqinë e njeriut para ligjeve të jetës

**2. Mesazhi i poezisë është:**

a. dhimbja për ikjen e kohës

c. dashuria për jetën

b. revolta e njeriut ndaj fatit

d. frika, pasiguria për ç’vjen pas vdekjes

**3. Cila nga fjalët e strofës së parë e jep me forcë gjendjen e heroit:**

a. me zemër të përvëlur

b. derth lot

c. me helm

d. me hidhërim

**4. Në ç’raport është e tashmja me të shkuarën në poezi? Nga përcaktohet ky raport? Gjenero shembuj ilustrues.**

*E tashmja me të shkuarën është në raporte të zhdrejta. Nga dhimbja që lë pas. Në një fazë të caktuar të jetës sikur shmanget nga rrjedha e saj. Në fakt është përmasa e dhimbjes së poetit për mënyrat që lë pas koha e shkuar, në vargjet*



Moj kohëz' e djalërisë,  
Sa me vrap ike dhe shkove!  
Hyr' në gjit të Perëndisë  
Edhe mua më harrove.

Koha ikën dhe nuk kthehet më

### 5. Ç'pikëpamje të filozofisë së Naimit gjeni në këtë poezi?

Në këto poezi Naimi **idealist** beson se shpirti i njeriut nuk vdes kurrë. Naimi jetai vetëm 54 vjet. Jeta e tij s'që e lehtë. Mjaftojnë humbjet e mëdha familjare dhe sëmundja e tij e pashërueshme që ta bënin atë që të ndërtonte me kohën një raport jo të mirë. Koha për të është gënjeshtare, mashtruese, se ikën e na lë:

O! sa fletë m'u këpunë  
Edhe ran' e më s'i pashë!

Poeti e pranon ikjen e kohës, por ndien dhimbje për të shkuarën, për djalërinë dhe trishtohet për pleqërinë që po troket:

O ditët e djalërisë  
Që kishit shumë gëzime,  
Ratë në det t'arratisë,  
Më latë në hidhërimë.

### 6. Ç'kuptim kanë dy emrat në vargun "Me mall shumë e mallëngjim"?

Mall për të shkuarën dhe mallëngjim për të sotmen që po e lë. Përsëritja shton dhimbjen.

### 7. Krahasoni strofën e16-të me strofën e fundit dhe gjeni të përbashkëtat në drejtim të kuptimit dhe të shprehjes artistike.

Poeti zbulon shkaku e gjithë këtij trishtimi: Koha e djalërisë që gjithçka ja kishte paraqitur të bukur, e kishte mbushur me gaz e gëzime ka ikur dhe e ka lënë në pragun e pleqërisë. Ky demoralizim është i qartë për kushtet dhe kohën. Naimi si besimtar kërkon ta mbyllë këtë çështje me një nënshtrim ndaj urdhërit të perëndisë por ky nënshtrim është krejt formal. Poeti nuk kënaqet dhe në vetëdijen e tij pikëpyetja që e bënte të trishtohet mbetet pa përgjigje.

### 8. Fjala gënjeshtare shpreh në poezi qëndrimin emocional të Naimit. Ç'figurë përftohet nga përdorimi i saj në vargun "Me kohën gënjeshtare"? Gjejini asaj sinonimin më të përshtatshëm në kontekst.

Epitet metaforik. Mashtruese, të e rreme.

### 9. Në ç'klasë fjalësh futet fjala të ngrirt' në vargun e 2-të, strofa e 4-tërt? Si është formuar ajo? Gjejini asaj një fjalë antonime.

### 10. Naimi shquhet për përdorimin e shumë fjalëve të prejardhura. Cili është formimi karakteristik i tij? Ç'i sjell fjalës ky formim? Ilustro me shembuj.

Prapashtesat zvogëluese – i jep ngjyrimë emocionale, qëndrime ndaj krijesës së gjorë si zogu..

### 11. Gjeni dy raste të përdorimit të polisindetit dhe thoni ç'vlerë u jep vargjeve kjo figurë?

Përsëritja e lidhëzave për të shtuar përmasën e ndjenjës së dhimbjes...etj.

### 12. Gjeni në strofën e 3-të paralelizmin figurativ dhe shpjegojeni atë.

Sheh dëborënë që bie,  
Edhe zinë, që ka rënë

Me dëborën, motin e keq paralelizohet jeta e vështirë, koha e njerëzisë.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Praktikë e udhëhequr:

Nxënësit pai kanë komentuar me mesuesin poezinë, i jepet detyrë të gjejnë mjetet stilistike

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive, pikëpamjeve filozofike të Naimit.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Bëni një ese argumentuese me temë:

1. "Ne e bëjmë kohën/apo koha na bën ne?"
2. Mbështetur në dy vargjet e fundit, bëni një koment krahasues për qëndrimin e Naimit dhe qëndrimin tuaj për dukurinë e ikjes së kohës.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Koment “Bukuria” N. Frashëri</b>			
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon tematikën dhe strukturën e poemthit, motivet në poezi si dhe shpjegon rëndësinë e tyre në fragmentin “Bukuria”;</li> <li>dallon elementet dhe mjetet stilistike të poezisë erotike;</li> <li>analizon ndjenjat që e karakterizojnë heroin lirik</li> <li>analizon gjendjen emocionale që krijohet;</li> <li>analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore, jetën dhe vdekjen; dashurinë dhe dhimbjen</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>perëndia bukuroshe</li> <li>zemër të përvëlur</li> <li>si pëllumbeshë</li> <li>tani jetën ç’e dua</li> <li>si hëna</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor,</li> <li>Vepra letrare</li> <li>Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, artet	<b>Situata e të nxënimit:</b> Lexim shprehës i poemthit Bukuria		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim për njohuritë paraprake, kllaser, Veprimtari e leximit të drejtuar, punë e udhëhequr</i>			

## Organizimi i orës së mësimimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**


-Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë.

Nxënësit kanë përzgjedhur njërën nga temat e esesë:

1. Ne e bëjmë kohën/apo koha na bën ne?”

2. Mbështetur në dy vargjet e fundit, bëni një koment krahasues për qëndrimin e Naimit dhe qëndrimin tuaj për dukurinë e ikjes së kohës.

Kllaster:

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Veprimtari e leximit të drejtuar:**

1. Dashuria dhe Bukuria përbëjnë boshtin kuptimor dhe artistik të poemthit *Bukuria*.

**a. Në ç’ marrëdhënie i vendos ato poeti me njëra-tjetrën?**

*Bukuria dhe dashuria janë në marrëdhënie varësie reciproke me njëra –tjetrën. Bukuria lind dashurinë dhe dashuria nuk ekziston pa të bukurën.*

**b. Ç’raport krijojnë ato me konceptin djalëri?**

*Raporte barazie ose të njëkohëshme.*

**c. Ç’raport krijojnë ato me konceptin pleqëri?**

*Raporte kundërshtie ose raporte përjashtimore.*

2. a. Kë lëvdon Naimi për mënyrën e veçantë të shfaqjes së bukurisë?

- a. Gruan   b. Natyrën   c. Perëndinë   d. Njeriun

b. A ndikojnë idetë filozofike të Naimit (platonizmi dhe panteizmi) në mendimin e tij mbi dashurinë dhe të bukurën? Argumentoni përgjigjen tuaj.

*Idetë filozofike të Naimit platonizmi dhe panteizmi ndikojnë. Perëndia është krijuesi që lind bukurinë e prej kësaj lind dashuria.*

3. Identifikoni dy veçori të romantizmit dhe dy tipare të poezisë popullore në këtë krijim të Naimit.

a. Poezisë popullore: vargu 8 – rrokësh; personazhi i shtrigës; figuracioni popullor; shprehjet popullore.

*Konceptimi i ndjenjës së dashurisë dhe mënyra se si e përjeton dashurinë. - mënyra se si përdor elemente të natyrës në krijim. - figuracioni; ( epitete, krahasime, simbole, metafora etj). - gjuha e pasur, pasuria leksikore, shprehitë popullore (P.sh leshratë në erë, do të qanj me thes në kokë...etj.) - elemente të metrikës.*

b. Veçori të romantizmit: raporti arsye/ndjenjë në favor të ndjenjës, mbështetje në folklor, Fjalor i pasur; idealizimi i dashurisë dhe i femrës; format e larmishme metrike.

*Kulti i ndjenjës. - tema e dashurisë, dashuria si bipolare. - nocionet estetike (vetë e bukura). – lirizmi*

4. a. Ç'ide thekson poeti përmes figurës së enumeracionit në vargjet :

*Kudo është Bukuria*

*Në qiej, në dhe, në hënë,*

*Në diell, në shënjë, në yj,*

*Ndër lule, ndër drurë, në pyj....*

*Ideja se bukuria shihet kudo.*

b. Ç'funktion stilistik përftohet nga zëvendësimi i vetës së tretë të përemrit vetor me vetën e dytë, në vargun "Dhe ajo ti është bërë". Cila është ti?

*Në kuptimin konkret: Lexuesi /në kuptimin simbolik:Vajza*

5. Dalloni figurën stilistike përmes së cilës shprehet gjendja shpirtërore e heroit lirik në vargjet e mëposhtme dhe interpretojeni atë:

*O ditët' e djalërisë, metonimi*

*Që kishit shumë gëzime, metonimi*

*Ratë në det t'arratisë, - metaforë*

*Më latë në hidhërimë. -metaforë*

*Metafora. Krijon përfytyrimin konkret për gjendjen e heroit lirik.*

6. Gjeni dallimin gjuhësor e kuptimor mes këtyre vargjeve:

*-Perëndi e bukurisë / -Perëndia bukuroshe*

*Dallimi kuptimor: e përcakton si lloj perëndie - vetë perëndia është e bukur, si cilësi*

*Dallimi gjuhësor: Përcaktor i shprehur emër - përcaktor e shprehur me mbiemër*

7. Ç'ndjenjë përftohet nga përsëritja e brendshme në vjershën e12-të? Pse përsëritet disa herë pjesëza mos ?

*Përsëritja e brendëshme përfton ndjesinë e dhembjes, lutjes, përlujes, lektisjes.Poeti nuk e përballon dot dhembjen. Përsëritja e pjesëzës mos e përforcon dhe i jep ritëm strofës.*

C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Praktikë e udhëhequr:**

*Jepni shembuj të figurave të intonacionit e sintaksës (pasthirrma, thirrurë, pyetje retorike, anafora), përmes të cilave shprehen gjendjet e ndryshme shpirtërore të heroit lirik.*

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive, pikëpamjeve filozofike të Naimit.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Realizoni diçka bukur! (mund të jetë detyrë për portofolin)

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore– <b>Realizmi</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evidenton kontekstin historiko-letrar të lindjes dhe përhapjes së këtij drejtimi</li> <li>• diskuton rreth zhvillimit të realizmit, si drejtim i rëndësishëm kulturor, letrar dhe artistik</li> <li>• veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj epoke në Europë dhe në botë</li> <li>• përcakton gjinitë letrare</li> <li>• evidenton veçoritë e realizmit</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• realizëm</li> <li>• zhvillimi kapitalist</li> <li>• pasqyrim me vërtetësi</li> <li>• Francë</li> <li>• Balzak</li> <li>• Angli</li> <li>• Dikens</li> <li>• pikturë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Tekste letrar</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> <li>• Interneti</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për realizmin.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Stuhi mendimesh, Di/Dua të di/Mësova, Grupet e ekspertëve, Diskutim.</i>			

## Organizimi i orës së mësimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Stuhi mendimesh:**

- Çfarë njohurish keni për kontekstin historik dhe kulturor të realizmit?
- Ç'ndryshime ndodhën në shoqërinë njerëzore?
- Cilët janë përfaqësuesit që njihni?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Di/Dua të di/ Mësova: Përmbledhje e strukturuar, INSERT.**

Njihen nxënësit me teknikën Di/Dua të di/Mësova. Plotësohen dy kolonat e para të tabelës.

Di	Dua të di	Mësova

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Grupet e ekspertëve.**

Mësuesja:

- cakton grupet bazë prej katër ose pesë nxënësish.
- u thotë nxënësve të numërohen brenda grupeve: “Një , dy, tre, katër”
- u jep nxënësve pyetjet e studimit dhe i cakton nxënësit nëpër grupe ekspertësh.
- u shpërndan nxënësve fleta me pyetje në to.

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Grupet eksperte përgatitin pjesën e tyre të pyetjeve.

Ekspertët kthehen tek grupet bazë dhe drejtojnë diskutimin atje me radhë.

Detyra e ekspertëve është jo vetëm të raportojnë për idetë, por edhe të bëjnë apo të marrin pyetje nga grupi.

### Çështjet:

#### Grupi 1:

Cili është konteksti historik i zhvillimit të realizmit?

#### Grupi 2:

Këndvështrim mbi përhapjen e realizmit në shumë vende të Europës dhe të botës.

#### Grupi 3:

Veçoritë dhe përfaqësuesit kryesorë të periudhës së realizmit.

#### Grupi 4:

Përhapja e gjinive letrare dhe kryesisht ato gjini që morën zhvillim më të madh.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

1. Ç'është realizmi? Cili është konteksti historik në të cilin lindi kjo rrymë letrare?

2. Listo disa nga përfaqësuesit e realizmit në vendet ku ai u zhvillua:

3. Cili është vendi i romanit në gjinitë që u zhvilluan më së shumti përgjatë kësaj rryme letrare? Shpjegoni pse.

4. Ç'kuptoni me *tipike* e *tipizim*?

Francë	Angli	Rusi	Amerikë	Shqipëri

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen dhe rolin në grup, për formulimin dhe përcjelljen e informacionit në grup, për shkallën e përvetësimit të njohurive.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Lexoni fragmentin e mëposhtëm, shkëputur nga romani "Iluzionet e humbura" të Balzakut. Gjeni dhe ilustroni me shembuj disa karakteristika të realizmit, si: vërtetësia; tema aktuale; konfliktet; gjuha si mjet individualizues etj.
- Për modelin e hartës së mendjes shih fazën e parashikimit të orës pasardhëse.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Realizmi (ora II)</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimi :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton rreth zhvillimit të realizmit, si drejtim i rëndësishëm kulturor, letrar dhe artistik</li> <li>• veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj epoke në Europë dhe në botë</li> <li>• përcakton gjinitë letrare</li> <li>• njeh dhe gjen tipare të realizmit në një fragment të dhënë</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizëm</li> <li>• Zhvillimi kapitalist</li> <li>• Pasqyrim me vërtetësi</li> <li>• Francë</li> <li>• Balzak</li> <li>• Angli</li> <li>• Dikens</li> <li>• pikturë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor</li> <li>• Teksti letrar</li> <li>• Interneti</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për realizmin.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Pema e mendjes, Ditari tripjesësh, Vëzhgim dhe diskutim</i>			


## Organizimi i orës së mësimi

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme*****Diskutim mbi njohuritë paraprake:***

Lexohen dhe diskutohen detyrat e shtëpisë. Nxënësit kanë gjetur dhe ilustruar me shembuj nga romani “Iluzionet e humbura”, Balzak, disa karakteristika të realizmit, si: vërtetësia; tema aktuale; konfliktet; gjuha si mjet individualizues.

***Pema e mendjes:***

*Nxënësit së bashku me mësuesin sjellin përmes pemës së mendjes njohuritë e marra një orë më parë*



**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Ditari tripjesësh**

Nxënësi ndërton një ditar tripjesësh dhe përmbledh parimet dhe karakteristikat e realizmit, më pas jep dhe komentën e tij për të.

Parimet e realizmit, karakteristikat	Përmbledhje/sqarim	Komenti i nxënësit
-Realizmi lindi si një kundërvënie ndaj romantizmit.	Rrymë e cila kishte mbizotëruar në letërsi dhe në art që nga fundi i shekullit XVIII. Ky drejtim letrar braktis lëndën ekzotike, emocionalizmin dhe dramën romantike dhe në vend të tyre portretizon njerëz të vërtetë dhe tipikë bashkëkohorë, situata me vërtetësi dhe saktësi të përpiktë, pa shmangur aspekte të pakëndshme të jetës.	
-Vendosin lidhje të drejtpërdrejtë midis artit dhe botës reale.	Ata e shohin botën si burim frymëzimi estetik e jo si objekt për riprodhimin mekanik të saj, e as si fushë për ushtrim formash origjinale artistike	
Karakteristikë e shkrimtarëve realistë është: -Prirja për të zbuluar konfliktet më të mprehta të jetës dhe për të gjetur burimin e tyre shoqëror.	Realiteti i kohës u ofroi shkrimtarëve probleme me karakter shoqëror, politik, filozofik, intim, midis të cilave problematika shoqërore është më e pëlqyera.	

-Pasqyrimi i problemeve kryesore të kohës, i realitetit objektiv.	E vërteta prozaike, pa zbulime artificiale. Realiteti flet vetë, - thotë Balzaku.	
-Besnikëria në riprodhimin e rrethanave tipike dhe saktësia e detajeve historike.		
-Përshkrimi i njerëzve të të gjitha klasave në situatat që lindin në jetën e zakonshme.		
-Shkrimtarët realistë i japin një rëndësi të veçantë detajit jetësor, i cili ngrihet pastaj në përgjithësim artistik.	Shkrimtarët realistë veçojnë ato shfaqje të jetës që kanë vlerë përgjithësuese, krijojnë një tip, një karakter tek i cili përmbledhen karakteristikat më të qarta e thelbësore, tipike të një kategorie të caktuar njerëzish.	
-Realistët krijojnë personazhe tipike.	Tipat artistikë të realistëve, duke ngjasuar me njerëzit e gjallë, janë më të plotë dhe më bindës, madje edhe se vetë njerëzit realë. Kjo ka bërë që figura si Grandeja, Gobseku, Ana Karenina të përmenden në përditshmërinë tonë si njerëz realë.	
-Shkrimtarët realistë paraqesin karakterin e personazheve në zhvillim, në përputhje me kushtet historiko-shoqërore në të cilat këto personazhe veprojnë.	Gjatë jetës ai ndryshon, zhvillohet, rritet, plakët dhe përpunon a zhvillon më tej pikëpamjet, bindjet e qëndrimet e veta.	
-Shkrimtarët realistë përdorën gjuhën si mjet shprehës artistik për individualizimin e personazheve.	Çdo personazh flet gjuhën e tij, individuale, ndryshe nga gjuha e personazheve të tjera apo vetë gjuha e autorit.	

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Khon Mile (John Millais), *Lulet e mollës në pranverë (1859)*



Pierre Auguste Renoir,  
*Vajzë duke krehur flokët (1894)*

#### **Vëzhgim dhe diskutim:**

Nxënësit vëzhgojnë figurat dhe u përgjigjen pyetjeve:

- A trajtojnë temë aktuale tablotë?
- Sa l vërtetë është iluzioni që shfaqet?
- Si jepen ngjyrat e tablosë?
- Po ravijëzimi i tipareve?
- karakteri psikologjik (vajza me krëhër) etj.

- A janë të idealizuara gratë në *Lulet e mollës në pranverë*?

Nxënësit duhet të analizojnë pikturën dhe nëpërmjet sjelljes së detajeve të arrijnë në përfundim që piktura është realiste.

- *Oborri i mbushur me lulet e mollës.*
- *Gratë në pozicione, dëshira të ndryshme.*



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

- Veshja e grave.
- Puna, ngutja, përkushtimi, zbukurimet.
- Gjelbërimi.

Nxënësit vëzhgojnë edhe pikturën “Vajza duke krehur flokët” dhe vërejnë detajet realiste në të.

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për imagjinatën e tij, për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, formulimin dhe përcjelljen e informacionit për saktësinë e tyre, për përmbledhjen dhe sqarimin e informacionit.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- *Vështrim* krahasues : Dalloni veçoritë e prozës realiste nga ato të prozës romantike.
- Lexoni jetën dhe veprën e Balzakut. Përmbledhni në fletore të dhënat që ju duken më të rëndësishme.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Balzaku. Jeta dhe krijimtaria</b>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Balzakut si realist, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• veçon veprat kryesore të Balzakut;</li> <li>• diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Balzakut në letërsinë botërore.</li> <li>• Evidenton tiparet dhe artin balzakian.</li> <li>• është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komedi njerëzore</li> <li>• Karaktere njerëzore</li> <li>• Romane</li> <li>• Realist</li> <li>• Gobsek</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Foto</li> <li>• Tabela ilustruese</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori	<b>Situata e të nxënësve:</b> Diskutim për jetën e Balzakut.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Stuhi mendimesh, Ditari dypjesësh, Korniza të skeletëzuara të mësimit</i>			

### Organizimi i orës së mësimit

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### *Diskutim mbi njohuritë paraprake:*

-Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrës së shtëpisë. *Vështrim* krahasues

Proza realiste	Proza romantike
<ul style="list-style-type: none"> <li>- kritikon romantizmin për mistifikim (idealizim) të realitetit,</li> <li>- marrëdhënie e ngushtë ndërmjet veprës së artit dhe realitetit,</li> <li>- nuk fotografon realitetin, por pasqyron ato anë që kanë vlera përgjithësuere,</li> <li>- temat dhe problematikat lidhen ngushtë me aktualitetin,</li> <li>- qëndrim opozitar ndaj polarizimit të shoqërisë,</li> <li>- dënon humbjen e vlerave njerëzore,</li> <li>- dënon vesin dhe ngre lart virtytet njerëzore,</li> <li>- realiste në të gjithë përbërësit e saj,</li> <li>- subjekti zhvillohet në mënyrë kronologjike,</li> <li>- ruan etapat klasike të kompozicionit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- i kundërvihet klasicizmit dhe rregullave të ngushta,</li> <li>- paraqit botën shpirtërore e interesat e njeriut,</li> <li>- kërkon të largohet nga realiteti dhe të drejtohet nga e kaluara historike ose të ëndërrojë për të ardhmen,</li> <li>- temat: historike, legjendare, ekzotike,</li> <li>- liri mendimi e forme,</li> <li>- Kulti i ndjenjës, i natyrës,</li> <li>- u afi rrua si arti i metaforës, kontrastit, zmadhimit</li> <li>- situata të jashtëzakonshme,</li> <li>- pranëvënia e të kundërtave.</li> </ul>

### Stuhi mendimesh:

Lexohen dhe diskutohen ato që nxënësit kanë lexuar për Balzakun:

- Ç'dini për jetën dhe veprën e Balzakut?
- Çfarë keni lexuar nga Balzaku?

- Balzaku lindi në Tur të Francës në qershor të 1799-ës. Ky vit shënon dhe fillimin e perandorisë së Napoleonit.
- Balzaku nis të shkruajë duke lakmuar titullin më të lartë, kurorën perandorake, njësoj si Napoleoni: *Atë çka ai nuk arriti ta përfundojë me anë të shpatës, unë do ta plotësoj me anë të penës.*
- *Merr diplomën e fakultetit të drejtësisë, por shpejt lë zyrën e noterit.*
- *Ka vendosur të bëhet shkrimtar. Për gati 10 vjet shkruan një dramë e 30 romane që janë dështime të njëpasnjëshme.*
- *Më 1829-ën, Balzaku boton romanin historik realist "Shuanët", me të cilin fillon të bëhet i njohur në rrethet letrare.*
- *Lavdia e shumëpritur do t'i vijë më 1831-in, me romanin "Lëkura prej shagrinë".*
- *Balzakut i lindi ideja për bashkimin e veprave të tij në një cikël të madh të vetëm, që më vonë do ta quajë "Komedia njerëzore".*
- *Ideja për rolin shkatërrues të parasë, e hedhur që te "Gobseku" e që do të bëhet dhe tema qendrore e tërë veprave të tjera të mëvonshme të "Komedisë njerëzore", do të zhvillohet më tej në romanin "Evgjeni Grande".*
- *Më 1834-ën shkruan "Xha Gorioi", më pas "Madhështia dhe rënia e Cezar Birotos", "Iluzionet e humbura", "Shkëlqimi dhe mjerimi i kurtizaneve", "Kushërira Betë", "Kushëriri Pons" etj.*

B. Ndërtimi i njohurive të reja

### Ditari dypjesësh:

Veprat	Komente
"Komedia njerëzore" është titulli i përbashkët	<p><b>Seria e parë</b>, e titulluar <b>Studime për zakonet</b>, përmbledh pjesën më të madhe të veprave ndarë në gjashtë cikle: <i>skena të jetës private, të jetës provinciale, të jetës pariziane, të jetës politike, të jetës ushtarake, të jetës fshatare.</i></p> <p><b>Seria e dytë</b> është titulluar <b>Studime filozofike</b>, <b>Seria e tretë</b>, <b>Studime analitike</b>. Balzaku arriti të shkruajë 97 romane e novela të mëdha, nga 143 që mendonte të shkruante. Ndër më të shquarat janë: "Fajdexhiu Gobsek", "Evgjeni Grande", "Iluzionet e humbura", "Xha Gorioi", "Fshatarët", "Kushërira Betë" etj.</p>

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Romani "Iluzionet e humbura"	-është konsideruar nga autori si pjesa e dytë e një trilogjie që fillon me "Xha Gorioin" dhe mbaron me "Shkëlqimin dhe rënien e kurtizaneve". -"Iluzionet e humbura" është tabloja e gjerë përgjithësuese e realitetit francez në vitet 20-30 të shekullit XIX dhe analiza më e thellë dhe më e pamëshirshme që Balzaku i bën vetes. -"Iluzionet e humbura" është një vepër plot krenari e revoltë, një vepër që përcjell mesazhin e madh: <i>mos e poshtëro veten nga padurimi e lakmia, por qëndro i fortë.</i>
"Evgjeni Grande"	Romani "Evgjeni Grande" zë një vend të veçantë në tërë krijimtarinë letrare të Balzakut. Temë e romanit bëhet forca shkatërruese e parasë në shoqërinë e kohës.
"Fajdexhiu Gobsek"	"Fajdexhiu Gobsek" jep idenë e rolit të parasë në jetën shoqërore. Fajdexhiu Gobsek ka vetëm një qëllim, ka vetëm një pasion: të fitojë para. Figura e Gobsekut është reale dhe tipike, ana themelore e tij është etja për të grumbulluar pasuri. Kjo anë errëson të gjitha anët e tjera të karakterit të tij.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Korniza të skeletëzuara të mësimit:**

Nxënësve u shpërndahen fletë me vende bosh për të reflektuar mbi materialin e diskutuar dhe për të kontrolluar shkallën e të kuptuarit.

Balzaku është një nga shkrimtarët \_\_\_\_\_ Balzaku është themeluesi i romanit \_\_\_\_\_ dhe është cilësuar \_\_\_\_\_. Balzaku është një artist i madh e novator i guximshëm. Ai e bëri romanin francez një pasqyrë \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ Balzaku është njësoj i përkushtuar, si për të sjellë \_\_\_\_\_ po aq \_\_\_\_\_ Balzaku është i pari shkrimtar që shtjelloi idenë se rritja e rolit të parasë në jetën shoqërore \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ numri i personazheve që veprojnë. Heronjtë e Balzakut \_\_\_\_\_..  
 Personazhet e tij janë gjithmonë \_\_\_\_\_. Balzaku ka përshkruar \_\_\_\_\_. Pasioni i tyre jo vetëm u thith atyre tërë energjitë, por edhe shkatërron të tjerët rreth e qark, ua merr atyre oksigjenin Nga ana tjetër, të gjitha personazhet kanë një zë të përbashkët: \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_; ku "njerëzimi nuk ka veçse dy tipa njerëzish: \_\_\_\_\_ siç thotë vetë në parthënie e "Komedisë njerëzore".  
 Romanet e Balzakut e marrin fuqinë që kanë nga fakti se kurrë nuk paraqitet e shkëputur; personazhet jetojnë në kuadrin e \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_. Veçoritë si: \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ ose konflikti intrigues i lënë vendin njëri-tjetrit në veprën balzakiane. Struktura është \_\_\_\_\_, në shumë linja \_\_\_\_\_, tema e ide që rimerren dhe personazhe që shfaqen dhe \_\_\_\_\_. Balzaku është mjeshtër i dhënies së dramacitetit, tensioni në vepër rritet \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për interpretimin, pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, argumentet, analizat dhe interpretimet.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Lexoni fragmentin shkëputur nga romani "Evgjeni Grande" dhe përgjigjuni kërkesave në vazhdim:

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
<b>Tema mësimore–Balzaku “Xha Gorio”</b>			
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin, detajet fizike, situatat etj);</li> <li>• dallon linjat dhe përmbledh ngjarjet kryesore të veprës Xha Gorio;</li> <li>• veçon tiparet e stilit balzakian dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi;</li> <li>• analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.</li> <li>• shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;</li> <li>• reflekton mbi veçoritë e realizmit të shfaqura në vepër.</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• aristokraci</li> <li>• pension</li> <li>• pasion</li> <li>• bijat</li> <li>• shfrytëzim</li> <li>• pasuri</li> <li>• ironi e vdekjes</li> <li>• atëvrasja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Tabakë,</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori	<b>Situata e të nxënimit:</b> Diskutohet mbi rolin e familjes si bërthama e shoqërisë njerëzore.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Harta e ngjarjes, Punë në grupe, Pesëvargësh</i>			

## Organizimi i orës së mësimimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Diskutohen pyetjet e detyrës së shtëpisë në zberthimin e fragmentit nga romani “Evgjeni Grande”.

- **Fragmenti jep çastet e fundit të plakut Grande. Ndonëse Evgjenia është pranë tij, plaku nuk e sheh, ndaj e thërret. Pse e thërret Grandeja të bijën?**

Edhe në çastet e tij të fundit, plaku mbetet i lidhur me dashurinë e vetme të tij, paranë (para tavolinës ku shtrohet ari). Ndërkohë që Evgjenia i thotë “baba”, ai asnjëherë nuk i thotë “bijë”. Ajo i kërkon uratën, ai në mënyrë cinike e kërcënon. E thërret për paratë

- **Cila është sjellja e Grandesë në çastet e fundit të jetës? A ju duket e panatyrshme?**

Plakun nuk e trondit aspak vdekja. Vdekja e vërtetë për plakun Grande është ndarja nga paratë. Për Grandenë paraja është sinonimi i jetës, lumturisë njerëzore, i vdekjes. Krejt e panatyrshme

- **Analizoni dy figurat kryesore: plakun Grande dhe Evgjeninë, sikurse dalin në këtë skenë. Ç’qëndrim mban Balzaku ndaj tyre? Shpjegoni, përmes ilustrimeve nga fragmenti, pasionin shkatërrues të plakut Grande.**

Dramaciteti buron nga fakti se Grandeja nuk shqetësohet se po vdes, por se po ndahet nga pasuria, nuk e shqetëson vajza që po lë vetëm, por ka hallin e mallit të tij. Nuk i bën përshtypje asnjë përkujdesje. Gjithçka ndodh në një kontrast bardh e zi. Në një anë Evgjenia me përkujdesjen e saj dhe në anën tjetër Grandeja i ftohtë dhe autoritar që mendon vetëm për paratë. Kjo makutëri dhe ky pasion i pandryshuar i tij nga asgjë, kjo mungesë e ndjenjave njerëzore sjell dhe dramacitetin në këtë fragment. Ideja e autorit shfaqet nëpërmjet fjalive, gjesteve, mimikës së personazhit. Këto realizohen përmes detajeve artistike si:

vatër, zjarr, fytyra që shkëlqen nga drita e lumturisë, sytë e bablokut, kryqi, vazoja, shandanët, nishani, dora. fjalive pyetëse, foljeve në urdhërore etj.

- **Krahasoni plakun Grande me fajdexhiun Gobsek.** Janë shumë të ngjashëm
- **Cila është rëndësia e veprës së Balzakut në letërsinë franceze dhe më gjerë?**

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

Nxënësit kanë lexuar romanin “Xha Gorio” dhe materialin teorik në libër.

**Harta e ngjarjes** saktësohet së bashku me mësuesen.

<b>Koha dhe hapësira</b>	Ngjarjet në roman nisin në fundin e nëntorit të vitit 1819. Pensioni familjar “Voker”, pronë e vejushës Voker, është mjedisi kryesor ku zhvillohen ngjarjet.
<b>Lloji</b>	Roman
<b>Personazhet</b>	Xha Gorio, Rastinjaku, Votreni, zonja Voker, Delfina, Anastasia
<b>Linjat</b>	-Në roman kemi dy linja që gërshetohen me njëra-tjetrën: -Nga njëra anë, <b>fati i tregtarit plak Gorio</b> , baba i braktisur prej dy vajzave, -Nga ana tjetër, takojmë <b>fatin e Eugjen Rastinjakut</b> , një nga personazhet më të rëndësishme të romanit dhe të gjithë <i>Komedisë Njerëzore</i>
<b>Ngjarjet kryesore</b>	Xha Gorio kishte hyrë në shtëpinë e zonjës Voker pasi kishte lënë tregtinë. Gjashtë vjet më parë, kur Gorioi erdhi fillimisht në pension, i kamur e me të ardhura të mira. Gorioja, për shkak të dashurisë së verbër ndaj vajzave të tij, pak nga pak fillon të humbë “pozitat e mira”, nis të zvogëlojë shpenzimet e shërbimet, i duhet të kursejë dhe brenda një viti e gjen veten në katin e dytë të pensionit. Ngjitja nga kati i parë në të dytin ishte shenjë varfërimi në atë pension. Nuk vonon shumë dhe plaku i mjerë do të nisë të banojë në katin e tretë të pensionit. Rastinjaku, studenti i drejtësisë, zbulon rastësisht se zonja e bukur që sheh në ballo, Anastasi de Resto, është një nga vajzat e xha Gorioit. I dëshpëruar Gorioi vendoset në pensionin “Voker”. Kishte aq të ardhura sa për të jetuar, por vajzat nuk ndalen deri sa i zhvasin gjithçka babait të tyre. Rastinjaku 21-vjeçar, i lidhur me familjen me ndjenjat më të pastra e më të shenjta, duke besuar te mirësia, përlozet teksa merr vesh të vërtetën e hidhur dhe i del krah Gorioit. Por Rastinjaku nuk ishte i pasur, të ardhurat nga familja ishin të pakta. Ia studimet, në fakultet kërkon të bëjë për vete vajzën e Gorioit, zonjën Dë Nysingen me të cilën dashurohet, luan bixhoz të madh, fiton ose humbet shumë mësohet me jetën e shturur, humb të gjitha të hollat e hyn në borxhe. Votreni, ky Mefistofel që di të lexojë mendjen e Rastinjakut, sheh qartë ambicien e tij, ndaj i propozon Eugjenit një plan për të siguruar të ardhmen: Megjithatë Rastinjaku nuk ka humbur çdo cilësi: ai nuk martohet me zonjushën Tajëfer, por i qëndron besnik deri në fund Delfinës.
<b>Ngjarjet përfundimtare</b>	-Votreni, mishërimi i poemës satanike, krimineli i arratisur nga burgu, arrestohet. - Telashet e vajzave dhe zënkat mes tyre e goditën pa mëshirë zemrën e plakut. - Me largimin e tyre Gorioi sëmuret rëndë, por thirrjet, vajtimet, kërkesat e tij pa fund për t’i pasur vajzat pranë në këtë çast të fundit nuk ia kthejnë të bijat. Plaku, i çmendur nga dhimbja, pohon tërë sakrificën dhe mosmirënjohjen e vajzave të tij. - Karroja e përmotshme do të shoqërohet nga Rastinjaku, një shërbëtor, dy varrmihësit dhe dy karrocet bosh të të bijave. - Bashkë me plakun, Rastinjaku varrosi lotin e fundit të djalësisë, <i>lotin e shkëputur nga emocionet e shenjta të një zemre të kulluar</i> dhe, me sytë plot lakmi, i drejtohet shoqërisë së lartë të Parisit: <i>Tani të shohim se kush do të fitojë, unë apo ti.</i>

<b>Tema</b>	<b>Tema</b> e romanit është jeta e përditshme, plot shqetësime e pasione e një borgjezi parizian, marrëdhëniet familjare dhe korrupsioni moral në shoqëri.
<b>Mesazhe</b>	Ai lëshon thirrjen: “Atdheu do të shkatërrohet në qoftë se prindët merren nëpër këmbë.”

**Punë në grupe:**


Pasi punohet me hartën e ngjarjes, kalohet në analizën e personazheve të veprës.

Lexohet materiali teorik në tekst.

Ndahet klasa në grupe.

Çdo grup do të analizojë një personazh: Xha Gorio, Rastinjaku, Votreni, Zonja Voker, Delfina.

Punohen në **klaster** në tabelë tiparet dhe veçoritë për secilin personazh. Ndalohet te figura e Xha Goriosë.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura****Pesëvargësh:**

Nxënësit ndërtojnë një pesëvargësh për Xha Gorioin dhe të bijat.

Përshkruaj Xha Gorioin.

-Me anë të një emri \_\_\_\_\_

-Me anën e dy mbiemrave \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

-Me tri folje \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

-Me anën e një fraze \_\_\_\_\_

-Duke e ripërcaktuar me një sinonim \_\_\_\_\_

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për leximin e veprës “Xha Gorio” dhe plotësimin e saktë të rubrikave të hartës së ngjarjes, analizës së personazheve, ilustrimeve me shembuj nga vepra dhe për plotësimin e saktë të pesëvargëshit.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**


- Shkruani: Përmes një eseje krahasim-kontrasti jepni të përbashkëtat e dallimet mes personazheve Votren dhe Mefistofel.

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Koment “Biruca”, Balzak</b>			
<b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave lëndore sipas temës së mësimet :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj.</li> <li>• analizon personazhin e Xha Goriosë, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet e personazhit etj.;</li> <li>• evidenton veçoritë e romantizmit përmes fragmentit</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Biruca</li> <li>• krevati</li> <li>• Dyshemenë</li> <li>• murin</li> <li>• Babloku</li> <li>• Mobiljet</li> <li>• vatrën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fletë formati</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	<b>Situata e të nxëniet:</b> Diskutohet mbi situatën e fragmentit <i>Biruca</i> .		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, Teknikat e të pyeturit, Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur në grupe, Shkrim i lirë</i>			

**Organizimi i orës së mësimet**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**  
**Diskutim mbi njohuritë paraprake**  
 Diskutohet detyra e shtëpisë.



**Teknika e të pyeturit:**

Ora nis me kontrollin e njohurive për materialin teorik.

**Pyetjet:**

1. Pse romani “Xha Gorioi” quhet çelës për veprën “Komedia njerëzore”?
2. Cilat janë dy linjat kryesore të romanit?
3. Ç’tipare të personazhit realist gjeni te personazhet e romanit “Xha Gorioi”?
4. Ç’vlera artistike e ideore bart vepra?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Praktikë e udhëhequr:**

Punohet me aparatën pedagogjik në tekst. Pyetje për kuptimin:

1. Balzaku përshkruan me detaje dhomën e plakut Gorio. Veçoni disa prej tyre lidhur me:

dritaren	Pa perde
dyshemenë	tërë lagështirë e plot pluhur.
murin	e zverdhur
krevatin	E keq
mobiljet	e vjetër me syprinë druri,
vatrën	s'kishte gjurmë zjarri,
komo	kishte nxjerrë bark

2. Megjithëse jeton në mjerim plaku nuk ankohet. Ana materiale zhvlerësohet para shqetësimit të xha Gorioit. Cili është ai? *Shqetësimi për vajzat që ata të kenë gjithçka, të bëjnë jetën që duhet...*

3. *Të gjitha janë këtu, - shtoi ai duke i rënë gjoksit me dorë. Ç'nënkupton gjesti i plakut Gorio?*

*Plaku Gorio nuk shpreh dot me fjalë atë që ndien për vajzat e veta. Pasioni i dashurisë ndaj tyre është kaq i madh!*

4. Çfarë ëndërron xha Gorio? A janë egoiste ëndrrat e tij?

*Xha Gorio ëndërron t'i ketë pranë vetes vajzat si dikur:*

*Eh, sikur të jetoja bashkë me to, vetëm sa t'u dëgjoja zërin, ta dija që i kisha aty, t'i shikoja të hynin e të dilnin, si atëherë që i kisha në shtëpinë time, do të më gufonte zemra nga gëzimi...*

*Ëndrrat e tij janë egoiste. Prindi nuk mund t'i ketë pranë vetes fëmijët gjatë gjithë jetës. Vjen një çast që fëmijët largohen e ngrenë strehëzën e tyre.*

### **Punë e pavarur në grupe:**

#### **Grupi I:**

5. Eugjeni i përsërit plakut fjalët e baroneshës, së bijës, por të zbukuruara. Ç'tregon kjo për natyrën e djaloshit? Po për Delfinën, vajzën e xha Gorioit?

*Rastinjaku është i sjellshëm, i vjen keq për plakun, nuk do ta lëndojë më, e di sa i do ai vajzat. Ndërsa për Delfinën ky fakt është tregues i marrëdhënies së saj me të atin: Delfina nuk vret mendjen se çfarë mund ta kënaqë më fort plakun.*

6. Plaku Gorio thotë: *Jeta ime janë vajzat e mia*. Si e kuptoni këtë thënie?

*Kjo thënie shpreh dashurinë e madhe që ka plakun Gorio për të bijat. Ai jeton vetëm për to. Vajzat janë gjithçka për plakun. Ato janë gëzimi e hidhërimi, lumturia e dëshpërimi i tij.*

7. Xha Gorio pranon se vajzat e tij e kanë zili njëra-tjetrën, por këtë rivalitet plakun e sheh si shenjë të dashurisë për atin e tyre. A mendoni dhe ju kështu? Dashuria dhe pasioni i xha Gorioit për vajzat a e ka bërë plakun të humbasë gjykimin e shëndoshë?

*Rivaliteti i vajzave nuk lidhet me dashurinë e tyre për të atin. Rivaliteti i tyre është shprehje e egoizmit dhe dëshirës për të dominuar. Vajzat kërkojnë një reputacion sa më të mirë në shoqërinë e lartë dhe këtë e shfaqin hapur, por xha Gorio, i cili tashmë e ka humbur plotësisht gjykimin e shëndoshë, verbuar nga dashuria e tij për të bijat, e sheh këtë rivalitet si do ai që të jetë dhe jo siç është në të vërtetë.*

8. Bëni komentin tuaj për thënien që mbyll fragmentin: *këto janë tronditje shpirtërore që të mbushin me kënaqësi*.

*Përmes kësaj thënieje xha Gorio tregon tërë kënaqësinë që buron nga atësia. Për të, të qenët prind është privilegj. Një prind merr lumturi nga lumturia e fëmijës së tij dhe dhimbje nga dhimbja e tij.*

#### **Grupi II**

9. Stili i Balzaku është prolis. Gjeni në tekst tre shembuj që e provojnë këtë dhe thoni ç'i jep veprës kjo veçori e stilit.

*Përmes përdorimit të detajit Balzaku krijon një përfytyrim të gjallë të mjedisit, në këtë rast të dhomës së plakut Gorio. Lexuesi sheh me sytë e mendjes tërë mjerimin e plakut.*

*Paragrafi i parë është dhënë më përshkrime të zgjatura të një mjedisi të varfër si një birucë.*

10. Gjeni shprehjet frazeologjike në fragment, jepni fjalët kuptimisht sinonimike me to. Shpjegoni funksionin artistik të tyre.



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

*Më gufon zemra nga gëzimi- jam i lumtur  
më ngrijë gjakun- friksohem  
të ngjethej mishtë- tronditem*

**11.** Me ç'mjet gjuhësor e stilistik e cilëson Eugjeni dhomën e xha Gorioit? Sipas tij, me çfarë kontraston ajo?

*Po si është e mirë të banoni në një **haur** të tillë, zoti Gorio...?*

*Eugjeni cilëson dhomën me emrin **haur**, një vend për kafshë a sende, ku nuk mund të jetojë njeriu. Ky cilësim shpreh qartë mjerimin e Gorioit.*

*Dhoma e plakut kontraston me vajzat e tij dhe jetesën e luksit që ato bëjnë.*

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Shkrim i lirë:**

Reagim ndaj historisë së këtij romani. Nxënësit shkruajnë në minutat e lëna në dispozicion reagimin dhe përshtypjet për ngjarjen e fragmentit.

Në historinë e Xha Gorioit më ka bërë veçanërisht përshtypje \_\_\_\_\_.  
Përshtypja ishte e fuqishme sepse \_\_\_\_\_.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në klasë, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi fragmentin.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

**Shkruani:** Gorioi i tregon Rastinjakut për ndjesitë që përjeton një baba dhe detyrimet që burojnë nga atësia. A mendoni se një marrëdhënie, për më tepër një marrëdhënie prind-fëmijë, ngrihet mbi bazën e përkushtimit të njërit kah, atij prindëror, apo mbi dashurinë dhe detyrimin reciprok? Shtjelloni idenë tuaj në një ese argumentuese.

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – <b>Koment “Protesta e Gorioit”, Balzak</b>			
<b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj;</li><li>• dallon temën dhe motivet e një teksti;</li><li>• analizon personazhin e Xha Goriosë, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet e personazhit etj.;</li><li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li><li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim);</li><li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li><li>• Reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.</li></ul>			

<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• paraja</li> <li>• gjithçka dhe asgjë</li> <li>• martirizim mizor</li> <li>• babai i florinjëve</li> <li>• botë e qelbur</li> <li>• drejtësia është me mua</li> <li>• Atdheu do të shkatërrohet</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fletë formati</li> </ul>
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	<b>Situata e të nxëniet:</b> Sa e rëndësishme është familja, dashuria për prindin...
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur në grupe, Punë e udhëhequr.</i>	

## Organizimi i orës së mësimin

### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

#### *Diskutim mbi njohuritë paraprake*

Diskutohet detyra e shtëpisë: Ese argumentuese në lidhje me veprën.

### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### *Praktikë e udhëhequr:*

Punohet me aparatën pedagogjik në tekst. Pyetje për kuptimin:

1. Ku zhvillohen ngjarjet e këtij fragmenti? Pse kjo përzgjedhje?

*Ngjarjet e këtij fragmenti zhvillohen në dhomën e pisët të katit të katërt të pensionit Voker ku u katandis plaku, i veshur me zhele. Autori ka zgjedhur pikërisht t'i japë fund jetës së Xha Gorioit në këtë vend për të treguar që ai tashmë kishte rënë plotësisht nga klasa e mëparshme sociale, ishte në varfëri të plotë dhe i braktisur, i mjerë, pa ngrohtësi.*

2. Me çfarë kërkonte ta fitonte dashurinë e vajzave plaku?

*Dashurinë e vajzave plaku kërkonte ta fitonte me para.*

3. Cilën rrugë gjente ai për të shlyer rastet kur e ndiente që i kishte bezdisur vajzat? Ç'kuptoni ju me togun "me të mira"?

*Rruga e vetme ishte ajo që kalonte tek paraja. Me të mira- paraja*

4. Si e prezantojnë plakun në rrethin e tyre shoqëror dhëndurët? Cila bëhet njësia matëse e vlerave njerëzore?

*"Kush është ky zotëria?". Ata i përgjigjeshin: "Është babai i florinjve, është i pasur". "Hej, djalli!" – ia bënte ai dhe më vështronte me respektin që u bëhet florinjve.*

*Njësia matëse e vlerave njerëzore bëhet paraja.*

5. Xha Gorioi thotë: *Gjithë plumbat më kanë goditur në shenjë dhe më kanë përshkuar zemrën. Cilët janë plumbat që kanë goditur zemrën e plakut?*

*Mosrespekti i vajzave ndaj të atit, marrëdhënia e interesit që ka kushtëzuar sjelljen e tyre.*

#### *Punë e pavarur në grupe:*

##### *Grupi I:*

6. Për një çast, xha Gorioi shfaqet në mëdyshje: *i pasur apo i varfër?* Gjenero këto mendime kontradiktore të tij në fragment dhe shkruani argumentet që jep ai për secilën nga alternativat. Cilën alternativë zgjedh ai? Ç'tregon kjo për natyrën e plakut? Po ju, cilën alternativë do të zgjidhni?

##### *Argumenti (i pasur)*

*- Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinën time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu,*

do të më lanin faqet me të puthura! Do të banoja në një pallat, do të kisha dhoma të bukura, shërbëtorë, ziarr për t'u ngrohur; dhe ato do të ishin këtu, me lot për faqe, me gjithë burrat e fëmijët e tyre. Do t'i kisha të gjitha.

Sikur të kisha thesare për të lënë, ato do të më rrinin te koka, s'do të dinin ç'të më bënin më parë, do t'u dëgjoja zënë, do t'i shikoja.

**Argumenti (i varfër)**

Ah, biri im i dashur, djali im i vetëm, më mirë që mbeta i braktisur e në mjerim!

Të paktën, kur e duan fatzinë, ai është i sigurtë që e duan me gjithë shpirt.

Plaku zgjedh alternativën e të qenurit i pasur: Jo, desha të isha i pasur.

7. Dashuria e madhe për vajzat e ka bërë xha Gorioin të varur. A është i ndërgjegjshëm ai për këtë varësi? Ku duket kjo? Me kë e krahason pasionin e vet xha Gorioi? A mund të vërë mend ai? Pse?

*"E shihja fare mirë unë që ma kishin me djallëzi; por qe sëmundje që s'kishte ilaç." Ai e krahason pasionin e tij me kumarin, prej të cilit nuk shkëputesh dot.*

*Jo, plaku Gorio nuk mund të verë mend sepse e ka të vështirë të shkëputet nga vesi. Pasioni i tij është mbizotërues. Pa vajzat, nuk ka jetë.*

8. Në këtë çast të fundit të jetës, si prind, xha Gorioi i njeh vetes disa gabime. Cilat janë ato?

- *Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinë time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu, do të më lanin faqet me të puthura! Paraja të jep gjithçka, edhe vajzat.*

- *Kaq e madhe ishte dashuria ime për to, sa që s'mbeti vend për dashurinë e tyre ndaj meje.*

- *Një atë duhet të jetë gjithmonë i pasur, duhet t'i mbajë për freri fëmijët e tij, si kuajt e hazdisur. Kurse unë rrija më gjunjë përpara tyre.*

9. Xha Gorioi provon një sërë ndjesish. Gjeneri dhe ilustroni me shembuj nga fragmenti këto ndjesi.

Dhembje: O perëndi! Po meqë ti e di se ç'të zeza kam hequr, meqë ti i ke numëruar thikat që kam marrë në atë kohë që më plaku, që më kërrusi, që më nxiu, që më vrau, që më thinji, pse më bën të vuaj sot? Zhënjim: Do të desha t'i mësoja të gjitha, por vetëm një gjë mësova mirë: që isha i tepërt në këtë botë.

Zemërim: Faqezetat! Po e kurorëzojnë denjësisht sjelljen që kanë treguar ndaj meje këto dhjetë vjetët e fundit.

Revoltë: Vajzat, vajzat e mia, Anastasinë, Delfinën dua t'i shoh. Dërgoni merrini me policë, me forcë! Drejtësia është me mua, të gjithë me mua janë, natyra, Kodi Civil. Unë protestoj! Atdheu do të shkatërrohet në qoftë se prindët merren nëpër këmbë. Kjo është e qartë. Boshti, rreth të cilit sillet shoqëria, gjithë bota, është atësia; të gjitha do të shemben, në qoftë se fëmijët nuk i duan prindërit e tyre. etj.

10. Cila është ideja e fragmentit? A mendoni se kjo është ideja e tërë veprës?

*Atdheu do të shkatërrohet në qoftë se prindët merren nëpër këmbë. Kjo është e qartë. Boshti, rreth të cilit sillet shoqëria, gjithë bota, është atësia; të gjitha do të shemben, në qoftë se fëmijët nuk i duan prindërit e tyre. Po, është ideja e gjithë veprës.*

**Grupi II**

11. Gjeneri fjalët që vendosen mes kllapave në fragment. Si mendoni, pse veçohen nga fjalët e tjera? Ç'tregon kjo për shqetësimin e plakut?

**(Oh! Ç'martirizim mizor!), (Plagë e kam këtë të shkretë kokë!), (Më dhemb, më dhemb shumë, o zot!)**

*Balzaku është mjeshtër për t'i dhënë dramacitet subjektit e për ta çuar atë në mënyrë të natyrshme drejt pikave kulmore. Monologu shpërthyes i jep romanit gjallëri dhe forcë të jashtëzakonshme. Gjykimet përgjithësuese marrin formën e sentencave morale duke bërë që arti balzakian t'i rezistojë kohës.*

*Fjalët brenda kllapave janë treguese të dhembjes fizike të plakut. Siç vihet re, ato janë fare pak krahasuar me pjesën tjetër të tekstit. Kjo gjë tregon sërish se dhembja fizike as që krahasohet me dhembjen shpirtërore.*

12. Përgjatë fragmentit të dhënë xha Gorioi i drejtohet Eugjenit në dy raste: Ah, biri im i dashur, djali im i vetëm dhe o i dashur Eugjen. Eugjeni është aty për të dëgjuar gjithë dëshpërimin e plakut. Mendoni

se ky fragment është ndërtuar në formën e dialogut apo monologut? Pse Balzaku zgjedh këtë teknikë ligjërimiti?

*Monologu i Xha Gorioit ka dhe një dëgjues, i cili qëndron përballë tij. Në momentet e fundit i vetmi person që qëndron pranë tij është Rastinjaku dhe Balzaku e vendos monologun e fundit të xha Goriosë me qëllim që ky i fundit të mësojë më shumë nga mjerimi i xha Goriosë. Rastinjaku nga ky veprim lartësohet në sy të lexuesit.*

**13.** Gjenerali gjymtyrët homogjene. Ç'figurë e stilistikës ndërtohet mbi bazën e tyre? Shpjegoni funksionin artistik të saj.

*Enumeracioni- Po meqë ti e di se ç'të zeza kam hequr, meqë ti i ke numëruar thikat që kam marrë në atë kohë që më plaku, që më kërrusi, që më nxu, që më vrau, që më thinji, pse më bën të vuaj sot? Enumeracioni thekson tragjizmin e situatës në të cilën ndodhet xha Gorioi dhe njëkohësisht përcjell revoltën e tij për vuajtjet që ka kaluar.*

**14.** Gjenerali krahasimin që përdor xha Gorioi për vajzat e veta. Ç'e provokon Gorioin për të shkruar te ky krahasim?

*Një atë duhet të jetë gjithmonë i pasur, duhet t'i mbajë për freri fëmijët e tij, si kuajt e hazdisur. Më kanë torturuar si xhelate...*

*Xha Gorioin e çon te ky krahasim sjellja e të bijave, zhgënjimi që ka marrë prej tyre.*

**15.** Në fragment janë përdorur fjalët të gjitha dhe asgjë. Cila është figura letrare e përfutur? Shpjegojeni atë në kontekst.

*Figura letrare e përfutur është antiteza. Përmes saj kuptojmë gjendjen në të cilën ishte katandisur Gorio, nga i pasur gjithçka në të varfër asgjë.*

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Punë e udhëhequr:**

Fjalja e zgatur me nënrenditje, si dhe shprehja lakonike, sentencat morale, janë karakteristika të gjuhës së Balzakit.

Gjeni nga një shembull për secilin rast dhe shpjegoni arsyen e një përdorimi të tillë.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

*Atdheu do të shkatërrohet në qoftë se prindët merren nëpër këmbë. Kjo është e qartë. Boshti, rreth të cilit sillet shoqëria, gjithë bota, është atësia; të gjitha do të shemben, në qoftë se fëmijët nuk i duan prindërit e tyre.*

**A mendoni se këto fjalë janë vetëm rënkimi dhe protesta e plakut të gjorë, apo edhe thirrja e shqetësuar e Balzakit për gjendjen e përgjithshme shoqërore? Ju tingëllon aktuale e universale kjo thirrje? Jepni mendimin tuaj përmes një eseje argumentuese.**

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Mendimi kritik për veprën “Xha Gorio”, Balzak</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe të sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve;</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha ose rrethanat në vepër.</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• kritik</li> <li>• tipizim</li> <li>• proliks</li> <li>• Tipizimi balzakian</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor</li> <li>• Video-projektor</li> <li>• korniza të skeletëzuara</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Qytetari.	<b>Situata e të nxënit:</b> Shkrimtarë të tjerë realistë të parapëlqyer.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim për njohuritë paraprake, Interpretim i fragmentit, Diskutim, Korniza të skeletëzuara</i>			

**Organizimi i orës së mësimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim për njohuritë paraprake:**

- Balzaku jetoi në kohën e romantikëve të mëdhenj: Hygo, Bajron, Lamartin etj. Ç’faktorë ndikuan në përqafimin e realizmit?
- Nisur nga ky fragment, shpjegoni pse realizmi vjen si kundërvënie ndaj romantizmit.
- Si u krijua lënda magjike e romaneve të Balzakut? Çfarë e bën tërheqës rrëfimin e tij?
- *Tipizimi balzakian* përbën një nga themelet e realizmit. Si e realizon Balzaku tipizimin e personazheve? Përmendni personazhet tipike të njohura për ju.
- A mund të themi që realisti Balzak bën një letërsi të angazhuar? Cili është kuptimi juaj për një letërsi të tillë?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Interpretim i fragmentit:**

Në këtë orë mësimore do të përqendrohemi në reflektimin për veprën.

Mësuesi/ja ka përgatitur në video-projektor një grup vlerësimesh nga autorë të ndryshëm për veprën e Xha Gorio. Disa prej tyre nxënësit i kanë edhe në tekst.

Qëllimi është të vendoset theksi te vlerat aktuale dhe universale që ka kjo vepër.

**Diskutim:**

**Shembulli 1**

*-Cili është komenti juaj për vlerësimin e Stefan Cvajg për veprën e Balzakut?*

Asnjë madhështi nuk i bën më atij përshtypje. Asnjë pështjellë romantike nuk e gënjen më atë, sepse ai ka hedhur sytë në thellësi të makinës shoqërore dhe ka parë aty vargonjtë me të cilët i lidhin debitorët dhe grackat nga të cilat ata dalin për të shpëtuar nga kreditorët. Ai di se si njerëzit e fitojnë paranë dhe si e humbasin, di se si i zhvillojnë gjyqet dhe si bëjnë karrierë, si i prishin pasuritë dhe si i grumbullojnë, si i mashtrojnë të tjerët dhe veten e tyre. Më vonë Balzaku do të thotë me të drejtë se, vetëm ngaqë në të ritë ndërroi shumë zanate dhe fitoi një ide të qartë për lidhjen midis tyre, arriti ta përshkruajë me vërtetësi kohën e vet. Dhe pikërisht kryeveprat e tij më të mëdha: “Iluzionet e humbura”, “Lëkura e shagrenit”, “Lui Lamberi”, “Cezar Birotoi”, këto epose të mëdha të borgjezisë, të bursës e të tregtisë s’do të ishte e mundur të krijoheshin pa zhgënjimet e thella që pësoi ai vetë gjatë kohës së punëve të tij tregtare. Vetëm kur fantazia e shkrimtarit u ndërthur me realitetin, vetëm kur realiteti depërtoi thellë në pëlhurën e trillimit, vetëm atëherë u krijua lënda magjike e romaneve balzakiane, përzierja e mrekullueshme e ngashëryese e realizmit me fantazinë.”

Stefan Cvajg

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

U shpërndahen nxënësve disa **korniza të skeletëzuara** për të reflektuar mbi veprën Xha Gorio

#### 1. Interpretim

Në pamje të parë \_\_\_\_\_ ishte një vepër \_\_\_\_\_ për një \_\_\_\_\_.

Megjithatë besoj se autori e ka përdorur ngjarjen për t’u dhënë lexuesve një mësim më të thellë për \_\_\_\_\_.

Për shembull \_\_\_\_\_ . Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Po kështu kur \_\_\_\_\_.

Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Së fundi \_\_\_\_\_.

#### 2. Argumentim bindës

A dëshironi të jetoni në një botë \_\_\_\_\_ . Kjo do të ndodhë në qoftë se \_\_\_\_\_ të gjithë ne \_\_\_\_\_ . Pse? Sepse \_\_\_\_\_ . Disa thonë që \_\_\_\_\_ . Ata motivohen nga \_\_\_\_\_ .

Përkundrazi këto zgjidhje vetëm shërbejnë për të \_\_\_\_\_ . Në fund të fundit, propozimi ynë është më i efektshëm sepse \_\_\_\_\_ .

#### 3. Zbatimi

Unë e kuptoj shumë mirë qëllimin \_\_\_\_\_ . Në momente të caktuara edhe unë ndihem \_\_\_\_\_ . P.sh. \_\_\_\_\_ . Megjithatë unë nuk \_\_\_\_\_ pasi \_\_\_\_\_ .

**4. Zbatimi** - Reagim ndaj një vepre.

Në romanin \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ më ka bërë veçanërisht përshtypje \_\_\_\_\_ e personazhit \_\_\_\_\_. Përshtypja ishte shumë e fuqishme, sepse \_\_\_\_\_

Për shembull unë \_\_\_\_\_. Megjithatë reagimi im nuk do të ishte i njëjtë me atë të personazhit. Unë \_\_\_\_\_, kurse personazhi \_\_\_\_\_. Mendoj që \_\_\_\_\_. Në të ardhmen do të \_\_\_\_\_.

**5. Sinteza**

Përtëarritur të kuptojmë më mirë çështjene \_\_\_\_\_ duhet të sintetizojmë këndvështrimet e mëposhtme: Këndvështrimi i parë thotë që \_\_\_\_\_ dhe si prova përdor \_\_\_\_\_. Kjo mund të jetë e vlefshme për \_\_\_\_\_. Këndvështrimi i dytë thotë që \_\_\_\_\_.

Kjo \_\_\_\_\_. Këndvështrimi i tretë i përshtatet më shumë \_\_\_\_\_. Për këtë arsye, ndonëse për këtë \_\_\_\_\_ ekzistojnë shu më \_\_\_\_\_, sinteza e këtyre këndvështrimeve tregon bindshëm që \_\_\_\_\_.

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për interpretimin, pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, argumentet, analizat dhe interpretimet.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Lexoni Floberin. Jeta dhe vepra

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Gustav Flober. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan momentet kryesore të jetës së Gustav Floberit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• Veçon veprat kryesore të Floberit;</li> <li>• Diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Floberit në letërsinë realiste.</li> <li>• Diskuton dhe vlerëson natyralizmin si drejtim i realizmit në lidhje me veprën “Zonja Bovari”</li> <li>• Evidenton veçoritë e realizmit në veprat e autorit.</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realist deri në natyralizëm</li> <li>• Jetë e vështirë</li> <li>• Krizë</li> <li>• “eremiti i Kruasesë”</li> <li>• Tundimet e Shën Antuanit</li> <li>• Salambo</li> <li>• Zonja Bovari</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• video-projektor,</li> <li>• tabela apo flipchart</li> <li>• internet</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë e shkurtër për Floberin		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP-Stuhi mendimesh, Diskutim mbi njohuritë paraprak, organizues grafik, diskutim</b>			

## Organizimi i orës së mëimit

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Stuhi mendimesh:**

Mësimi fillon më pas lexohen dhe diskutohen ato që nxënësit kanë lexuar për Floberin.

- Ç'dini për jetën dhe veprën e Floberit?

- Çfarë keni lexuar nga Floberin?

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Punohen në tabelë të dhënat kryesore për jetën dhe veprën e Floberit, pasi lexohen disa nga përmbledhjet e nxënësve. Mësuesi/ja mund të përdorë teknika vizuale.

- Gustav Floberi, një nga prozatorët më të mirë francezë, lindi më 12 dhjetor të vitit 1821, në Ruan dhe vdiq më 8 maj 1880, në Kruase.
- Floberi kaloi një fëmijëri të trishtë, ngaqë pjesën më të madhe e kalonte në ambientet mjediset e punës të së atit, në spitalin e Ruanit ku ai punonte si mjek.
- Në vitin 1841, familja e dërgoi në Paris, në shkollë për drejtësi, pasi prindërit ëndërronin që ai të bëhej avokat; Nuk dëshiron
- 16 vjeç boton tregimin e parë, i cili do të bëhej pikënisje për romanin “Tundimi i shën Antuanit”.
- Romanet autobiografike “Kujtimet e një të marri” (1838) dhe “Nëntori” (1842).
- Në krijimtarinë e tij, një rol të rëndësishëm luajti edhe miqësia me poetin Luigj Buile, i cili e ndihmonte me mendime ose vërejtje mbi veprat. “Zonja Bovari” dhe “Salambo” janë shkruar nën vërejtjet dhe këshillat e tij.
- Rrugëtimet më të frytshme të Floberit ishin ato në Britani pastaj në Egjipt, Greqi dhe Azinë e Vogël




dhe ai pasqyroj gjithçka që përjetoj prej tyre në “Letrat” dhe “Shënimet e udhëtimit”.

- Ai vdiq më 1880, pasi bëri një jetë të qetë e të vetmuar; pa i ndërruar asnjëherë bindjet e tij, pa kërkuar famë e lavdi. Ato do t’i vinin vetiu. Kjo provohet nga fakti që në letërsinë franceze dhe atë europiane, emri i Floberit përbën një kult. Qysh në gjallje, atë e quajtën themelues të romanit modern.

## B. Ndërtimi i njohurive të reja

### Organizues grafik:

U ngarkohet nxënësve të lexojnë tekstin dhe më pas ta përmbledhin atë duke ndërtuar organizues grafik.

Realist. Hapi dyert e natyralizmit, dhe romanit modern	1821-1880	“Zonja Bovari”
“Salambo”		“Edukimi i ndjenjave”
roman historik, i cili i vendos ngjarjet në shek. III p.e.s. në Kartagjenë,		Romani është vepër e dështimit të përgjithshëm të njeriut të asaj kohe, i konceptuar si dështim shumëplanësh: shoqëror, moral e shpirtëror.
vepra u bën jehonë problemeve të Francës ku, pas Revolucionit të viteve 1848 – 1849,		
Romani ka nëntekst social. Ai mbahet si model i romanit impresionist.	“Tundimet e Shën Antuanit”	nismëtar i antiromanit dhe romanit të ri.
	konsolidimit të kristianizmit në shek. IV të erës sonë.	

### Ditari i të nxënësve:

Nxënësi ndërton një ditar tri-pjesësh dhe përmbledh veçoritë e veprës së Gustav Floberit.

Parimi estetik	Përmbledhje/sqarim	Komenti i nxënësve
Estetika	Mbështetet në parime kryesore të tilla, si objektivizmi dhe impersonalizmi.	
Objektivizmi	Parathotë pasqyrimin e jetës në letërsi me atë saktësi e paanshmëri që gjejmë në shkencat e natyrës.	
Impersonalizmi	Ka të bëjë me atë që artisti duhet t’ia dalë të harrojë veten, se vetëm kështu ai mund t’i kuptojë më mirë botën dhe njerëzit.	
Impresionist	Si shkrimtar që priret të lërë mbresa të forta. për të lëmuar e përsosur pandërprerë stilin, figuracionin, gjuhën artistike dhe kompozicionin.	
Analizën e thellë psikologjike	Në romanin e tij, ai shquhet për shikimin e kthjellët mbi sjelljet e individit dhe të shoqërisë	

Risitë	Atë e cilësojnë si shkrimtar të realizmit natyralist, i cili solli risi për romanin modern.	
Estetika është e vërteta.	Përpara se ta shprehte me magjinë e fjalës, ai punonte jashtëzakonisht shumë për të njohur të vërtetën.	
Ngjarjet i tregon në vetën e tretë	Duke qëndruar mbi personazhet dhe duke vëzhguar së jashtmi	
Objektiviteti shkencor	I solli ngjarjet jo thjesht si një realitet, por si pasqyrim i thellë i tij me objektivitet shkencor, sa më afër së vërtetës, përmes njohjes së saj.	

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Diskutim:**

1. Cilat janë momentet kryesore të jetës së Floberit?
2. Metoda krijuese e Floberit mbështetet në parimin e dyfishtë të së vërtetës dhe të së bukurës. Sipas tij, e vërteta dhe e bukura bashkëpunojnë me njëra-tjetrën aq mirë sa vetëm përmes së bukurës del më qartë e vërteta, se përmes së vërtetës, e bukura shpalos “bukurinë”, hirin e saj. Diskutoni mbi këtë metodë krijuese ashtu si ju e kuptoni atë.
3. Çfarë problematikash trajtoi Floberi në veprat kryesore të tij?
4. Cila është rëndësia dhe vlera e krijimtarisë së Floberit për letërsinë franceze dhe atë europiane?
5. Diskutoni për vizionin dhe botëkuptimin e këtij shkrimtari pararojë, nisur nga vepra “Edukimi i ndjenjave”.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për imagjinatën e tij, për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre, për përmbledhjen dhe sqarimin e informacionit.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Mësoni subjektin “Zonja Bovari
- Gjeni shprehje të Floberit . (mund të përdoret për portofolin)

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
<b>Tema mësimore – G. Flober “Zonja Bovari”</b>			
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);</li> <li>• dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të veprës “Zonja Bovari”;</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.</li> <li>• shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;</li> <li>• reflekton mbi veçoritë e realizmit të shfaqura në vepër</li> <li>• demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• romane sentimentale</li> <li>• analizë psikologjike</li> <li>• e brishtë</li> <li>• provincë</li> <li>• dashnorë</li> <li>• Sharli</li> <li>• vetvrasje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Tabakë</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori	<b>Situata e të nxënimit:</b> Diskutohet, Ema Bovari e parakohëshme		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Hartën e ngjarjes, Punë në grupe, Diskutim</i>			

**Organizimi i orës së mësimimit**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Lexohen shprehje nga jeta e Floberit , nxënësit i kanë skeduar.

“Personazhet e mi imagjinare veprojnë mbi mua, më përndjekin, ose më mirë me thënë, unë jam ata.”

“Mos lexoni si fëmijët, për t’u argëtuar, e as si lexojnë ambiciozët, për të fituar dije. Jo, lexoni për të jetuar.”

“Shpirti i njeriut matet me përmasën e dëshirave të vetvetes”.

“heronj të kohës së palavdishme”

“Nuk shkruhen gjërat me zemër, por me kokë.”

Nje nga nxënësit me pak fjalë rrëfen subjektin e veprës “Zonja Bovari”

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

Nxënësit kanë lexuar “Zonja Bovari” dhe materialin teorik në libër

**Hartën e ngjarjes** saktësohet së bashku me mësuesen.

<b>Koha dhe hapësira</b>	Në disa provinca të Francës. 1856
<b>Lloji</b>	Roman realist
<b>Personazhet</b>	Ema Bovari, Sharli, Rudolphi , Leoni, Farmacisti Ome, Lëre

<b>Tema</b>	-Me <b>temën</b> që trajton, Floberi na sjell pranë kohën e vet, duke i bërë asaj autopsinë.
<b>Konflikti kryesor</b>	
<b>Ngjarjet kryesore</b>	-Sharli mjek martohet me Ema Bovarinë , Ema-bashkëshorte, e bukur dhe romantike ndien se pasioni, dashuria, lumturia nuk i buzëqeshën me atë martesë. Sharli për Emën ishte prozaik. -Fillon të mërzhitet nga jeta monotone e provincës (në Tot) dhe kupton që burri i saj nuk ishte burri i ëndrrave. -Ftesa e Vobisarit. -Largimi për në Jonvil, shtatzania. -Rënia ekonomike ja trondiste Emës gjendjen. -Ëndërronte të ishte djalë, pasi djali të paktën është i lirë, të shëtisë nëpër vende të ndryshme e të shijojë lumturinë e paarritshme. Por lindja e vajzës, rrëkëlleu tatëpjetë ëndrrat e saj. -Në këto takime, Ema dhe Leoni krijuan një lloj lidhjeje ortakërie, përmes shkëmbimit të vazhdueshëm të librave dhe romancave. -Ardhja e Rudolf Bulanzhesë në zyrën e Sharlit, ndryshon gjendjen. u hodh në sulm dhe e bëri Emën për vete shumë shpejt. Ema ndërkohë lumturohet që më në fund do përjetojë dashurinë, ethet e lumturisë.
<b>Ngjarjet përfundimtare</b>	Ema gjente arsye të ndryshme për të shkuar në Ruan të takonte Leonin. Gënjeshtrat tani për Emën ishin bërë nevojë, mani, kënaqësi. Borxhet ndaj Lëreit, tregtarit mashtrues, rriten dhe familja vë në rrezik gjithçka që kishte. E dëshpëruar kërkon borxh te Leoni, te noteri e te Rodolfi, por asnjëri nuk iu përgjigj kërkesës së saj. E më pas s'mbetet asgjë veç fundit tragjik të saj. Në kulmin e dëshpërimit e mungesës së rrugëdaljes, Ema vetëvritet. Pak pas saj, Sharli vdes i dërrmuar nga humbja e Emës.
<b>Subjekti</b>	Në të nuk përshkruhet veprimi, por gjendjet. Ky lloj subjekti i ngjizur quhet subjekt psikologjik, sepse gjithçka ndodh, zhvendoset brenda personazhit.
<b>Bovarizmi</b>	<i>Jeta e saj është ëndërro-zhgënjeu, ëndërro e prapë zhgënjeu, se ajo niset romantike e përfundon romantike, pa e pranuar realitetin vrasës. Kjo prirje e saj mori emrin <b>bovarizëm</b>.</i>
<b>Ironia</b>	<i>Kontrasti midis ëndrrave që ushqen Ema dhe realitetit që ia përmbys e shkatërron këto ëndrra, përbën burimin nga rrjedh <b>ironia</b> e hidhur që e përshkon tërë veprën.</i>

**Punë në grupe:**

Pasi punohet me hartën e ngjarjes dhe diskutohen pyetjet dhe çështje të ndryshme të ngritura na mësuesja dhe nxënësit

-Kalohet në analizën e personazheve të veprës.


-Lexohet materiali teorik në tekst.

Ndahet klasa në **grupe**.

Çdo grup do të analizojë një personazh- **Ema Bovari, Sharli, Rudolfi, Leoni, Farmaciti Ome**

Punohen në kllaster në tabelë tiparet dhe veçoritë për secilin personazh.

Ndalohet te figura e **Emës**.



**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Diskutim:**

1. Ku zhvillohen ngjarjet në roman? Evidentoni vendet kryesore ku Ema ka jetuar dhe dhe thoni ç'rol luan ai mjedis në jetën e Emës.
2. Cilës shtresë shoqërore i përkasin personazhet kryesore e dytësore të veprës? (klasës borgjeze) Pse autori i vendos ato përballë Emës? (pasi i përkasin të njëjtës klasë dhe përplasen interesat që kanë.) Ku ndryshojnë dhe ku ngjasojnë? (në kërkesat që kanë për jetën, interesat, dëshirat, shijet por ngjasojnë dhe janë produkt i kohës dhe vendit ku jetojnë)
3. Ç'qëndrim mban Floberi ndaj Emës? (objektiv dhe pse ai thotë "Unë jam Ema")
4. Ç'rol luan ironia në vepër? A shërben ajo për të mbështetur parimet estetike të Floberit? Ilustrojeni përgjigjen tuaj.
5. A ka ndikim realizmi i Balzakut në krijimtarinë e Floberit? Çfarë solli ndryshe Floberi?

<p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.</p>
<p><b>Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexoni fragmentin "Ditët e para pas martesës"</li> <li>• Gjeni ironi të përdorur në fragment</li> </ul>

**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Fragment "Ditët e para pas martesës" Flober</b>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimimit :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj .</li> <li>• dallon temën dhe motivet e një teksti;</li> <li>• analizon personazhin e Emës, Sharlit, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• reflekton mbi veçoritë e realizmit në fragment;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> </ul>			
<p><b>Fjalë kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtëpi prej tullash</li> <li>• Fjalori</li> <li>• Sytë përhumnin</li> <li>• I dërgonte një të puthur</li> <li>• Qortonte veten</li> <li>• Vriste mendjen</li> </ul>	<p><b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Dërrasa e zeze</li> <li>• Shkumësa</li> </ul>		
<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi</p>	<p><b>Situata e të nxënit:</b> Sekuenca filmike</p>		
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, Punë në grupe, <i>Diskutim</i>.</p>			

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake**

Bëhet kontrolli detyrave të shtëpisë.

Nxënësit tashmë janë njohur me fragmentin kanë gjetur ndonjë ironi

Një nxënës rrëfen subjektin e fragmentit.

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Punë me grupe:**

Nxënësit janë udhëzuar të vazhdonin leximin e pjesës deri në fund në shtëpi.

Ndahet klasa në grupe dhe punohet me fragmentin duke shfrytëzuar aparatën pedagogjik.

**Grupi 1: Kuptimi i tekstit. Shfrytëzohen këto pyetje:**

1. Si na përgatit autori për jetën që e pret Emën në këtë shtëpi “të re”? A ndikon mjedisi për këtë? Gjenerali nga elementet më domethënëse që e përbëjnë mjedisin “e ri”.

*Ndaluni në përgjigje të ambjentit që ka nevojë për mjaft përmirësime dhe rregullime, pasi është tepër i varfër në orendi. “Mbrapa derës ishin varur një pallto me jakë të vogël, një kapistall, një kasketë prej lëkure të zezë dhe, përtokë, gjendeshin një palë kallçina ende të papastruara nga balta e thatë... një dhomë e vogël kjo, rreth gjashtë hapa e gjerë, me një tryezë, tri karrige, si dhe një kolltuk zyre.” përdorimi i numërorit një.*

2. A mund të ishte Ema e lumtur në një mjedis të tillë?

*Ky vend nuk është i bukur si ajo priste të ishte. Pamja na parapërgatit se Ema nuk do të jetë e lumtur këtu.*

3. A ju duken normale kërkesat e Emës që ka për të ndryshuar gjërat në shtëpi? Ç’domethënie fsheh kërkesa e Emës për ta ndryshuar mjedisin e shtëpisë?

*Po është normale, pasi ajo kërkon të krijojë një jetë të re të vetën, ndryshe nga ajo që Sharli ka krijuar me gruan e parë*

**Grupi II Analizë e tekstit**

1. Përshkrimin romantik të ndjenjës së Sharlit, autori përpiket ta japë sa më afër së vërtetës. Me ç’ngjyrim stilistik e shpalos objektivitetin e vet Floberi në fjalinë: “...ikte duke bluar me vete lumturinë e tij, si ata që s’pushojnë së përtypuri edhe pas darke, shijen e kërpudhave që me kohë u kanë përfunduar në stomak.”? A ju duket e qëlluar analogjia në këtë fjali?

2. Sjelljet dhe veprimet që Ema dhe Sharli shfaqin në mëngjes me të puthurat dhe përshëndetjet janë të singerta, të natyrshme, të pasforcuara, apo të shtirura? Ç’imazh krijojnë ato te ju?

*Të shtiruar; autori thotë “ai ishte i lumtur dhe s’donte t’ia dinte për gjë në botë” dhe nuk flet për lumturi të të dyve.*

3. Në fjalinë: *Të gjashtë raftet e bibliotekës prej pishë ishin mbushur pothuajse vetëm me volumet e “Fjalorit të shkencave mjekësore” me fletë të paprera, po që u ishte dëmtuar shumë lidhja, ngaqë ishin shitur dorë pas dore...”,* çfarë informacioni merrni mbi njohuritë apo dëshirën për të studiuar të Sharlit?

Librat janë të hapapur, por të vjetëruar. A ju ka ndodhur të blini libra që t’i rrijnë bukur formalisht bibliotekës suaj?

*Sharli nuk është modeli i mjekut që studion, prandaj dhe volumet që ka, janë të vjetër për tjetër arsye, jo se ai ka studiuar me ta.*

**Grupi III Interpretimi gjuhësor dhe stilistik**

4. Gjenerali në tekst kontrastin e përdorur midis dy grave të Sharlit. Analizoni natyrën e tij. A na bën ky kontrast të kuptojmë nga niset Sharli për t’i gjykuar dy gratë? A ka ndryshuar këndvështrimi i tij nga njëra grua te tjetra? Nëse po ose jo, cila është arsyeja?

*Ambjenti ku jetojnë. P.sh. skulptura në kopësh dhe ndryshimi me Hauzin me peshq. Ndryshe e kishte këtë ambient grua e parë dhe ndryshe e kërkon Ema. Të dy zgjedhejt etij janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, për të kuptuar se ai nuk e sheh me seriozitetin e duhur martesën. Në të dyja martesat, ai ka parë interesin e tij. Sharli është i lumtur tani ndryshenga maartesa e parë, por ai nukdi të shohë përtej vetes, është shumë tuaf.*

5. Ç’mendoni në lidhje me pohimin që Ema, natën e parë të martesës, mendon vdekjen? A është normale diçka e tillë për ju?

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

*Jo, nuk është normale. Kjo parashikon se jeta e çiftit nuk do të jetë e lumtur për shumë kohë.*

6. A na përgatit autori që në fillim për ndryshimet që kanë midis tyre Ema dhe Sharli? A përbën ky ndryshim një parakusht për fatin e këtij çifti apo të kësaj familjeje? Ilustroni ndryshimet.

*Po, sepse autori e tregon të lumtur vetëm Sharlin ndërsa për Emën nuk thotë gjë. Ilustrimet lidhen me ambientin para ardhjes së Emës dhe ndryshimet që pësuajnë me ndryshimet e saj.*

7. Ema është natyrë romantike. A e shpjegon sjellja e saj diçka të tillë? Ilustroni mendimin tuaj me shembuj nga fragmenti.

*Po, sidomos tek objektet që zgjedh të vendosë në oborr, apo takimet e mëngjesit me hedje luljesh e puthje që shkëmbejnë në ajër.*

8. Ndaluni në paragrafin e fundit. Cila është përgjigjja juaj për arsyen e shqetësimit që nisi të provojë Ema që ditën e parë të martesës?

*Zgënjimin që pësoi, ajo e ka ëndërruar aq shumë këtë moment, sa që ai nuk mund të jetë aq i bukur.*

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

1. Tipar dallues i Sharlit është mediokriteti. Ç'rrjedhoja sjell ky mediokritet te Sharli mjek? Ku duket kjo në fragment? A mund t'ia besosh shëndetin tënd një mjeku si Sharli?

2. Si ju duken ankesat e Sharlit mbi jetën e mëparshme? A ndodh ta përdorni ankesën për të justifikuar mungesën e guximit, të shpirtit kërkues për të kapur maja më të larta në jetën tuaj?

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Shkruani një ese argumentuese me temë: Ema, një histori e largët apo një histori që vazhdon?
- Lexini fragmentin Njohja me Leonin

## PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Fragment “Njohja me Leonin” Flober			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj .</li> <li>• analizon personazhin e Emës, Leoni, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit të fragmentit</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ditën e parë</li> <li>• adhuronte fëmijët</li> <li>• thartonte turinjë</li> <li>• u zhvesh</li> <li>• sytë e përplotur</li> <li>• lumturia</li> <li>• pengesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Skeda</li> <li>• Kartonë</li> <li>• Fetë formati.</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi

Situata e të nxënësve: Si gjykoni me veprimet e Emës

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, Praktikë e udhëhequr, Punë në grupe, Diskutim.

## Organizimi i orës së mësimi

### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

#### Diskutim mbi njohuritë paraprake

Bëhet kontrolli detyrave të shtëpisë. Kanë punuar esenë

Një nxënës rrëfen subjektin e fragmentit.

### B. Ndërtimi i njohurive të reja

#### Praktikë e udhëhequr:

#### Punohet me aparatën pedagogjike në tekst. Pyetje për kuptimin e tekstit

*Leoni, sekretar i zotit Gijomen, jetonte në një dhomë në katin e dytë të banesës së farmacistit, z. Ome. Në atë qytezë ku s'ndodhte asgjë, ardhjen e Emës djaloshti e pa si një ndryshim tepër të bukur. Ai ra në dashuri me të dhe gjithçka që ajo ëndërronte...*

1. Ku duket në fragment që ideja e të qënurit e dashuruar, thjesht e lumturon Emën? A ka ajo dashuri për të tjerët? Si është ndjenja që ajo ka për vajzën?

*Kështu ndodhi edhe ditët e tjera; ajo ndryshoi të folurën, sjelljet, gjithçka. Filloi t'i merrte me qejf punët e shtëpisë, të shkonte rregullisht në kishë dhe të tregohej më e rreptë ndaj shërbëtores.*

Ajo e adhuronte, e bija ishte ngushëllimi, gëzimi, pasioni i saj dhe, duke e përkëdhelur kalonte në shfrime lirike,

2. Si e kuptoni rezistencën e Emës ndaj ndjenjave që ka për Leonin?

*Ajo e dashuronte Leonin Me sa dukej, atë e mbante mefshtësia ose frika e tmerrshme, po gjithashtu edhe turpi. Ajo mendonte se e kishte larguar sa s'bëhet se s'ishite koha për gjëra të tilla, se gjithçka kishte marrë fund. Pastaj krenaria, kënaqësia që ndiente kur thoshte me vete: "Jam grua e virtytshme unë",*

3. Ema qan dhe vuan si një i sëmurë. Si mund ta diagnostikojmë sëmundjen e saj? Nga çfarë "sëmundjeje" vuan ajo?

Ajo vuante pafundsisht ngaqë nuk ishte e lumtur, si çdo grua ëndërronte të kishte një jetë tjetër...

4. A mendoni se Ema nuk i tregon Sharlit gjendjen e saj se nuk do që ta pikëllojë, apo ngaqë e di që ai nuk do e kuptojë dot? Jepni mendimin tuaj.

*Jo ai nuk do ta kuptojë dot se kishte kuptuar asnjëherë*

#### Praktikë e udhëhequr:

#### Punë në grupe

#### Grupi I

5. Si i kuptoni fjalët "...Ema sa më tepër e ndiente dashurinë, aq më shumë e ndrydhte, me qëllim që të mos i shfaqej dhe t'i zvogëlohej."? Vazhdoni dhe lexoni më poshtë sajimet e saj për ta "zvogëluar" dashurinë. Shpjegoni atë që kuptoni.

Po ajo shprehet vazhdimisht ashtu, ka frikë, ndrojtje, turp ia donte zemra që Leoni ta merrte me mend; dhe përfytyronte ca rastësira, hatara që do t'ia bënë më të lehtë këtë gjë. Me sa dukej, atë e mbante mefshtësia ose frika e tmerrshme, po gjithashtu edhe turpi.

6. Analizoni Emën që shohim jashtë të gjithë ne dhe Emën që fshihet pas pamjes së jashtme. A ka mundësi që njeriu të jetë kaq ndryshe? Pse Ema e bën natyrë të dytë të saj gënjeshtrën? Nga përcaktohet kjo?

Ema është shumë e bukur jashtë, joshëse, duket e lumtur, tërheqëse, te gjithë e kanë zili por nga ana tjetër ajo fsheh gruan e shkatërruar, tronditur, të palumtur Ema reflekton krejt ndryshe me anën e saj të brendshme ajo tashmë është e shkatërruar Ema pret një ndryshim në jetën e saj. Se si do të jetë



ky ndryshim, ajo se ka të qartë. Por ajo pret diçka ndryshe, diçka që të mos i ngjasojë jetës monotone dhe pa emocione që bën.

7. Si ju duket gjykimi i Emës, kur shpreh zili ndaj gruas së farmacistit, vetëm pse ajo jeton në të njëjtën çati me Leonin? A shpreh ajo gjykimin e një njeriu të pjekur, apo ju duket si një adoleshente që dashurohet për herë të parë?

Ajo shfaqet si një adoleshente që dashuronte për herë të parë, nuk jepet aspak e pjekur

8. Analizoni fjalët e autorit duke kuptuar se çfarë e mundon atë: *“Merrte inat për hiçgjë, për një gjellë që nuk ia shërbenin mirë në tryezë apo për një derë të pambyllur mirë, qajej që s’kishte rroba kadifeje, që nuk gjente lumturi, që ushqente ëndrra tepër të mëdha në një shtëpi aq të vogël.”*

*Përmes antitezës ushqente ëndrra tepër të mëdha në një shtëpi aq të vogël kuptojmë se asaj i është bërë jeta monotone, pa kuptim dhe shije, është e trazuar mendërisht, se ka mendjen tek shtëpia sepse nuk ka gjetur gjer më sot dashuri dhe lumturi...*

Ema braktis gjithçka, humbet interesin dhe zhytet në vetmi dhe kotësi.

9. A është normale që zonja e shtëpisë t’i qajë hallet me shërbëtoren e jo me bashkëshortin e saj? Ç’regon kjo për natyrën e lidhjes që Ema ka ndërtuar me Sharlin dhe për ndjenjat që ajo ushqen për të?

Jo aspak por ajo s’kishte kuj t’ia thoshte . ishte vetë ai që e kishte çuar në këtë gjendje

### **Grupi II**

10. Gjeni krahasimin me pëllumbat dhe shpjegoni vlerat kuptimore dhe emocionale që ai bart. si pëllumbat e *Luanit të artë* që vinin aty të lagnin nëpër ullukë këmbët e tyre ngjyrë trëndafili dhe krahët e bardhë. Bart ngarkesa emocionale që simbolizojnë vetë Emën që si një pëllumb kërkon të fluturojë drejt dashurisë

11. Ndjenja që Ema ka për Leonin është:

- a) ndjenjë çasti,
- b) e provokuar nga boshllëku i brendshëm,
- c) apo ndjenjë që nxitet nga dëshira për aventurë të re?

Argumentoni përgjigjen.

12. Ema ka nevojë t’ia kujtojë vetes shpesh që është e martuar dhe është e virtytshme. Pse e bën ajo këtë? Kujt kërkon t’ia mbushë mendjen për këtë, nëse askush nuk e dëgjon atë që thotë?

*Kërkon t’ia mbushë mendjen vetes, pasi ajo thellë brenda saj, nukndjehet e martuar me Sharlin, pasi nuk e dashuron burrin e saj.*

13. Pse autori thotë *“kur shihej në pasqyrë duke marrë poza si e nënshtruar ndaj fatit të saj, ngushëllohej për sakrificën që kujtonte se po bënte”*? Gjykoni grupin e fjalëve **si e nënshtruar ndaj fatit** dhe **sakrificën që kujtonte**, për të kuptuar më mirë Emën.

14. A e kupton dot Leoni atë që ndien Ema për të? Si i gjykon ai sjelljet dhe përkujdesjet e saj ndaj Sharlit? Po ju si i gjykoni ato?

E paarritshme. Ato dukeshin të lumtur , ishte një familje...

15. Cilat janë ato të vërteta të Emës që shprehen në pyetjet retorike: *“Kujt, pra, t’i qëndronte besnike? A nuk bëhej vetë ai pengesë për çdo lumturi; shkak për çdo mërzi dhe si ajo maja e tokëzës e futur në një rrip të ndërlikuar që e shtrëngonte nga të gjitha anët?”*

*Mashkulli Sharli ishte i padenjë, ajo kërkon të kujtojë gjithë të vërtetat që të realizojë më shpejt dashurinë me Leonin*

### **C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

#### **Rrjeti i diskutimit:**

Mësimi fillon me një diskutim rreth asaj që nxënësit mendojnë

PO

JO

A është martesë një mbarim,  
apo mbyllje e jetës në një nënshtrim?

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Fjalë e fundit e thënë nga Ema, tregon se vuajtja e saj është nga mungesa e dashurisë, nga të qenit e dashuruar. A është dashuria çelësi që hap portën e mirëqenies në jetë?
- Lexoni fragmentin për koment

**PLANIFIKIMI DITOR**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – <b>Koment “Rikthim” Flober</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj .</li> <li>• Evidenton përballjen mes dy kohëve</li> <li>• Reflekton mbi ndryshimet që ka pësuar Ema</li> <li>• analizon personazhin e Emës, duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ditën e parë</li> <li>• adhuronte fëmijët</li> <li>• thartonte turinjtë</li> <li>• u zhvesh</li> <li>• sytë e përlotur</li> <li>• lumturia</li> <li>• pengesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Dërrasa e zezë</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Arte, Filozofi	<b>Situata e të nxënit:</b> Si gjykoni me veprimet e Emës		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Diskutim mbi njohuritë paraprake, Teknikat e pyetjes, Hapësira e fjalës, Nxjerrja e përfundimeve.			

**Organizimi i orës së mëimit****A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Mësimi nis me detyrën e dhënë , merren mendimet nga nxënësit  
Nxënësit janë njohur me fragmentin për koment

**Teknikat e pyetjes:**

1. Një fillim të romanit, autori tregon jetën që Ema ka bërë në kolegji, ndërsa në këtë fragment jemi në fund të rrugës së jetës së saj. Ç'synon të realizojë Floberi me përballjen e dy kohëve? Si ndjehet Ema në këtë përballje?

*Ajo ka arritur zhgënjim dhe ka humbur orientimin, nuk gjen më pikë takimi mes asaj që ëndërroi të ishte dhe asaj që u bë.*

2. A është Ema ajo që ka qenë? Gjithçka apo diçka ka ndryshuar tek ajo? Ilustrojeni mendimin tuaj. *Dhe asaj i dukej se kishte qenë aty, mbi atë stol, tërë jetën e jetëve.*

*Ema jetonte e dhënë plotësisht pas atyre të sajave, ndërsa për paranë sa mund ta vriste mendjen një arkidukeshë aq e vriste dhe ajo.*

3. Është mirë apo keq të ëndërrojmë? Mos duhet t'i shtrijmë këmbët aq sa kemi jorganin? *Është mirë të ëndërrojmë por jo pafundësisht.*

4. "Megjithatë e dua", thotë Ema, sikur do të marrë veten në mbrojtje ndaj asaj që ka bërë deri tani. Ç'lloj fjalie është kjo? Hiqeni lidhëzën *megjithatë* dhe shikoni se ç'kuptim bart ajo në fjali?

*Lejore po të heqim lidhëzën merr kuptimin e sigurtë e dua.*

**Hapësira e fjalës:**

- Midis dy ideve lidhur me ëndrrat e Emës për jetën, cila do të ishte përligjja më e drejtë:

"Ëndrra që s'e ka marrë shpjegimin e saj, i ngjan një zarfi të pahapur". Talmudi.

"Ëndrra është rruga mbretërore për të kuptuar të pavetëdijshmen". Z. Frojd.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Nxjerrja e përfundimeve:**

Mësuesi/ja ngre çështjet për diskutim, duke u përqendruar te:

-Ema, natyrë iluzioniste apo lodër në duart e pasionit iluziv?

-Pasioni është robëri dhe vuajtje. Kur? Pse?

- Nëse do të vendosnim personazhin e Emës përkundruall thënies së Spinozës:

"Njeriu i çliruar nga iluzioni bëhet shembulli i natyrës njerëzore", cilat do të ishin disa nga idetë që do të na ngacmonin?

- Ç'karakter kanë ëndërrimet e Emës: janë ëndrra prozaike apo poetike?

- Po t'i referohemi arsyetimit të Erik Fromit: "Ëndrra është poetike, ajo fl et me gjuhën universale të simboleve", a duhet gjykuar Ema për ëndrrën e saj për jetën?

- I përshtatet Emës shprehja: "Ajo sheh ëndrra me sy hapur"? Pse?

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, për përfshirjen në diskutim, për pyetjet dhe përgjigjet që jep.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Bëni një ese interpretuese-vlerësuese. Ema nuk është vetëm viktimë, por edhe fajtoare. Ku qëndron faji i saj? A mund ta shfajësoni atë?
- Lexoni jetën e Dostojevskit

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Dostojevski. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Dostojevskit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• veçon veprat kryesore të Dostojevskit;</li> <li>• gjykon për mënyrën se si realizmi gjen shprehje në krijimtarinë e Dostojevskit</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Moskë</li> <li>• Përkthyes</li> <li>• Realist</li> <li>• Vuajtje</li> <li>• Rrëfim tri planësh</li> <li>• Karakteri polifonik i veprës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Interneti</li> <li>• Biblioteka</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Njohja e kulturave, Histori	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi të veçantat e jetës së autorit		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP - Diskutim mbi njohuritë paraprake, Kllaster, Ditari i të nxënit, Vendosje.			


## Organizimi i orës së mësimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Punohen në tabelë të dhënat kryesore për jetën dhe veprën e Dostojevskit, pasi lexohen disa nga përmbledhjet e nxënësve. Mësuesi/ja mund të përdorë teknika vizuale, si: pemë mendjeje, kllaster ose thjesht tabela

- Fjodori lindi në Moskë më 30 tetor 1821
- Mjedisi ku nisi të formohej e afroi me njerëzit e varfër e të poshtëruar, e njohu me fate dhe përvoja njerëzore.
- Ai nisi të shkruajë e të përkthejë nga frëngjishtja. Qe i dashuruar pas Balzakut, përktheu “Evgjeni Grande” e më pas romane të Zhorzh Sandit.
- Shkruan romanin epistolar “Njerëz të varfër”(1845), një etyd mjeshtëror, i hedhur në letër “me pasion dhe me lot në sy”.
- “Net të bardha” (1849) vlerësohet si kulm poetik.
- Filloi të frekuentonte rrethin e Petrashevskit, ku, të premtëve, predikoheshin ide liberale e socialiste. Pjesëmarrësit i arrestuan në prill 1849.
- Me pranga në duar, e nisën në Siberi. Atë që përjetoi atje e ka quajtur: “Vuajtje që nuk shprehet dot, vuajtje që nuk kishin fund...”

**Kllaster:**



**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Ditari i të nxënës:**


Nxënësi ndërton një ditar tri-pjesësh dhe përmbledh veçoritë dhe artin e Dostojevskit.

Arti i Dostojevskit	Përmbledhje/sqarim	Komenti i nxënësit
Paraprijës dhe themelues i : - <b>ekzistencializmit</b> të shekullit XX, - <b>simbolizmit</b> rus dhe po ashtu -paraprijës i <b>ekspresionizmit</b> dhe - <b>psikanalizës</b> së Frojdit. -pararendës i romanit të ideve. Me të lind <u>romani tragjedi</u> që debaton për dashurinë, vdekjen, individin, lirinë, vuajtjen, revoltën.	Me të lind <u>romani tragjedi</u> që debaton për dashurinë, vdekjen, individin, lirinë, vuajtjen, revoltën.	
<b>Artisti mendimtar:</b>	Secili personazh në romanet e Dostojevskit ka mendimin e vet të argumentuar, për të njëjtën çështje. Përmes personazheve Dostojevski përfaqëson vetveten.	
<b>Realizmi i pamëshirshëm (gati magjik):</b>	Njeriu i Dostojevskit është në kërkim të së vërtetës, të realitetit të drejtpërdrejtë të qenies së tij të kufizuar.	
<b>Karakter i polifonik i veprës:</b>	ka të bëjë me kompozicionin origjinal të veprave të tij, me ndërtimin e tyre në shumë plane, që harmonizohen në një	
<b>Rrëfimi triplanësh:</b>	-Dostojevski nuk kërkon të bindë, por të rrëfejë. Në veprat e Dostojevskit gjithnjë ndërthuren 3 plane: plani social, plani psiko-analitik, plani ontologjik.	
<b>Heroi si ngërthim kundërshtish:</b>	Sipas Dostojevskit, njeriu është një ngërthim kundërshtish.	
<b>Shkurtësia stenografikë përshkrimin e heronjve</b>	Dostojevski skicon në mënyrë magjike. Kur na njeh me personazhet, vetëm me tre rreshta, ai mund të vizatojë tiparet...	
<b>Parimi ekzistencial “Vuaj pa jam”:</b>	Personazhet e Dostojevskit vuajnë, e duan shumë vuajtjen, nuk ngopen me të, zgjedhin rrugë që i bëjnë të vuajnë edhe më shumë	

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

1. Përdorni **fjalët kyçe** në kuadratin e mëposhtëm për të ritreguar momentet kryesore të jetës së Dostojevskit.

Moskë, autoritar, “spital për të varfërit”, nëna, karrierë ushtarake, përkthyes, varfëri, ushtri, komplot, izolim, falje nga Cari, Siberi, Europë, udhëtim, lavdi, internim, epilepsi, vdekje.



2. **Vendosni titujt** e veprave të Dostojevskit në një prej pjesëve të shtëpisë. Argumentoni përzgjedhjen tuaj.

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për Interpretimin e realizuar.

**Detyre shtëpie dhe punë e pavarur:**

Përcaktoni veçoritë më thelbësore të dy kryeveprave të Dostojevskit: “Krim dhe ndëshkim” dhe “Idioti” dhe shkruajini ato në tabelën e mëposhtme.

**PLANIFIKIMI DITOR**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore–Dostojevski “Vëllezërit Karamazovë”			
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);</li> <li>• evidenton strukturën dhe kompozicionin</li> <li>• dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të veprës “Vëllezërit Karamazovë”</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.</li> <li>• shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;</li> <li>• reflekton mbi veçoritë e realizmit të shfaqura në vepër dhe vlerat artistike të veprës;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• 4 pjesë</li> <li>• Epilogu</li> <li>• dashuria e dyfishtë</li> <li>• Aliosha</li> <li>• Tortura e Zotit</li> <li>• Triumfi i jetës</li> <li>• Të gjithë janë profetë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Interneti</li> <li>• Biblioteka</li> </ul>	

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Histori	Situata e të nxënit: Diskutim rreth veprës
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Hartën e ngjarjes, Punë në grupe, Diskutim</i>	

### Organizimi i orës së mësimi

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### *Diskutim mbi njohuritë paraprake:*

Diskutohen detyrat e shtëpisë

Veçori e romanit “Krim e Ndërshkim”	Veçori e romanit “Idioti”

#### B. Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit kanë lexuar “Vëllezërit Karamazovë” dhe materialin teorik në libër

**Hartën e ngjarjes** saktësohet së bashku me mësuesin/en.

<b>Koha dhe hapësira</b>	Kjo vepër u botuar më 1881 në dy vëllime
<b>Lloji</b>	Roman realist, modern
<b>Struktura e veprës dhe rrëfimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Organizuar në dy vëllime. Vepra përbëhet nga 4 pjesë dhe epilogu.</li> <li>-Vëllimi I përmban dy pjesët e para, ku secila pjesë ndahet në 3 libra ose krerë.</li> <li>-Vëllimi II përmban pjesën e tretë dhe të katërt, secila pjesë e ndarë po nga 3 libra ose krerë, pra e gjithë vepra është organizuar në 12 krerë.</li> <li>-Përmban një sërë elementesh moderne si dhe teknika rrëfimi të shumëllojshme.</li> <li>-Rrëfyesi është një shkrimtar i vetëshpallur, i cili duke i përcjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë perceptimet e ndjenjat e tij për personazhet e veprës, bëhet edhe vetë një karakter i veprës.</li> <li>-Mungesa e një zëri autoritar që rrëfen.</li> <li>-Rrëfimit i bashkëngjitet teknika e individualizimit të gjuhës së personazhit.</li> <li>-Karakteristika të rrëfimitarisë së Dostojevskit janë:             <ul style="list-style-type: none"> <li>-përdorimi i burimeve të ndryshme të informacionit;</li> <li>-trajtimi i subjekteve artistike (temave, personazheve) parë nga shumë këndvështrime.</li> </ul> </li> </ul>

<b>Subjekti dhe kompozicioni</b>	<p>Libri I “Historia e një familjeje të vogël”          Libri II “Një takim krejt i pavend”          Libri III “Epshorët”-          Libri IV “Gulçima dhe ankth”-          Libri V “Pro dhe kundra”-          Libri VI “Murgu rus”-          Libri VII “Aliosha”-          Libri VIII “Mitia”          Libri IX “Hetimi paraparak”-          Libri X “Djemtë”          Libri XI “Vëlla Ivan Fiodoroviçi”          Libri XII “Gabimi gjyqësor”  <b>Pika e kthesës</b> është dëshmia e mallkuar e Katerinës kundër Dmitrit, e cila shërben si provë kryesore.          Epilogu</p>
<b>Personazhet</b>	Fjodor Pavloviç Karamazov, Dmitri Fjodoroviç Karamazov, Ivan Fjodoroviç Karamazov, Aleksei Fjodoroviç Karamazov, Agrafena Aleksandrovna Svetlova (Grushenjka), Katerina Ivanovna, Murgu Zosima
<b>Dukuria e dashurisë së dyfishtë</b>	-Dukuria e dashurisë së dyfishtë te Dostojevski është krejt e natyrshme. Nga dashuria e dyfishtë që ndjejnë personazhet krijohen shumë trekëndësha dashurie/xhelozie: Dmitri- Grushenka-Fjodor; Dmitri-Katerina-Ivan; Katerina-Dmitri-Grushenka; Dmitri- Grushenka- oficeri Pol
<b>Tortura e Zotit dhe triumfi i jetës</b>	Dostojevski predikon dashurinë ndaj Perëndisë.
<b>Vlerat artistike të veprës</b>	<p>Bota fantastike e Karamazovëve shpaloset vetëm në pak ditë.</p> <p>Një jetë e tërë mbyllet në një hapësirë të ngushtë kohore.</p> <p>Njeriu kolos aty është i zhveshur, pa mbrojtje dhe i vogël, nën qiellin tragjik të fatit. Përjetësisht takohen të kundërtat:</p> <p>Një veçori e personazheve të Dostojevskit është fakti se ata i “nuhasin” gjërat para se ato të ndodhin, e kuptojnë njëri-tjetrin plotësisht gjer në fund të thellësisë;</p> <p>Të gjithë janë “profetë”, njerëz me veti parashikuese, njohës, kuptues të gjithçkaje, ashtu siç ishte dhe vetë Dostojevski.</p>

**Punë në grupe:****Kllaster**

Ndahet klasa në **grupe**.

Çdo grup do të analizojë një nga personazhet më kryesorë.

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura****Diskutim:**

1. Përmbliidhni me gojë përmbajtjen e veprës “Vëllezërit Karamazovë”
2. Çfarë e frymëzoi Dostojevskin për shkrimin e kësaj vepre?
3. Si është strukturuar vepra? Në sa vëllime, pjesë e libra (krerë) është ndarë ajo?
4. Listoni personazhet e veprës dhe shpjegoni marrëdhëniet midis tyre. Secilin prej personazheve portretizojeni me një fjalë.



## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

5. Cili është rrëfyesi i ngjarjeve në këtë vepër? Ç'veçori ka rrëfimi?
6. Ç'vend ka tema e dashurisë në vepër? Si konceptohet ajo nga Dostojevski?
7. Cilat janë trekendëshat dashurorë në këtë vepër. Përcaktojini ata dhe shpjegoni shkurt dinamikat që i karakterizojnë këto marrëdhënie.

### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për njohuritë që demonstroi për veprën, saktësinë e përgjigjeve, saktësinë në krahasimin mes personazheve, ilustrimet e goditura nga fragmenti dhe nga vepra, imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.

### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

- Lexoni fragmentin: "Përse rron një njeri si ky?" Bëni përmbledhjen e fragmentit.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore – Koment "Përse rron një njeri si ky?" Dostojevski</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimin :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj;</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst</li> <li>• dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të një teksti;</li> <li>• analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;</li> <li>• reflekton në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>• tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjithçka lejohet</li> <li>• nuk ka virtyt</li> <li>• i pafe</li> <li>• i çuditshëm</li> <li>• atëvrasës</li> <li>• nuhasin gjërat</li> <li>• modern</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Biblioteka</li> <li>• Interneti</li> <li>• Skeda,</li> <li>• Kartonë</li> <li>• bioskeda personazhesh.</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe	<b>Situata e të nxënit:</b> Lexohet përmbledhja e pjesës së parë të fragmentit.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Stuhi mendimesh, Praktikë e udhëhequr, Punë në grupe, Diskutim.</i>			

## Organizimi i orës së mësimin

### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

#### **Stuhi mendimesh:**

1. Në cilat çaste të jetës vendoset individi në këtë vepër të Dostojevskit, apo dhe në vepra të tjera. Përse ai është individ tragjik?
2. Përcaktoni ç'është *Zoti* dhe *jeta* sipas Dostojevskit. Proveni të jepni dhe ju mendimin tuaj për to.
3. Përse kërkimi i së vërtetës i shpie personazhet e Dostojevskit deri në cakun e absurdit? Ç'është lumturia sipas tij?
4. Kjo vepër i sugjerohet të lexohet çdo intelektual të ri. Arsyetoni rreth rëndësisë së veprës duke përdorur argumente të ndryshme.

5. Listoni disa nga vlerat artistike të veprës dhe ndani me shokët vlerësimin tuaj për këtë veprë. Çfarë do të donit të mësonit diçka të re nëpërmjet leximit të kësaj vepre?

**Praktikë e udhëhequr:**

Punohet me aparatën pedagogjike në tekst. Pyetje për kuptimin.

1. Ndajeni fragmentin në pjesë dhe secilës pjesë vëri nga një titull. Dalloni paragrafët përshkrues nga ata rrëfyes.

2. Cila është arsyeja që të gjithë janë takuar në dhomën e at Zosimas? Për çfarë diskutojnë ata? Cili është motivi i sherrit midis Dmitrit dhe të atit të tij? Pse takimi gjeneron në një sherr të madh?

3. Identifikoni në tekst të gjitha detajet përshkruese që portretizojnë Dmitrin? Çfarë përshtypjeje ju lë përshkrimi i hollësishëm i autorit në fillim të fragmentit? Po shpërthimi i zemërimit të tij ndaj të atit çfarë detajesh të tjera i shtojnë portretin e tij?

4. a) Identifikoni në tekst dhe listoni në tabelën e mëposhtme detajet që përshkruajnë secilin nga personazhet në këtë fragment.

Murgu Zosima	Ivan Fjodoroviçi	Fjodor Pavloviç	Miusovi	At' Josifi	Grushenka	Katerina Ivanovna	Aliosha

α) Si identifikohen, ose portretizohen ata? Vendosni emrat përbri në mënyrë të portretizimit të tyre në tekst:

- nëpërmjet rrëfimit të autorit për ta - \_\_\_\_\_
- nëpërmjet rrëfimit të një personazhi - \_\_\_\_\_
- gjatë kohës kur ata janë duke folur - \_\_\_\_\_
- gjatë kohës kur janë të tjerët duke folur për ta - \_\_\_\_\_

5. Ritregoni me fjalët tuaja teorinë e Ivanit "Gjithçka lejohet". Çfarë kuptoni ju me shprehjen: "Nuk ka virtyt, po nuk pati pavdekësi!"?

6. Murgu i vjetër e bekon në mënyrë të veçantë Ivanin dhe i përulet deri në tokë Dmitrit. A mendoni se ka diçka të fshehtë e misterioze te këto dy personazhe që nuk është shfaqur ende plotësisht? Identifikoni cilësimet që iu vendosen nga të tjerët këtyrë dy personazheve:

Ivani: i pafe, i çuditshëm, \_\_\_\_\_

Dmitri: atëvrasës, shënjtëri, \_\_\_\_\_

**Punë e pavarur në grupe:**

**Grupi I:**

1. Si paraqiten në këtë fragment marrëdhëniet e Fjodor Pavloviç Karamazovit me djemtë e tij? Ç'natyrë kanë këto marrëdhënie?

2. Mitja ka të drejtë që thotë se ky takim ishte një kurth i ngritur nga i ati mashtrues e komedian për të shkaktuar një skandal. Rilexoni dhe njëherë pjesën e mëposhtme dhe analizoni detajet që vërtetojnë fjalët e

Mitjas.

– "O at' i shenjtë! O mishërimi i frymës së Zotit! – thirri Fjodor Pavloviç duke treguar me kokë në drejtim të Ivan Fjodoroviçit. – Ky është im bir, është gjaku i gjakut tim, është pjella ime më e dashur! Është si të thuash, Karl Mori im më i respektuar, ndërsa ky që sapo hyri është djali tjetër, Dmitri Fjodoroviç, për të kam ardhur

te ju që të lyp këshillën tuaj. Ky është Karl Mori më i parespektuari, që të dy janë nga “Cubat” e Shilerit, kurse unë, në këtë rast, mbetem të jem Regiren der Graf von Mor! Gjykonani dhe shpëtonani!

Kemi nevojë jo vetëm për lutjet tuaja, por edhe për profecitë tuaja.”

**Model përgjigjeje:** *Fjodor Karamazovi me anë të një paralelizmi me konfliktin që ndërton veprën Cubat” e Shilerit, paraqet marrëdhëniet që ai ka me djemtë e tij. Duke u sjellë në mënyrë teatrale, si një kloun apo bufon ai ofendon të afërmit e tij duke diferencuar pikërisht ata që i ka pjellë e gjak të tij. Duke e cilësuar Mitjan si “më i parespektuari” ai i “fryn zjarrit” dhe zbulon skenarin e parapërgatitur. Gjithashtu nevoja e tij që At Zosima të lutet e të profetizojë për të zgjidhur një konflikt që vetëm ai me ndryshimin e qëndrimit të tij mund ta zgjidhë është një paturpësi dhe fyryje për të gjithë të pranishmit.*

3. Një veçori e personazheve të Dostojevskit është fakti se ata ata i “nuhasin” gjërat para se ato të ndodhin. Ilustroni idenë “gjithçka dihet nga të gjithë” me detaje nga teksti dhe analizoni funksionin e këtyre elementeve rrëfyese të cilat autori ia bën të ditur lexuesit para se ato të ndodhin.

**Detaje: 1.** “Sidoqoftë, pamja e njeriut disi të sëmurë, që i kishte fytyra në këto çaste, e kishte shpjegimin: **që të gjithë ishin në dijeni të jetës së “shfrenuar” që bënte kohët e fundit, ashtu si ishin në dijeni dhe të grindjeve të përsëritura me të atin për të hollat e mohuara.”**

2. “Se prej natyre Dmitri Fjodoroviçi ishte njeri gjaknxehtë dhe tip i rrëmbyer, kjo dihej...”

3. të më falni për zemërimin, por **e parandjeva** që ky plak belaçar ju thirri këtu për të kurdisur skandalin e paramenduar.

4. E dëgjoni ç’thotë, o murgj, ky **atëvrasës?** – iu hakërrye Fjodor Pavloviçi at’ Josifit

4. a) Rrëfyesi ndalet gjatë në fillim të fragmentit në zhbirimin e shikimit të Dmitrit. Gjeni këto detaje, analizoni ato dhe shpjegoni funksionin e përshkrimit me kaq detaje të shikimit të Dmitrit.

Detaje përshkruese të shikimit të Mitjas: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

b) A mendoni se shikimi i këtij personazhi pasionant e gjaknxehtë përbën një detaj artistik me rëndësi?

Lexoni pjesën e mëposhtme përpara se t’i përgjigjeni pyetjes.

“- O atë dhe mësues,- tha me përgjërime dhe emocion Aliosha. – Janë të paqarta fjalët që the...Ç’është ajo dhimbje dhe vuajtje që e pret tim vëlla?

- Mos u trego kureshtar. Dje m’u duk, që atij do t’i ndodhë një gjë e tmerrshme...**Shikimi që kishte ia shprehte fatin që e priste. Ai vështrim...ma mbushi zemrën me tmerr. Një fat të zi po përgatit për veten e tij ai njeri. Një a dy herë më ka qëlluar në jetën time të shoh shikim të atillë te njerëzit...Në të gjen të mishëruar fund e krye atë që po i përgatit vetes njeriu, parashikimi u vërtetua...”**

### Grupi II:

7. Frazat a shprehjet frazeologjike të mëposhtme zëvendësojini me një fjalë. Reflektoni si e pasuron përdorimi i tyre nga ana gjuhësore e stilistikore tekstin.

Heq dorë-\_\_\_\_\_

Mori dhenë:\_\_\_\_\_

S’u bë kiameti:\_\_\_\_\_

Dhëntë Zoti:\_\_\_\_\_

8. Interpretoni kuptimin e dialogut të mëposhtëm. Mbi ç’figurë është ndërtuar ?

- Mbase ka mëkatuar në të ritë e shtyrë nga mjedisi dhe rrethanat, por ajo “ka dashuruar shumë”, kurse atë që dashuron shumë dhe Krishti e ka falur

- Krishti nuk ka folur për të tillë dashuri...- i doli me gulç nga kraharori të urtit at’Josif.

- Jo, o murgj, për të tilla ka falur! Ju këtu kërkoni ta shpëtoni shpirtin duke u ushqyer me lakra dhe pandehni se i latë mëkatet! Ushqeheni me cironka, nga një cironkë në ditë hani, dhe kujtoni se kështu e bëni për vete

Zotin!

*Model përgjigjeje: Referenti i kësaj bisede është Grushenjka. Ajo komentohet nga Fjodori si “e përdalë dhe fëmër e fëlliqur dhe e ligë”. Ndërkohë që paraqitet si mëkatore paralelisht me të qëndrojnë “ata që nuk bëjnë mëkate”, murgjit të cilët mbajnë kreshmë për “t’i pëlqyer” Perëndisë. Ironia e folësit është therëse dhe i revoltton murgjit.*

*Dialogu ndërtohet nëpërmjet ironisë e cila realizohet nga pranëvënia semantike e fjalëve: “dashuron shumë” dhe “hani nga një cironkë në ditë”.*

9. Gjeni epitetet, metaforat, epitetet metaforike dhe krahasimet në këtë fragment.

Epitete: \_\_\_\_\_

Metafora: \_\_\_\_\_

Epitete metaforike: \_\_\_\_\_

Krahasime: \_\_\_\_\_

10. Duke u nisur nga ky fragment, por dhe nga vepra në tërësi cilat elemente e bëjnë Dostojevskin paraprijës të modernizmit të shek. XX? Argumentoni mendimet tuaja.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Diskutim:**

-Pavarësisht pasqyrimin të botës ruse të një periudhe të caktuar, vepra “Vëllezërit Kramazovë” është një vepër e gjithëkohshme dhe temat dhe problematikat që ajo trajton, janë gjithnjë aktuale. Krahasojeni këtë botë me botën reale dhe shoqërinë ku ju jetoni. Ndaluni në:

- vlerat dhe virtytet që karakterizojnë krijesat e Dostojevskit dhe njerëzit e kohës suaj;
- rregullat e moralit në botën e Dostojevskit dhe ato të botës suaj;
- qëndrimi ndaj fesë dhe besimit në botën e personazheve të Dostojevskit dhe qëndrimi i njerëzve të botës suaj.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Detyrë: Shkruani një ese argumentuese me teme:

“Virtytet apo vetitë që unë vlerësoj më tepër tek një njeri”

PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
Tema mësimore – Koment “Rebelimi”, Dostojevski			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>tregon me fjalët e tij fragmentin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj;</li> <li>veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;</li> <li>analizon personazhet, evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);</li> <li>analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;</li> <li>reflekton në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>4 muaj</li> <li>Dhunë</li> <li>Depërtues</li> <li>Lot fëmijësh</li> <li>Mosbesues</li> <li>Metafizikë</li> <li>“zot si vetja”</li> <li>Rebelim</li> <li>Vuajtje</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Biblioteka</li> <li>Interneti</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutohet mbi fragmentin	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Stuhi mendimesh</i> , <i>Grupe ekspertësh Diskutim</i>			

Organizimi i orës së mësimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

***Stuhi mendimesh:***

Mësimi fillon me një diskutim

- Ç’janë virtytet?
- A kultivohen ato?
- Jetojmë në një botë kaotike, çfarë mund të ndryshojmë?
- Cilët janë disa vlera njerëzore që i kemi hasur tek personazhet e Dostojevskit?
- A duhet ta shmangim luftën? Cila është forma më e mirë?
- Si ndihen kur derdhen lot fëmijësh dhe bëhen vrasje?
- A ka luftra sot?
- etj

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

***Grupet e ekspertëve me role të specializuara:***

Analizohet fragmenti duke përdorur metodën *Grupet e ekspertëve*.

**1. Hulumtuesi-**Detyra e tij është që të japë informacion paraprak për çdo gjë që lidhet me tekstin. Si p.sh: tema, konflikti, personazhet, periudha historike, mesazhet, etj.

Për këtë mund të shfrytëzohen pyetjet pas mësimit 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8

**2. Gjetësi i citimeve-** Detyra e tij është që të gjejë citimet dhe fjalët më domethënëse që karakterizojnë personazhet, t’i paraqesë me zë dhe të ftojë grupin në komentim.

Për këtë shfrytëzohen pyetjet pas mësimit: 9, 10, 11, 12

**3. Interpretuesi i personazheve-** Detyra e tij është që të mendojë me kujdes për personazhet, karakteret e tyre mesazhet që përcjellin fjalët dhe sjellja e tyre dhe t'i diskutojë ata me nxënësit e tjerë. Metoda e zgjedhur është plotësimi i bioskedës për personazhet.

**4. Lidhësi:** Ka për detyrë të gjejë lidhjet mes tekstit dhe botës jashtë shkollës, realitetit të përditshëm, shembuj nga letërsia, filma, fjalë të urta shqiptare që përcjellin mesazhe të ngjashme për lakminë për pasuri dhe pushtet, marrëdhëniet familjare etj.

Shfrytëzohen pyetjet 13, 14

**5. Pyetësi-** Kërkon në tekst pyetje dhe probleme për tu shqyrtuar. Pyetjet: 15, 16, 17.

Pasi nxënësit kanë punuar me kërkesat e tyre kalohet në diskutime.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### Diskutim:

Rrëfëni në klasë raste të përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, shoqëri.

Përpiquni të argumentoni se “dhuna pjell dhunë” dhe se “lufta më e mirë kundër dhunës, është ta shmangësh atë dhe ta duash më shumë tjetrin”.

#### Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për detyrën e realizuar në shtëpi, për njohuritë për veprën, për përgjigjet për pyetjet që ngrihen, si dhe për reflektimin mbi veprën.

#### Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:

Detyrë: Shkruani një ese me temë:

“E tërë bota e dijeve bëhet e pavlefshme, në lejohen të derdhen lot fëmijësh.”

Lexoni dy fragmentet e fundit shtesë nga vepra

### PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore – Mendimi kritik për veprën e Dostojevskit			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mëimit</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson mendimin kritik mbi veprën e Dostojevskit</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e veprës</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon;</li> <li>• bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësim</li> <li>• vepër me ndikim</li> <li>• kuturisje në vetvete</li> <li>• mendim</li> <li>• psikologjik</li> <li>• profetik</li> </ul>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Video projektor,</li> <li>• Korniza të skeletëzuara</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Qytetari.	<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutohen fragmentet e fundit		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP - Diskutim për njohuritë paraprake, Interpretim i fragmentit, Diskutim, Korniza të skeletëzuara.			

### Organizimi i orës së mëimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Diskutim për njohuritë paraprake:**

**Nxënësit kanë lexuar fragmentet:**

- Inkuizitori i madh
  - Vëllai i murgut të vjetër Zosima
- Bëjnë përmbledhjet

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Interpretim i fragmentit:**

Në këtë orë mësimore do të përqendrohemi në reflektimin për veprën.

Mësuesja ka përgatitur në video-projektor një grup vlerësimesh nga autorë të ndryshëm për veprën e Dostojevskit. Disa prej tyre nxënësit i kanë edhe në tekst.

Shfaqen thëniet dhe komentet një nga një dhe nxitet diskutimi i nxënësve për thënien, veprën dhe aktualitetin e veprave.

Qëllimi është të vendoset theksi te vlerat aktuale dhe universale që ka kjo vepër.

**Diskutim:**

**Shembulli 1**

*-Cili është komenti juaj për vlerësimin e Niçes për veprën dhe autorin?*

*Asnjë nuk e ka zërthyer përbërjen e komplikuar të njeriut si ai; mendimi i tij psikologjik është i jashtëzakonshëm, profetik. Për vlerësimin e madhështisë së tij na mungon masa; ai qëndron vetëm. Bashkëkohësit e tij deshën ta masin, por dështuan. Ai qe shumë pa modesti, i madh.*

*Fridrih Niçe*

Pasi diskutohet për kritikën e ndryshme të veprës mësuesja shkruan në tabelë:

- Shprehni mendimin dhe ndjenjat tuaja për veprën duke argumentuar pse:

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

U shpërndahen nxënësve disa **korniza të skeletëzuara** për të reflektuar mbi veprën “Vëllezërit Karamazovë”. Dostojevski

**1. Interpretim**

Në pamje të parë \_\_\_\_\_ ishte një vepër \_\_\_\_\_ për një \_\_\_\_\_.

Megjithatë besoj se autori e ka përdorur ngjarjen për t’u dhënë lexuesve një mësim më të thellë për \_\_\_\_\_.

Për shembull \_\_\_\_\_ . Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Po kështu kur \_\_\_\_\_.

Kjo nënkupton se \_\_\_\_\_.

Së fundi \_\_\_\_\_.

**2. Argumentim bindës**

A dëshironi të jetoni në një botë \_\_\_\_\_. Kjo do të ndodhë në qoftë se \_\_\_\_\_ të gjithë ne \_\_\_\_\_.  
 \_\_\_\_\_ .Pse? Sepse \_\_\_\_\_. Disa thonë që \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_. Ata motivohen nga \_\_\_\_\_.

Përkundrazi këto zgjidhje vetëm shërbejnë për të \_\_\_\_\_. Në fund të fundit propozimi ynë është më i efektshëm sepse \_\_\_\_\_.

**3. Zbatimi**

Unë e kuptoj shumë mirë qëllimin \_\_\_\_\_. Në moment të caktuara edhe unë ndihem \_\_\_\_\_. P.sh. \_\_\_\_\_.  
 Megjithatë unë nuk \_\_\_\_\_ pasi \_\_\_\_\_.

**4. Zbatimi - Reagim ndaj një veprë.**

Në veprën \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ më ka bërë veçanërisht përshtypje \_\_\_\_\_ e personazhit \_\_\_\_\_. Përshtypja ishte shumë e fuqishme, sepse \_\_\_\_\_.

Për shembull unë \_\_\_\_\_. Megjithatë reagimi im nuk do të ishte i njëjtë me atë të personazhit. Unë \_\_\_\_\_, kurse personazhi \_\_\_\_\_. Mendoj që \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_. Në të ardhmen do të \_\_\_\_\_.

**5. Sintezë**

Përtë arritur të kuptojmë më mirë çështjen \_\_\_\_\_ duhet të sintetizojmë këndvështrimet e mëposhtme: Këndvështrimi i parë thotë që \_\_\_\_\_ dhe si prova përdor \_\_\_\_\_. Kjo mund të jetë e vlefshme për \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_. Këndvështrimi i dytë thotë që \_\_\_\_\_.

Kjo \_\_\_\_\_. Këndvështrimi i tretë i përshtatet më shumë \_\_\_\_\_.  
 \_\_\_\_\_. Për këtë arsye ndonëse për këtë \_\_\_\_\_ ekzistojnë shu  
 më \_\_\_\_\_ sinteza e këtyre këndvështrimeve tregon bindshëm  
 që \_\_\_\_\_.

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për interpretimin, pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, argumentet, analizat dhe interpretimet.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur: Ja pse më pëlqen ky personazh nga Dostojevski!**



**PLANIFIKIMI DITOR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore– Letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XIX</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton rreth zhvillimit të kësaj letërsie, rrymave dhe drejtime letrare moderniste.</li> <li>• veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj letërsie në Europë dhe në botë.</li> <li>• evidenton vendet ku u zhvillua ky drejtim letrar.</li> <li>• Dallon veçoritë kryesore të drejtimit letrar parnasjan, simbolizmit, dekadentizmit...</li> <li>• përcakton llojet dhe gjinitë letrare</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• simbolizëm</li> <li>• arti i kulluar</li> <li>• përparësi forma</li> <li>• vetëm poezia është art</li> <li>• parnasianët</li> <li>• dekadentë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Teksti letrar</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori, Arte, Njohja e kulturave	<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim rreth njohurive që kanë nxënësit për letërsinë e kësaj periudhe.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Stuhi mendimesh, Lexim i imët me kodim teksti, Pema e mendjes, Ditari dy pjesësh, Vëzhgim dhe diskutim			

**Organizimi i orës së mësimi**

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

**Stuhi mendimesh:**

- Çfarë njohurish keni për kontekstin historik dhe kulturor para dhe gjatë kësaj periudhe?
- Ç'ndryshime ndodhën në shoqërinë njerëzore?
- Cilët janë përfaqësuesit që njihni?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Lexim i imtë me kodim teksti:**

U kërkohet nxënësve të lexojnë tekstin dhe më pas të të kodojnë tekstin duke vendosur simbole anash. Më pas nxënësi grupon informacionin në tabelë si më poshtë:

<b>F-</b> Fakte	Në gjysmën e dytë në shek.XIX , në Francë
<b>D-</b> Drejtime	-Parnasianët -Dekadentizmi
<b>O-</b> origjina	Parnasianët:Nga kanë ardhur... Dekadentizmi: Simbolozmi:
<b>P-</b> Përfaqësuesit	<b>Parnasianë:</b> Gotje, Banvil, Lil, <b>Simbolistë::</b> Edgar Alan Poe, <b>Bodëler</b> , Artur Remboja , Stefan Malarmeja, Pol Verleni <b>etj.</b>

**V-Veçoritë**


**Parnasianët** ngrihen kategorikisht kundër çdo forme të pragmatizmit në art. Ata janë ithtarë të flaktë të kultit të formës, kujdesen për përpunimin e vargjeve deri në imtësi, kërkojnë që poeti të jetë virtuoz i rimës, metrit, vargut, strofës. Etj.

**Dekadentët** u ngritën kundër kanuneve a rregullave morale e letrare, shpërfillën normat e mirësjelljes e idealet e larta për jetën.

**Simbolistët** iu kundërvunë kështu realizmit. Është e nevojshme që poeti të barazohet me Zotin, sepse vetëm kështu përpara tij do të zbulohet kuptimi i fshehtë i qenies. simbolistët shfrytëzuan ligjësi më të veçanta të ngjizjes gjuhësore të ligjërimin poetik, të prirur deri te formime në pamje të parë alogjike, që mundësojnë ndriçimin e lidhjeve e korrespondencave nga më të ndryshmet, të afta të shprehin njëherësh emocione e ndjesi të shumëfishta. shpallën kultin e përparësisë së formës e mbrojtën tezën e artit të kulluar. Idenë e krijimit të simboleve poetike, përmes të cilave arrihet tek e mistershmja, e dha Bodleri etj.

**Pema e mendjes:**

Nxënësit vetë përmes kodimit të tekstit kanë zbuluar drejtimin e simbolizmit dhe bashkë me mësuesin marrin informacionin përmes pemës:



- poezia fiton harmoni të pastër, të ngjashme me muzikën;
- prirjet për t'u bërë muzikë;
- stimulon shqisat dhe intelektin e lexuesve;
- ndërmjet fantazisë zbulon atë që fshihet nga bashkimi i tingujve/ritmeve/fjalëve;
- piktura, ndikim të madh në vizionin simbolist.

**Ditari dypjesësh:**

<b>Përfaqësuesit kryesorë</b>	<b>Llojet letrare</b>
Edgar Alan Poe Sharl Bodëleri Artur Remboja Pol Verleni Stefan Malarmeja	

**C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Diskutim:**

1. Përcaktoni dy nga zhvillimet e reja në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX që parapërgatitën simbolizmin.
  2. Cilat janë risitë që sollën simbolistët në poezi? Ç'qëndrim mbajtën ata ndaj traditës në poezi?
  3. Cilët janë përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së gjysmës së dytë të shekullit XIX? Ç'lloje letrare lëvruan ata?
  4. Krahasoni letërsinë realiste me prirjet e zhvillimet e reja në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Si e shpjegoni faktin që simbolistët janë kryesisht poetë dhe realistët kryesisht romancierë?
  5. Lexoni poezinë "Prapësia" nga Sharl Bodëleri dhe përgjigjuni kërkesave në vazhdim:
    - Ç'vlerësim ka Bodleri për poezinë e poetin?
    - Cili është Sizifi? Pse i drejtohet atij poeti?
    - Si e sheh Bodleri procesin e krijimit të artit të vërtetë, të poezisë?
    - A duhet që poeti të luftojë për famë? Cilën quan Bodleri "famë" të vërtetë?
    - Poezia e simbolizmit synon të ngacmojë shqisat. A vërehet ky tipar i poezisë simboliste në këtë poezi?
- Gjykoni për strukturën e poezisë. Si quhet kjo formë e poezisë? Ç'të veçantë ka ajo që pëlqehet nga simbolistët?

**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pyetjet dhe përgjigjet që formulon, për saktësinë e tyre dhe për shkallën e përvetësimit të njohurive.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Mësoni përmendsh poezinë "Annabel Li" të E. A. Poes në variantin e saj origjinal dhe në variantin të shqipëruar nga mjeshtri ynë i përkthimit Fan Noli. Recitohet të dyja variantet bukur në klasë. (klasa ndahet në grupe)
- Lexoni jetën e Bodëlerit.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
Tema mësimore – <b>Sharl Bodëler. Jeta dhe vepra</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan momentet kryesore të jetës së Bodëlerit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>• veçon veprat kryesore të Poetit;</li> <li>• diskuton rreth veçorive, vlerave, strukturës, simbolizmit dhe rëndësisë së veprave të tij.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Simbolist</li> <li>• Frances</li> <li>• Ndjeshmëri</li> <li>• Lulet e së keqes</li> <li>• Parajsat artificiale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor</li> <li>• Tabela apo flipchart</li> <li>• Interneti</li> <li>• Biblioteka.</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe.	<b>Situata e të nxënit:</b> Bisedë mbi rëndësinë e Bodlerit si themelues i poezisë moderne		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- Interpretim, <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Punë në grupe, Diskutim.</i>			

## Organizimi i orës së mësimi

## A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

**Interpretim:**

- Nxënësit interpretojnë variantet e poezive të tyre të ndarë në grupe *Poesë* dhe përkthimin e Nolit

**Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

- Punohen në tabelë të dhënat kryesore për jetën dhe veprën e Bodlerit, pasi lexohen disa nga përmbledhjet e nxënësve. Mësuesi/ja mund të përdorë teknika vizuale, si: pemë mendjeje, kllaster ose thjesht tabela.

- Bodleri “*artist*”, se ai krijoi veçse duke përmbushur deri në përsosje ligjësitë e artit të vërtetë.
- Artisti simbolist që jetoi veç 46 vite, nga 9 maji 1821 deri më 13 gusht 1867. Lindi dhe u shua në Paris. Kaloi një fëmijëri të trazuar.
- Studioi në Lion e Paris, për pak kohë ndjek studimet për drejtësi, po asgjë s’e kënaqte, përveçse letërsia.
- Mori pjesë në Revolucionin e Shkurtit të vitit 1848, luftoi në barrikada, por ngjarjet e mëvonshme (1851) bënë që ai të largohej përfundimisht nga politika, duke iu përkushtuar vetëm letërsisë.
- Që në vitin 1847 kishte botuar novelën “*Fanfarlo*”, një lloj autoportreti ironik dhe ishte marrë me përkthime të Edgar Poes, nën gjurmët e të cilit Bodëleri do të ecte.
- Më 1857 doli vëllimi poetik “*Lulet e së keqes*”, kryevepra e Bodëlerit, për të cilën u akuzua për fyerje të moralit shoqëror dhe përbaltje të besimit fetar.
- Në 24 prill 1864 nisët për në Belgjikë, për një tur konferencash. Në Belgjikë, poeti u godit nga paraliza, u gozhdua në shtrat në prill dhe në gusht të po atij viti (1867), mbylli sytë në Paris.

-“*Kuriozitete estetike*” – përmbledhje me shkrime kritike për artin ku shquajnë artikujt për pikturën e Delakruasë.

-“*Arti romantik*” përmbledhje me kritika për letërsinë ku shfaqen hapur kuptimi që ka Bodëleri për letërsinë si art dhe shijet e holla estetike të atij që mishëroi i pari në art mitin e “*poetit të mallkuar*”.

-“*Brenga e Parisit*” – përmbledhje me proza poetike plot emocione që të trondisin me situatë të pazakonta.

-“*Parajsat artificiale*” – një libër i quajtur monografi për drogat.

-“*Ditari intim*” – përmbledhje me shënime letrare, por që e kalojnë fushën e letërsisë, sepse rrokin edhe fusha të tjera si atë të *estetikës, të filozofisë, të moralit e të sociologjisë*

## B. Ndërtimi i njohurive të reja

### **Punë në grupe:**

Ndahet klasa në grupe me detyra të përcaktuara nga mësuesja në skeda apo kartonë për secilin grup. Të gjithë nxënësit do të lexojnë me vëmendje tekstin dhe do të plotësojnë tabelat që u janë caktuar.

### **Grupi i parë:**

Detaje të atmosferës politike	Detaje të atmosferës ekonomike	Detaje të atmosferës shoqërore

### **Grupi i dytë:**

Detaje Objektive	Detaje subjektive

## C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

### **Diskutim:**

1. Kërkoni të dhëna për historinë e Francës në vitet 1820-1870, vite kur ka jetuar Charl Bodëler. Krijoni një panoramë të qartë historike dhe diskutoni lidhur me angazhimet e tij në politikë.
2. Cilat janë veprat kryesore të Bodëlerit dhe të ç’lloji letrar janë ato?
3. Për çfarë flet autori te veprat “*Brenga e Parisit*” dhe “*Parajsat artificiale*”?
4. Si e kuptoni termin “*poet i mallkuar*” që përdoret zakonisht për të?
5. Shpjegoni me disa fjali, si i kuptoni idetë që ai trajton në veprën “*Parajsat artificiale*”, lidhur me tema që ne i quajmë tabu, si p.sh.: droga, alkoli, jeta e natës etj?
6. Në planin letrar, ç’të re solli ai në letërsinë botërore?

### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen aktive në mësim, interpretimin, për rolin në grup, për saktësinë e kryerjes së detyrave.

### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Shkruani një tekst të shkurtër reflektues me temë: “Shkrimtarët janë pasqyra e epokës ku ata jetojnë. Shkrimtarët novatorë e kapërcejnë epokën e tyre. Ata krijojnë ura lidhëse me të ardhmen dhe i paraprijnë asaj”.

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
Tema mësimore – <b>Bodëler “Lulet e së keqes” Analizë</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimi :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon gjerësia e tematikës, thellësia e ndjenjës, bukuria e vargut në vëllimin “Lulet e së keqes”.</li> <li>dallon lirizmin, simbolizmin, si prirja më e natyrshme e talentit të Bodëlerit.</li> <li>dallon temën dhe motivet në vepër;</li> <li>Analizon ritmet, simbolet, ndjenjat, imazhet, figurat në poezi</li> <li>analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut</li> <li>demonstron vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;</li> <li>bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;</li> <li>mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>		<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>vepër nismëtare moderne</li> <li>vetëdije kritike</li> <li>sensual</li> <li>shpërthim mistik</li> <li>e keqja</li> <li>prolog</li> <li>spleen</li> <li>revoltë</li> <li>vdekje</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti shkollor</li> <li>Flipchart</li> <li>Tabela e zezë</li> </ul>	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe		<b>Situata e të nxënit:</b> Interpretoj vargje nga vëllimi “Lulet e së keqes”	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Të nxënit me këmbime, Diskutim.</i>			

## Organizimi i orës së mësimi

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme*****Diskutim mbi njohuritë paraprake :***

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutim i detyrave të shtëpisë.

“Shkrimtarët novatorë e kapërcejnë epokën e tyre. Ata krijojnë ura lidhëse me të ardhmen dhe i paraprijnë asaj”.

-Ç’të reja solli Bodëleri në letërsinë e fund shekullit të XIX ?

**B. Ndërtimi i njohurive të reja*****Të nxënët me këmbime, grupe ekspertësh:***

- Klasa ndahet në grupe ku secili prej tyre ka pesë nxënës (sipas numrit të pjesëve të zgjedhura të vlefshme për t’u caktuar si detyrë. Përgatitim **fletën e ekspertit** që do t’i ndihmojë nxënësit të bëhen ekspert kur të bëjnë përmbledhjen e një pjese të tekstit.


– Një grup do të jetë me emër **Prologu**, caktohen nga mësuesi

- Fletët përgatiten me numra nga 1-6. Secila fletë ka pyetjet për përgatitjen e grupit fillestar ekspert 1,2,3,4,5,6,

Nxënësit numërojnë nga 1-6 më pas udhëzohen që të grupohen për përgatitje për ekspert njëshat bashkë, dyshat e kështu me radhë deri tek grupi ekspert 6

## PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

- Ndaj tekstin me analizën “Lulet e së keqes” në 6 pjesë të zgjedhura me numrat 1-6
- Shpërndaj fletët me pyetjet e përgatitura për grupet e ekspertëve nga 1-6 (nga eksperiencia rekomandohet grup heterogjen që të gjithë nxënësit të përfitojnë nga njëri-tjetri) Nxënësit mbajnë shënime dhe fillojnë përgatitjen rreth 15 minuta (në varësi të pjesës)



Nxënësit diskutojnë në grupet bazë. Arrijnë të mbajnë përgjegjësinë secili do t’ia transmetojë si ekspert i përgatitur grupit ekspert. Më pas bashkohen në grupe të tjera heterogjene në përgatitje 1, 2, 3, 4, 5.

Ekspertët 1 ia transmetojnë përgjigjet grupit ku bën pjesë, po kështu vazhdon eksperti 2 e kështu me radhë duke arritur të përvetësohet plotësisht mësimi. Nxënësve u lihet një kohë e caktuar në dispozicion.

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Diskutim:**

1. Si është strukturuar vepra “Lulet e së keqes”?
2. Ç’lidhje krijohet mes titullit të veprës dhe natyrës së Bodëlerit?
3. Në bazë të cilës figurë letrare ndërtohet titulli?
4. Cili është kuptimi i fjalës splin (spleen) dhe cili është qëllimi për të cilin e përdor poeti? Përballë këtij koncepti, cilin koncept vendos ai?
5. Si del figura femërore në poezinë e Bodëlerit?
6. Si e kuptoni shprehjen e Flobërit për Bodëlerin: “Ju jeni i qëndrueshëm si mermeri dhe i tejdukshëm si një mjegull e Anglisë!”?

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për leximin e veprës “Lulet e së keqes” dhe plotësimin e saktë të grupeve të ekspertëve, duke ilustruar me shembuj nga vepra, diskutimet rreth saj.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

- Gjeni një poezi simbolike nga L. Poradeci. Krahasoni me një poezi të Bodëlerit

## PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Letërsi	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
Tema mësimore –Koment “Albatrosi” Bodleri			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon dhe gjykon për vlerat e lirikës popullore</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikaliteti toni (i gjallë, i zymtë, i ngrohtë, solemn); gjatësia e vargut,</li> <li>• vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• zbulon motivet e poezisë</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, kohaapo rrethanat e një teksti</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Albatrosi</li> <li>• Viganë</li> <li>• Moskokçarës</li> <li>• Udhëtar ngordhalaq</li> <li>• Qesharak</li> <li>• Poeti</li> <li>• Princ resh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori. Biologji	<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Interpretim i poezisë</i>		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP- diskutim mbi njohuritë paraprake, Interpretim, <i>Lexim i drejtuar me ndalesa (VLMD), Diskutim</i>			

## Organizimi i orës së mësimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme****Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Diskutohet detyra e shtëpisë: Krahasime vargje nga Bodëler dhe Poradeci

**Interpretim:** Interpretohet bukur poezia duke krijuar atmosferë nga mesuesi ose një nxënës

**B. Ndërtimi i njohurive të reja****Veprimtari e leximit të drejtuar:**

Lexohet poezia me ndalesa duke komentuar.

Jepet një panoramë e përgjithshme rreth të kuptuarit të përmbajtjes së poezisë, më pas drejtohen pyetje në të kuptuar:

1. Cila është tema që trajton poeti në këtë poezi? Shpjegoni misionin e një poeti në “tokë”?

-Tema : Roli i artistit në shoqëri

-Poeti është si ky princ i reve, i mësuar mes fortunave, që nuk i trembet shigjetave të harkëtarit, por është mërgimtar në tokë, misionar fisnik.

2. Shpjegoni arsyet e përzgjedhjes nga autori të këtij shpendi për të dhënë figurën e një poeti?



*Kur fluturon në qiell, albatrosi të huton me madhësitinë, hijeshinë dhe bukurinë e tij. Kur zbret në tokë ose në anije (si në poezi), ai ecën në mënyrë qesharake, lëkundet majtas e djathtas si një i pirë dhe në këtë mënyrë bëhet objekt i përqeshjes. Kur poeti shkruan vargjet e tij të frymëzuara, “që ngjiten lart në qiell”, hijeshia dhe bukuria e tyre e mrekullojnë lexuesin që e njeh dhe e ndjen poezinë (njeriun e kulturuar dhe të arsimuar). Por kur poeti prek tokën dhe e vendos veprën e tij në duart e dokujtudo, këtij të fundit poeti i duket i çuditshëm, i paqartë, që edhe kur ecën “lëkundet”. Në këtë moment, ai bëhet si albatrosi: qesharak, i shëmtuar dhe i përqeshur.*

3. Sillni poezi të ngjashme nga poeti ynë L. Poradeci dhe bëni krahasimin me “Albatrosin”.  
Poezia “Vdekja e Nositit” I. Poradecit, “Gjeniu I anijes”

4. Përballë albatrosit qëndrojnë marinarët? Kë përfaqësojnë ata në shoqërinë tonë?

*Ka njerëz që injorojnë dhe mohojnë mirësinë te njeriu (ose kafsha) dhe përqendrohen në anën e dobët apo të keqe, me qëllim që të shprehin mizorinë përmes përqeshjes dhe talljes. Ka nga ata që kënaqen kur zbulojnë të meta te një artist i famshëm apo kushdo tjetër. Ata i kritikojnë pa mëshirë për këto të meta.*

*Detarët te “Albatrosi” janë shembulli i këtyre njerëzve mizorë.*

5. Cili është kuptimi alegorik i detit, apo i udhëtimit në vargun “Përmes thellësive të hidhura të detrave”?

*Kuptimi simbolik i udhëtimit- rruga që bën poeti gjatë jetës ose qenia njerëzore.*

*Thellësitë e hillura të deteve- përballja me vështirësitë , gjendje të trazuara, përballje...*

6. Shpjegoni kuptimin e fjalëve “sovrani i kaltërsisë”. Çfarë ideje përcjell përdorimi i ngjyrës së kaltër? Cilës i përket kjo ngjyrë? Në rastin tonë me cilin e lidh poeti dhe pse (detit apo/edhe qiellit)?

*-Ashtu si sovran i kaltërsisë, albatrosi, artet janë forma të krijimeve të bukura. Por vetëm pak njerëz mund ta kuptojnë dhe vlerësojnë artin. Mjerisht, kur vepra e një poeti bie në duart e një lexuesi të keq, ai bëhet si albatrosi: i shëmtuar dhe qesharak.*

*-Përdorimi i ngjyrës së kaltër fluturime shpirtërore drejt lartësish nga dete në qiell, shpirti i lirë.*

7. Cila është figura kryesore stilistike që përdoret në këtë poezi? Cili është zberthimi kuptimor i kësaj figure për të na transmetuar mesazhin?

*-Simboli - Albatrosi simbolizon poetin. Poeti është si ky princ i reve, i mësuar mes fortunave, që nuk i trembet shigjetave të harkëtarit, por është mërgimtar në tokë, midis njerëzve që e venë në lojë dhe krahët gjigandë me të cilat mund të fluturojë i lirë, e pengojnë të ecë.*

8. Gjeni krahasimin e përdorur në strofën e dytë dhe shpjegoni arsyen e këtij përngjasimi të albatrosit me krahë gjigandë.

*Mjerisht, krahët e bardhë, i lë të zvarritur,*

*Si një çift rremash të vozitura me ngadalsi.*

**Ngjashmëri fizike**

9. Fjalët kyçe që përdoren në poezi janë: **kaltërsi, udhëtar, tokë, thellësi detrash, aq të bukur**. Këto fjalë na tregojnë idenë e poetit për udhëtimin e tij. Cilët janë tri rrugët që i ofrohen dhe cila prej tyre është rruga e duhur?

*Njëra lart drejt qiellit, tjetra drejt thellësive poshtë dhe enigmave e vështirësive si dhe e treat drejtvizore. Rruga e duhur është ajo e qiellit, e lartësive.*

10. Gjeni antitezat e përdorura në poezi, si dhe shpjegoni botët që autori ve përballë.

*-Dikur sovran i qiejve – tani i qullët, qesharak, ngordhalaq;*

*Dikur madhështor – tani zvarritet;*

*I shëmtuar – i bukur (shëmtia dhe bukuria);*

*Qielli i pafund – kuverta e anijes (hapësira – izolimi)*

11. Gjuha që përdor Bodëler është gjuhë me një organizim shumë të mirë sintaksor duke përdorur mjaft mbiemra dhe përcaktorë. Gjejini ata dhe ndaluni tek epitetet e përdorura.

*Viganë, moskokçarës, të hillura, i kaltërsisë, të zvarritur, plogët, ngordhalaq, qesharak, të shëmtuar*

#### A. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

##### **Diskutim mësimor:**

1. Marinarët, në këtë poezi, janë përfaqësues emblematicë të njerëzve të sipërfaqshëm, konformistë dhe të zakonshëm, të pazotë të kapin esencën e realitetit e të shpjegojnë me thellësi atë që shohin e njohin. A ju ka ndodhur të gjykoni shpejt një poet, ngaqë nuk ia kuptoni poezinë? Diskutoni mbi problemet që krijohen në një shoqëri, ku poetët trajtohen me shpërfillje dhe nuk përpiqeni t'i kuptoni.

2. A jemi të sigurt se i kuptojmë shpejt të gjitha mendimet apo ndjenjat e të tjerëve? Çfarë mendoni se duhet bërë, kur të tjerët shfaqin idetë e tyre?

##### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit simbolik.

##### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Bëni një përshkrim të lirisë së njeriut "të mbyllur" nëpër qytete të mëdha, nisur nga shprehja e Bodlerit: *"Në vetminë e fushave, në labirintet e gurta të një kryeqyteti, ju xixëllim yjesh, ju shpërthim fenerësh, ju jeni fishekzjarret e hyjneshës Liri!"*

#### PLANIFIKIMI DITOR

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore –Koment "Epilog" Bodëleri			
<b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave lëndore sipas temës së mësimorit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon dhe gjykon për vlerat e lirikës popullore</li> <li>• veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); muzikaliteti toni (i gjallë, i zyrtë, i ngrohtë, solemn); gjatësia e vargut,</li> <li>• vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• zbulon motivet e poezisë</li> <li>• analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, kohaapo rrethanat e një teksti</li> <li>• formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• zemërlehtë</li> <li>• bregore e bukur</li> <li>• spitali, bordelo</li> <li>• marrëzia e njerëzve</li> <li>• shpërthen</li> <li>• mikja plakë</li> <li>• horr kryeqytet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti shkollor,</li> <li>• veprat letrare (mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës),</li> <li>• interneti</li> </ul>		

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Histori.	Situata e të nxënësve: <i>Interpretim i poezisë</i>
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP -diskutim mbi njohuritë paraprake, Interpretim, Lexim i drejtuar me ndalesa(VLMD), Diskutim	

### Organizimi i orës së mësimi

#### A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

##### **Diskutim mbi njohuritë paraprake:**

Diskutohet detyra e shtëpisë:

##### **Interpretim:**

Interpretohet bukur poezia duke krijuar atmosferë nga mesuesi ose një nxënës

#### B. Ndërtimi i njohurive të reja

##### **Veprimtari e leximit të drejtuar:**

Lexohet poezia me ndalesa duke komentuar.

Jepet një panoramë e përgjithshme rreth të kuptuarit të përmbajtjes së poezisë, më pas drejtohen pyetje në të kuptuar:

1. Cili është kuptimi i fjalës *epilog* dhe gjeni lidhjen me përmbajtjen e poezisë.

*Kapitull i fundit ose pjesë përmblylëse në një vepër letrare, ku jepet zgjidhja e veprës a përfundimi i ngjarjeve që shtellohen në të ose flitet për fatin e mëtejshëm të personazheve pasi ka kaluar një farë kohe që nga ngjarjet e treguara; kund. prolog. Epilogu i romanit (i dramës).*

*Situata e ndodhur si përfundim, konkluzion I nxjerrë...*

2. Cilit i drejtohet poeti në poezi? Gjени disa nga fjalët me të cilat i thërret dhe që e etiketon atë. Kryeqytetit, Parisit

*I fjetur qofsh, në ag i shtrirë gjithë përtaci,*

*I rëndë, i terratosur, me rrufë a i ngrefosur*

*Të dua, ashtu si je, o horr kryeqytet!*

3. Zgjidhni një nga alternativat dhe gjykoni mbi zgjedhjen tuaj. Qëndrimi që mban Bodëleri ndaj qytetit është:

- mohues, se Parisi atë e ka braktisur
- pajtues, se është i pafuqishëm vetë për t'iu imponuar kryeqytetit
- dualist, se Parisi është bukur, dashuri djallëzore
- **adhures, se Parisi është shpirti dhe vetë thelbi i një francezi?**

4. Në poezinë e Bodëlerit, cila është figura kryesore që ai përdor? Nisur nga kjo, Bodëleri, është përfaqësues i: Epiteti

- Realizmit
- **Simbolizmit**
- Natyralizmit
- Romantizmit?

5. Simbolistët kërkojnë që poezia të ngacmojë shqisat. Cilat shqisa tuaja ngacmon kjo poezi? Ilustroni përgjigjen me vargje a fjalë të poezisë.

**Shqisën e të parit:** *duket i shtrirë skaj më skaj Spitali, purgatori, bordello, ferri, burgu,*

**Të shijes:** *të dehem thumb/Prej mishit skëterror të saj të ndizem flakë.japin shpesh ca ëndje*

**Prekjes:** *spërkitur me flori,mishit skëterror*

6. Ç'detaje sjell poeti për ta parë Parisin si burim të *splin*-it të tij? Ç'kuptime fshihen nën to? Ilustrojeni mendimin tuaj.

Fjala angleze *spleen* emërton një lloj mërzie të pashërueshme që zgjat pafundësisht. Me këtë kuptim nuk ka fjalë as në shqip as në frëngjisht.

*marrëzia e njerëzve, satan, zot i brengës, dehem thumb, prej mishit skëterror të saj të ndizem*

7. Te çdo njeri apo te çdo gjë që na rrethon, a gjendet si e mira dhe e keqja? Si e kuptoni lidhjen e poetit me Satanin *si Zot të brengës së tij*? A ju duket e çuditshme kjo mënyrë e emërimit të *Satanit* si *Zot*?

*Tek çdo njeri, tek çdo gjë që na rrethon gjendet si e mira ashtu dhe e keqja dhe tek njeriu splin (spleen) satani është zot.*

8. Me cilën e krahason poeti kryeqytetin? Për të, cili është personifikimi i këtij qyteti, që dashur pa dashur e tërheq pas vetes?

*Me horrin*

9. Në vargun *“Ku marrëzia ... si një lumnajë”*, ç’kuptim ka krahasimi me lumnajën, ndërsa ai vendos *marrëzinë e njerëzve*, përballë fjalës *lumnajë*? Cili është interesi i këtij krahasimi, lidhur me qytetin që e tërheq pas vetes, me gjithë të metat e tij?

*Ta shuajë mërzitjen, nuk vonon dhe e zbukuron gjendjen, kërkon ta kalojë, përpiqet të gjejë diçka të mire. Pavarësisht të gjithave, e do.*

10. Parisi është kryeqyteti i atdheut të poetit. A e mishëron ai të *Bukurën*? A është ajo e *Bukura* që përkufizon estetika simboliste?

*Për simbolistët, vetëm poezia është art, të tjerat janë veç letërsi. Si e tillë poezia shpreh dhe i shërben së Bukurës, ndaj ajo s’ka të bëjë me moralin, me politikën, me filozofinë. Vlerat dhe shërbimet e saj janë vetëm estetike.*

### C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

#### **Diskutim mësimor:**

1. Poeti e sheh Parisin si dashnore. Pse ajo nuk është femra e ndershme për të? Cili është kuptimi që i jep autori qytetit dhe si e shihni ju lidhjen tuaj me kryeqytetin tuaj? A është ai një qytet-sfinks modern, i ngjashëm me Parisin e Bodëlerit?

2. Cili është koncepti juaj për të *Bukurën*? Diskutoni rreth saj, si dhe sillni shembuj të ndryshëm që ju i përfshini tek e bukura.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit simbolik.

#### **Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur:**

Nisur nga diskutimi i zhvilluar mbi raportin tuaj me kryeqytetin e vendit tuaj, bëni një ese me titullin: *“Tirana që unë dua”*.

Detyrë për disa nx. Të interpretojnë prozat poetike dhe poezitë.

PLANIFIKIMI DITOR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Letërsi</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: XI</b>
<b>Tema mësimore –Proza poetike dhe lexime të tjera, Bodëleri</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit :</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evidenton disa nga tiparet e poezisë së Bodlerit</li> <li>• vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.</li> <li>• Reflekton mbi marrëdhëniet reciproke të bodlerit me botën që na rrethon</li> <li>• vlerëson poezinë universale të Bodlerit</li> <li>• reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>• demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin.</li> </ul>			
<b>Fjalë kyçe:</b>	<b>Burimet dhe mjetet mësimore:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• njeri i mistershëm</li> <li>• floknaja jote</li> <li>• të vuash pambarim</li> <li>• t’i largohesh bukurisë</li> <li>• si engjell</li> <li>• unë jam perandori</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti shkollor,</li> <li>• Veprat letrare (mund të sigurohen nga Biblioteka e shkollës),</li> <li>• Interneti</li> </ul>		
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhë shqipe, Histori.	<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Interpretim i prozave poetike</i>		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> PNP-Bashkëbisedim, Interpretim, <i>Diskutim, shkrim i lirë.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

**A. Lidhja me njohuritë e mëparshme**

***Bashkëbisedim:***

- Lexoni fragmentet e mëposhtme dhe nxirrni në pah disa nga tiparet e poezisë dhe prozës poetike të Bodlerit.
- Cili është raporti i tij me botën që na rrethon? Me cilët arrin të krijojë marrëdhënie më të mira?
- Pse Bodëleri cilësohet si poet *i mallkuar* apo *i nëmur*? Çfarë kuptoni me termin “*bohem*”?
- Ndaluni te pjesa “*I huaji*” dhe analizoni “*dashuritë*” e Bodlerit. Si e kuptoni relacionimin e tij me gjithçka përreth?
- Lexoni citimet mbi autorin dhe i diskutoni domethëniet e tyre

**B. Ndërtimi i njohurive të reja**

***Interpretim:***

*Krijohet atmosferë në interpretimin e prozës poetike e poezive të Bodlerit*

Mësuesja ka përgatitur në video-projektor një grup vlerësimesh nga autorë të ndryshëm për veprën e Bodlerit. Ose me flipchart

Disa prej tyre nxënësit i kanë edhe në tekst.

Shfaqen thëniet dhe komentet një nga një dhe nxitet diskutimi i nxënësve për thënien, veprën dhe aktualitetin e veprave. .

Qëllimi është të vendoset theksi te vlerat aktuale dhe universale që ka kjo vepër.

**Diskutim:**  
**Shembulli 1**

“Bodëleri nuk ishte vetëm poeti i epshit, i ankthit, trullosjes dhe vdekjes. Ai ishte gjithashtu kritik me një inteligjence të mrekullueshme. Në një epokë kur gjenia e Ëagner -it ishte e panjohur, ai e zbuloi dhe lavdëroi veprën e tij. Po ashtu, ishte ai që adhuroi e mbrojti disa piktorë të cilëve u përkiste e ardhmja, të tillë si : Delacroix, Courbet, Manet dhe Cézanne.”

Jean d’Ormesson (akademik francez)

Pasi diskutohet për kritikën e ndryshme të veprës mësuësja shkruan në tabelë:

- Shprehni mendimin dhe ndjenjat tuaja për veprën duke argumentuar pse: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Shkrim i lirë:**

**Perceptim** titullohet detyra. Tani ti je një Bodler krijoni pak vargje lidhur me pikturën



**Vlerësimi:**

Nxënësi vlerësohet për interpretimin, pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë e përgjigjeve, pyetjet që ndërton, qëndrimet, argumentet, analizat dhe interpretimet.

**Detyrë shtëpie dhe punë e pavarur: Nën tingujt e poezisë së Bodlerit ( pikturë, poezi etj.)**

## TESTI 1 FRAGMENTI *BURGU* NGA VEPRA “FAUSTI” I GËTES

**Përgjigjet me qarkim:**

1 – B / 2 - D / 3 - C / 4 - B

**Përgjigje 5:** Margarita përjeton 2 gjendje të kundërta. Më së shumti ajo është jonormale, është nën pushtetin e ankthit e të makthit. Por dhe kthjellohet e bie në realitet, bëhet normale, e arsyeshme dhe eqartë në komunikim.

Gjendja e parë lidhet me brengën që e gërryen, fëmijën që mbyti dhe nënën e vëllanë që vdiqën prej saj. E dyta lidhet me dashurinë për Faustin. Gjithçka tek ajo është shembur e shkatërruar, përveç dashurisë. Por dashuria e Margaritës është fatale. Ajo është e paracaktuar të mos realizohet.

- Koha në të cilën lidhen është sa shkuara, aq dhe e tashmja.
- Këto gjendje këmbëjnë njëra-tjetrën në mënyrë shumë të natyrshme, aq sa nuk ndjehen. Kjo falë mjeshtërisë artistike të Gëtes, i cili gërsheton monologët tronditës me dialogë akoma më tronditës.

**Përgjigje 6:** Fausti është në gjendje shumë të rënduar shpirtërore. Ai e deshi Margaritën dhe ndjehet me faj për ç’ka ndodhur me të. Vuajtja e tij nuk ka përmasat thjesht personale. Ai jeton “brengën e gjithë njerëzimit”

*Fjalët kyçe:* tmerr, brengë, druan, ke frikë, drithma, pushton.

*Mjeti artistik:* monologu tronditës.

**Përgjigje 7:** Në atë gjendje çmendurie Margarita diku thellë e kap realitetin. Atë e vret ndërgjegjja aq shumë, sa e dëshiron vdekjen. Është e bindur se për vrasësin s’ka shpëtim.

Vargjet: Po si nuk të vjen frikë ty prej meje?

A nuk e di, o shpirt, kë po liron?

Nuk mund; për mua s’ka më shpresë.

Jo, dashuria për Faustin nuk mund ta ngushëllonte Margaritën. Mbytja e fëmijës është akt krimi. Nëna- vrasëse e foshnjës së vet, nuk mund ta mbushë varrin e hapur me dashurinë e një burri, qoftë ky dhe babai i fëmijës. Ajo as që ka më forca të dashurojë.

E përse t’iki?

Kudo të vete, do t’më ndjekin...

S’dua me pahir!

Me duar prej katili mos më prek.

**Përgjigje 8:** Detajet: 1. Prishja e kurorës së nusërisë;

2. Lulet e shpërndara;

3. E bukur isha.

Në vargje mbi të gjitha shfaqet dashuria e madhe e Margaritës për jetën (lërmë të jetoj/ akoma jam e re/ dhe duan të vdes që tani/ falma jetën).

**Përgjigje 9:** Për ta dhënë sa më mirë këtë gjendje Gëte “luan” me metrin e vargjeve. Vargjet happen, zgjaten, kur ajo bie në të dhe shkurtohen, ngushtohen. Kur atë e pushton dhimbja e ankthi e kalon në gjendje të çmendur, atëherë i zgjohet tmerrri i asaj që bëri me duart e veta.

**Përgjigje 10:** Në vargun e parë ka dhanore etike. *Funksioni* i saj është: bie mbi vetë Margaritën veprimi, pasoja. (mua më – atë e) afrohet e bëhet bashkëvuajtëse – dashuria paska qenë e saj.

Të dy vargjet janë pyetje retorike mbi metafora folje: humbur/vjedhur.

**Përgjigje 11:** Në vargje antiteza vë përballë dy çaste kulmore të jetës së njeriut:

a) dasmën- si realizim ëndrrash, dashurie, çast lumturie, plot jetë.

b) vdekjen – si fundi i gjithçkaje, fund i jetës, çast trishtimi, dhimbjeje. Nuk është vdekja për

Margaritën.

Vargu i fundit- përmasat e jashtëzakonshme, rrokin botën mbarë, njerëzimin, tokë e qiell - e ka paracaktuar fatin e Margaritës?

Krahasimi me varrin është drithërues. Ajo që po ndodh është ideja e varritafrohet, bëhet aq i prekshëm në nëntekstine asgjësë (Edhe pse Margarita është fetare).

**Përgjigje 12:** Stili është tragjik, elegjiak, se autori i jep rrugë dhimbjes dhe vajit për një jetë të fikur pa filluar, për ëndrrat e shkatërruara,

Një vdekje që vjen me drithërima e tmerre- me djaj, xhelatë, kokë të prerë...

Një vdekje e trishtim për atë që meritonte këngë djepi.

Nxito! Nxito!.../ Po lermë t'i jap sisë foshnjes...e vrava unë.

Stili është elegjiak sepse vuajtja, dhimbja shpirtërore, përjetimi i krimit, ankthi, makthi, ndërgjegjja që vret njeriun që e desh aq shumë jetën, nuk mund të shprehen me tjetër stil.

## TESTI 2 FRAGMENTI RRËMBIMI I ESMERALDËS NGA VEPRA “KATEDRALJA E PARISIT”, VIKTOR HYGO

**Përgjigjet me qarkim:**

1-C/

2-D/

3-C/

4-B/

5-B/

6-C

**Përgjigje 7:** Turma është një masë amorfe që ndërron formë. Qëndrimi i saj është i njëjtë, se ajo udhëhiqet nga instiktet dhe reagon nga kthesat e menjëhershme që marrin ngjarjet.

Instikti i turmës lidhet me idenë e mbrojtjes së një viktime të pafajshme, prandaj ajo brohoret bashkë me Kuazimodon.

- Raporti i turmës me Kuazimodon është sa në kontrast, aq dhe në paralelizëm.

**Përgjigje 8:** Kuazimodoja provon ndjenja të skajme. Në krye - gjendje të rënda në kulm: dëshpërimi për Esmeraldën e trondit në ato përmasa, sa e bëjnë të nxjerrë nga vetja fuqi të jashtëzakonshme fizike dhe shpirtërore, të bëjë veprime të paimagjinuara më parë (koka si e luanit).

• Së dyti, më pas, ai përjeton një gjendje ngazëllimi, triumfi, krenarie, lumturie që arrin kulmin kur Hygoi thotë: “...në atë çast...vërtet i bukur...”.

- Gjendja e Kuazimodos jepet e përshkallëzuar deri tek ideja e mbrojtjes me çdo kusht.

(dashuri, dhembje, përkushtim, dhembshuri, përkujdesje, ngrohtësi, mbrojtje)

**Përgjigje 9:** ...syrin e vetëm ... shndriste / syri prej ciklopi ... duke lëshuar shkrepëtimë - detaj shumë i gjetur Syri, për Kuazimodon është armë që ai e përdor për të:

a) ledhatuar, adhuroar e shprehur dashurinë për Esmeraldën

b) dënuar, goditur, qëlluar apo dhe vrarë ata që dënuan Esmeraldën, si dhe turmën.

**Përgjigje 10:** Po ishte i bukur ...

Artistikisht fjalia është realizuar me: 1- kontrastin: Kuazimodoja njeri përballë tigrave kafshë, me epitete: i neveritur, të madhërishtëm; me enumeracion: jetim, fëmijë i gjetur, njeri i neveritur, apo shkallëzim: ata tigma, ata gjyqtarë, ...xhelatë, tërë atë forcë të mbretit.../ me frazeologji: drejt e në sy / i kishte rrëmbyer prenë / i kishte lënë me gisht në gojë... (si metafora)

**Përgjigje 11:** Pavarësisht nga kontrasti i thellë Hygoi i barazon duke i quajtur të përbuzur, të mjeruar. Shkaktarë të gjendjes së tyre janë po ato: a) natyra (fati); b) (shoqëria)

- Ajo që i bashkon është fakti që ato mishërojnë fatin e individit të braktisur, të lënë në mëshirën e fatit apo të të pushtetshmeve. Te të dy, mjerimi, së pari, është shpirtëror. Të dy kanë zemër të madhe, të dyve u mungon dashuria, mbi të dy shoqëria ushtron dhunën e saj: njërin e përbuz për shëmtinë, pa pyetur se ai është i pafajshëm, tjetrën, pradoksalisht, për bukurinë, pasionin, shpirtin (se s'mund t'ia arrijë).

- Pranë njëri-tjetrit ata ndjehen mirë pikërisht prej asaj që kanë “status të njëjtë”.

• Hygoi demokrat gjithnjë i sheh virtytet e larta, sjelljet e bukura dhe shpirtin e pastër e të dliër te njerëzit e thjeshtë e të vuajtur.



**Përgjigje 12:** Veçori të romantizmit:

- 1- kthesat e papritura
- 2- e jashtëzakonshmja
- 3- kulti i ndjenjës (përshkrimi i botës së ndjenjave dhe shqetësimeve të brendshme)
- 4- kontrasti

## TESTI 3      FRAGMENTI VAJZA E SARAGOZËS NGA VEPRA “UDHËTIMI I ÇAJLD HAROLD”, XHORXH GORDON BAJRON

**Përgjigjet me qarkim:**

- 1- A      2-C      3-A      4-C

**Përgjigje 5:** Figura: inversion. Zhvendosja synon të theksojë mbiemrin e emëruar *spanjolja*, për të shprehur vlerësimin plot respekt për popullin liridashës të Spanjës, që lind e rrit bij të tillë, si vajza e Saragozës.

**Përgjigje 6:** Detaji: *kitara*, si simbol i këngës dhe i dashurisë për jetën, simbol i gëzimit dhe haresë.

Nënteksti: Vajza la mënjanë dashurinë e saj (*për jetën, për djalin..*) jetën e saj të bukur për hir të atdheut, të detyrës ndaj tij, e bindur se, kur armiqtë rrëmbejnë tokën tënde, pronën dhe të shkëlin nderin, nuk mund të jetosh e të gëzosh lumturinë vetjake.

**Përgjigje 7:** Portretin e vajzës, Bajroni e bën përmes epitetesh dhe krahasimesh (*e lehtë, t'ëmbël, e zes, posi mëndafshi, si selvi, si të zanës...*); përmes enumeracionit: *zënë, sytë, gërshetat, shtatin, hiret.*

Portreti i vajzës bart mbi vete të Bukurën në dy plane:

a) atë fizik b) atë të brendshëm, moral, shpirtëror

Portreti fizik flet për një vajzë aq të bukur, ai i brendshmi flet për forcë, guxim, trimëri të pashoqe (*mishëruar në një trup, fizik e cilësi të butë, të ëmbël, fin, elegant..*)

**Përgjigje 8:** Vargjet 5-9 janë në marrëdhënie varësie me vargjet 1-4 dhe, ndërkohë, ato plotësojnë me radhë ç'u tha në vargjet 1-4 (këta të fundit ngrihen mbi antitezë). E veçanta qëndron në atë që tani nuk operohet me antitezë, por me pyetje retorike, të cilat përforcojnë idenë se vajza, duke sakrifikuar dashurinë, gëzimin e vet, duke duruar dhimbjen e humbjes se të dashurit, shpalos shpirtin vetëmohues e trimërinë e popullit të thjeshtë.

**Përgjigje 9:** Vargjet: strofa 57 (vargjet 7,8,9), strofa 58 (vargjet (8,9)). Realizon *kontrastin*, raport kundërshtie (*vajza e Saragozës përballë grave të salloneve aristokratike*).

Vajza e Saragozës qëndron më lart në forcë, butësi, shpirtmadhësi, përballë grave në Veri (të varfëra në shtat, të mekura, të verdha - pa frocë, pa jetë. Bajroni është me njerëzit e thjeshtë e të virtytshëm.

**Përgjigje 10:** Elemente nga mitologjia: Febi, Gorgona, Amazona, (mit. gr); Marsi, Minerva (mit. romake); zana (mit. shqiptare). Domethënia lidhet me prirjen e romantikëve për nga krijimtaria gojore popullore dhe adhurimi i kulturës së lashtësisë.

**Përgjigje 11:** Viza zëvendëson lidhëzën kundërshtuese *ndërsa, kurse*.

-ajo ahkakton asindet, ngjesh vargun;

-viza ndan dy pjesët e një mendimi-vargu dhe shërben për të ndërtuar *antitezën*; -pjesa e dytë e secilit nga 4 vargjet shërben përtë vizatuar qëndresën, heroizmin, ndjenjën e lartë të detyrës e të përgjegjësisë së saj ndaj atdheut të dashur. nëse i shohim vertikalisht, në të dy krahët shfaqet *shkallëzimi ngjitës*.

**Përgjigje 12:** Karakteri i vajzës ka ndryshuar. Ajo është lartësuar. Krahasuar në dy kohë (e tashme, e

shkuar), ajo është rritur, trimëruar, ka kuptuar se njeriu s'vlen, nëse *sheh e kujdes* vetëm vetveten (*ajo që trembej nga një shejë plage, ajo që zverdhej e frikësohej nga vaji i kukuvajkës... tani me çap Minerve, shkon atje ku Marsi do të dridhej- hiperbolë*). Motivi i ndryshimit është i lidhur me ndjenjën e lartë të detyrës të përgjegjësisë për fatet e Spanjës, nënës së saj të shtrenjtë.

**Përgjigje 13:** Tipare të romantizmit

- heroi romantik – i kundërvihet realitetit në emër të lirisë
- hinnizim i vlerave liridashëse të popullit
- paraqitja dhe adhurimi i popullit – kur vajzën e ngre në mishërim të heroizmit e të trimërisë popullore
- kulti i ndjenjës

**Përgjigje 14:** Pyetja retorike si figurë e shqiptimit poetik - është e shpeshtë. Intonacioni pyetës krijon një situatë të veçantë emocionale. Përmes saj jepet një pohim i madh dhe nxitet përfytyrimi ynë. p.sh. *Ç'vajzë u jep zemër burrave të trembur?/ Kush iu vërsul më rreptë Galit n'ikje/ I mundur nga një grua përgjesh të rrëzuar?*

Pyetja retorike i jep vargut ngarkesë emocionale; tërheq vëmendjen e lexuesit; tregon habi për një gjë të rrallë apo të pazakontë: një vajzë më trime se burrat, që prin në luftë burrat që kacafytet me vdekjen dhe triumfon.

## TESTI 4      FRAGMENTI NJË SHPIRT I TRAZUAR (KËNGA XVI) NGA VEPRA “KËNGËT E MILOSAOS”, JERONIM DE RADA

**Përgjigjet me qarkim:**

1-B    2-C    3-D    4- A    5- C    6- A

**Përgjigje 7:** Kënga ka dy pjesë (ndahen me pyetjen e Milosaos për Erën)

**Në pjesën e parë**-heroi i sapozgjuar e do Erën sepse

- ajo e ngroh, e përkëdhel e ia kënaq shpirtin (e zgjon bukur ajo)
- e do atë se mendon se është era e mëmëdheut, që i sjell aromën e tij, aty në vend të huaj tek ka shkuar të luftojë për liri.

Në këtë pjesë Milosaosja është i qetë, e adhuron natyrën (ilustrimi).

**Në pjesën e dytë** – heroi shfaqet i shqetësuar. Është larg. Ka mall për gjithçka, veçmas për Rinën. Shqetësimin e shpreh pyetja e Milosaos. Gjendja e tij shpirtërore rëndohet pas përgjigjes së Erës. Kjo shkon deri aty, sa ai i hakërrehet Erës, e dëbon duke e quajtur bushtër. Fjalët e saj e lëndojnë aq keq, sa i ngrijnë (metaforikisht) dhe eshtrat, (ndryshe i akullojnë ndjenjat e i trondisin besimin tek dashuria).

**Përgjigje 8:** Era, e shpirtëzuar **luan rolin e një personazhi**. Perceptimi i saj nga Milosaosja është pozitiv në krye-gjë që shprehet në urimin e tij: *Rrofsh...Ajo e kënaq me freskinë dhe ëmbëlsinë e saj. Më pas, Era shndërrohet në personazh negativ për Milosaos, kështu e percepton ai, deri kur e shan dhe e dëbon.*

- Jo, nuk është era në natyrë ajo që e trazon Milosaosin. Mjeshtëria artistike bën që ulje-ngritjet e brendshme të heroit, i ftohti dhe i ngrohti që përplasen brenda tij, të marrin formën e erës së personifikuar. **Është ndërgjegjja e bërë lëmsh ajo që krijon Erën tek Milosaosja.** (Ka shkuar të kryejë detyrën, por mendjen e ka te Rina-malli, xhelozia...)

**Përgjigje 9:** Në 6 vargjet e para natyra përshkruhet nga autori. Si romantik, ai e adhuron atë e nuk

mund ta lërë jashtë jetës së heroit. Raporti që ndërton autori (nga këndvështrimi i Milosaos) është pozitiv e përcjell dashuri, adhurim për natyrën.

**Figurat**-nis të shfaqet shpirtëzimi, që do të plotësohet më pas.

- **Tipike për De Radën është inverzioni** (*ëmbël ma dheli fytyrën..*)

**Përgjigje 10:** Dialogu është një mjet artistik që mundëson më mirë se rrëfimi e përshkrimi paraqitjen e një situatë emocionale e psikologjike të nderë, të tensionuar; paraqet më me forcë dallgëzimet e ndjenjave, kulmet e dallgëve që karakterizojnë heroin në këto çaste.

**Përgjigje 11:**Në vizatimin e Rinës (me gojën e Erës) poeti vë në pah këto tipare:

1. fodulle (mendjemadhe, e ka veten në qejf..)

2. shumë e gjallë, madje e shkujdesur që nuk përmbahet e nuk e kontrollon veten

3. në këto dy tipare shfaqet e bukura provokuese, ngacmuese që të trazon.

-pamja e jashtme e plotëson këtë me katër detaje: 1.fustani 2.gjiri 3. flokët 4. sytë

- **Po, ka ndonjë pikë takimi**, si bukuria fizike me elementin sensual të gjirit. Por këtu nuk është Rina e drojtur, e turpshme.

-elementet gjuhësore-**foljet**..

-figuracioni-mendoj se nga enumeracioni shkohet në **shkallëzim ngjites** (sytë-si pasqyrë e shpirtit)

**Përgjigje 12:** Veçori të romantizmit në fragment:

a. heroi romantik, me një botë të trazuar shpirtërore, në kërkim të dashurisë, paqes apo lumturisë.

b.Kulti i natyrës c. kulti i ndjenjës

d. kontrasti i gjendjeve, si figurë tipike e romantizmit.

**Përgjigje 13:** *Fëshfërin // shpupuris*

Roli që luajnë fjalët onomatopeike është në funksion të muzikalitetit të vargjeve (fjala bëhet muzikë). De Rada e ka këtë qëllim dhe veprën ka arritur ta bëjë me muzikalitet të ndjerë dhe shumë të prekshëm.

## TESTI 5 FRAGMENTI XHA GORIOI DHE TË BIJAT NGA VEPRA “XHA GORIO”, HONORE DE BALZAK

**Përgjigjet me qarkim:**

1-B/ 2-C/ 3-B/ 4-D/ 5-C/ 6-A/ 7-D

**Përgjigje 8:** Fragmentin e bën dramatik:

a) raporti armiqësor mes vajzave-motra, mungesa e dashurisë, cinizmi, fjalori i ulët e toni i ashpër; b) qëndrimi i vajzave ndaj të atit: duke vënë maskën e bijave të mira e të dhembshura duan të përfitojnë sa më shumë nga ai; c) vuajtja dhe shqetësimi i singertë i Gorioit për pamundësinë që ka për t'i ndihmuar vajzat/ ai pranon të bëhet kriminel, deri edhe të vdesë; d) zgjedhja e ligjërimit – si dialog i tensionuar, tronditës, në një frikë kulmore – ku shpaloset shthurja e familjes /dialog si në veprat dramatike.

**Përgjigje 9:** Në thelb është monolog; shpalos vuajtjen e tronditjen e brendshme të xha Gorioit. Gorioi e gjykon shumë rreptë veten. Ai e gjykon veten me fjalët: varfanjak, i mallkuar, më i lig se qeni – në shkallëzim – Fjalja: “S’jam më i zoti për asgjë, s’jam më baba, jo.”

**Përgjigje 10:** Gabimi i Gorioit është shumëplanësh:

1. Gorioi është egoist në dashurinë e tij, se ushqen dashuri të njëanshme;

2. ka kuptim të gabuar për dashurinë;

3. s'i edukoi fare të bijat.

**Përgjigje 11:** Toni i motrave me njëra-tjetrën: armiqësor, cinik deri në fyerje e poshtërim – *ti s'më ke dashur kurrë/ më ke bërë hasha/ gjithnjë e ligë si floriri ke qenë/ ti je kuçedër.*

- Toni i xha Gorioit ndaj vajzave: i butë, i ëmbël, lutës, përgjërues.

Ndryshimi shkakton kontrast. Toni i vajzave përcaktohet nga gjendja e rivalitetit të përhershëm mes tyre, nga mendjelehtësia dhe shkëputja e lidhjeve të dashurisë; ato nuk ndjehen motra.

Toni i Gorioit përcaktohet nga ndjenja e dashurisë e kthyer në pasion shkatërrimtar dhe nga dëshira e sinqertë për një familje të vërtetë.

- Ilustrimi i Gorioit:
  - Pushoni, bijat e babait!
  - Bijat e babait, përqafohuni, bijat e babait!
  - Ju jeni dy ëngjëj ... duajeni njëra-tjetrën ...

**Përgjigje 12:** *-e ligë si floriri*  
*- një bukuri të pashpirt*

Këto figura ngrihen mbi paradokse. Krahasimi me floririn, në përmbysje kuptimi, shprehje e vetëdijes për rolin shkatërrues të parasë (etjes së pakufi), edhe pse duket e thënë instiktivisht.

Tek e dyta, epiteti metaforik e përmbys kuptimin e të bukurës që tradicionalisht lidhet me të mirën dhe pozitiven, këtu bëhet negative.

## TESTI 6      FRAGMENT NGA PJESA II, KAPITULLI XV VEPRA “ZONJA BOVARI”, GUSTAV FLOBER

**Përgjigjet e vërtetë e gabuar:**

- 1- b dhe c janë të vërteta (të tjerat të gabuara)
- 2- a dhe d janë të vërteta (të tjerat të gabuara)
- 3- b është e vërtetë (të tjerat të gabuara)
- 4- c është e vërtetë (të tjerat të gabuara)
- 5- b është e vërtetë (të tjerat të gabuara)
- 6- c është e vërtetë (të tjerat të gabuara)

**Përgjigje 7:** Në kuptim të parë, në provincë, një shfaqje (opera) është një ngjarje e rëndësishme. Por në veçanti, për Sharlin, shfaqja është një mënyrë, një ngjarje që mund t'i bënte mirë Emës (e dërrmuar, e sëmurë) dhe së dyti, shfaqja do ta bënte të merrte vesh një ngjarje (të zakonshme), edhe pse ai s'kishte zotësi të rrokte thelbin e saj; ai nuk e sheh atë si art që rrezaton vlera estetike. Ai është i pandjeshëm në këtë anë.

Për Emën, ishte një ngjarje që ia thyente monotoninë e përditshmërisë (*asaj i rrahu zemra, me të hyrë... U gëzua si fëmijë...*); ishte ngjarje që e bëri për vete, e bëri të përjetojë emocione të forta, të shijojë, të kënaqet, të përjetojë ndjenja e mbi të gjitha, të ëndërrojë. Ema e do artin, ajo është ushqyer me letërsi që në moshë të re.

**Përgjigje 8:** Në fragment Ema jepet si femra që e do jetën, që ka etje për jetë të bukur e të mbushur. Pavarësisht nga gjendja fizike e saj, arti, vepra që do shfaqej ia zbulon më qartë tiparet e gruas, të femrës që ëndërron e ëndërron pafundësisht, të femrës që i mungon dashuria. Është e qartë në fragment që Ema ka mbetur po ajo romantikja e pandreqshme, që vazhdon ta dojë (dëshirojë) jetën si në libra (*ajo u gjend sërish në botën e librave të rinisë... Emës ia kishte qejfi të...*). Zhgënjimet e njëpasnjëshme nuk kanë mundur ta zbresin Emën në tokë. Ajo zhgënjehet dhe prapë ëndërron, prapë zhgënjehet e prapë ëndërron. Ema nuk di të bëjë kompromis me jetën dhe të përshtatet me të.

**Përgjigje 9:** Fragmenti na paralajmëron për një fund të hidhur të Emës. Kjo për faktin që goditjet

që i kishte dhënë jeta herë pas here, s'kishin mundur ta mësonin atë; ajo nuk ka mësuar nga pësimet. Përderisa ajo mendonte e ëndërronte të vrapojë e të hidhet në krahët e dashurisë, ëndërronte dhe përfytyronte jetë të bujshme, të jashtëzakonshme, të shkëlqyer pra *ëndërron të pamundurën*, kjo do të thotë se fundi i saj do të jetë trishtues, në mos i rëndë e tragjik (duke patur parasysh dhe kohën kur jetoi ajo). Fragmenti të bën të kujtosh ëndërrimet e Emës së sapomartuar, prej së cilave ajo s'është shkëputur.

**Përgjigje 10:** fjalët kyç: *jetë/ të bujshme/ të jashtëzakonshme/të shkëlqyer/ përfytyronte/ do të kishte udhëtuar/ të vraponte/ dashuri/ ëndrrat.*

Emë ka nevojë të ëndërrojë se duke ëndërruar ajo mbush boshllëkun shpirtëror që nuk ia plotësojnë dot as mjedisi, as Sharli, as dashnorët; ëndërimi e shkëput nga realiteti i zbrazët dhe mediokriteti i provincës.

**Përgjigje 11:** Në fragment rrëfen autori. Aty ka pak dialog dhe ndërrohet veta III në të parë, kur Floberi na sjell zërin e brendshëm të Emës. Në ato fjalë ne rrokim dëshirën-ëndërr të Emës për t'u arratisur nga realiteti që po e mbyt dalëngadalë. Fjalët i dallon një ton i shqetësuar lutës, përgjërues, toni i vetë shpirtit që vuan e s'gjen qetësi.

Gjuhësisht në urdhërore + trajtën e shkurtër *më/ me* lidhore. Rolin e luajnë foljet brenda një fjalie me gjymtyrë homogjene.

**Përgjigje 12:** Emë është njeriu që e gjen kudo dhe kurdo. Ajo është jashtë kohës e realitetit, por pjesë përbërëse e tyre. Nuk është keq të ëndërrosh, përkundrazi, ëndrra e nxit përpara njeriun. Problem qëndron se çfarë ëndërrojmë.

**Përgjigje 13:** Tipare të artit të Floberit në fragment:

- trajtimi i shpirtit njerëzor me paanshmëri
- objektiviteti dhe impersonalizmi
- tema e përditshmërisë
- imagjinata e fuqishme
- ironia e fshehur

## TESTI 7      FRAGMENT NGA VEPRA “VËLLEZËRIT KARAMAZOVË”, FJODOR DOSTOJEVSKI

**Përgjigjet me qarkim:**

1- B ;      2- C ;      3- C ;      4-D ;      5-D ;      6-B ;      7- C ;

**Përgjigje 8:** Tiparet e botës shpirtërore e mendore të Grushenkës në fragment janë:

Grushenka- një ngërthim kundërshtish, zbulon, përmes të folurit të vet, vetveten, përjeton me zjarr situatë të ndezura, jeton si në jerm, mishëron filozofinë e vuajtjes e të sakrificës, ka dashuri për jetën, dashuron me zjarr, ndien dhimbje për të varfërit. Tërë këto tipare e bëjnë atë heroinë dostojevskiane.

**Përgjigje 9:**

α) E shfaqin veten duke folur

β) Në situatë të tendosura, kur ata ndizen flakë

Ilustrimi: “Ti më puth, më puth fort, ja kështu...Më puth! Më rrih...ma merr shpirtin...”

**Përgjigje 10:**

Grushenka është personazh i një pene realiste që bart vërtetësi. Ajo e do me zjarr. Me passion Mitjan. Ndjenja e saj është shpërthyesë, s'ka gjë që ta përmbajë. Ajo sheh tek dashuria ndjenjën që do

t'ia shërojë shpirtin e vrarë nga fyerja dhe poshtërimi. Ajo pranon dhe dëshiron vuajtjen në emër të dashurisë së vërtetë. Ajo e sheh veten të lidhur në vargonjtë e vuajtjes, të dashurisë dhe të besimit e faljes (Njeriu mund të bëhet i mirë).

Përkundër saj, Esmeralda mishëron bukurinë fatale; ajo dashuron në mënyrë të njëanshme; dashuron pa u futurë thellë botës së tjetrit. Febysi për të është i bukur e i mirë. Ajo është më afër me Emën- të dyja romantike, por njëra viktimë e të tjerëve, tjetra më shumë e vetvetes, e ëndrrave të veta. Margarita dashuron singërisht, me tërë fuqinë e zemrës, pa menduar për pasojat, në gjithçka është provinciale, sepse e sheh dashurinë si rrugë drejt martesës e krijimit të familjes.

Grushenjka di të dalë nga fundi ku është katandisur, ajo nuk pranon poshtërimin, është vepruese, e fuqishme e jo si Esmeralda që e lë veten në duar të të tjerëve; nuk bën krim në emër të ndjenjës, si Margarita; nuk shkon drejt vetëvrasjes dhe as është egoiste, si Ema. Ajo është e bindur se duke vuajtur ajo pastron dhe lartëson shpirtin e vet, se vuajtja e fisnikëron njeriun.

### Përgjigje 11:

**Fjalja:** “Të bëhet ç’të bëhet! Për një minutë të vetme, gati jam gjithë botën ta fal!”

**U bë vrasës në emër të pasionit dashuror.**

**Ideja e Dostojevskit:** Paradoksalisht, pasioni lind edhe krimin dhe madhështinë.

**Përgjigje 12:** Dostojevcki synon të na japë një përfytyrim sa më realist dhe psikologjik të personazheve.

Ilustrim 1:

Ilustrim 2:

**Përgjigje 13:** Janë fjali të thjeshta, të pazgjeruara, të paplota (kryefjala mungon). Kanë karakter thirrormor, të pashprehur me pikësim, janë me intonacion pyetës, gati retorike, janë pyetje pa përgjigje. Kanë ritëm të shpejtë, të nxituar.

Situatë është e elektrizuar, gjendja e Grushenkës është e tronditur deri në thelb, e prekur, e tensionuar. Forma e fjalive është aq e përshtatshme. Ato japin ritmin e ndjenjave që përjeton Grushenjka, ritëm i shpejtuar.

### Përgjigje 14:

**Fjalja:** “Vetëm një ndjenjë fikse, përvëluese, aq fort përndjekëse nuk lndahej për asnjë çast, i rrinte “si thëngjill përvëlues në shpirt”, kujtoi më pas.

**Ndërtimi:** fjali e përbërë me marrëdhënie bashkënditjeje.

**E veçanta:** gërshetohet në të ligjerata e drejtë me të zhdrejtën, sepse në të flet dhe autori dhe Mitja. Theksi logjik bie mbi krahasimin “si thëngjill...”.

## TESTI 8 POEZIA *SPLIN* (*SPLEEN*) NGA VEPRA “LULET E SË KEQES”, SHARL BODËLER

### Përgjigjet me qarkim:

1 – C

2 – C

3 – B

4 – A

**Përgjigje 5:** Gjendja shpirtërore e poetit-hero është gjendje *splin*-i. Ajo është një gjendje e rëndë. Poetin e ka mbytur mërzia e trishtimi; shpresat i janë plagosur shpirti i lëngon dhe ankthi i ekzistencës ka ngritur mbretërinë në të. Mjetet stilistike që i japin këtë gjendje janë: metaforat (folje); shpresa përpëlitet; shpresa qan; ankthi ngul flamurin. epitetet: truri mërzimadh/ i mposhtur (nga lëngata), krahë të mpirë/ rrjeta të kobshme/ ankthi tiranik. Të gjitha këto figura (mjete) shprehin një gjendje mërzie e trishtimi që ka lënë vragë në karakterin e poetit. Emocionet që provon ai janë negative. Ato burojnë nga fakti se poeti e ndien veten të vetmuar, të braktisur nga bota dhe bota i duket gjithnjë e më e huaj. Mërzia dhe dëshpërimi e kanë zënë për fyti poetin e nuk i shqiten më kurrë.

**Përgjigje 6:** Tri strofat e para nisin me një lidhëz kohore, por ajo lidhëz nuk të jep idenë e një kohe

të përcaktuar. Si e tillë, koha pa kufi, pa limit, është koha në përhershmeri. Papërcaktueshmëria e kohës kur “*ndodh*” fenomeni ka të bëjë me vetë natyrën apo karakteristikën e Splin-it, që është gjendje që zgjat pafundësisht.

**Përgjigje 7:** Në pamje të parë duket se shkak është natyra që është jashtë dhe pavarësisht njeriut, me këto elemente detaje:

- a) *qielli* (që peshon si saç);
- b) *toka* (që është bërë si qeli);
- c) *shiu* (hedh litarë në tokë).

Në thelb është gjendje që shkaktohet nga faktorë të brendshëm njerëzorë; i pari është vuajtja shpirtërore prej të ndjerit i braktisur, i vetmuar, pa ngrohtësi e dashuri familjare; i dyti është pesimizmi i Bodëlerit që sheh e ndien se asnjë përparim s’mund të ketë në një kohë dhe në një botë, kur e keqja është komponent përbërës i genit njerëzor. Ilustrimi: *tokën e sheh si burg, shiu (rrëketë) i ngjan me hekurat e qelisë, shpresën të thyer, truri mërzimadh, shpirti gjithë mërzë*.

**Përgjigje 8:** Efektet pamore e dëgjimore- a) *pamore*: qiell plot re, ditë të zymta pa diell, tavani me myk e lagështi, shiu, hekurat, qelia, burgu, merimangat, korbat, flamuri. b) *dëgjimore*: zhurma e shiut, piskama e këmbanave, krka-krka e korbave, përplasja dhe përpëlitja e krahëve të lakuriqëve të natës në muret e qelisë dhe kujën (e shpirtrave) qan-vaji (i shpresës).

Imazhi- përfytyrimi që shkakton është ai i një dite që nxin si nata, nën tingujt funebër të këmbanave, nën krrokatjet e korbave e litarët e shiut.

**Përgjigje 9:** Dukuri abstrakte është gjendja e Splin-it, domethënë mërzia, trishtimi, ankthi- konkrete janë detaje të tilla si: a) shiu që s’pushon (ashtu si mërzia e trishtimi që janë të përhershme) b) hekurat e burgut (qelia) që kufizojnë e mohojnë lirinë, poeti tërë jetën do të ndjejë veten pa të drejta dhe “të vogël”; c) këmbanat- ndjellakeq – për perspektivën e mbyllur. Poeti konveron detajet konkrete në abstrakte.

**Përgjigje 10:** Ngjyra që sundon është e zeza. Ditë e zezë-si nata; qelia- pa dritë, pa diell, e zezë; rrjeta të kobshme = vdekjeje – e zeza; tmerri i zi/ ferr – i zi; korbat- pendësterrë/përzishëm; (flamurin) e zi. Arsyeja: është ngjyra e mërzisë, e trishtimit e ankthit.

**Përgjigje 11:** Fjala shpresë përdoret dy herë: a) *Shpresa* si lakuriq nate përpëlitet, b) e mundur *Shpresa* qan. Në të dy rastet fjala shkruhet me të madhe; në të dy rastet metaforizohet: përpëlitet dhe qan; në të dy rastet *Shpresës* i jepen cilësi konkrete, gjallesash. Kemi krahasimin e *Shpresës* me lakuriqët (analogji) dhe *Shpresa* është e mundur e thyer (raport shkak-pasojë)

**Përgjigje 12:** Është finalje e poezisë, finalja e hidhur, dramatike, e keqja ka triumfuar. Mërzia, me kthetra si të bishës e ka mbërthyer heroin. Në kështjellën e shpirtit e të mendjes valëvitet flamuri i zi – symbol i fitores së Splin-it. Nuk ka vend për ëndrra, ato janë thyer e mundur (se e keqja mbretëron). Poeti u jep tipare njerëzore koncepteve abstrakte ndjesore si *Shpresa* dhe *Ankthi*. Inversion i epitetit metaforik “*E mundur*” e veçon fjalën me theks të fuqishëm sa logjik aq emocional, pasuar kjo nga metafora “*qan*”. Ndërsa “*ankthi*” ndjenja që të mban pezull frymën dhe sundon shpirtin njerëzor duke e torturuar atë që e përjeton është “*tiranik*” – sa metaforë aq hiperbolë në kuptim. Dhe fundi bëhet më se tronditës e trishtues. Përmbysja e kuptimit të fjalës flamur, si symbol i së keqes që pllakos mbi dhe në shpirtin njerëzor, i vë vulën gjithçkaje. Flamuri- simbol fitoreje, këtu është veçse i zi, me ngjyrën e vdekjes, të natës, të burgut, të pendëve të korbit. Përdorimi i të tashmes (ngul) të foljes e bën veprimin gjithnjë të pranishëm e konkret, ndodh në çdo çast ligjërimi, mbase në përhershmeri.

**Përgjigje 13:** Në poezi Bodëleri shfaq një ndjeshmëri të lartë shqisore dhe forcë të jashtëzakonshme

imagjinative.

-me shqisën e të parit (sytë) poeti na bën të shohim një qiell që është i mbingarkuar, si para një stuhie a rrebeshi të madh; një ditë që s'ka as dritë, as qiell, as ngrohtësi të zezë e të zymtë; qelitë e lagështa të burgut me mure plot myk; qielli derdh litarë shiu; këmbanat që bëjnë muzikën e përzishme, korbata dhe duke parë, ne dëgjojmë zhurmën tmerruese të një shiu që s'është së rëni me tërsëllim, dang-dangun e këmbanave që jo vetëm të vret veshët, por të godet thellë shpirtin se ato bëjnë muzikën e vdekjes (lukuninë e merimangave që të zënë në rrjetën e tyre e dalëngadalë të asfiksojnë) dhe si për ta bërë më trishtuese pamjen, poeti sjell pranë krrokamën e korbave pendësterrë. Forca e imagjinatës së Bodëlerit është e paparë:

1. shpirtra që arratisen nga ferri;
2. qielli që peshon si saç;
3. Shpresa si lakuriq nate;
4. shiu që imiton hekurat e qelisë;
5. merimangat që e thurin rrjetën në trurin tonë;
6. kambanat i kap tmerri etj.

**Përgjigje 14:** 1. kur toka është qeli plot lagështu 2. kur shiu... hekurat e një burgu të paanë imiton.

Shpjegimi: 1. Gjendja e Splin-it, e shkaktuar nga faktorë të jashtëm e të brendshëm, e bën Bodëlerin ta shohë botën (dhe atë që ai jetonte) si një qeli të errët, të ftohtë, të mbyllur - figura është metaforë.

2. Gjendja që përjeton poeti e çon drejt përqasjes e analogjisë. Ai ndërton paralelizmin dhe vetë korrespondencat, karakteristike për simbolistët: rrëketë e shiut i përngajnë me hekurat e qelisë.

**Përgjigje 15:** Koncepti i palimpsestit shprehet në: a) mbivendosjen e imazheve; b) mundësinë e shumë interpretimeve, nga këndvështrime të ndryshme; c) atë që lidhet me kërkimet e simbolistëve mbi kombinimet e mistershme të trurit; d) nxjerrjen në sipërfaqe të gjurmëve të fiksuara në nënvetëdije.

Shpjegimi: mbivendisja e imazheve.

- Imazhi i një qelie pus në një ditë që nxin, qeli e lagësht në muret e së cilës përplasen lakuriqë nate; mure plot me pezhishka merimangash të panumërta – lukuni (si ujçër); jashtë qelisë litarët e shiut imitojnë hekurat e burgut; e në fund vjen imazhi i një ceremonie mortore, ku marrin pjesë korbata pendësterrë. Kortezi mortor lëviz nën piskamën e lemerishme që lëshojnë këmbanat e tmerruara. Ky kortezh mban e çon drejt varrit *Shpresën* e mundur (shpresa vdes e fundit dhe kur kjo ndodh, atëherë s'mbetet asgjë).